



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 28 TETOR 2021, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**

*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.10.2021 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*

2. Njoftime *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Interpelancë me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave kërkuar nga deputeti Ferdinand Xhaferraj *(neni 80 i Kushtetutës dhe neni 96 i Rregullores)*

4. Projektligji "Për Eurobondin, që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga

tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë" *(nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

5. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a.

(OSHEE), dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19" (nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e cilësuar votash për miratim: absolute)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. Projektligji "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2020" (neni 164 i Kushtetutës dhe nenet 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Projektvendimi "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe procedurën e ndjekur nga ana e organeve ekzekutive në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane në Tiranë, Elbasan dhe Fier" (neni 77 i Kushtetutës, neni 25 i Rregullores së Kuvendit, ligji nr. 8891, datë 2.05.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", votim i hapur, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60')

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

Të nderuar kolegë, hapim seancën plenare.

Sot në rendin e ditës kemi çështjet e mëposhtme:

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Fillojmë me çështjet sipas rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, urdhëroni.

**Alfred Rushaj** – Ne sapo depozitua një kërkesë në bazë të nenit 33 të Rregullores. Ka një ngjarje shumë të rëndë që është verifikuar në Krujë për shkak të ndotjes së ujit të pijshëm. Janë qindra qytetarë nga Kruja që janë detyruar të shkojnë në spital për të marrë ndihmën e shpejtë dhe, nga çfarë është verifikuar deri tani dhe është transmetuar nga burime të ndryshme, rezulton se kemi të bëjmë me një papërgjegjshmëri dhe shkelje të ligjit në furnizimin me ujë të pijshëm të qytetarëve të Krujës.

Për këtë arsye ne sapo paraqitëm kërkesën të firmosur nga 10 deputetë, sipas nenit 31 të Rregullores, dhe kërkojmë të ndryshohet rendi i ditës, pra të votohet ndryshimi i rendit të ditës, dhe të vendoset si pikë e parë diskutimi për situatën emergjente të krijuar nga ndotja e ujit të pijshëm në Bashkinë e Krujës.

Mendojmë se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka detyrim që të diskutojë për këtë ngjarje të rëndë që ka çuar në dëmtime masive, do të thosha, të shëndetit të qytetarëve në këtë bashki.

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Balla.

**Taulant Balla** – Së pari, unë dua t'u uroj shërim të plotë të gjithë atyre banorëve që, siç raportohet nga të gjitha organet shtetërore prezente në vend, rezulton të jenë të kontaminuar nga uji i pijshëm atje dhe, sigurisht, siç raportohet gjithashtu, edhe prokuroria, edhe Policia e Shtetit po bëjnë hetimet gjithëpërfshirëse për t'i shkuar deri në fund kësaj ngjarjeje.

Unë nuk e di që Kuvendi i Shqipërisë katribute të bëjë qoftë hetime penale, qoftë hetime të karakterit mjekësor. Këto do t'i bëjnë autoritetet shtetërore. Unë besoj që deri javën e ardhshme qoftë ministrja e Shëndetësisë, me të gjithë strukturën e saj, qoftë ministri i Brendshëm, me të gjithë strukturën e tij për shkak të mbulimit që i bën Policisë së Shtetit apo edhe struktura të tjera shtetërore do të jenë në

gjendje që t'i bëjnë Kuvendit të Shqipërisë një informacion të plotë.

Për sa i përket sugjerimit tim mbi kërkesën pa mbulim në Rregulloren e Kuvendit, në Kuvendin e Shqipërisë mund të kërkojmë ndryshim të rendit të ditës për një ligj për një projektvendim. Nëse doni një interpelancë urgjente, ajo duhet depozituar deri ditën e martë dhe, natyrshëm, nëse është kërkuar nga mbi 7 deputetë, ajo hyn si pikë e parë e rendit të ditës në seancën pasardhëse.

Kështu, në këtë këndvështrim, gëzoni të gjithë të drejtën, zoti Rushaj dhe grupi juaj parlamentar, që të kërkonin një interpelancë urgjente.

Ndërkohë, zonja Kryetare, unë do të propozoj, edhe si sugjerim është, që ngjarje të tilla të politizohen sa më pak dhe të ketë sa më shumë hetim dhe përgjegjësi. Natyrshëm, ajo që unë mund ta them me bindje të plotë është se nga momenti i parë të gjitha strukturat shtetërore kanë qenë prezente dhe po bëjnë detyrën e tyre sipas ligjit. Kështu që kjo është një çështje që nuk mund të hyjë në rend dite, sepse nuk ka propozim ose nuk ka një çështje të rendit të ditës, ose nuk ka një interpelancë të propozuar për këtë çështje.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Rushaj.

**Alfred Rushaj** – Zonja Kryetare, ne nuk kërkojmë as hetime penale, nuk kërkojmë asgjë tjetër veçse, në përputhje me nenin 31, pika 2, të Rregullores, kjo seancë të ndryshojë rendin e ditës dhe besoj të fillohet me diskutime për atë ngjarje që është shumë e rëndë.

Të gjitha institucionet janë të mirëpritura të bëjnë punën e tyre, duke filluar nga policia, prokuroria dhe çfarë ka tjetër, por në këtë Kuvend kemi deputetë që përfaqësojnë qytetin e Krujës. Ata mendojnë se janë të shqetësuar dhe duhet të diskutojnë për çfarë ka ndodhur, pse ka ndodhur dhe cilat janë masat që duhet të marrim që kjo gjë të mos përsëritet më.

Kështu që kërkesa jonë është e mbështetur, siç e thashë edhe një herë, në nenin 31/2 të Rregullores, ku parashikohet që 10 deputetë mund të kërkojnë ndryshimin e rendit të ditës, në qoftë se ky Kuvend e miraton me tre të pestat.

Unë ju ftoj që ta votojmë dhe deputetët që përfaqësojnë qytetarët e Krujës ta diskutojnë këtë

ngjarje, që është jashtëzakonisht shqetësuese dhe shumë e rëndë.

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Balla, fjala për ju.

**Taulant Balla** – Nuk ka akt, nuk ka asnjë projektligj, asnjë projektvendim, asnjë interpelancë, asnjë instrument parlamentar që parlamenti, sipas oreksit tuaj, të kthehet në një instrument diskutimi.

Keni një interpelancë me shumë rëndësi, të cilën ne e vlerësojmë dhe dua t'ju shpreh garancinë tonë që në çdo rast, në momentin më të parë, sipas Rregullores, interpelancat do të mbahen, të ftojme zëvendëskryeministrin dhe deputetin Xhaferraj të mbajnë interpelancën apo kush është deputeti tjetër që e ka propozuar, se Shehu është për një interpelancë tjetër.

Në këtë këndvështrim, do të theksoja që çështjet që diskuton Kuvendi nuk janë debate kafenesh, asnjëherë. Çështjet që shtrihen Kuvendi janë debate për projektligje, projektvendime apo debate të strukturuar në formën e interpelancave.

Ka një instrument tjetër Kuvendi, që është seancë pyetje-përgjigje që, nëse do ta kishit pasur në vëmendje, mund ta kishit kërkuar. Por unë do t'ju kërkoja përsëri, ju lutem, nuk duhet politizuar ajo ngjarje. Le të presim institucionet shtetërore të bëjnë detyrën e tyre dhe në seancën tjetër, atë të javës pasardhëse, mund të kërkonin një interpelancë qoftë me ministren e Shëndetësisë, qoftë me ministrin e Brendshëm, qoftë me ministren e Infrastrukturës dhe të Energjisë, nëse do ta konsideronit një çështje të problematikës që lidhet me ujësjellës-kanalizimet.

Prandaj, zonja Kryetare, nuk kemi çfarë të votojmë. Nëse duam të votojmë diçka që nuk ekziston, le ta votojmë, por besoj që nuk ka ven dhe të kthehet në praktikë që çohet kryetari i grupi apo një deputet nga opozita dhe duan të bëjnë debat për një çështje. Çështjet se për çfarë bëhet debati janë të përcaktuara nga Rregullorja. Kështu që kërkoj që propozimi im të hidhet në votë, vazhdojmë me rendin e ditës.

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Rushaj.

**Alfred Rushaj** – Unë nuk kërkoja, e përsëris, as të bëjmë hetime penale, nuk kërkoja as të nxjerrim një ligj të veçantë, por kërkoja të bëjmë diskutime.

Për çështjen e provës dhe të faktit ka qindra të sëmurë atje prej disa ditësh. Kështu që është diçka që mendoj se mjafton për të kërkuar vëmendjen tonë dhe për t'u lënë mundësi deputetëve të Krujës që të shprehin shqetësimet e tyre. Sidoqoftë, unë përsëri ju propozoj që ta hedhim në votë, ta ndryshojmë rendin e ditës dhe kjo seancë të fillojë me diskutime për këtë ngjarje që është shumë shqetësuese.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Mirë është që ne të presim përgjigjen e organeve kompetente për këtë rast. Patjetër, të gjithë si qytetarë dhe si deputetë bashkohemi me shqetësimin për njerëzit që kanë probleme shëndetësore në Krujë, por ne kemi të gjitha mundësitë, patjetër besoj është edhe në nderin tuaj për të mos bërë politikë me këto situata, por të presim dhe të kërkojmë përgjegjësitë deri në fund, në kohën dhe në momentin e duhur.

Po ashtu, unë mendoj se është koha dhe momenti i duhur që ne të vijojmë me ndryshimin e rendit të ditës, ndërkohë që kemi çështje të përcaktuara dhe për të cilat kemi rënë dakord edhe në Konferencën e Kryetarëve për të vijuar sipas programit të përcaktuar të rendit të ditës për këtë seancë plenare.

Jemi dakord të vijojmë me rendin e ditës?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është kundër?

Atëherë, vijojmë me rendin e ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 25.10.2021. Procesverbalin e keni marrë elektronikisht. Ka ndonjë deputet vërejtje?

Miratohet procesverbali.

Kalojmë te njoftimet. Ju njoftoj se nga deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është depozituar projektligji “Për një shtesë në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar””, si dhe një kërkesë për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Gjithashtu, ju njoftoj se ditën e hënë u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila vendosi sa vijon: miratimin (me mirëkuptim) të kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, miratimin (me mirëkuptim) të kalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 25 tetor-12 nëntor 2021. Të dy kalendarët i keni marrë në rrugë elektronike, gjithashtu, i keni edhe këtu, në sistemin elektronik në sallë. Deputetët në lozha

dhe në galeri kanë si gjithmonë kopjen fizike të materialeve.

Sjell në vëmendjen tuaj se shqyrtimi në parim i projektbuxhetit është caktuar për datat 15 dhe 16 nëntor, ora 10:00, kurse shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi është caktuar për datën 25 nëntor 2021, ora 10:00.

Lidhur me kohën e diskutimeve, Konferenca e Kryetarëve vendosi zhvillimin e diskutimeve sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 48 të Rregullores, sipas të cilit çdo deputet mund të diskutojë jo më shumë se 10 minuta.

Në përfundim, ju njoftoj se administrata ka shpërndarë formularin për anëtarësimin tuaj në organizimet vullnetare, konkretisht në Aleancën e Grave Deputete dhe Miqtë e Fëmijëve. Kështu që gjatë seancës, ju lutem, shprehni vullnetin tuaj se në cilin organizëm doni të kontribuoni.

Fillojmë me çështjet. Interpelancë me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Shtetit për Rindërtimin dhe programin e reformave, kërkuar nga deputeti Ferdinand Xhaferraj, lidhur me shfuqizimin e vendimit nr. 404, datë 30.06.2021, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjellbërimit", Durrës””. Interpelanca kërkohet bazuar në nenin 80 të Kushtetutës dhe nenin 96 të Rregullores së Kuvendit.

Përpara se të fillojë interpelanca, dua të sqaroj diçka lidhur me objektin e saj. Zoti Xhaferraj, ju keni thirrur në interpelancë dy ministra, ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonjën Balluku dhe zëvendëskryeministrin e ministrin e Shtetit për Rindërtim dhe programet e reformave, zotën Ahmetaj. Në fakt, objekti i interpelancës, pra shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, është një çështje që përfshihet vetëm në fushën e përgjegjësisë së zotit Ahmetaj. Unë kam këtu dy vendimet e Këshillit të Ministrave, ku propozues tek të dyja vendimet rezultoi zoti Ahmetaj.

Nëse kërkon interpelancë për gjendjen në të cilën ndodhen këto rrugë, mund të depozitoni një tjetër interpelancë dhe ministria do t'ju përgjigjet në respektim të detyrimit kushtetues që ka një anëtar i Këshillit të Ministrave.

Atëherë, fillojmë duke respektuar minutazhin e përcaktuar në nenin 96 të Rregullores.

Zoti Xhaferraj, keni të drejtën për të parashtruar interpelancën, koha deri në 7 minuta.

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

I nderuar zoti Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin,

Të dashur qytetarë,

Para se të filloj me shpjegimin e objektit të interpelancës, do të doja t'i thosha zonjës Kryetare që, në frymën e Kushtetutës dhe të ligjit, ju dhe qeveria nuk keni të drejtë të përzgjedhin se kush duhet të jetë ministri që mendon të ftojë deputeti.

Është e vërtetë që çështja lidhet si me VKM-në që ngarkon se kush duhet t'i bëjë rrugët edhe me VKM-në që e shfuqizon vendimin e parë vetëm me zëvendëskryeministrin, por kërkesa për interpelancë dhe objekt imi ka qenë që të zgjidhet problemi. Duke qenë se është një problem me infrastrukturën dhe duke qenë se zëvendëskryeministri për Rindërtimin i ka larë duart dhe ka thënë që rrugët nuk do të bëhen, për këtë arsye unë kisha menduar të jetë edhe ministrja e Infrastrukturës. Pra, kam dashur të di se si do të zgjidhet problemi. Dhe ç'është më kryesorja, e theksoj edhe një herë, është deputeti që përcakton nëse duhet të vijë Kryeministri, duhet të vijë ministri dhe nuk u lëmë dorë qeverisë apo juve që të përcaktoni e të gjykoni për të projektuar një vendimmarrje.

Gjithsesi, i nderuar zoti Ahmetaj, me vendimin nr. 404 të datës 30.06.2021, Këshilli i Ministrave ka vendosur të përdorë një fond për rindërtimin në masën 1,4 miliardë lekë pa TVSH për të financuar rikonstruksionin e rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjelbërimi", të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, njësi administrative, Bashkia Durrës. Këto rrugë shërbejnë si rrugë kryesore, nuk i shërbejnë vetëm asaj zone, por në projekt është për t'i shërbyer të gjithë qytetit me aksin kryesor të rrugës "Azem Hajdari".

Një muaj më pas, më 30 korrik, pa dhënë asnjë arsye apo sqarim publik, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 480, datë 30.07.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 404 të Këshillit të Ministrave për përdorimin e këtyre fondeve për këto rrugë.

Në kushtet e mungesës së plotë të transparencës për këtë vendimmarrje, në cilësinë e deputetit të qarkut të Durrësit dhe, bazuar në

nenin 96, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 80, pika 1, të Kushtetutës, kam kërkuar zhvillimin e kësaj interpelance, pra thashë, me zëvendëskryeministrin dhe me ministren Balluku, për të parë mundësinë se si do të zgjidhej ky problem.

Kjo është me sa kam parashtruar. Këtu ke të dyja vendimet e Këshillit të Ministrave, njëri që e jep dhe ju ngarkon ju që të bëni rrugët, dhe tjetri që e zhbën dhe ju ngarkon përsëri ju që ta zhbëni vendimin.

Do t'ju lutesha për sqarime, gjithmonë me interesin madhor, se si do të zgjidhet ky problem për banorët e asaj zone.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Ahmetaj, keni fjalën. Mund të jepni shpjegimet tuaja, koha në dispozicion deri në 20 minuta.

**Arben Ahmetaj** – I nderuar deputet,

Të falënderoj për thirrjen në interpelancë dhe e vlerësoj thellësisht shqetësimin tuaj si deputet i qarkut të Durrës dhe si qytetar!

Në lidhje me shfuqizimin e vendimit të datës 30.06.2021, pra është vendimi nr. 404 "Për rikonstruksionin e rrugëve "Miqësia" dhe "Azem Hajdari - Gjelbërimi", dua t'ju sqaroj zyrtarisht si më poshtë.

Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, i cituar nga ju në kërkesë, vjen si rezultat i harmonizimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave me memorandumun e mirëkuptimit të lidhur me Fondin e Abu Dabit për Zhvillim, i cili është një donacion i qeverisë së Emirateve të Bashkuara në kuadër të përballimit të pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor dhe konsiston në ndërtimin e 2 mijë apartamenteve, ku vetëm në zonën e re për zhvillim (pra zona 4, së cilës i referohemi si Spitalë) do të ndërtohen rreth 996 apartamente.

Siç besoj se tashmë jeni në dijeni, zona e re për zhvillim, së cilës i referohemi Spitalë, së bashku me koordinatat dhe hartën e zonës, janë shpallur me anë të vendimit nr. 164, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Durrës, Bashkia Durrës" dhe caktimi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese. Vendimi është harmonizuar edhe me memorandumun e mirëkuptimit, siç iu referova më sipër, të lidhur midis qeverisë shqiptare dhe Fondit të Abu Dabit për Zhvillim. Siç ju thashë,

praktikisht, njësi zbatuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Arsyeja e drejtpërdrejtë e ndryshimit është për të futur të dyja rrugët brenda një PDV-je (plani të detyruar vendor) më të gjerë, në mënyrë që rrugët të funksionojnë më mirë për qytetarët dhe, siç e thatë ju, me të drejtë, në diskutimin që kemi pasur edhe me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, të dyja rrugët nuk janë thjesht për përdorim të zonës, por praktikisht janë lidhëse, kyçe, kritike për të lidhur zonën e Spitalës me qytetin. Domethënë, jemi përpara faktit që të gjitha rrugët lidhëse, të cilat janë brenda konturit dhe koordinatave, ku përfshihet edhe infrastruktura kritike ndihmëse, pra rrugët e sipërpërmendura “Miqësia” dhe “Azem Hajdari – Gjelbërimi”, do të ndërtohen dhe do të rikonstruktohen nga njësi zbatuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit me financimin...

Zoti Xhaferraj, dua që, në respekt të kërkesës suaj, ta theksoj këtë fakt: është alokuar fondi nga buxheti i shtetit, me anë të VKM-së nr. 307, datë 16.04.2020, e ndryshuar. Aktualisht ka përfunduar hartimi i projektit të zbatimit dhe për pak ditë, më njofton Fondi Shqiptar i Zhvillimit, do të lidhet kontrata e zbatimit të punimeve për rrugën “Miqësia” dhe deri në fund të nëntorit për rrugën “Azem Hajdari”. Ju informojmë se fondi i alokuar për vitin 2020-2021 për ndërtim dhe rikonstruksion të infrastrukturës publike është në masën 1,8 miliardë për të dyja dhe vetëm për këtë vit janë akorduar 1,2 miliardë.

Pra, për t’ju dhënë një përgjigje shumë të drejtpërdrejtë dhe zyrtare, të dyja rrugët janë brenda buxhetit, pra fondit të rindërtimit, programit të rindërtimit, janë të financuara, do të bëhen. Njëra ka përfunduar edhe si procedurë, pra deri në fund të nëntorit, kurse tjetra përfundon në fund të dhjetorit.

Ju falënderoj realisht për shqetësimin!

Fatmirësisht, edhe për shkak të vëmendjes ndaj Durrësit, edhe për shkak të vëmendjes ndaj qytetarëve dhe familjeve të dëmtuara nga tërmeti, edhe për korrektesë të qeverisë së Emirateve të Bashkuara dhe Fondit të Abu Dabit, praktikisht jemi në situatë të avancuar.

Ajo që ju ka shqetësuar, realisht, ndoshta më mirëkuptoni që përdor fjalët “jeni ngatërruar”, ne kemi ndryshuar PDV-në, pra kemi përfshirë edhe rrugët në PDV, nuk kemi hequr financimin. Por, gjithsesi, do të desha që

t’ju sqaroja në detaje për këtë. Ndërkohë, harta është e botuar në Fletoren Zyrtare, mund ta shikoni dhe ndoshta për të verifikuar fjalët që unë them zyrtarisht përpara jush tani në parlament mund edhe të shikoni procedurën brenda Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Unë sot sapo ju deklarova zyrtarisht që fondi është 1,2 miliardë lekë.

Shpejtësia e punimeve

Mua më rezulton që Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një nga njësitë më produktive të qeverisë shqiptare, në shpejtësi dhe në cilësi. Sidoqoftë, ne këtu jemi dhe unë jam në dispozicionin tuaj dhe të çdo deputeti apo të çdo qytetari që ta informoj.

Ndërkohë, dua të më mirëkuptoni, me këtë rast po ju jap edhe një informacion më të gjerë edhe juve, edhe qytetarëve, për sa i përket rindërtimit. Sot janë 15 mijë familje që trajtohen me bonus qiraje. Deri sot janë dhënë rreth 50 milionë dollarë, 5 miliardë lekë për bonusin e qirave.

Përfituesit nga programi i rindërtimit sot janë rreth 49 mijë veta. Janë alokuar nga buxheti i shtetit 2020-2021 53,5 miliardë lekë, që do të thotë janë rreth 530 milionë dollarë, nga ku 28 miliardë lekë janë në vitin 2020 dhe 25,5 miliardë janë në vitin 2021, pra në vitin korrent.

Grante rindërtimi dhe rikonstruksioni janë 15,1 miliardë lekë. Për grante rikonstruksioni janë alokuar 12,2 miliardë lekë, pra 122 milionë dollarë, dhe vazhdon si proces për shkak të vlerësimit gradual që bëjnë njësitë vendore në bazë të aktit normativ nr. 9. Vetëm nga grantet e rikonstruksionit janë përfitues 37 797 qytetarë; janë disbursuar deri tani 9,3 miliardë lekë, pra rreth 93 milionë dollarë, 33502 janë përfitues.

Për sa u përket granteve të rindërtimit, që është një nënprogram tjetër brenda programit, janë alokuar 2,9 miliardë lekë për 1342 përfitues. Janë disbursuar deri tani 1,6 miliardë lekë për 876 përfitues.

Për sa i përket rindërtimit të banesave individuale dhe kolektive, nga njësi zbatuese, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë 1442 banesa individuale në proces, 663 të përfunduara, 779 përfundohen deri në fund të këtij viti.

Njësi zbatuese, Bashkia e Tiranës, ka 712 në total, nga të cilat 390 të përfunduara, 11 në fillim të nëntorit dhe 311 mbarohen deri në fund të nëntorit.

Për banesat kolektive, pra u referohem pallateve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka 34 kontrata me 181 pallate. Ka filluar puna për ndërtimin e 113 pallateve, ndërkohë që në Bashkinë e Tiranës, që është një njësi tjetër zbatuese, kemi 30 banesa kolektive në zonat e reja “5 maji” dhe “Kombinat” dhe ecuria e punimeve, në raport me atë që kanë parashikuar brenda këtij viti është 50%. Ndërkohë, ka filluar zbatimin i punimeve për rihforcimin e banesave kolektive, pra e pallateve DS4.

Për sa u përket objekteve arsimore, që është një nënprogram tjetër brenda programit të rindërtimit, janë 167 objekte arsimore, nga të cilat 60 kanë përfunduar, 36 i ka përfunduar Fondi Shqiptar i Zhvillimit, 15 i ka përfunduar UNDP-ja, që janë brenda donacionit të Komisionit Europian prej 115 milionë euro në total, të ndara në 75 milionë për objektet arsimore dhe 9 nga Bashkia e Tiranës, se pa dashje e kalova atë linjë. Pra, 91 shkolla janë me financim nga buxheti i shtetit, 69 nga donatorët dhe 7 të tjera janë në proces financimi për shkak të vlerësimeve të mëvonshme.

Për nënprogramin tjetër “infrastruktura publike” janë 25 kantiere të hapura, 14 i ka Fondi Shqiptar i Zhvillimit, 11 i ka Bashkia e Tiranës, plus 8 kantiere të tjera të cilat pritet të fillojnë në zonën e re për zhvillim në Kombinat.

Do të dorëzohen brenda 26 nëntorit rreth 700 apartamente. Bashkitë deri në fund të javës miratojnë në këshillat bashkiakë rregulloren e hedhjes së shortit publik. Çfarë është shorti publik? Për sqarim për familjet, po edhe për ju, të nderuar deputetë: praktikisht mënyra se si do të veprohet për ndarjen e apartamenteve, për të qenë sa më transparentë, me vendim të Këshillit të Ministrave janë urdhëruar bashkitë që të bëjnë short publik, madje edhe me prezencë të medieve, patjetër, të qytetarëve. Pasi të hiqet lista prioritare, që janë familje me ndihmë ekonomike, nëna kryefamiljare apo familje me anëtarë me probleme shëndetësore të verifikuara nga, le të themi, KEMPI, apo ndoshta familje të policëve të vvarë, këta janë prioritarë, këto familje marrin menjëherë apartamentet. Pas kësaj liste, hidhet shorti për familjet e tjera.

Siç e theksova, shorti do të jetë publik.

Për ta shpjeguar, për të bërë një ushtrim fare të thjeshtë në parlament përpara qytetarëve kryesisht, po edhe në funksion të informacionit

për ju, në qoftë se kemi 100 familje që marrin, në bazë të vlerësimit dhe të kurorave apo frymëve në familje, apartament “1+1” dhe 100 të tjera “1+2” dhe 100 të tjera “1+3”, sigurisht që një pjesë e “1+1” janë në katin e parë, një pjesë janë në katin e dytë, një pjesë janë në katin e tretë.

Një pyetje fare normale do të ishte: “Po si i ndan ti, kë çon ti në kat të parë, kë çon ti në kat të dytë, kë çon ti në kat të tretë?” Për të mos ua lënë autoriteteve, se, gjithsesi, do të duhet të bëjmë një ndarje transparente, atëherë shortohen të gjitha familjet që janë në “1+1”, hidhet shorti transparent në sytë e publikut, në sytë e familjeve, sigurisht që autoriteti ose edhe vetë familja, por autoriteti në rastin konkret trazon të gjithë pjesën e numrave, të cilët janë të palosur, të fshehur, nxirret numri dhe fillimisht flitet emri i familjes (pra, futet dora në shortim, nxirret numri). Aty ke edhe noterin, i cili bën aktin noterial që familja ta gëzojë përjetë shtëpinë falas. E gjitha kjo është bërë për transparencë, po edhe për të hequr ndonjë keqkuptim në terren, ku familjet mund të ngelen pa dashje të pakënaqura dhe të thonë: pse më dha mua kryetari i bashkisë katin e parë dhe nuk më dha katin e dytë? Ia kemi hequr të drejtën autoritetit dhe e kemi bërë me short për transparencë.

Hedhja e shortit në Bashkinë e Krujës bëhet në datën 10 deri në 12, në Bashkinë e Durrësit bëhet në datën 15, në Bashkinë e Lezhës bëhet po në datën 15.

Pra, për ta mbyllur fjalën time, realisht ju falënderoj që më thirrët në interpelancë. E vlerësoj shumë shqetësimin tuaj për punët e rindërtimit në zonën ku ju jeni deputet dhe dua t’ju garantoj që ato rrugë janë të financuara dhe do të mbarojnë sipas planit që ka hartuar njësia zbatuese.

Mbetem në dispozicionin tuaj në çdo moment qoftë për pyetje drejtpërsëdrejti këtu në sallë, qoftë jashtë salle, kudo qoftë, që t’ju kthej përgjigje realisht në çdo moment që ju do të doni informacion më tepër.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Xhaferraj, në mbështetje të nenit 96, pika 5, të Rregullores, mund të shprehni lidhur me përgjigjen e zotit Ahmetaj. Koha deri në 15 minuta.

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

I nderuar zoti Zëvendëskryeministër, ju falënderoj për etikën e përdorur!

Ju falënderoj për përgjigjen që dhatë lidhur me rrugët, por doja t'ju thosha: po me tërmetin ç'patët?! E vetmja vlerë madhore e kësaj interpelance, jashtë rrugëve, është që po u krijoni bindjen qytetarëve shqiptarë se ju duhet të lejoheni të flisni, sepse po vetëdemaskoni edhe demagogjinë në 3D.

Çfarë më thoni për tërmetin? Flisni në fund të tetorit të 2021-shit për tërmetin, kur Kryeministri juaj, zoti Rama, shikoni çfarë thotë këtu.

(Shfaq videoja.)

“Brenda qershorit të 2021-shit kemi mbaruar punë me tërmetin.”, - thotë Kryeministri më 14 dhjetor me zë dhe me figurë.

Në fund të tetorit të 2021-shit, qytetarët e Durrësit dhe të të gjitha qyteteve të dëmtuara nga tërmeti ende kanë nga 2 muaj pa marrë bonusin e qirave, ndërkohë ju dje dolët e krekoseshit, sepse në datat 20 deri më 26 nëntor do të trajtoni 1000 prioritetet e para. E kupton ku jeni me tërmetin?!

Po le të kthehem një herë te problemi i rrugëve, pastaj do të filloj të çmontoj gradualisht edhe për tërmetin.

Ju thatë që rrugët do të zgjidhen dhe sinqerisht ju falënderoj që keni gjetur mundësinë për të zgjidhur atë projekt shumë të rëndësishëm për zonën, por problemi është shumë më i rëndë dhe shumë më i thellë sesa e paraqitët ju. Pse? Në dhjetor të vitit 2020, dy shoqata “Konsumatori shqiptar” dhe “Durrësi aktiv” i janë drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se kishin vite që kërkonin bërjen e atyre rrugëve dhe qeveria jo vetëm i neglizhonte, por zyrtarë dhe drejtues të administratës, më vjen keq ta them, i trajtonin me epitelin “çeçen”; një turp i paparë! Dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e ka gjetur me vend ankesën e tyre dhe me dy shkresa zyrtare (është komisioneri që i drejtohet bashkisë). E para shkresë zyrtare daton në janar të vitit 2021, e dyta shkurtin e vitit 2021 dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk merr përgjigje nga bashkia!

Kur arrini të diskriminoni Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, imagjinoni se çfarë u bëni qytetarëve! Dhe kjo e ka detyruar komisionerin që në mars të gjobisë bashkinë.

Gjosit komisioneri bashkinë, sepse nuk jep informacion!

Të dashur kolegë, të së majtës dhe të së djathtës, e kuptoni ku jemi?! Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkon informacion dhe nuk e merr. Çfarë ndodh me qytetarin që ka hall dhe kërkon të zgjidhë një problem? Pse? Sepse e ka mbushur administratën me halabakë (dhe unë kurrë nuk përdor terma të tillë, ia kam marrë borxh Kryeministrit, i cili shkarkon drejtorin e hipotekës *live*, si halabak dhe shkon e emëron drejtor muaj më mbrapa në Bashkinë e Durrësit)! E ky është një problem shumë i rëndë. Pse? Kjo tregon se i vetmi zë që dëgjon qeveria juaj, është zëri i ryshfetit; diskriminohet edhe komisioneri.

I vetmi zë që dëgjoni ju, është zëri i oligarkëve. Ai fond është tërhequr nga bërja e rrugëve, sepse ju në shtator të vitit 2021 keni dhënë 1,9 miliardë lekë për atë që ju e quani projekti për infrastrukturën e zonës Porto Romano – Spitalle, por në të vërtetë është spostimi i hidrovorit. Kjo është afëra më e rëndë, pra spostimi i hidrovorit për llogari të portit të Durrësit!

Për t'iu kthyer tani problemeve të tërmetit, për çfarë zgjidhje të problematikës së tërmetit flisni ju?! E para një herë, mbani një përgjegjësi shumë të rëndë dhe SPAK-u duhet ta hetojë, jo se nuk keni nxjerrë përgjegjësinë se kush i shkaktoi 50 viktimat nga tërmeti, por e keni fshehur përgjegjësinë.

Puna e parë që bëtë një ditë pas tërmetit, ishte që rrafshuat sheshet, që të humbnit gjurmët. Puna e dytë që bëtë, e morët drejtorin e legalizimeve, që ishte i pandehur, kur ishte ende i ndjekur nga prokuroria dhe e emëruat drejtor në bashki. Pse? Kodi i mafies. Hesht, pa dalë përgjegjësia. Në Durrës nuk ka vrarë tërmeti, ka vrarë masakra urbane. Ato pallate që ishin ndërtuar sipas kushteve teknike rezistuan dhe viktimat i shkaktoi masakra urbane. Për çfarë flisni ju, për tërmetin? Për shkollën “Njazim Mastori” në Sukth, 2,5 miliardë lekë pa TVSH, që rridhte pasi e inauguroi Kryeministri Rama? Për çfarë flisni ju për tërmetin? Për shkollën “Shaqe Mazreku” që në korrik të vitit 2020 e vizitonte Kryeministri dhe ishte pa leje ndërtimi, punohej pa leje ndërtimi? Për çfarë flisni ju, për tërmetin, kur rrafshuat 30 sheshe dhe brenda vitit 2020 filloi ndërtimi vetëm aty ku banonte



zëvendësministrja e Brendshme dhe ku banonte drejtori i bashkisë?

Kjo është historia juaj me tërmetin: një turp i paparë! Tërmeti ekspozoi vetëm një gjë, shtoi diçka tjetër për qeverinë tuaj, që ju jeni të gatshëm të përfitonit. Pra, babëzia ju çon deri aty, sa të përfitonit edhe nga fatkeqësia.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Ahmetaj, nëse doni të shpreheni përsëri, keni në dispozicion edhe 3 minuta kohë.

**Arben Ahmetaj** – I nderuar deputet, pavarësisht mënyrës sesi shpreheni, unë sërish e vlerësoj thellësisht.

Iu referuat intervistës së Kryeministrit, midis asaj interviste, me të drejtë, edhe të gjithë objektivat, ka ndodhur një gjëmë që shpresoj që ju ta keni kaluar pa u cenuar, COVID-19, që po vazhdon gjatë vitit 2021 dhe parashikimet thonë se do të vazhdojë edhe në vitin 2022. Kjo do të thotë, që me gjithë pandeminë e rëndë, ne jemi në një shpejtësi realisht të pakrahasuar me asnjë projekt publik tjetër dhe, po deshe, në referencë të transparencës, por edhe të produktivitetit të institucioneve që punojnë për rindërtimin; mund ta krahasoni edhe me shumë vende të tjera që u ka ndodhur gjëma dhe u ka shkuar rindërtimi edhe 10 vjet.

Iu referuat shkollave, por shkollat janë krenaria jo thjesht e qeverisë, por e qytetarëve, e familjeve, e prindërve. Me shumë dëshirë, me shumë dashuri, ju ftoj edhe pa asnjë cinizëm, se nganjëherë, kur bëjmë ndonjë gjë të sigurtë, duket sikur jemi cinikë, zoti Xhaferraj, të vini me mua, po në mos me mua, me këdo që ju ndiheni rehat dhe të vizitohet shkollat, t'i shikoni sesi edhe ju do të krenoheni. Sigurisht, nuk do ta ma thoni, jam i bindur, as publikisht nuk do ta thoni, por jam i bindur që do të ndiheni shumë mirë. Do të ndiheni shumë mirë.

Të shikoni pallatet jam i bindur që do të ndiheni shumë mirë për familjet, se në finale jeni zgjedhur deputet, si një njeri i përgjegjshëm për qytetarët, pavarësisht, se në raport me maxhorancën, ju morët shumë herë më pak vota nga sa duheshin për t'ju dhënë përgjegjësinë, se përgjegjësinë na e dhanë sërish neve, për përgjegjshmërinë, por ky nuk është debati që kemi sot. Pra, unë të ftoj t'i prekim *site*-t, po deshe, një nga një, do të ndihesh krenar. Nuk të kërkoj të ma thuash, nuk të kërkoj që ta thuash

publikisht, por jam i bindur që do të kënaqesh dhe do të jesh i lumtur brenda vetes, për familjet e Durrësit, për ato familje që do të hyjnë në shtëpi për shkak të granteve DS3, për ato familje që kanë marrë grante DS4 dhe DS3 në dy vjet rresht dhe do të vazhdojnë të marrin deri ditën e fundit edhe familja e fundit.

Besoj se në shtator të vitit tjetër do të kemi mbaruar. Shpresojmë që pandemia të mos na e frenojë procesin e akseleruar, të përshpejtuar të rritjes ekonomike, që do të shkojë gati 9% këtë vit, por edhe të rindërtimit brenda gjithë proceseve të investimeve publike.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Xhaferraj, në mbështetje të nenit 96 të Rregullores, keni në dispozicion edhe 3 minuta kohë për t'u shprehur.

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

I nderuar zoti Kryeministër, se e shoh që paskeni ardhur,

Zoti Zëvendëskryeministër, unë me shumë dëshirë, në qoftë se është një investim që shkon në dobi të komunitetit, do të ndihesha krenar dhe jo ashtu sikurse thoni ju, që e bëri kjo qeveri apo ajo qeveri; do të isha krenar t'ju njihja atë meritë edhe juve. Ne shkollat shkojmë i vizitohet bashkë, por mos harroni që shkollat duhet t'i vizitohet edhe SPAK-u. Keni pasur për të ndërtuar 13 shkolla në bilancin e parë të tërmetit dhe i çuat në 29, nga makutëria, babëzia për të përfutur edhe nga fatkeqësia. Kur do ta vizitohet shkollën "Naim Frashëri"? Do të vizitohet shkollën, apo ndonjë kompleks pallatesh që keni ndër mend të bëni aty? Do të jemi krenarë që të shkojmë ta vizitohet shkollën "Naim Frashëri". Kështu që, unë e them dhe e rithem: tërmeti ju vuri një etiketë plus, ju shpalli të aftë, të babëzitur për të përfutur edhe nga fatkeqësia,

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për Kryeministrin.

**Edi Rama** – U ndjeva i detyruar të ndërhyj këtu, sepse, realisht, çdo njeri ka të drejtën të gabojë; të gabosh është njerëzore, të këmbëngulësh në gabim është djallëzore. Ngritët me furi një uturimë shpifjesh edhe akuzash, si dhe bëtë edhe një gjest digjital këtu. Me siguri ju keni qenë i zënë me pasionin tuaj për të përmirësuar cilësinë e diellit dhe nuk e keni vënë re që, ndërkohë mes angazhimeve tona për të

adresuar pasojat e tërmetit dhe afateve të vendosura, ka ndodhur diçka që ka tronditur gjithë botën, zoti Xhaferraj, pandemia. Ju kujtoj që kanë qenë muaj të tërë, kur kantieret kanë qenë të bllokuara, kështu që detyrimisht edhe afatet do të shtyeshin. Por ajo që më shqetëson më shumë nuk është ky aspekt, është aspekti tjetër: mbi ç'bazë ju i ngrini gjitha këto akuza dhe flisni për babëzi e për makutëri? Mbi ç'bazë? Keni ndonjë shifër? Keni ndonjë fakt? Mbi ç'bazë? Shkollat kanë standarde. Shkollat kanë kriteret. Shkollat kanë preventiva. Shkollat janë zhvilluar si proces ndërtimi me gara. Garat kanë dosje dhe, mbi të gjitha, për këto fakte mund të bëhen edhe qëmtime, edhe hulumtime, edhe investigime, pastaj mund të nxirren konkluzione profesionale. Jo si mjek popullor dhe jo si akrobat popullor cirku, se është shumë e shëmtuar, me thënë të drejtën, që e gjithë kjo përpjekje të përballet në këtë farë feje, pa asnjë bazë.

Ndërkohë, siç ju tha edhe zëvendëskryeministri, shkollat janë aty, krah për krah me shkollat që keni ndërtuar ju dhe kontrasti është i njëjtë si kontrasti mes të sotmes dhe Mesjetës, të them të drejtën, kur vjen puna në të gjitha standardet, kur vjen puna në të gjitha kushtet, në të gjitha hapësirat që ofrojnë shkollat sot dhe që ofronin deri dje.

Natyrisht, në këtë aspekt nuk matemi me ju, se nuk mund të matet cilësia e diellit me errësirën, por pa diskutim me shumë vëmendje do ta mirëprisnim çdo lloj fakti dhe argumenti, jo dokrra dhe të shara prej të dehuri në klub, por fakte dhe argumente. Zotëria jote, thua që na qenkan fshirë sheshet për të fshehur gjurmët! Cilat gjurmë?

*(Deputeti Ferdinand Xhaferraj flet nga salla pa mikrofon.)*

Godinat?

Unë nuk emëroj drejtorë. Mos më ndërprit, se të dëgjova me shumë vëmendje.

Unë nuk emëroj drejtorë.

Cilat godina? Të gjithë godinat e prishura kanë historikun e tyre dhe historiku i tyre është vlerësuar nga organet kompetente, nuk ka qenë fare e nevojshme që të mbahen gërmadhat aty me muaj dhe me vite, por ndryshimi mes nesh dhe jush është se juve ju janë imunizuar sytë prej shumë vitesh nga plehrat, nga shëmtia, nga deformimi, se ndryshe nuk do të ishit krenarë pa

kthim për gjithë masakrën urbane që keni lejuar dhe keni promovuar si mrekulli të 8-të botës në Shqipëri. Nuk do të ishit krenarë, se në kohën kur ju qeverisnit, duhet të dilje me duar në hundë për të mos marrë erë dhe me duart në sy për të mos parë. Kjo është karakteristikë e qeverisjes suaj historikisht dhe këtu nuk kemi se çfarë të diskutojmë, sepse kemi një konflikt estetik. Kemi një konflikt në raport me atë që është edhe dallimi më i madh mes civilizimesh, mes qytetërimesh, mes epokash, kështu që këtu është e kotë të flasim. Për ju janë të panevojshme, janë të tepërta, janë kot këto për të cilat flasim ne dhe për të cilat investohemi ne.

Megjithatë, që ta mbyll, unë po ju them se numri i familjeve, që sot gëzojnë shtëpinë, është i madh dhe do të rritet eksponencialisht në javët e fundit të këtij muaji dhe ju ftoj personalisht, zoti Xhaferraj, që të na bashkoheni në hapjen e dyerve të shtëpive, të apartamenteve për mijëra familje, deri në datën 26 nëntor, kur bëhen edhe 2 vjet nga tërmeti. Ju do shikoni me sytë tuaj sesi në Ishëm, për shembull...

Është në Durrës, apo jo? Në Ishëm, por jo shumë larg Durrësit është edhe Thumana, është edhe Fushë Kruja, është edhe Laçi, është edhe Bubqi. Po të mos përtoni, ju mund të vini me ne edhe në Lezhë. Tiranën ja ku e kemi, shkojmë bashkë te "5 Maji", këtu afër dhe t'i shikoni me sytë tuaj, se ka shumë gjëra për të cilat mund të flisni, ka shumë gjëra për të cilat mund të kritikoni, ka shumë gjëra për të cilat mund të ngrini pretendime, por për çështjen e tërmetit mendoj t'i rrini larg shumë. T'i rrini larg shumë, se bëheni shumë qesharakë, kur flisni për një nga ndërmarrjet më të mëdha, që do të mbeten në histori, zoti Xhaferraj. Po të them se sot e gjithë ditën në Italinë fqinje, që është vendi i G7-s, njerëzit janë ende në rulotë mbas 15-vjetësh, mbas 12-vjetësh, mbas 9-vjetësh pas tërmeteve, ndërkohë që këtu, jo se ne jemi më të zotët, por sepse ne nuk kemi luksin t'i lëmë njerëzit të presin, të gjithë, pa përjashtim do të marrin atë që u takon.

Dhe me një ndryshim të vetëm nga ajo intervista, a çfarë ishte, që nxorët ju këtu, duke bërë një prezantim që afatet spostohen si rezultat i pandemisë që hyri në mes, i bllokimit të kantierëve, që ishin të detyruar, nuk është se i imponuam ne, si rezultat i domosdoshmërisë për të garantuar cilësinë maksimale për njerëzit.

Asnjë familje, zoti Xhaferraj, që është kthyer apo do të kthehet në shtëpi, dhe këtë e dëshmojnë vetë ata, ju mund të shkoni vetë t'i takoni edhe pa ne, nuk është sot dhe nuk do të jetë nesër në shtëpinë e re më keq, por do të jetë shumë më mirë se para tërmetit. E gjithë ajo krizë e madhe është kthyer në një mundësi të madhe dhe në një perspektivë të re për të gjitha familjet. Në të gjitha pikat, ku ka goditur tërmeti, do të jetojnë jo vetëm në shtëpi më të mira, më të sigurta, as nuk diskutohet, por do të jetojnë edhe në hapësira, edhe në komunitete që deri dje nuk i kishin, për shkak të një mijë e një arsyeve.

Kështu që, duke ju lënë si këshillë që të shkoni edhe në Shijak, të shkoni edhe në Kavajë, se i harrova më përpara, afër i keni. Natyrisht, po të keni nevojë për ne, vijmë, nuk diskutohet. Ju lajmërojmë që të vini edhe me ne, të na i thoni në sy, aty, kur të shkojmë t'i shikojmë, te na thoni. Hajde bashkë me preventivët, bashkë me gjitha argumentet dhe shkojmë t'i shikojmë. Edhe te shkollat ku shkoj unë që sipas jush na u mbushkan me ujë, të gjitha bashkë të shkojmë t'i shikojmë bashkë, hajdeni të shkojmë atje dhe t'i ballafaqojmë atje, por në prani të ekspertëve, jo unë dhe ju, se nuk jemi as unë, as ju ekspertë gjatë kësaj pune.

Ndryshimi mes nesh është ky: atë që shoh unë, ju nuk e shihni. Kaq

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Këtu përfundon zhvillimi i interpelancës së kërkuar.

Kërkoni të merrni fjalën, zoti Basha?

**Lulzim Basha** – Sa për sqarim, zonja Nikolla, rregullat zbatohen pa asnjë përjashtim, kështu që pa diskutim do ta marrë fjalën pas parafolësit. Sikundër edhe kërkuesit të interpelancës i lind e drejta për replikë, edhe opozita nuk ka ndër mend të dorëzojë asnjë nga këto dy të drejta në këtë foltore.

Se çfarë katastrofe ka qenë keqadministrimi dhe korrupsioni me të ashtuquajturin “rindërtim”, por edhe me pandeminë, këtë shqiptarët e njohin në lëkurën e tyre. Pavarësisht se janë harxhuar më shumë para dhe kohë televizive për gënjeshtër, për reklamë, për propagandë, prapë se prapë disa fakte nuk shlyhen dot, sepse janë aty në mëngjes, njerëzit çohen ende në çadrat apo në banesat e të afërmyve ku jetojnë prej 2 vjetësh, apo në banesa me qira që nuk financohen nga bonusi i premtuar, janë

ende larg pallateve të rrafshuara në Kombinat, ku ndërkohë zona që do të shpronësohej për të ndërtuar pallatin, ende nuk është shpronësuar, por, sigurisht, hajdutët e fatkeqësisë kanë bërë gati planin që aty ku rrafshuan pallatet të ndërtojnë projektin e radhës për të pastruar paratë që zyrtarët e lartë të kësaj qeverie dhe të këtij regjimi u kanë zhvatur shqiptarëve, sigurisht në bashkëpunimin e përhershëm me bankën tjetër më të madhe të këtij regjimi, që janë paratë e drogës dhe të kriminelëve, me të cilët ka ardhur dhe mban pushtetin përdhunshëm.

Kështu që, në qoftë se ka diçka për të mbajtur duart në hundë, është era e kërmës që qelb këtë sallë, e regjimit të instaluar duke blerë vota, duke shkruar në një shtetin me partinë dhe të parin e këtij regjimi, që krekoset mbi këtë pleh, që s'ka lidhje as me demokracinë, as me shtetin e së drejtës, as me aspiratat e shqiptarëve për një jetë më të mirë, as me aspiratën kombëtare për të udhëtuar drejt destinacionit tonë europian, nuk ka lidhje me pandeminë, por ka lidhje vetëm me babëzinë për pushtet, babëzinë për para, që ju ka zënë sytë. Kjo babëzi nuk ju pengoi, ndërkohë që COVID-i ju paska penguar të ndërtonit shtëpitë, ta ngrini kullën 50 kate në bashkëpronësi me oligarkët dhe krimin e organizuar me të gjithë bosët e narkotikës, të gjithë bosët e kokainës.

Ti e di fare mirë, e di edhe unë nga partnerët tanë, ti duhet ta dije nga policia jote, ndoshta ta thotë edhe drejtori i ri se cili bos kokaine ka rezervuar, cilin kat te ndërtesa më e lartë në Shqipëri, të cilën COVID-i nuk e pengoi. Siç nuk ndaloi kullat e tjera që zotrote i kishte planifikuar që kur ishte kryetar i bashkisë, që i vinte erë aq e mirë, saqë mund të shpiket edhe ndonjë parfum me emrin “Gropa e Ajdin Sejdisë”. 11 vjet kryetar bashkie kaq shumë të pëlqente parfumi! Ti na flet ne për etikë, ti na flet ne për të bukurën, për shijen, për aromën e Partisë Demokratike, të cilën shkrintari më i madh bashkëkohor e ka quajtur “partia më e bukur e Lindjes” për idealet, por edhe për gjërat e tjera. Mbi ty rëndojnë akoma akuza të gjendjes personale, sanitare nga paraardhësi yt dhe vjen këtu e flet që të mbajmë hundën me dorë?! Po, more, e mbajmë ne, e kemi mbajtur 11 vjet kur ke qenë kryetar bashkie, s'e mbylle që s'e mbylle gropën. S'e mbylle se doje të bëje kullë apo s'e mbylle sepse shija jote është pikërisht aroma e

asaj grope. Këtë s'do e marrim vesh, sepse gropën e mbylla unë dhe e shndërrova në lulishte, ndërsa paraardhësi yt Uriah Hip, që ke vënë aty, do të bëjë dhe aty kulla për të pastruar paratë që u vidhni shqiptarëve, me paratë e drogës dhe të kriminelëve, me të cilët keni ardhur në pushtet dhe mbani dhunshëm pushtetin.

Tani të kthehem edhe një herë te hallexhinjtë e tërmetit që njësoj si këta të pandemisë i keni bërë mish për top, sepse edhe në kohë pandemie me tenderë sekretë vodhët paratë që duhej të shkonin për gjërat më bazike, sollët medikamente të skaduara, shpallët sekret kombëtar tenderët për blerjen e maskave, ndërkohë që nxirrni autobлиндat në rrugë dhe ti dilje nga mikrovala në frigorifer, se në televizor ishe gjithë ditën, si gogol për t'u thënë shqiptarëve: "rrini brenda, rrini brenda". Sa të ka shkuar numri i vdekjeve sot, krahasuar me mesataren e para 3 vjetëve? E ke lexuar gjë raportin e FMN-së, kur haje hallvë në Egjipt, që të thotë se jemi vendi me numrin më të lartë të vdekjeve? Ata dhjetëra mijëra prindër, nëna, baballarë, bijë dhe bija prindërisht, gjyshër, gjyshe që sot, në vend që të jenë në shtëpitë e tyre, kalben varrezave, sipërfaqet e të cilave janë dyfishuar. Ato të rëndojnë ndopak në ndërgjegje, ndërkohë që vazhdon harxhon miliona për oligarkët me PPP-të që kanë kapur rekordin e Europës? Ke shkuar në 10%, vendi i dytë të afrohet, është me 3%. Apo është e kotë të të kërkoj ty të të brejë ndërgjegjia, kur ndërgjegje s'ke dhe s'ke pasur ndonjëherë? Sepse çdo akt nuk është keqmenaxhim, as keqadministrim, është akt i vetëdijshëm. Ti ke zgjedhur, ti ke vendosur prioritet kullat e korrupsionit dhe të drogës dhe të oligarkisë, sepse janë kullat e tua. Ti ke vendosur prioritet, ke vendosur t'i klasifikosh sekret tenderët e pandemisë, sepse edhe atëherë kur shqiptarët kishin më shumë nevojë se kurrë për paratë që paguajnë si taksa të rritura të kësaj qeverie, ti vidhje me një grusht njerëzish. Këto janë vendimet e tua, nuk janë aksident. Nuk janë vepër e Zotit. Nuk është as si COVID-i, as si tërmeti, është më keq se të dyja bashkë, fatkeqësia kombëtare, që ti drejton dhe pas të cilës fshihesh për të gjitha dështimet, që kanë sjellë kaq shumë vuajtje dhe vazhdojnë të sjellin vuajtje te banorët e Durrësit, të Kavajës, të Lezhës, të Krujës dhe të Tiranës.

Për sa u përket tenderëve, meqë kërkon të flasësh me shifra, por shifrat nuk i di, apo bën sikur nuk i di, të vetmit tenderë me procedura korrekte janë ata të zhvilluar me fondet e Bashkimit European, që ti i urren, sepse aty e di që nuk e përcakton dot, siç përcakton çdo tender mbi 1 milion euro në zyrën tënde, siç e dinë të gjithë biznesmenët; edhe tarifën ta dinë. Nuk e di e ke vendosur vetë apo me Engjëllin, por tarifën e tua në çdo tender mbi 1 milion euro, se nën 1 milion euro je bujar, ua ndan këtyre të tjerëve, ato tarifa i di gjithë Tirana. E gjithë Tirana i ka marrë vesh, prandaj fondet e Bashkimit European s'të pëlqejnë ty, se te fondet e Bashkimit European ka disa rregulla ndryshe, që nuk e bën dot tenderin ti me një ofertues dhe nuk e jep dot në limit 99,99% apo 99,6%.

Kështu që merri pak ato letrat kudo ku i ke futur, ndoshta i ke akoma te zyra e ish-zëvendëskryeministrit, ndoshta "tigrin" i ka djegur, ndoshta ish-zëvendëskryeministri ka ruajtur një kopje, e shikoje pak se si në tenderët e tu nuk ka konkurrencë, sepse i ke përcaktuar ti, pra ky do të marrë këtë, ai do të marrë këtë, ai do të marrë atë. Pastaj ke përcaktuar jo vetëm ryshfetin, por edhe si do të ndahet ryshfeti. Vëmendje të veçantë ke gjithmonë për pronarët e ekraneve që të bëjnë fresk nga mëngjesi deri në darkë. Ky është sistemi që ke ndërtuar ti dhe këtë sistem do ta mbash në këmbë me çdo kusht, me patronazhistë, me lekët për tërmetin, që e mori vesh gjithë bota që javën e fundit dhe 85 herë më shumë seç kishe dhënë në dy vjet, më fal, 89 herë. Këto janë faktet! Faktet janë fare të thjeshta. Ti bën sikur nuk i sheh, ti bën sikur nuk i lexon, bën sikur nuk i njeh. Ja çfarë thonë faktet: java zgjedhore, Bashkia e Durrësit ndan 6 milionë euro për rindërtim. Transferata vetëm për individin 89 herë më shumë seç ka shpërndarë për këtë kategori shpenzimi nga dhjetori i 2019-s, deri më 25 mars 2021, për 15 muaj.

E, pra, po të krahasojmë pagesat për këtë kategori shpenzimi nga 1 dhjetori i 2019-ës, që është muaji i parë i pasojave të tërmetit, deri në 25 mars 2021 dita e parë e fushatës, vlera e ekzekutimeve ishte vetëm 6 637 194 lekë të rinj, krejt ndryshe me një javë para zgjedhjeve, sepse ti nuk u gjendesh pranë njerëzve në fatkeqësi, ti i shikon ata vetëm si votues, të cilët duhet t'i shantazhosh, t'i blesh, t'i intimidosh, t'i

frikësosh me një qëllim: të mbash me çdo kusht pushtetin.

Tani kjo është marrë vesh botërisht dhe arsyeja jonë e vetme për të qenë në këtë sallë, nuk është për të bërë lojëra fjalësh me ty, se ty ta kanë pirë lëngun të gjithë, të gjithë, edhe ata që mendon se i ke akoma miq. Qëllimi ynë është që me rrugën më pak të dhimbshme për shqiptarët të të largojmë nga kjo sallë, ty dhe gjithë kalorësit e korrupsionit dhe kriminit të organizuar dhe t'ua kthejmë këtë sallë shqiptarëve, me qëllim që vendimet, që do të merren nga kjo sallë, të merren për shqiptarët, jo për miqtë e tu, as për oligarkët e tu, as për kriminelët e tu, as për xhepat e tu. Që kjo të ndodhë, duhet patjetër që ne të ndryshojmë ligjin themelor të vendit dhe t'i hapim rrugë asaj që ti e ke frikë si djalli temjanin, vetingut të politikanëve.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për Kryeministrin.

**Edi Rama** – Kanti thotë: “Kur dikush të akuzon për diçka që nuk e ke bërë, ose e ka bërë vetë, ose do ta bënte vetë në vendin tënd”.

Kur vihesh përballë akuzash të tilla, është, në fakt, barra e akuzuesit të provojë akuzën, nuk është barra e të akuzuarit të provojë që nuk e ka bërë atë për të cilën akuzohet, por zotëria më dha një mundësi për shkak të paaftësisë së tij proverbiale, në raport me shifrat, që unë të përgjigjem thjesht. Po sikur fondet e vëna në dispozicion për rindërtimin e shkollave nga Bashkimi Europian, në raport me fondet e vëna në dispozicion nga qeveria për rindërtimin e shkollave, të rezultojnë më të larta në shpenzim për investim sesa fondet e qeverisë, çfarë duhet të bëjmë me gjithë këtë çarçaf që sapo u var në foltoren e Kuvendit?

Po sikur të gjitha investimet e bëra nga qeveria shqiptare për shkollat një për një, në aspektin e kostos, të jenë më të ulëta sesa investimet e bëra nga programi i Bashkimit Europian, po në aspektin e kostos, për të njëjtat standarde dhe kritere, çfarë i mbetet parafolësit? Parafolësit i mbetet ajo që i ka mbetur gjithmonë në fakt, humbja. Humbja që e ka në konstitucionin e vetë mënyrës së të qëndruarit në skenën politike, qysh në ditën e parë. Humbja që e përgatit me duart, me gjuhën dhe me qëndrimet e veta çdo ditë.

E pra, mua fondet e Bashkimit Europian, Lulzim, më pëlqejnë jashtëzakonisht shumë. U

jam shumë mirënjohës, jo vetëm Bashkimit Europian, por të gjithë partnerëve tanë që ndihmuan dhe na ndihmojnë në këtë proces, që nga Brukseli e deri në Abu Dhabi, që nga shumë kryeqytete të Europës, ku vende të caktuara kanë marrë përsipër të kontribuojnë për shkollat drejtpërdrejt, deri në Ankara. Por po të them që në aspektin e nikorqillëkut në shpenzimin e fondeve u jam shumë mirënjohës atyre që kanë punuar për këtë projekt, sepse kanë garantuar që ne të bëjmë më shumë me më pak lekë. Po kështu, edhe me koston e apartamenteve për të njëjtat standarde.

Kështu që atë fjalën “hajdut”, që të ka mbirë në majë të gjuhës, gëlltite brenda, bëji gjuhës një kthesë në drejtim të ezofagut dhe herën tjetër, kur nxjerr gjuhën këtu, matu mirë kur flet për hajdutëri e hajdut dhe matu mirë kur tregon sesi shpërndahen paratë e lejeve të ndërtimit në zyrën e kryetarit të bashkisë, matu mirë kur flet për radhë të afërmish që merren me ndarjen e indulgjencave, duke shfrytëzuar zyrën e kryetarit të bashkisë! Mati mirë këto dhe bëhu burrë, një herë të paktën! Të ka ardhur prapë rasti të bëhesh burrë, por nuk po e shfrytëzon. Sa për “pranë njerëzve”, nuk ma tregon dot mua ti, se e kam thënë më përpara dhe e them përsëri me shumë krenari: kjo nuk është ndonjë zotësi në raport me të tjerët, por sa kilometra kam bërë unë dhe sa njerëz kam takuar unë, për shkak të detyrës, nuk i kanë bërë bashkë të gjithë kryeministrat që nga formimi i shtetit shqiptar, kurse zotrote nuk takon dot as partinë tënde sot. Nuk del dot nga zyra të shkosh të takosh njerëzit e tu, të partisë tënde dhe më tregon mua se ç'është të jesh pranë njerëzve?! Pranë njerëzve është ajo që ti nuk e mëson dot, sepse je vonë për ta mësuar, por të paktën dilu zot njerëzve të tu, se i ke dhe 95%, e mos i lër rrugëve, e mos hajde këtu të bësh leksione morali, e mos hajde këtu të ndysh shtëpitë e shqiptarëve. Çdo ditë sa herë del, ulu e ngri hajdutë, kriminelë, bosë e stërbosë, se nuk ta ka borxh njeri, Lulzim.

Edhe arsyeja pse ti nuk fiton, nuk janë as kriminelët, as bosët, as të gjithë ata që ti rendit. Arsyeja pse ti nuk fiton je ti, sepse me këtë mënyrë të foluri, nuk të beson askush. Ti gënjen veten tënde dhe me këtë mund të gënjesh dhe të tjerët për njëfarë kohe, por ndrysho sa nuk është vonë.

Ta kam thënë dhe herë tjetër: unë jam këtu për të respektuar këtë institucion, për të respektuar këtë përgjegjësi që kemi marrë bashkërisht, për të të respektuar edhe ty bashkë me partinë tënde, por që kjo parti është “partia më e bukur e Lindjes”...! *Give me a break. Give me a break*” Partia më e bukur e Lindjes, “miss Lindja”. Ti mund të jesh “mister Lindja”, sot po lind më në fund. Lind dhe mos vazhdo të flasësh sikur je akoma në pelenat e mjekut. Bëhu burrë dhe mos hajde këtu me dëngla, me akuza, me shpifje, me baltë dhe llum, por hajde me argumente!

Sa për ata që gdhihen në çadra, unë nuk e di ku i sheh ti ata që gdhihen në çadra, se ti zgjohesh shumë vonë e kur ti zgjohesh, ata që rrinë në çadra, janë në punë. Po të them përsëri, ti e di, por po e them për ata që akoma të dëgjojnë, për atë 95%-ësh që mezi pret, që është në çadra qysh nga dita e parë dhe sot që flasim, janë rreth 400 familje, janë edhe sot, por siç ke kërkuar dhe ke gërmuar më parë dhe faktikisht nuk gjete gjë, mund të shkosh prapë të kërkosh dhe të gërmosh nëse nga ata që janë në çadra ka ndonjë familje që sot, që flasim, nuk vazhdon të marrë bonusin e qirasë. Pse rrinë në çadra ata? Ata rrinë në çadra jo se i kemi lënë në çadra, Lulzim, që ta mësosh, por ata rrinë në çadra, sepse ndryshe nga ti, ata punojnë. Ata rrinë në çadra, sepse ndryshe nga ti e nxjerrin bukën me punën e tyre, jo me punën e të tjerëve. Ata rrinë në çadra, sepse ndryshe nga ti, nuk i ka mbajtur njeri në krah, me vite të tëra, duke i prezantuar sikur po bëjnë atë që ti, në fakt, ke bërë sikur e ke bërë. Ata rrinë në çadra, sepse e kanë larg tokën, e kanë larg fermën, e kanë larg gjënë e gjallë nga zonat ku mund të marrin apartamentet. Kështu që ti, kur u qan hallin të tjerëve, sidomos kur i qan hallin popullit, mban një erë hipokrizie, ore ti, Lulzim, sa dhe këta që janë këtu, që janë me ty, aq shumë të vështirë e kanë ta përballojnë, sepse edhe këta aq shumë e kanë gënjyer veten që ti je lideri i tyre, saqë edhe tani, çdo ditë gdhihen dhe ngrysen me pyetjen: “Je ti apo nuk je ti, mund të jesh ti vërtet ai që këta i kanë thënë vetes se je, apo mund të mos jesh”, por kjo nuk është puna ime. Puna ime është të të kujtoj edhe një herë tjetër, që kur bën të fortin këtu, e para, kujtohu mirë se çfarë ke bërë.

E dyta, kur thua këtu “e di gjithë Tirana” apo “e di gjithë Shqipëria” këtë apo atë,

mendohu mirë njëherë se sa shumë gjëra dinë Tirana dhe Shqipëria për ty, Lulzim, dhe sa shumë gjëra dinë këta që janë këtu rreth e rrotull teje. Ke një mundësi t'i shmangësh këto budallallëqe dhe të fokusohesh te çështjet, faktet dhe argumentet. Nëse ke fakte, hajde t'i ballafaqojmë. Patjetër, ka shumë fakte, të cilat flasin pse qeveria nuk është në lartësinë e duhur në një fushë apo në një fushë tjetër, në një hap apo në një hap tjetër. Ka shumë argumente që mund të trajtohen në mënyrë civile që mund të jenë vlerë e shtuar, por këto sjellje, që del si i fort këtu, na u kurse neve dhe shqiptarëve. Shprehjen “pranë njerëzve”, të lutem, mos e përsërit më, derisa të provosh se je në gjendje të rrih pranë 50 demokratëve në të njëjtën kohë. Kur t'i mbledhësh bashkë 50 demokratë jashtë mureve të SHQUP-it, hajde flasim si rrihet pranë njerëzve, të keqen vëllai, se të kam xhan.

**Lulzim Basha** – Zonja Kryetare, ka diçka themelisht gabim kur para se të ...

**Lindita Nikolla** – Zoti Basha, e ka marrë fjalën për procedurë...

**Lulzim Basha** – E kam nisur fjalën, kështu që jepja më pas fjalën për procedurë. Duhet ta kishe bërë më parë.

Është problem i madh kur vjen këtu me të vetmin citim që ke mësuar përmendësh, që është Kanti, ndërkohë që unë të ftoj të lexosh edhe Frojдин, edhe Jungun, ta bëra ftesën që herën e parë, sepse je bërë kaq i lexueshëm, saqë në çdo fjali të gjithë e kuptojnë se ku e ke hallin. E ke hallin ti te Partia Demokratike? Ke hall ti se sa demokratë mbledh unë? Të ka marrë malli ty? Thuaj: “Më ka marrë malli për Sali Berishën dhe Ilir Metën”. Thuaje që ta dëgjojnë të gjithë. Shko edhe ti në foltore, ose fillo foltoren tënde. Bëni Trekëndëshin e Bermudës dhe qajini hallet të tre bashkë, nëse i keni të njëjtat. Unë jam këtu për të qarë hallet e shqiptarëve, as të tuat, as të Sali Berishës, as të Ilir Metës dhe as të atyre që ju rrinë nga mbrapa juve.

Kështu që, të paktën ti dil hapur dhe mos u fshi. A do ta plotësojnë demokratët ty dëshirën që të na kthesh pas? Të jesh i sigurt që s'kanë për ta plotësuar. Mua do të më kesh përballë, jo Sali Berishën. Mua që të munda në vitin 2011 dhe ta mbusha gropën e Ajdin Sejdisë, ta zhduka parfumin “Ajdin Sejdia” nga qendra e Tiranës. Aty doli pastaj që nuk ishte bashki, por ishte bankomat. Ti e di vetë ku u arratisë 3 javë me

radhë, derisa more veten për t'u rikthyer. E di edhe unë, se disa miq i ke ti, por disa miq i kam edhe unë.

Kështu që, nëse te dukem i fortë, është problemi yt. I dobët nuk kam qenë ndonjëherë. Unë po flas me tone civile dhe nuk kam nevojë fare të të poshtëroj, sepse ti poshtëron veten me mënyrën sesi flet këtu. Faktet të poshtërojnë dhe të nxjerrin gënjeshtar, dështakun dhe kusarin, që ke qenë gjithë jetën tënde në politikë.

Ja ku i ke faktet. Kërkoja tigrin të t'i japë.

Bashkimi Europian: fondi limit 15 milionë euro, numri i shkollave 22, fondi për një shkollë 681 mijë euro.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit: 34 milionë e 223 mijë euro, 45 shkolla, mesatarja 760 mijë për një shkollë.

Bashkia Tiranë: 10 milionë e 721 mijë euro, 8 shkolla, 1 milion e 340 mijë euro për një shkollë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

S'ke çfarë të sqarosh, tigër, po rri rehat aty. Çfarë do të sqarosh ti? Ti do të manipulosh. In shallah i ke djegur të gjitha ato që ke gjetur te zyra e paraardhësit. Bashkia tjetër 30 milion euro, 14 shkolla, 2 milionë e 173 mijë euro për një shkollë. Këto janë të vërtetat. Burimi: Partia Demokratike.

*(Të qeshura në sallë.)*

U kënaqët, ë? Jo, jo, burimi është Agjencia e Prokurimit Publik. Shiko si qeshin! Afroje pak kamerën, zotëri i nderuar, jo, siç bëri regjia herën e kaluar, që kur thashë afroje, e largoi. Shiko si u zgërdhinë, kujtuan se ishte vërtet PD-ja. Burimi është APP-ja, Agjencia e Prokurimit Publik. Do të qeshni tani? Do të qeshni? Ja ku i keni! Këto janë shifrat tuaja që ti nuk i lexon, se merresh me shifra të tjera, sigurisht. Ç'të interesojnë ty këto! Borxhin ua ke shqiptarëve. Provat i ke në familjet e çdo shqiptari të goditur nga pandemia që paguan minimalisht 1 milion lekë për t'u kuruar, për shkak të shëndetësisë tënde falas dhe shkon deri në 5 mijë euro. Zhyten në borxhe.

I ke në Shtish-Tufinë dhe në Sharrë, nëse nuk ke kohë të dalësh jashtë Tiranës. I ke te FMN-ja që të tha, kur po haje hallvë në Egjipt, se ke numrin më të lartë të vdekjeve për frymë. Këto janë faktet, të cilat i ke në raporte, në shtëpitë e shqiptarëve, tavolinat e shqiptarëve dhe në xhepat e shqiptarëve dhe shkaktari je ti. Kështu që mos u kap kot pas Trekëndëshit të

Bermudës, megjithëse je njëra nga brinjët e trekëndëshit.

Koha e Trekëndëshit të Bermudës ka marrë fund. Misioni im dhe i partisë më të bukur të Lindjes është që të mos përsërisim gabimet e 92-it, as të 97-ës dhe as të 2009-ës dhe të mos bëjmë më asnjë kompromis me të keqen, qoftë kjo për hir të zgjedhjes së një presidenti, krijimit të një koalicioni apo të dhënies së besimit një njeriu, i cili nuk duhej të ishte as në politikë. Në fakt, kam dhe unë pjesën time të fajit që je aty, por pjesën më të vogël, se pjesën tjetër e kanë dy brinjët e tjera të Trekëndëshit të Bermudës.

Klientët me të cilët ti ndan paratë janë: "Salillari" 1,81 miliardë lekë, "Alko Impleks-i", nipat e Sadri Abazit, 306,4 milionë, "Bami" 639 milionë, "Start Tek-u" 567 milionë, "Geci" 970 milionë, "Mane TCI" 1,83 miliardë lekë, "Ndërtim Montim Patos" i incineratorit të Fierit 447,2 milionë lekë, "Albstar-i" i kullës së stadiumit 415 milionë lekë; "Fusha" 334 milionë lekë. Këto janë vendet ku ju çoni lekët e shqiptarëve. Meqë doje faktet, këto janë shifrat.

Se sa qejf i ke ti plehrat, këtë e tregove në fushatë, kur mblodhe gjithë grupin parlamentar tek incineratori i Elbasanit. Ti që na flet neve për pastrimin e Shqipërisë, i vure flakën Durrësit, Kavajës, Fierit.

Ti bëre mbledhje të veçantë me kryebashkiakët dhe u the diçka që as gjenerali në Kajro nuk guxon ta thotë: "Do ju shkrij bashkitë, në qoftë se nuk pranoni të firmosni që lekët tuaja, apo lekët që ju jap me buxhet, t'i çoni te Mirel Mërtiri dhe Klod Zoto.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Mirel e ka, mos ki merak, se edhe aty të ka plasur lufta. Kanë shkuar lekët nga tigrin tek Uriah Hipi dhe më duket se kanë dalë te Damiani, të paktën kështu thotë TIMS-i. Ose keni lidhur ndonjë miqësi apo krushqi, se mbi njëzetë herë me avion brenda pak viteve nuk shpjegohet, apo janë vetëm ujësjellësit? Po qenë vetëm ujësjellësit, ndoshta nuk i kap SPAK-u, i kap Prokuroria e Tiranës, sigurisht pas vetingut.

Pra, që t'i themi gjërat shkoqur dhe qartë: këtu ka një betejë midis 30 vjetëve llum të tranzicionit, ku pa diskutim maja e llumit je ti. Pa diskutim, llumi nuk i takon vetëm një partie, kemi edhe ne pjesën tonë të llumit, por unë të siguroj që pjesën tonë të llumit, që e ke peshkuar mirë 8 vjetët e shkuar, një pjesë e ke pasuruar,

një pjesë e ke graduar, një pjesë e ke grepuar, e ke përdorur, e ke hedhur kundër opozitës, e ke hedhur kundër ndryshimit, kundër proceseve demokratike që, në fund të fundit, janë mënyra e një shoqërie për të zgjidhur mosmarrëveshjet, pa kaluar në përplasje sociale, atë pjesë llumi Partia Demokratike dhe unë jemi të vendosur ta pastrojmë deri në fund, sado që t'i të subvencionosh oligarkët dhe mediat e kapura për të kundërtën.

Sakrificat e demokratëve në emër të shqiptarëve nuk do të shkojnë kot. Masakra zgjedhore e 25 prillit nuk do të mbajë gjatë. Vendosmëria ime është e pakthyeshme. Trekëndëshi i Bermudës i ka ditët e numëruara. Kështu që, jepini gjajret njëri-tjetrit, sa të doni, por shpëtim nga ajo për të cilën i keni hyrë në hak shqiptarëve, ti i pari dhe, mbi të gjithë, nuk keni për të pasur. Gjërat kanë ndryshuar njëherë e mirë. Një pas një, brinjët e Trekëndëshit të Bermudës do të bien. Shqiptarëve do t'u hapet rruga e mbyllur në 30 vjet. 15 veta që kontrollojnë tranzicionin, politikën, ekonominë, medien do të japin llogari politikisht.

Ndaj, për sa i përket transparencës, meqë t'i pretendon se nuk e di çfarë bankomati ishte bërë Bashkia e Tiranës kur ti ishte kryetar dhe se sa të dhëmbi kur e humbe bankomatën, meqë ti paske harruar bandat dhe banditët me të cilët e more tri herë bashkinë dhe u përpoqe ta marrësh për herë të katërt, meqë pretendon se nuk i njeh banditët me të cilët bëre masakrën zgjedhore të 25 prillit, meqë pretendon se nuk ke pasuri të pajustificueshme të tuat, të të afërmeve të tu, të ortakëve të tu apo të bashkëpronarëve të tu në Tiranë, në Shqipëri dhe anembanë botës, meqë pretendon të kundërtën dhe më thua mua mendohu mirë, e di ç'ke, bëhu ti burrë një herë në jetën tënde dhe votoje vetingun e politikanëve. T'i marrim me radhë dhe, ndryshe nga rregulli i vjetër, ta mos e fillojmë nga plaku, por ta fillojmë nga i riu. E bëj unë i pari vetingun, mos ki merak, në të gjithë komponentët e tij, bëje ti i dyti, pastaj të gjithë tjerët në këtë sallë dhe të gjithë politikanët, nga i pari tek i fundit.

*(Duartrokitje në sallë.)*

Do që t'i japësh fund këtij monologu që bën këtu, ku të ka shteruar edhe mundësia për të përsëritur të njëjtat figura letrare? E ke shumë të thjeshtë, voto vetingun në politikë dhe lëri punët

e demokratëve, se demokratët i kanë gjërat e qarta dhe nuk ka gjë të të shpëtojë ty nga vendosmëria e tyre me mua në krye për t'i dhënë fund këtij regjimi.

**Lindita Nikolla** – Fjala për procedurë për zotën Vasili.

**Petrit Vasili** – Zonja Kryetare, po ju drejtohem juve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo sallë do të funksionojë me rregullat që kemi vendosur këtu dhe janë këtu, apo është pronë e çdolloj tangoje politike që ka kohë të tjera për t'u bërë?

Deklaruat pas fjalës së Kryeministrit që interpelanca mbyllet. Kjo Rregullore, çobani i së cilës jeni ju, nuk parashikon në asnjë pikë të saj, përveç dy njerëzve, atij që kërkon interpelancë dhe ai që përgjigjet në interpelancë. Aty interpelanca mbyllet.

Hapni diskutimet. Lërimi të bëjnë muhabet sa herë të duan, me orë të tëra, se është kjo mundësi në Rregullore, por, së paku, formalisht, bëjeni këtë sallë të funksionojë në mënyrë normale. Kryeministri nuk është pronar i Rregullores, që thotë se do ta marrë fjalën kur të dojë, nuk ia ka lejuar Rregullorja këtë. Le ta ndryshojë përsëri Rregulloren dhe të thotë që nuk do të flasë njeri veç Kryeministrit, por atëherë kur ka radhën, në zbatim të atij libri rregullash që kemi vënë për të funksionuar. Bëjeni këtë detyrë, ose thoni që kjo është një anarki.

Për sa i përket kërkesës për të folur për procedurë, jua kam kërkuar disa herë, ndonëse neni 49 thotë që fjala jepet menjëherë. Ku do të shkojmë ta kërkojmë fjalën, te shkallët e Kuvendit? Kjo ka mbetur. Kthejeni sallën në normalitet, mbylleni këtë debat, hapni diskutimet dhe le të flasim sa të duan, sepse Rregullorja e mundëson, por boll me këtë rrumpallë parlamentare, e cila është pa rregull dhe pa asgjë.

Unë e kuptoj që për dy vjet kjo ka qenë një sallë me një ngjyrë, ku bëje çfarë të doje, por kjo kohë ka mbaruar. Së paku të zbatojmë këto rregulla, të cilat janë kaq të qarta dhe mbi këto nuk del asnjë njeri në këtë sallë. Të vetmin element të barabartë që kemi janë rregullat e shkruara këtu. Nëse nuk i doni, griseni Rregulloren publikisht dhe thoni që kjo nuk është salla e deputetëve, por e Kryeministrit dhe vazhdojmë rrumpallën, por ju bëj thirrje ta ndalni këtu këtë çështje.



Kjo interpelancë konsiderohet e mbyllur që pas fjalës së fundit të zotit Xhaferraj, i cili ka 3 minutat e fundit, siç thotë neni 96, pika 5 dhe pastaj hapni debatin për çështje të tjera të rendit të ditës. Kthejeni në normalitet këtë sallë! Hiqjeni rrupallën dhe kthejeni normalitetit.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Vasili! Po, zoti Kryeministër.

**Edi Rama** – Tangoja na ka mbetur ne, se Baftjarin nuk e kemi në programin e partisë.

Dola përsëri këtu, sepse është e nevojshme. Meqë, Lulzim, kërkove t'i referohemi Frojdit, ndër të tjera Frojdi thotë: “Koha e harxhuar me macen nuk është kurrë kohë e humbur”. Të lutem! Kështu që unë e konsideroj kohë të shfrytëzuar me efektivitet kohën që harxhoj me ty.

Duke iu referuar atij burimit të Partisë Demokratike, kostot maten me metër katror, Lulzim, nuk maten me numër shkollash, sepse ka shkolla që janë me palestra të mbyllura, ka shkolla që janë me kënde sportive të hapura, ka shkolla që janë më të mëdha, ka shkolla që janë më të vogla. Prandaj, jepi porosi ekspertëve të t'i bëjnë llogaritë e shkollave me koston për metër katror ndërtim, e pastaj hajde flasim këtu javën tjetër bashkë me burimin e Partisë Demokratike.

Se mos e bëni siç e bëtë me Unazën e Re, që ulnit e ngrinit koston e lartë për kilometër, a thua se kilometrat e rrugëve janë si metrat e teritalit. Kur blen terital, është njësoj, e blen për metër. Për sa u përket kilometrave të rrugëve, varet se çfarë bën aty. Tani që po e shohim të gjithë se çfarë po bëhet aty, është e qartë se aty nuk po bëhet një kilometër rrugë në fushë, por aty po ndërtohet një vepër shumë komplekse inxhinierike, me një sërë tunelesh e të tjera e të tjera. Këto janë gjëra shumë të thjeshta. Ti gropën e Ajdin Sejdisë ke mbushur, se nuk ke bërë ndonjë punë tjetër, kështu që nuk i di këto. Të paktën të dije matjen me metër kub dhe për mbushje gropash, se me këtë gropë që po të hapet do të duhen shumë metra kub dhe që ta mbyllësh.

Sa për Partinë Demokratike, Lulzim, unë nuk jam fare i shqetësuar dhe nuk i referohem fare asaj që ndodh në Partinë Demokratike, përveçse, e këtë e kam thënë, kur ti më fton ta bëj këtë gjë ose kur dikush tjetër këtu na fton ta bëjmë këtë gjë, ne vijmë këtu të diskutojmë me

ju për çështje që lidhen me çfarë bën ky parlament, siç e tha edhe zoti Baftjari që na la tani.

Kur ju na ftoni në këto hulli, atëherë çfarë të them unë? Kur ti më thua që duhet të shkosh pranë njerëzve, çfarë të bëj unë ty, ti më kërkon me zor të të them po ti ku i ke njerëzit? Unë të kërkoj me qiri, por nuk të shoh gjëkundi tjetër përveç se në atë kutinë e vogël të *News 24*. Ku i ke njerëzit?

Çfarë të bëj unë me ty? Ti thua populli po vuan, ata ngrihen që në sabah në çadra. Po ku e di ti kush ngrihet që në sabah në këtë vend? E dinë të gjithë që ti ngrihesh vonë. Edhe këtu në parlament vjen gjithmonë i fundit dhe të duhet një kohë për të bërë xhiron që të vësh në punë gjithë makinerinë tënde. Tani, pse më fton në këto rrugë? Pse më detyron? Çfarë po më thua tani për historitë e bashkisë së Tiranës? Pse ma kërkon me zor atë që dinë të gjithë?

Ndryshe nga ti, unë nuk jam nga ata që i gjurmojnë dynjasë me emra, se unë mendoj që çdokush në këtë vend ka të drejtën të jetë në punën e vet dhe për punën e vet përgjigjet përpara ligjit, përpara organeve që merren me zbatimin e ligjit dhe nuk përgjigjet para teje, meje apo të gjithëve ne. Të marrësh mikrofonin, duke qenë i zgjedhur nga populli, e të rreshtosh emra njerëzish që janë në punën e tyre, kjo ndodh vetëm kur vihen gjoba, Lulzim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Cilat emra përmenda unë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla.)*

Jo, unë e kisha për Babalen, por nuk e kuptove ti.

Kështu që të vijmë tani te çështja. Po, Lulzim, jo vetëm që unë jam i bindur që me ndërtimin e impianteve të përpunimit të mbetjeve apo inceneratorëve, siç thua ti, është bërë një hap shumë i madh përpara, për ta pasur Shqipërinë një vend të pastër, nuk diskutohet kjo, por, patjetër, ato investime janë bërë pikërisht për të mos lejuar që të vazhdojë të ushqehet kanceri që latë ju në të gjithë territorin me qindra e qindra e qindra vendhedhje mbeturinash ilegale, pranë lumenjve, pranë tokave të bukës, që janë helm. T'u japësh njerëzve alternativën e helmit se kërkon të bësh luftë politike, mund ta bësh, por kjo është prapë një arsye pse humbet, që ta dish.

Patjetër që po, sot bashkitë, në të gjithë Shqipërinë kanë në dispozicion pikat fundore, që

janë ose impiantet e përpunimit të mbetjeve, inceneratorët, siç i quan ti, ose *landfill*-et e investuara dhe, sigurisht, janë të detyruara që mbetjet t'i çojnë atje, që të mbyllet një histori e madhe, e pëshitirë e helmit në mjedis, por dhe historia e abuzimit, që është bashkëshoqëruese e saj.

Ka abuzim shumë të madh, historik, Lulzim, me sasi të mbetjeve dhe ti e di shumë mirë këtë, se je marrë me Sharrën për një kohë të gjatë. Ke pasur partneritet PPP të pashpallur për Sharrën dhe për mbetjet, kështu që këto ti i di mirë. Megjithëse ti nuk merresh me shifrat, janë të tjerë që merren me shifrat për ty, por po t'i pyesësh ata, do të thonë po, kështu është.

Atëherë, përqendrohu kur flet, se kujton se bie përballë e i bie vetes gjithë kohës. Përqendrohu kur flet!

Më flet mua për llumin e tranzicionit dhe tani ke filluar edhe fjalinë e bukur që edhe PD-ja ka pjesën e vet të llumit. Lulzim, nëse PD-ja ka pjesën e vet të llumit (unë fjalën "llum" nuk e kam përdorur ndonjëherë, as për PD-në, që të jemi të qartë, se është fjalë e madhe), ajo pjesa e llumit të ka nxjerrë ty. Ti je pjella më e brilantinosur e atij llumi, kështu që kujdes. Nuk e kam fare për të mbajtur me gajret foltoren. Foltorja është gajreti i Shqipërisë. Çfarëdo që të bëj unë, foltorja është një gajret i madh për Shqipërinë. Shqipëria shikon dhe mban brinjët me dorë me foltoren, përveç atyre që janë të përfshirë drejtpërdrejtë e që duket se kanë hyrë në karvanin e bacës Isa me axhën Ismail e do çlirojnë prapë Shqipërinë nga perandoria e radhës, perandoria amerikane. Ata po, janë në karvan e do të dalin me atë karvan. Unë nuk kam çfarë t'i mbaj me gajret foltores, foltorja na mban me gajret ne, kurse ti jo.

Mos i sill këtu këto, mos na e çoj gjuhën aty ku të dhëmb dhembti ty, të lutem. Rrotulloje gjuhën në një mënyrë që të mos shkojë atje, se na detyron edhe ne të të vijmë atje pastaj. Kur thua ti, do apo nuk do, mua do më kesh përballë, kjo është pastaj çfarë të të them unë ty. Dua apo nuk dua, unë ty do të kem përballë! Po unë ty të dua përballë gjithmonë, dihet ajo punë. Unë të kam dashur, të dua e do të të dua, por nuk di si të të ndihmoj. Realisht. Nuk e kam cinike këtë, por realisht, për ta ngritur në një nivel tjetër debatin. E di çfarë bën ti? Ti vjen këtu ekzaktësisht duke

lexuar abetaren që të ka mësuar ai llumi nga i cili tani po distancohesh.

Nuk bëhet distancimi nga llumi duke qenë zgjatim i tij. Trego që nuk je dhe je realisht i distancuar e mos shpif si llumi, mos shaj si llumi, mos merr njerëz nëpër gojë si llumi, pra, shkurt muhabeti, mos ji karikatura e llumit. Llumi është origjinali, ta kam thënë. Mos e harro kurrë që ti ke sfidën më të madhe, jo PD-ja, sepse ti duhet t'i provosh vetes në radhë të parë, pastaj të tjerëve, që megjithëse ai llum ty të nxori në krye, ti je tani diçka tjetër. Ti duhet të rilindësh.

Ne e dimë se si shkohet drejt rilindjes, ndaj na dëgjo. Ki besim dhe ndërvepro këtu me gjuhën e fakteve. Ka plot fakte. Ia thashë edhe Ferdinandit. Nëse hyj në garë unë me Ferdinandin se kush ka më shumë kritika për të bërë për Durrësin, e fitoj unë garën, e nuk ka nevojë fare as të shpif, as të akuzoj, as të kriminalizoj dynjanë me llafe, por duke iu referuar fakteve dhe urdhëroni, si ju do t'i bënit këto. Kjo është opozita. Si do t'i bënit ju.

Nëse ti më thua që plehrat duhet t'i lëmë rrugëve, unë nuk jam dakord me ty, por duhet t'i mbledhim nëpër pikat e grumbullimit. Nuk është kjo alternativa, ashtu sikundër nuk është alternativa të përdorësh burime pa pasur asnjë ...

E ke lexuar raportin e FMN-së apo nuk e ke lexuar, se po e përmend këtu FMN-në? E para, FMN-ja nuk ka lidhje fare me raportimin e vdekjeve, Lulzim. Nuk i raporton FMN-ja shifrat e vdekjeve, që ta dish, por tjetër institucion. FMN-ja në raportin e vet ka thënë qartësisht që ekonomia shqiptare ka treguar qëndrueshmëri të konsiderueshme dhe politikat e ndjekura kanë garantuar një rimëkëmbje të shpejtë dhe të qëndrueshme. Këtë e ka thënë FMN-ja në raport. Pse më thua mua "a e ke lexuar sa të vdekur keni se e kam lexuar te raporti i FMN-së"? Tek cili raport i FMN-së e ke lexuar? Mblidh burimet. Shtrëngohu. Fokusohu.

Sa për atë sfidën e madhe që bën ti, nuk dua të bëj komente, sepse unë e kuptoj shumë mirë ku e ke hallin me atë vetingun tënd. Është gjetje e lodhur, në fakt, që të jemi të qartë, se nuk ta beson njeri ty, megjithatë unë nuk dua ta diskutoj, sepse unë i qëndroj atij parimi që kam thënë. Hajde ta diskutojmë, siç meriton të diskutohet, me ekspertët tuaj, me ekspertët tanë, ku doni të dilni, si doni ta bëni, mbi cilat praktika

të mira ndërkombëtare bazohet, në cilat vende ka treguar që ka sukses, çfarë thonë partnerët tanë për këtë punë, çfarë thonë institucionet. Nëse del që kjo nismë është shpëtimtare për vendin, patjetër që ne do ta votojmë, por nëse na rezulton që kjo nismë është një kamerdare, si ato të fëmijëve që fryhen me gojë për të bërë sikur notojnë, në formë peshkaqeni, atëherë ne do themi: “Lulzim, vazhdo vëlla, bëj rolin e peshkaqenit të gomës, që të mbrohesh nga peshkaqeni i foltores”. Nuk është puna jonë kjo. Thjesht ta ndajmë këtë. Ju keni ekspertë plot, ne kemi disa, e shohim dhe e diskutojmë. Patjetër, për çdo gjë që i shërben interesit të përbashkët të vendit, ne na keni pro, kurse për çdo gjë që mban pastaj era foltores, ne na keni kundër.

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Xhaferraj, çfarë kërkoni?

**Ferdinant Xhaferraj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

U bë e disata herë që Kryeministri më përmend. Në fakt, ia thashë dhe zëvendëskryeministrit, këta janë në një moment që duhen lënë të flasin. Sa më shumë flasin, aq më shumë tregojnë.

Është e vërtetë që para disa vitesh Kryeministri ka qenë më me klas, më fin. Më përmendi cilësinë e diellit me të njëjtin nivel siç ma përmend militanti socialist i Lushnjës: “Të përmirësojmë cilësinë e diellit”.

Lidhur me cilësitë e mia, zoti Kryeministër, mund të pyesësh Damian Gjikhurin, i cili ka ardhur në shkollë në Amerikë pas meje dhe i di cilësitë e mia të performimit.

Ajo që unë dua të ngre me shumë shqetësim, ka të bëjë me faktin ku e keni degraduar shtetin. I thashë zëvendëskryeministrit që në janar dhe shkurt, dy herë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka kërkuar informacion administratës dhe administrata nuk i ka kthyer përgjigje. Nuk i kërkon të zgjidhë problem, por informacion. Je në gjendje të kuptosh, zoti Kryeministër, se çfarë ndodh me një qytetar që ka hall, ndërkohë që diskriminohet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi? E kuptoni ku e keni degraduar shtetin? Pse? Iniciatori jeni ju. Ju keni shkarkuar direkt nga Facebook-u drejtorin e hipotekës dhe pastaj atë drejtor hipoteke e emëruat Drejtor të Përgjithshëm Shërbimesh në bashki. Ai

halabaku, i etiketuar nga ju, do të japë shërbime në bashki.

Ju lutem, dëgjoni me shumë kujdes!

Si mund të zgjidhë hall qytetari në administratën tuaj, kur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk merr përgjigje?

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Basha.

**Lulzim Basha** – Faleminderit!

Zoti Xhaferraj, e kam detyrim t’ju tërheq vërejtje pse krahasoni një krijesë punëtore, që çohet pa gdhirë dhe shkon në shtëpi pasi perëndon dielli, siç janë fermerët socialistë të Lushnjës dhe Divjakës, me një krijesë që mungesën e gjumit e ka për patologji të tjera, politike dhe mjekësore. Meqë i pëlqen rima, se poezia është fjalë e madhe, thjesht t’i kishe thënë: cilësinë e diellit krahasova, jo cilësinë e miellit. E mbyllje me kaq. Të lutem, herë tjetër mos ofendo as militantët socialistë të Divjakës dhe Lushnjës dhe as militantët socialistë kudo që janë, se të siguroj që e kanë hallin dyfish më të madh! Pse? Se tanët e kuptojnë. Ka ardhur banda, i heq nga puna dhe kur shkojnë në gjykatë, u thotë gjyqtarëve: po u dhatë të drejtë, do të thërrasim këta të vetingut, që i kontrollojmë ne, dhe do t’u themi do të heqim gjyqtarin. Demokratët e kanë të qartë që këta e kanë kapur shtetin, por hallin më të madh e kanë socialistët, sepse nuk kanë kujt t’i qahen. Sigurisht detyra dhe sfida jonë është që të na qahen ne, me kusht që t’ua zgjidhim problemet, pra, që t’i japim fund trekëndëshit të 30-vjeçarit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)*

Edhe ty, nëse reflekton. Unë kam një mendim. Kurrë nuk të kam pasur simpati, por s’e kam me ty, për qëndrimet politike që ke mbajtur, por për koherencën e qëndrimeve nuk mund të ankojem, me përjashtim të rastit të fundit, kur me vullnetin tëndin pranove dezturnin. S’duhet të ishe në dezturn. Ose e pranoje dhe bëje edhe zëvendëskryeministrin, por s’duhet ta pranoje të ishe dezturn. Kjo është çështje që nuk kisha pse ta konsumoja në këtë nivel. E ka gjetur zëvendësuesin ai, ashtu siç e ka midenë. I diskutojmë më vonë këto.

Ndoshta shkojmë i diskutojmë edhe te fermerët e Lushnjës dhe Divjakës, në qoftë se ti i ndan hallet e tyre, ashtu siç i ndaj unë, sepse kohët e fundit ndoshta unë kam qenë më shpesh se ti, por ky nga piramidat e Gizës nuk na sheh,

ky që ka takuar më shumë sheikë dhe investitorë strategjikë sesa qytetarë këto 4 muajt e fundit.

Ky e ka hallin se më dhemb mua dhëmbi. E para e punës, mua nuk më dhemb asnjë dhëmb. I kam dhëmbët e mi, ta dish, dhe gjenetiksht i kam goxha të fuqishëm. Gjithashtu, kujdesem për to. Kështu që mos u qaj hallin dhëmbëve të mi, sepse njëherë që të kafshuan u zhduke për tri javë dhe nuk i the as partisë ku shkove, apo jo? Apo e ke harruar? Një herë që të kafshuan dhëmbët e mi, u zhduke fare për tri javë. Vetëm ti dhe unë e dimë ku shkove, nga burime të ndryshme.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ajo të dhemb ty. Bankomati i vitit 2011 të dhemb më shumë se çdo gjë tjetër. Shenjat i ke, s'të ikin, s'të del e keqja.

Tani, meqë këto nuk i kemi për llafe, por për vepra dhe meqë the se nuk do të diskutojmë për vetingun politik, por diskutove 10 minuta për vetingun politik, ç'ke ti, pse trembesh nga vetingu në politikë? Kujt do t'i drejtohesh ti? Venecia e ka shprehur mendimin.

Fole një çerek ore dhe the këtu që të marrim mendime, të pyesim. Jo, e ke gati propozimin për vetingun e politikanëve. Që mos të kesh frikë se do të jesh ti objekti i vetëm, filloje nga unë, nga të duash ti filloje, nga pasuria ime, e familjes sime, e të afërmeve të mi, e çdokujt që ka lidhje me mua. Çfarë merak ke? Ku e ke merakun ti? Propozimi për vetingun në politikë është i miratuar sipas të gjitha rekomandimeve të Venecies. Çfarë do ti më shumë sesa Komisioni i Venecies? Kë do ti që ta aprovojë këtë? Rrok Gjoka me Salillarin? Toma? Kujt i druhesh ti? Merre, ja ku e ke, kaloje. Pse spërdridhesh këtu duke thënë do ta diskutojmë, s'do ta diskutojmë, do e diskutojmë po nuk është momenti për ta diskutuar. E ke përpara: veting në politikë.

Të gjithë politikanëve, nga i pari tek i fundit, t'u kontrollohet pasuria personale, e familjes, e ortakëve, lidhjet me krimin e organizuar dhe kontaktet e papërshtatshme. Metodologjinë e ke miratuar këtu me 140 vota për gjyqtarët dhe prokurorët. Po të them ta bëjë SPAK-u, nga i cili, të paktën, sipas listës së patronazhistëve të tu, treçereku dalin që janë votues të tutë. Ku e ke frikën ti? Pse të fle lepurit në bark? Pse vjen këtu e më thua mua "e di ti Sharrën, s'e di ti Sharrën". Nxirre Sharrën e të

shikojmë se çfarë është bërë në Sharrë. Është bërë një vrasje e një djaloshi 16-vjeçar që përfshin Uriah Hipin tënd dhe drejtësinë e kapur dhe sot e kësaj dite nuk ka përgjegjës. Janë përfshirë strukturat e Partisë Socialiste, që menaxhonin në mënyrë të paligjshme. Këto fakte di unë. Nëse ti di fakte të tjera, dërgoi për hetim. Ti s'do hetim, ti i mban dorën çdo hetimi.

Ti je pengesë për reformën në drejtësi. Ti do që ta zgjasësh pafundësisht vetingun, sepse në këtë mënyrë i kontrollon gjyqtarët dhe prokurorët. Ti e zgjat pa fund integrimin europian të vendit, sepse pastaj nuk vjedh dot siç vjedh këtu. Me 15 milionë euro të Bashkimit Europian ndërton 22 shkolla me mesatarisht 681 mijë euro për shkollë, me 34 milionë euro të qeverisë tënde ndërton 45 shkolla me 760 mijë euro për shkollë, ndërsa me këto të Bashkisë së Tiranës arrin në rekorde të tjera, 1,3 dhe 2,1 milionë. Je bërë edhe inxhinier konstruktiv. S'mbushe dot një gropë, më bën ti mua inxhinierin konstruktiv, ti që dole kundër Durrës-Kukës. Shyqyr që sajove dhe çështje në prokurori, të paktën, se do të ishte harruar si dhe kush dhe çfarë sfidash duhej që të bëhej Durrës-Kukës. Ti që brenda ditës bredh nga Jugu në Veri falë rrugëve që kemi ndërtuar ne flet sikur je mbi gomar.

Pra, këto shifrat këtu, që u shkritë së qeshuri ju, që ju thashë unë, janë shifrat e PD-së. U çliruat? Jo se e meritoni të qeshni, në fakt, me këtë që u keni bërë shqiptarëve. Këto janë shifrat e Engjëll Agaçit, shefit të APP-së, Agjencisë së Prokurimit Publik. Hë? Heshtje? Të atij janë këto. Janë të atij.

Të vijmë te çështja më kryesore. Njerëzit rrinë në çadra, thua ti, se u pëlqen të rrinë në çadra e të marrin bonusin, pra qeveria u ka dalë borxhit, por njerëzit rrinë në çadra. Ministrja jote tha para dy seancash që varfëria është çështje teknike. Po, po, janë të regjistruara, janë bërë meme. Ndërkohë që me propozimin që keni sjell këtu, i cili do të diskutohet kur të mbarosh justifikimet verbale, se justifikimet e vërteta të kanë mbaruar bashkë me vajin e kandilit, me këto që keni sjellë këtu, prapëseprapë, keni propozuar që t'ju merrni para shqiptarëve për 7 kontrata koncensionare me vlerë 2 miliardë dollarë, PPP-të e klientëve tuaj dhe, nga ana tjetër, thoni s'kemi ku të gjejmë paratë për të zbritur TVSH-në e ushqimeve nga 20% në 6%,

me një kosto totale për buxhetin prej 150 milionë euro. 150 milionë euro për të ulur çmimin e bukës, të vajit, të sheqerit, të familjeve që ti i viziton ditë për ditë, por nuk e di që shumica e tyre kanë vetëm një herë në ditë dhe ata me borxh; nuk i dëgjon dot!

Ke sjellë prapë 7 kontrata koncesionare me vlerë 2 miliardë euro. Ky je ti. Tjetra është fasadë, tjetra është shpresa që këto fjalë të shuhet, që kur të dalim jashtë sallës, mediat e kapura nga ti të japin vetëm cirkun tënd, që SPAK-qilimkuqi të bëj sikur s'na ka dëgjuar dhe paditë që kemi çuar të bëjë sikur s'i ka parë dhe ti, dhe banda jote të vazhdoni të vidhni. Ky është plani yt, këtë ke bërë 8 vjet ti.

Natyrisht, të vjedhësh shqiptarët, të vjedhësh pasuritë e shqiptarëve, pastaj t'u vjedhësh edhe votën, nuk është virtyt, nuk është as thjesht ves, është krim; krim që duhet ndëshkuar. Por, duke qenë se drejtësisë së reformuar të 22 korrikut 2016 çdo dhëmb vogël që i del, ia thyen ti me çekiç, atëherë ne, për detyrim ndaj shqiptarëve dhe jo për karshillëk ndaj teje, se Zoti na ruajt, jo mua, por më të riun dhe më të renë në grupin tonë parlamentar, që të na shkojë mendja të bëjmë karshillëk me ty, se na duhet 10 jetë të të kapim në maratonën e veseve, gjynaheve dhe borxheve, me të cilat i ke rënduar shqiptarët, duhet t'u shpjegojmë shqiptarëve që ta kuptojnë se kush e merr këtë foltore për të mbrojtur të pambrojtshmen, varfërimin e shqiptarëve, mbitaksimin e shqiptarëve, shpunësimin e shqiptarëve, largimin e shqiptarëve, poshtërimin e shqiptarëve, burgosjen e shqiptarëve, padrejtësitë ndaj shqiptarëve, Ndërkohë, një grusht njerëzish majmen, pasurohen dhe kanë pushtet më shumë se Byroja Politike e vaktit dhe kush e merr këtë foltore për të kërkuar diçka të thjeshtë, që e kupton çdo shqiptar, dhe të jesh i sigurt që e mbështet çdo shqiptar, edhe ai grusht deputetësh këtu, që nuk ndihen, por që nuk kanë gjë për të fshehur, vetëingun e politikanëve.

Çfarë do të bësh ti? Konsulta me komunitetin ndërkombëtar? Ti e ke miratuar vetëingun e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Ti dole nga selia e PS-së dhe the se nuk ka diskutime, nuk ka negociata, do të zgjatet kjo dhe pikë. Pse kur bëhet fjalë për vetëingun tënd, dhe unë them ta fillojmë nga unë, fillon dhe belbëzon e më thua diskutime, konsultime? Çfarë

është kjo, përveçse frikë? Frika jote do ta mbajë peng vendin? Frika nga korrupsioni është edhe më e keqe se korrupsioni, sepse frika nga korrupsioni i shtyn të korruptuarit të bëjnë gjëma të mëdha, si ajo që bëre me 25 prill.

Asgjësimi i ndryshimit përmes sistemit të patronazhistëve, shkrirjes së shtetit me partinë, abuzimit me fondet e ndërtimit, abuzimit me fondet e tërmetit dhe të pandemisë, abuzimi me burimet njerëzore, fryrja e administratës dhe 12 mijë anonimë që i punësove gjoja në shtet (por, në fakt, ishin patronazhistë dhe tani i ke degdisur), shkatërrimi i rregullave elementare të konkurrencës në treg, këto janë konstatimet e ODIHR-it, të cilat ta kanë vënë vulën ty si Lukashenko i Ballkanit, por Shqipëria nuk mund të kthehet në Bjellorusi dhe nuk mund të të pranojë as ty dhe askënd të qeverisë vendin si Lukashenko.

Të kanë mbetur shumë pak argumente. Po kërkon dëshpërimisht aleatë. Brenda shtëpisë tënde të ka ngelur një grusht, brenda oborrit të oligarkëve edhe më pak, atyre që të dalin për zot me kobure në xhep dhe lekët e drogës, të jesh i sigurt se ka filluar t'u rrëshqasë toka nën këmbë. Siç e di edhe vetë fare mirë, sepse të kanë thënë, edhe aty kopaçka do të fillojë të kërcasë dhe nuk i mbron më as Ard Veliu dhe as presionet e tua ndaj cilitdo zëvendësuesi të tij.

Përpjekja për të ndërtuar një aleancë të pashenjtë me Trekëndëshin e Bermudeve, që të del nga barku sa herë që s'ke argumente, do të dështojë po kështu. Ti ke vetëm një rrugë, të pranosh që ke tetë vjet që e mban vendin peng të egos tënde të sëmurë. Të kërkosh ndjesë për jetët e humbura, për shpresën e vrarë, për të rinjtë e larguar, për ekonominë e rrënuar, të tregosh pendesë për asgjësimin e themelit të bashkëjetesës demokratike në një shoqëri, që janë zgjedhjet e lira dhe të ndershme, t'i heqësh duart nga fyti i SPAK-ut, të votosh vetëingun në politikë dhe të lejosh që Partia Socialiste, e marrë peng në bodrumet e oligarkisë dhe krimin të organizuar, të ketë guximin të konkurrojë ndershëm në një fushë beteje të barabartë me Partinë Demokratike me një përplasje idesh, vizionesh dhe programesh dhe, të paktën, si fillim dhe jo, sigurisht, si një e përhershme konstante, të pranojë të paevitueshmen, daljen në opozitë si interesi më i mirë i Shqipërisë dhe i shqiptarëve dhe pastrimin nga llumi i banditëve,

kriminelëve, oligarkëve me të cilët ke ardhur dhe mban pushtetin.

**Lindita Nikolla** – Fjala për Kryeministrin.

**Edi Rama** - Nuk po zgjatem shumë, por unë e kuptoj, dhe në këtë rast jam i bindur që të gjithë e kuptojnë, se pse të duhet ty Lulzim kjo retorika e trimtë të madh, që nuk ka shokë shumë dhe që ka përballë frikacakë, që nuk ia dalin dot të ballafaqohen me sfidat e këtij trimi. Kjo është shumë e qartë. Por, edhe një herë, dhe do ta bëj këtë parantezë deri kur të humbas shpresën dhe pastaj të mos angazhohem më në këto lloj debatesh, respekt, që të të respektojnë! Nuk mundet dot ti apo dikush, qoftë individ apo forcë politike, që në përpjekjen për të realizuar një objektiv të vetin, duke mos pasur as shumicën, të dhunojë verbalisht rivalin. Nuk e bën dot. Kjo nuk funksionon.

Fatkeqësia është që ti e ke provuar shumë shpesh dhe aq herë sa e ke provuar, aq herë të është kthyer mbrapsht, dhe aq herë sa ke mbajtur këto fjalime këtu, që janë bërë bozë, me “orën që ka ardhur”, me “momentin që ka mbërritur”, me “pakthyeshmërinë e procesit”, me “lirimin e pengjeve”, se këtu u bënë të gjithë pengje e nuk po merret vesh kush është pengmarrësi, aq herë ke dështuar.

Këto doktrat e tua me trimëri e me ndershmëri e me pathyeshmëri, thuaja vetes, por mos dil këtu që të shfrytëzosh këtë foltore si Beni që ecën vetë, natën në pyll e këndon që të mundi frikën. Të lutem! Të lutem, se u bërë qesharak fare. Nëse do dhe je serioz të bësh procese këtu në këtë parlament, bashkë me ne, për ato nisma që i ke lançuar, duhet të kuptosh që ne nuk kemi kohë për të humbur, por angazhohemi në të gjithë kohën për t'i bërë këto seriozisht.

Zotrore e ke treguar më shumë se një herë që, jo vetëm me shifrat, por edhe me geramat ke probleme dhe lexon, siç të konvenon në atë moment, kur improvizon ditën e radhës në politikë. Më vjen shumë keq! Ti ke leximin tënd, puna jote, por ne nuk mund të hyjmë më në proces ndryshimi Kushtetute e ndryshimi ligjesh këtu, duke të besuar ty se si lexon ti.

Këto bëhen me dialog midis përfaqësuesve të Partisë Demokratike dhe përfaqësuesve të Partisë Socialiste, të cilët bën mirë shumë t'i respektosh, po të them dhe një herë tjetër, nëse nuk do që ta ndërpresim përfundimisht këtë

mënyrë komunikimi dhe nëse nuk do që edhe ne ta kthejmë me mosrespekt, jo duke nxjerrë nga goja ato që guxon të nxjerrësh ti, se shkove deri te kafshimet tani, se ke qenë aleat me një që kafshonte publikisht deri dje dhe të ka mbetur dhe kafshimi si strapallë në kokë dhe e nxjerr këtu se sa herë ke kafshuar ti dhe si kafshon ti.

Goxha burrë! S'je goxha burrë ndaj e bën këtë. “Kafshoja. Kafshoja. Kur kafshoj unë. Ti e di si kafshoj unë”. Çfarë janë këto muhabete? Ku i bën? Je këtu a nuk je? Po të shohin njerëzit, nuk je në ëndërr, është ora 12 e gjysmë e drekës. Zgjohu! Zgjohu dhe lëri këto! Kafshoj, kafshoj.

E di nga e ke aleatin që ke pasur në krah, me kafshime, me premtime për kafshime në vesh, në qafë a ku di unë se ku. Të lutem, mos na bëj të gjithëve qesharakë këtu se po flet përçart! Po të them që të mbyllim këtë persistencën tënde në të njëjtën gjë: “Shpif, shpif se diçka do mbetet”. Kostoja, Lulzim, kostoja e ndërtimit është me metra katror, kur vjen fjala për shkolla, për apartamente apo për njësi banimi. Nuk është me sasi, Lulzim. Kaq shkolla kaq, e kaq shkolla aq, sepse varet si janë ato shkolla. Po të them që kostoja e ndërtimit për metër katror të shkollave të investuara nga fondet e buxhetit të shtetit është mesatarja 47 mijë lekë.

Kostoja e ndërtimit të shkollave, të investuara nga programi i Bashkimit European, është mesatarja mbi 47 mijë lekë, nuk po ta them sa. Nuk po ta them sa, gjejeni ju, se nuk dua të bëj konkurrencë. Është mesatarja 60 mijë lekë Dakord? Kjo nuk ka lidhje fare këtu me një garë dhe mund të ishte edhe e kundërta e prapë nuk do të kishte lidhje për të bërë akuza e për të shpifur këtu. Prandaj hezitova ta them, pikërisht për të mos futur këtë lloj narrative këtu. 47 mijë lekë. Ato kompanitë e zgjedhura janë 400 kompani, Lulzim, që nga kompanitë e projektimit të kompanitë e ndërtimit, që janë angazhuar për rindërtimin dhe i gjithë programi i rindërtimit është më pak se gjysma e asaj rrugës Durrës-Kukës, që vazhdon e përmend këtu dhe akoma sot vazhdon e ndërtohet.

Këto janë faktet. Urdhëro, shko, merri shifrat e hajde këtu ballafaqoi, se shifrat nuk janë opinione! Shifrat nuk janë si ai vetingu që ke ti në kokë (trimëri, që jam trim unë dhe e bëj kështu dhe e vë kështu). Shifrat janë shifra. Pastaj hajde t'i interpretojmë pse është më lart e më poshtë, por jo t'i kthesh shifrat në opinione.

Del atje me letra, që as nuk i kupton. Mos u merr me shifra, se nuk i kupton! Ti ke treguar historikisht që nuk i kupton. Mos u merr se ngatërrohesh!

Ti nuk kupton germat, tregon çfarë thotë FMN-ja për vdekjen e foshnjave, tregon çfarë thotë Venecia për vetingun. Ku e di ti? Ti i merr të gjithë dhe i përdor sipas asaj këngës së radhës që ke. Këto janë gjëra që diskutohen në tryezë midis përfaqësuesve tuaj dhe përfaqësuesve tanë, nëse do. Nëse mendon që do të bësh këtu amendamente dhe nisma me ultimatum, nga kjo selia këtu afër, atëherë këto harroji. Mund të bësh propagandë me këto sa të duash, dhe ta thashë, mos vazhdo me të njëjtën gjë, se nuk mund të më flasësh mua për njerëzit, kur në selinë e partisë tënde futesh nga mbrapa sot, siç nuk futesh dot as nga përpara ditën, se ka njerëz atje e nuk dihet çfarë “foltoreje” të shfaqet rrugës.

Mos u hyr këtyre fare, pse u hyn? Këtu ke ardhur në parlament, ne nuk kemi punë fare as me “foltoren”, as me ju. Hajde këtu në parlament e fol për çështjet që kanë njerëzit! Më tregon mua koncesionet dhe PPP-të dhe miliarda këtu e aty. I ke parë çfarë janë ato, i di çfarë janë ato miliarda që përmend? E di që janë aty të tëra të mbledhura edhe nga koha e mëparshme, përfshirë gjithë ato të energjisë me të gjitha detyrimet për ato lejet e hidrocentraleve, që janë me ato kontrata me parablerje? Janë të gjitha ato aty.

Po të them që jo vetëm nuk u heq asnjë presje atyre që kam thënë për partneritetin publik-privat dhe nuk kompleksohem fare nga ato që thonë ju, se me mendjen tuaj Shqipëria mbeti aty ku ishte. Por faktet flasin dhe më 29 nëntor do të hapet Rruga e Arbrit që të kalojnë njerëzit, me të vetmin problem në Qafën e Murrizit, për shkak të përbërjes gjeologjike të tunelit, që ka krijuar vonesa të mirëdokumentuara, gjithë pjesa tjetër është gati.

Ja çfarë bën këtu, Lulzim, partneriteti publik-privat. Nëse ajo që ndodhi me tunelin e Murrizit, - dëgjo këtu, dëgjo, të mësosh ndonjë gjë, dëgjo çfarë ndodhi, Lulzim, me shfaqjen e një përbërjeje gjeologjike të papritur dhe do të ishte me buxhetin e shtetit, atëherë do të duhet të nxirrnim nga buxheti i shtetit një mal me lekë të tjera, siç keni nxjerrë ju dhe siç jemi detyruar të nxjerrim ne për ata tenderët pa projekte

gjeologjike e pa projekte fare, që keni bërë ju për të shkuar për të bërë “foltoren” në tunelin e Elbasanit para zgjedhjeve, bashkë me llumin, me atë që i thua “llum” sot ti. Ke qenë ti atje, ty të nxori llumi përpara atje e tha: “Ja ku e keni djalin tonë” e ti në majë të daullës atje. E kur erdhi puna, pasi i ratë daullës atje, bashkë me llumin, siç thua ti, jo unë, u deshën sa e sa para për të vazhduar e për t’u marrë me rrëshqitjet e me lemeritë e projektit. Apo me Qukës-Qafë Plloçën, që e latë me disnivel. Ura nga njëra anë në një tjetër 17 metra, sikur kishit bërë trampolinë për të kërcyer llumi nga lart-poshtë e të binte këtu. Këto janë projektet tuaja dhe ky është koncepti juaj.

Kurse me partneritetin publik-privat ne nuk kemi punë fare. I themi kompanisë “të doli tuneli me atë përbërje gjeologjike, është tek ti, jo tek ne”, nuk shtojmë ne para për atë punë. E rëndësishme është që me paratë, që përndryshe do të duheshin vite për t’u bërë të gjitha bashkë, për t’u bërë Rruga e Arbrit, ne thjesht do të paguajmë në vite kthimin e investimit për një rrugë që është gati atje.

Më 29 nëntor merre dhe deputeten e Dibrës, meqë e pyete, se e ke konsulente, dhe kaloni andej, por kujdes se tek ajo rruga ka shumë “foltore” rrugës dhe mos ngecni rrugës. Unë nuk di ç’të bëj me ju, se njëri thotë “Më bllokoi Edi Rama, por unë Kavajën e dua aq shumë, sa nuk ka gjë që më bllokoi”. Tjetri thotë që llumi këtej e andej, njëri thotë që të ka marrë peng ty, ti thua më ka marrë peng ai, atë nuk e di kush e ka marrë peng.

Lulzim, lëri këto, se këto janë hallet tuaja, jo tonat. Këto janë hallet e partisë më të bukur të Lindjes. Si the? Partia më e bukur e Lindjes. Miss Lindja. Faktet janë fakte. Ke fakte? Hajde këtu! Vazhdon më bën trimin tani! Dhe mos e përmend më atë gropën e Hajdinit, “Kam mbushur gropën e Hajdin Sejdisë”. Ke 100 vjet verdallë këtu dhe e vetmja gjë që thua është “Kam mbushur gropën e Hajdin Sejdisë” A e kupton se ku je, apo jo? Dhe e paske fituar ti Tiranën?!

Po Ristani çfarë thotë, se nuk është këtu. Nuk po them rezultatet, por nuk ka asnjë rëndësi.

Urdhëroni? Çfarë të bëj? Çfarë të çoj në SPAK? Gropën e Hajdin Sejdisë? O zonjë, të lutem se e kam me pengun!

Lulzim, këto nuk janë për ty, nuk ka asnjë problem që në politikë je në garë, edhe fiton, edhe humbet. Edhe nëse është ashtu si thua ti, nuk ka asnjë problem. Këtu nuk është çështje kreshnikësh. Këtu është çështja që ti duhet ta ndash, ta ndash mirë; çfarë e ke marrë falë llumit dhe çfarë ke marrë falë vetes. Deri tani bilanci anon nga llumi, pa llumin ti nuk do të ishte këtu fare njëherë, si fillim.

Ndaj, mos hajde të na bësh moral, mos hajde të na bësh leksione dhe, mbi të gjitha, mos hajde këtu e të përsërisësh këngën e llumit sa herë merr fjalën, në garë me llumin se kush akuzon, shpif e shan më shumë. Jo se më bën dëm mua e na bën dëm ne. Nga pikëpamja e interesit tonë, Lulzim, po ta them sot, se i ka parlamenti këto me shkrim, çfarë them, jua them, po ta them sot: në zgjedhjet e ardhshme, do të dilni më keq, të dyja palët, se do të jeni dy, se nuk jeni më një, se nuk keni se si të jeni një, do të dilni më keq të dyja palët. Të dyja bashkë nuk do të bëni dot atë që bëtë kur ishit llum komplet. Dakord?

Ndaj të them që interesi cinik është i qartë, ndërsa interesi ynë, i vendit, i çështjeve për të cilën jemi zgjedhur për të diskutuar, është diçka tjetër. Nëse doni të merremi me këto, hajde të merremi.

Nëse do vazhdosh ti, bashkë me ju, të vini këtu me të shara, me baltë, me akuza dhe me një gjuhë, e cila të turpëron ty si prind, personalisht, na turpëron të gjithë ne si prindër, që japim këto mësimë këtu se si në një mjedis publik i thua tjetrit “Unë të kam kafshuar”, imagjino çfarë mendojnë fëmijët, kur të shohin një goxha profesor, me brilantinë dhe me kollare, që i thotë një tjetri, një plaku si puna ime, rrugës “Unë të kam kafshuar”. Imagjinon sa pleq do të kafshoheshin sot po të dëgjonin ty, fëmijët?

A e kuptove? Kështu që, mblihd mendjen, Lulzim! E kuptoj që e ke të vështirë, por këtu kjo është serioze. Nëse doni të kthehemi prapë te koha e llumit e ta përdorni këtë foltore këtu për llum, vazhdoni, s’ka problem, nuk iu ndalojmë dot të drejtën e fjalës, por harroje se do të harxhojmë kohë këtu me ju dhe harroje se do të rri unë këtu të merrem me macen, siç thotë Frojdi, sepse dhe ajo koha e të marrit me macen ka një limit.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Basha.

**Lulzim Basha** - Si the pak më parë, që FMN-ja s’ka thënë gjë për vdekjet? Rri dëgjoje gënjeshtren tënde! Nuk rri dot. Mirë. Ja ku e ke konfirmimin e FMN-së, meqë dole të qetësohesh pak te dhoma ngjitur dhe të uroj qetësim të mbarë dhe të shpejtë. Si? Dhe cilësinë e diellit, ose të miellit. Dëgjoje nga dhoma ngjitur, meqë s’ke guxim të rrih këtu! Shqipëria kishte numrin më të lartë të vdekjeve në Europë në vitin 2020, në raport me mesataren e 2015-2019-ës, sipas publikimit të fundit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në dokumentin e quajtur “Pasqyra Rajonale Europiane”, tetor 2021. Pra, ndryshe nga të paaftët, që të rrethojnë dhe s’të ndihmojnë dot në paaftësinë me të cilën ke hipur në atë karrige e mbahesh me thonj, e vërteta është ajo që deklarova unë dhe që, në fakt, e ka botuar çdo media serioze dhe e pakapur.

Sipas grafikut të botuar nga FMN-ja, vdekjet shtesë ishin mbi 20% më të larta se mesatarja e 2015-2019-ës, e para në Europë. Pra, jo vetëm në Europë, por nga shtetet e rajonit ti ke një diferencë të jashtëzakonshme edhe me mikun tënd të dashur, Aleksandër Vuçiq. Pastaj pasqyra i bën të qarta vendet ku pandemia nuk ka pasur efekte të tilla shkatërrimtare. Mos kini merak se, çfarëdo që të thoni mbrapa meje, këto të FMN-së nuk i ndryshoni dot, vetëm shpjegojani atij, të mos dalë këtu për faqe të zezë, se pastaj meritoni t’ju shkarkojë edhe më shpejt se çka ndërmend t’ju shkarkojë.

Prandaj, këtij fakti mos i ik, siç i ike sallës, siç i ike edhe herën e kaluar! Del këtu, përdor një fjalor të padenjë ndaj zonjave, siç e ke zakon, siç të ka shoqëruar gjithë jetën tënde, pastaj, një e dy, merresh me dhëmbët dhe me brilantinën. Në radhë të parë, të siguroj që në jetën time s’kam përdorur brilantinë. Nëse ke interes se si i mirëmbaj unë flokët, s’është për parlamentin, por as nuk të duhet, se ti s’ke flokë, por këtu s’jemi për punën e flokëve, as të dhëmbëve. Ke harxhuar një orë duke folur për flokët e mia, një orë. Pse? Që të mos flasësh për hallet e shqiptarëve. Cilat janë pengjet? Pengjet janë shqiptarët, pengje të varfërisë, pengje të mosshpërblimit për dëmin e shkaktuar nga tërmeti, që e premtove, pengje të shkollave që nuk i ke ndërtuar akoma, se do që sheshet e ndërtimeve t’ua japësh oligarkëve, si “Naim Frashërin” në Durrës, pengje të padrejtësisë, të grabitjes së pronave, të shkatërrimit të shtëpive



pa ligj, siç bëre këto dy ditë të “5 Maji”, pengje të mizorisë, që të shpërfaqet nga shpirti me çdo akt të këtij shteti brutal, pa fytyrë njerëzore, pa zemër, që ke ndërtuar këto 8 vjet, si një shërbëtor i oligarkëve, i kriminelëve dhe si një shtypës i qytetarëve të thjeshtë, si një kullë pa dyer dhe pa dritare, ku nuk troket dot askush, as i varfëri, as sipërmarrësi, as punëdhënësi, as shtresa e mesme, as studenti, as pedagogu, sepse përgjigjja jote tash 8 vjet është që faji është kudo tjetër, përveçse tek ai që qeveris vendin prej tetë vjetësh, që je ti dhe vetëm ti.

Ndaj dy ditë më parë, për t’i dhënë fund hipokrizisë tënde, në depozituam projektligjin për uljen e TVSH-së së shportës nga 20 në 6%. Kjo është një masë urgjente që duhet ndërmarrë për të ndihmuar familjet shqiptare, për të cilat ty s’ta ndien, sepse sa herë që vjen fjala për ta ose vjen këtu dhe bën klounin, ose ia kërcet e ikën, siç ike. Ka familje që po përballen ditë për ditë me rritjen e çmimeve si rezultat i korrupsionit dhe i dështimit të qeverisë tënde, jo vetëm shtresat në nevojë, por të gjitha familjet që jetojnë me punë të ndershme dhe që mbajnë rekord në Europë për shpenzimet që shkojnë për ushqime dhe s’ka tregues më të dhimbshëm se ky.

Rekordi i shpenzimeve për ushqime në Europë tregon varfërinë e lartë në vend, që disa në këtë sallë mund ta injorojnë, por që askush nuk mund të bëjë sikur nuk e di. Deputetët e vendit me nivelin më të ulët të të ardhurave për frymë dhe varfërinë më të lartë në rajon, me fuqinë blerëse më të ulët, ku rritja e çmimeve vrapon shumë më shpejt se rritja anemike e pagave dhe pensione, më të ulëta në 30 vjet, nuk mund të heshtin për aq sa e konsiderojnë veten deputetë dhe jo pengje të pengmarrësit të të sotmes së shqiptarëve, as të mbyllin sytë, as të mbyllin veshët përballë njerëzve që blejnë me lista nëpër dyqane apo të gjithë të tjerëve që po varfërohen për shkak të shtrenjtimit të çmimeve.

Ndaj kemi përgjegjësi përballë familjeve shqiptare, që e dinë më mirë se të gjithë ne se çfarë po heqin në jetën e tyre të përditshme dhe përgjegjësia është t’u ofrojmë nga kjo sallë, jo shfajësimet e të mbyturit, që kapet pas fijos së kashtës dhe Trekëndëshit të Bermudeve, por t’ju ofrojmë zgjidhje konkrete.

Ky parlament, pavarësisht se i pjellë nga paligjshmëria, e ka mundësinë ta ofrojë këtë

zgjidhje, e ka mundësinë t’ua lehtësojë barrën e rëndë të gjithë atyre familjarëve, që duhet të shtrojnë tryezën e tyre, të paktën 2 herë në ditë për ata që kanë fat, sepse edhe deputetët e këtij që u largua e dinë që në zonat e tyre ka familje që hanë një herë në ditë dhe ngrysen me ankthin e të nesërme dhe me pasigurinë për fëmijët e tyre.

Ndaj ky propozim është për ta, nuk është për të llogje, as për të gjetur justifikime, as për ta devijuar debatin te metaforat e lodhura dhe të stërdëguara të të sëmurit të Tiranës, që, në fakt, kanë qenë një premtim për shumë, shumë, shumë kohë i pambajtur, i vetë këtij dhe i partisë suaj, i programit tuaj elektoral.

Pas gënjeshtreve tuaja elektorale, në kohën kur njerëzit kanë më shumë nevojë, ulja e TVSH-së për shportën ushqimore duhet të bëhet realitet sot. Sipas përlllogaritjeve tona, kostoja për buxhetin e shtetit është 150 milionë euro. Pyetja që do të shtrojnë ata, që mendojnë se është më mirë që këto para t’i kenë në duart dhe në xhepat e tyre dhe të një pushteti që ka dhënë prova se i bën rrush e kumbulla, është: ku do të gjenden paratë? Kjo është pyetja që do të shtrojnë. E di që kjo pyetje i ha nga brenda, sepse ka kohë që sa herë ne propozojmë diçka, që është për njerëzit dhe u vlen njerëzve, që prek interesat e familjeve apo të sipërmarrjes shqiptare, apo të fermerit shqiptar, këta bëjnë si kursimtarë, me një shtirje sa tragjike, aq edhe qesharake, që do t’ua kishte pasur zili edhe kopraci i Molierit. Por kur vjen radha për të firmosur tenderë sekretë, tenderë dhe PPP publike, koncesione për miqtë dhe klientët e pushtetit, papritur shndërrohen në atë personazhin e “1001 netëve” dhe nuk e kam fjalën për Sheherezaden, por e kam fjalën për Ali Babën. Ali Baba, me një “Hapu Sezam”, u lëshohet taksave të qytetarëve bashkë me 40 hajdutët.

Prandaj, ndërkohë që përgatiteni për ta sjellë në parlament aktin kriminal të 7 kontratave koncensionare me vlerë 2 miliardë dollarë, 150 milionë euro për qytetarët duhet dhe mund t’i gjeni duke i hequr nga PPP-të dhe shpenzimet e tjera joprioritare, sepse marrëzia me PPP-të, ky abuzim i pacipë i parave të familjeve shqiptare, nuk mund të vazhdojë të përgjakë në mënyrë kaq flagrante buxhetin e shtetit, duke u ngarkuar brezave të ardhshëm barrën e pazareve që bëni

dhe të parave që ndani me një grusht oligarkësh dhe që e keni çuar nga 60%, ku e gjetët, në 100%, përfshirë faturën e PPP-ve tuaja.

Cili motiv është që ju shtyn me turravrap të rinovoni kontratat për PPP-të? Kujt i shërbejnë PPP-të? Shqiptarëve jo. Vendi më i varfër i Europës nuk mund ta vendosë ekonominë e drobitur nga korrupsioni dhe vjedhja në funksion të projekteve, nga të cilat fitues të vetëm dhe të garantuar janë ata që caktoni ju dhe që e dini fare mirë që i caktoni ju dhe jo gara. Ju vijnë me duar në xhepa, ju sjellin projektin apo ua jepni ju, varet nga ujdia, dhe bëjnë sikur investojnë. Nga 120 milionë që ka qenë Rruga e Arbrit, ka shkuar në 360 milionë dhe ti ke kurajën të vish dhe të na krenohesh këtu, në vend që të japësh llogari se pse paguan 240 milionë euro më shumë, 3 herë më shumë projektin për Rrugën e Arbrit. Na flet këtu për rrëshqitje. Si e quajti? “Befasi tektonike, gjeologjike”! Jo, nuk është fare befasi gjeologjike, është babëzi tipike, është hajdutëri me çizme.

Pra, ky maskarallëk, ky borxh i fshehur, që është i gjithi klientelist dhe korruptiv, nga ata të shëndetësisë tek ata të mafies së inceneratorëve, janë vendet ku ndodhen paratë e shqiptarëve. Nuk ka nevojë as për shkencë, as për tigra prej letre për të gjetur para për të lehtësuar ekonominë. Mjafton të silleni si kryefamiljare apo si kryefamiljarë, si çdo person normal i këtij vendi, që ka një familje për të mbajtur. Kur një person normal, kur një kryefamiljare apo kryefamiljar ka një problem, një ngushtësi ekonomike, ndodhet përballë problemeve të përditshme, i shembet çatia e shtëpisë, duhet të paguajë shkollën e fëmijëve, universitetin, duhet të paguajë një operacion shëndetësor, sepse dihet, shëndetësia falas këtu ishte njësoj si premtimi juaj për heqjen e TVSH-së, apo për 300 mijë vendet e punës, çfarë ndodh? Ky kryefamiljar apo kjo kryefamiljare nuk i përdor kursimet dhe nuk merr pare borxh për të blerë satelit, apo televizor HD, por i jep prioritet meremetimit të çatisë apo shkollimit të fëmijës, apo shëndetit. Ju bëni të kundërtën. Ju e filloni duke blerë televizor HD. Ju thoni do të blini satelit.

Ne themi: ulni TVSh-në për ushqimin, se nuk po e paguajnë dot më shportën”, ky thotë: “Do të blej satelit”. Pra, me PPP-të dhe koncesionet jo vetëm që nuk ka asnjë përfitim

për publikun, por është publiku që e paguan dyfish.

Së pari, se publikut, njerëzve, u merren taksat.

Së dyti, se, për hir të këtyre koncesioneve dhe PPP-ve, tani po hyni edhe në borxh. Borxhin prapë do ta paguajnë qytetarët. Me borxhin më të lartë në historinë e tranzicionit ju jo plan që s’keni, jo vizion që s’keni, por ju po e asfiksoni atë pak ekonomi që ka mbetur, sepse, edhe pse keni marrë më shumë borxh se çdo qeveri tjetër prej vitit 1991, nuk keni qenë të aftë ta përktheni në rritje ekonomike, por vetëm përfitim për veten tuaj dhe klientët tuaj që i çojnë këto para në parajsa fiskale.

Sot vini me një tjetër Eurobond 700 milionë euro dhe ofendoni inteligjencën e njerëzve duke i rënë gjoksit se jeni të aftë të merrni borxh për të fshehur dështimin e asaj që i keni bërë ekonomisë, sepse po merrni borxh për të larë borxhe. Prandaj, kur thoni “Eurobondi merret për mbulimin e përgjithshëm të shpenzimeve buxhetore.”, citoj nga dokumenti juaj, pa shpjeguar praktikisht asgjë, tregoni pikërisht se e keni për të mbyllur gropat që keni hapur këto vite, sidomos në masakrën e fundit zgjedhore, ku bashkë me shpenzimet buxhetore që partiashtet bëri në kurriz të demokracisë, i morët përkohësisht në punë, duke i gënjyer 12 mijë patronazhistë apo klientë elektoralë në sektorin publik vetëm si qokë elektorale që sot u kushtojnë qytetarëve shqiptarë 117 milionë euro më shumë; 117 milionë euro më shumë! Ju duken pak? Por, në fakt, duhet të besoni që në duart e konsumatorëve janë shumë.

Shumë janë edhe 165 milionë euro që institucionet shtetërore dhe kompanitë publike i kanë sot borxh OSHEE-së së Ard Çelës, që është kthyer në një grup të strukturuar kriminal; një shifër dy herë më e lartë se në vitin 2013. Kjo është reforma e energjisë?! Kjo është reforma juaj e energjisë? Është për të qeshur, apo për të ulur kokat?! Të paktën të kesh ivercencën të ulësh kokën, si deputetët e tu, si ata që ke zëvendësuar. 165 milionë euro janë më se të mjaftueshme për ta ulur TVSH-në e shportës nga 20% në 6%. Këtë e di unë; e dinë ekspertët tanë; e dinë ekspertët tuaj; e di ai që e hoqën; e di edhe ti që e ke zëvendësuar për ta bërë gropën më të thellë në emër të klientëve të Edi Ramës dhe atij që të ka vënë aty.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Kujt t'i djegë, lë ta mbajë!

S'kam ndërmend ta harxhoj kohën me çirakun, duke qenë se ustai ia mbathi. Pra, unë mund të rri gjithë ditën të numëroj dëmet që i keni shkaktuar këtij vendi për të treguar se ku mund t'i gjeni paratë për të ulur TVSH-në. Ndërkohë, qytetarët do të vazhdojnë të pyesin si ka mundësi që nuk u ngopët?! Si nuk u ngopët me PPP-të, me koncesionet, me tenderët që ju kanë pasuruar ju dhe oborrtarët tuaj? Si nuk u ngopët duke u bërë dëme familjeve shqiptare, që sot e ndiejnë në xhepat e tyre rënien në pikiatë të konsumit?

*(Bie gongu.)*

**Lindita Nikolla** – Po, edhe një minutë!

**Lulzim Basha** – Në qoftë se propozimi ynë për uljen e TVSH-së për produktet e shportës mund t'i zbusë disi vështirësitë që familjet shqiptare po përjetojnë, zgjidhja afatgjatë për jetët e tyre është zhdukja e një tjetër takse që avullon ditë për ditë të ardhurat, shpresën e tyre dhe largon fëmijët e tyre nga familjet. Kjo është taksa e korrupsionit, një gangrenë që e ndien çdo shqiptar që, siç jua tregova të hënën, e ka çdo raport ndërkombëtar. Ndaj që të zhdukim taksën më të rëndë për shqiptarët bashkë me propozimin tonë të argumentuar për uljen e TVSH-së për shportën ushqimore, lërimi dënglat e atij që e di fare mirë se propozimi ynë është në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias, merrni kurajën, bashkoni votat me Partinë Demokratike, votoni vetingun e politikanëve!

**Lindita Nikolla** – Zoti Ahmetaj e ka fjalën për procedurë. Më pas – e ka fjalën zoti Braçe.

**Arben Ahmetaj** – Zoti Basha, më vjen keq që, ndërkohë që je duke bërë punën tënde, si e bën është gjykimi yt, unë jam duke bërë punën time dhe ti kthehesh e fillon e thua: “Jo mos qesh, jo qesh”. Nuk është serioze. Të lutem! Në diskutimin me mua ruaj etikën. Unë e ruaj etikën me këdo qoftë nga ju, edhe kur ju e humbisni atë. Nuk është serioze as për ju, as për mua. Unë flas me kolegët, flas me ministren e Jashtme, ti vazhdo punën tënde. Të lutem! Besoj e ke vënë re që unë nuk e humbas etikën asnjëherë as me ju, as me dikë tjetër, edhe kur ju provokoni: “Jo, tigr, jo luani, jo elefanti?”. Këto histori nuk të shkojnë, mua jo e jo, seriozisht!

Tani po të lexoj se çfarë thotë FMN-ja, për të qenë të sinqertë dhe seriozë me shqiptarët. Në

datën 12.10.2021 FMN-ja thotë: “Ekonomia shqiptare ka treguar një qëndrueshmëri të konsiderueshme pas tërmetit të vitit 2019 dhe pas pandemisë. Pas vitit të vështirë 2020 aktivitetet ekonomike po ringrihen fuqishëm. Politikat luajtën rol kyç në ruajtjen e jetëve dhe mjeteve të jetesës, duke i hapur rrugë rimëkëmbjes së vendit”.

Për sa i përket borxhit, se aty nuk ke njerëz, e vratë atë që merrte vesh dhe mbajtët këta që liruan kriminelët kur kanë qenë ministra të Drejtësisë që kanë firmosur “Gërdecin”, llumin e vërtetë, jo atë llum që i referohesh ti sot, për shkak të besueshmërisë së qeverisë në mbajtjen e deficitit dhe të borxhit përpara goditjeve, është bërë i mundur zgjerimi dhe furnizimi me financim i të gjitha politikave të miratuara nga qeveria.

E treta, për qytetarët, kur i referoheni raportit të FMN-së, për korrektesë do t'ju lutesha, të flisni për vitin 2020, që nuk iu referuat me qëllim, sigurisht. Në atë vit Shqipëria ishte vendi me uljen më të vogël, me gjithë të dyja goditjet rresht.

Nuk i referoheni, sërish për shqiptarët, që tani ky vit është me rritjen më të madhe në rajon. Ja edhe numri i vdekjeve! Fatkeqësisht diskutojmë për vdekjet, FMN-ja thotë që ruajtëm jetët për shkak të politikave që ndoqëm. Ja ku e keni! Ja ku është Shqipëria! Fatmirësisht, falë Zotit dhe falë punës së mjekëve, të të gjithëve...

*(Bie gongu.)*

Më fal, zonja Kryetare, do t'ju lutesha, mos ma ndërprisni! Është e rëndësishme, dua ta ndaj me pozitën dhe opozitën.

**Lindita Nikolla** – Të lutem, të respektojmë kohën!

**Arben Ahmetaj** – Patjetër!

Të lutem! Faleminderit! Ndoshta, një koleg ma jep një minutë!

Ja ku e kemi, nuk jemi në krye, falë Zotit dhe falë punës së mjekëve, të të gjithëve, si dhe falë politikave.

Për sa u përket taksave, e kam relacionin tuaj kur na keni rrëzuar të njëjtën politikë, ku keni thënë: “Bëhuni seriozë me politikën fiskale! Çfarë po bëni? Po ndihmoni oligarkët me TVSH-në e ushqimeve që doni të ulni?!”. Na keni thënë: “Me këto politika populiste përfitojnë vetëm oligarkët dhe monopolet, se çmimet nuk ulen, çmimet janë instrument i tregut”. Keni thënë ju

atëherë. Çfarë do të themi ne kur të vini ju këtu, është histori tjetër. Mos harroni kurrë që e latë biznesin e vogël me taksë 10%, sot është zero.

Dua t'ju them vetëm dy politika që po vijnë me buxhetin: 15 familje të ndihmës ekonomike, që janë me tre fëmijë nën 18 vjeç, do të marrin 2-fishin dhe 3-fishin e kësaj ndihme.

Meqenëse iu referuat shkollave dhe nxënësve, 283 mijë fëmijë i marrin librat falas, asnjë si merrte atëherë.

Të lutem, për respektin që kam, për seriozitetin që kam, mos dëgjo njerëz që kanë nxjerrë kriminelë nga burgu për të manipuluar zgjedhjet e vitit 2009, se ata do t'i përgjigjen drejtësisë...

*(Zotit Ahmetaj i ndërpritet fjala, pasi i mbaroi koha në dispozicion.)*

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka kërkuar zoti Braçe për procedurë.

**Erion Braçe** – Nuk ka kuptim më.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – E ka kërkuar për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, jo, të lutem, zoti Basha! Ia kam dhënë fjalën zotit Braçe për procedurë.

Urdhëroni, zoti Braçe!

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Keni folur, zoti Basha, dhe kemi respektuar të gjitha procedurat e Rregullores.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Ju lutem! Nuk mund ta merrni fjalën, ju lutem! Sot e keni fjalën marrë tërë kohën. Ju lutem, të respektojme Rregulloren!

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për Eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financës dhe Ekonomisë (do ta merrni përsëri fjalën për këtë çështje), miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksave dhe parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë”. A ka pyetje për projektligjin? Nuk ka.

Fillojmë me diskutimin në parim për paraqitjen e projektligjit nga nismëtari.

Zonja Ibrahimaj, keni fjalën.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Zoti Basha, ju lutem, urdhëroni! Ju lutem, vetëm fokusohuni në procedurë!

**Lulzim Basha** – Sigurisht që duhej të ma kishit dhënë fjalën për replikë, sepse ministri doli këtu dhe përmendi emrin e një deputeti. Rregullorja është fare e qartë. Unë nuk përmenda asnjë emër, përmenda vetëm fakte dhe njerëz të lidhur me fakte, sepse mua pak më intereson se cila është lopata me të cilën vjedh Kryeministri. Mua më intereson që këto para dalin nga xhepat e shqiptarëve dhe i shtyjnë ata e më thellë në varfëri; më intereson ta ndal këtë gjë me çdo mënyrë dhe mjet. Kjo më intereson mua. Prandaj nuk përmenda fare asnjë emër.

Ndaj, meqë u mor fjala për procedurë, por nuk u përdor për procedurë, sepse kjo ju nuk pëlqen, sepse standardin e dyfishtë ju e hani bashkë me turpin. A doli këtu për procedurë?! A foli për procedurë?! Sigurisht, që jo! Atëherë unë kërkoja replikën dhe i thashë Kryetares së Kuvendit: “Nuk më duhet shumë kohë, më pak se një minutë”. Dijeni vendin tuaj; dijeni vendin tuaj, sepse, edhe kur e ngatëroni, unë nuk do t'ju ngatëroj. Çiraku është çirak, ustai është usta. Ustai ia ka mbathur, që të mos japë përgjigje. Mos merr rolin e ustait, rri në rolin e çirakut që, edhe kur të vijë dita e përbaljes, të mos i ngatëroni rolet, siç mendon ai që mund t'ia hedhë, duke u lënë çirakëve të tij përgjegjësinë për të gjitha gjëmat, korrupsionin, batërdinë, varfërinë dhe shkatërrimin e gjithçkaje që ka pasur në dorë, në veçanti në 2 vjetët e fundit, që ka sjellë këtë situatë katastrofike për familjes shqiptare. Pra, ustai, që do ta heqë vëmendjen nga hallet e shqiptarëve, ia mbathi. Çiraku t'i mëshojë vendit e t'i kthejë përgjigje propozimit tonë të plotë, ku ulja e TVSH-së nga 20% në 6% është për shqiptarët.

Unë e di që juve as ju intereson fare, as jua ndjen fare për shqiptarët, por ne nuk jemi këtu për ju, nuk na ka marrë malli për ju, as besoj se do të na marrë ndonjëherë malli për ju. Ne jemi këtu për një interes, që është përtej interesit të Partisë Demokratike, për të bërë gjithçka që, pas masakrës zgjedhore, këtij vendi t'i kthehen legjitimiteti dhe demokracia, por në këtë moment emergjence minimumi i minimumit jepuni shqiptarëve atë që është e shqiptarëve: uleni TVSH-në nga 20% në 6% për shportën ushqimore!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Ibrahimaj.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Ju lutem, mos flisni nga vendi!

Zoti Ahmetaj, ju lutem, ia kam dhënë fjalën zonjës Ibrahimaj!

**Delina Ibrahimaj** – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – Zoti Ahmetaj, ju lutem, ia kam dhënë fjalën zonjës Ibrahimaj.

**Delina Ibrahimaj** – Sot ndodhem përpara jush për të prezantuar projektligjin që lidhet me emetimin e instrumentit të Eurobondit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – Zoti Ahmetaj, zoti Basha, ju lutem, mos flisni nga vendi!

Zoti Ahmetaj, ju tërheq vëmendjen!

Fjala për zonjën Ibrahimaj.

Zonjë, vijoni!

**Delina Ibrahimaj** – Sot ndodhem përpara jush për të prezantuar projektligjin që lidhet me emetimin e instrumentit të Eurobondit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Kjo është hera e pestë që Shqipëria kërkon financim në tregjet e kapitalit ndërkombëtar përmes Eurobondit. Ky transaksion do të na ndihmojë të përmbushim nevojat tona financiare për realizimin e reformave ekonomike, gjithashtu, përbën një mundësi për të pasqyruar perspektivat optimiste afatmesme kundrejt investitorëve.

Më lejoni t'ju paraqes një vështrim të përgjithshëm të situatës së borxhit në vend. Nevojat e lindura për financim, si rezultat i goditjes së dyfishtë të ardhur nga tërmetit i nëntorit të vitit 2019 dhe nga pandemia e COVID-19, ndikuan në rritjen e borxhit publik. Por, ndryshe nga çfarë thuhet këtu në parlament, ky borxh shkoj për të financuar investime, projekte, të cilat po përkthehen në rritje ekonomike. Siç është thënë edhe nga FMN-ja, rritja ekonomike në 6- mujorin e parë në Shqipëri është më e larta në rajon.

Rreth 83% e borxhit sovran të Shqipërisë është afatgjatë. Borxhi i brendshëm përbën 54,4 % të totalit të borxhit ose 697 miliardë lekë, ndërkohë që borxhi i jashtëm përbën 45,6 % të totalit të stokut ose 585 miliardë lekë. Është e rëndësishme që shifrat e lartpërmendura të shihen nga një këndvështrim dinamik dhe të analizohen se si kanë ndryshuar me kohën. Interesat e borxhit kanë ardhur në rënie. Në vitin

2020 Shqipëria pagoi rreth 34,39 miliardë lekë interesa ose 2% më pak se një vit më parë, ndërkohë që, në krahasim me vitin 2010, këto ishin 17,3% më pak. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së menaxhimit të borxhit, ku rëndësi të veçantë kanë daljet në tregjet e huaja të kapitalit, pasi norma e interesit është më e ulët sesa ajo e tregut të brendshëm. Patjetër që ka ardhur edhe si rezultat i kushteve të favorshme në tregje, ku normat e interesit kanë qenë më të ulëta, por edhe kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë e lartë, duke treguar një kredibilitet të investitorëve ndaj qeverisë shqiptare. Për më tepër, maturiteti mesatar ka ardhur në rritje dhe kjo ka kontribuar në përmirësimin e ndjeshëm në drejtim të menaxhimit të riskut dhe të rifinancimit. Risku i normave të interesit, gjithashtu, është reduktuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normat e interesit në harkun kohor të një viti është ulur ndjeshëm. Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës të titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshëm në portofolin e borxhit. Emetimi i Eurobondit vjen në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit Publik të hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Instrumenti pritet të ketë një madhësi rreth 700 milionë euro dhe maturim 7-10 vjet, në varësi të kushteve të tregjeve financiare ndërkombëtare. Aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë është drejt fundit të përgatitjes së dokumentacionit.

Jemi konsultuar me këshilltarët tanë ndërkombëtarë për kohën e përshtatshme për realizimin e transaksionit për të siguruar rezultatet më të mira në terma çmimi dhe vëllimi dhe po punojmë me intensitet që në fillim të muajit nëntor Shqipëria të dalë në treg. Financimi i siguruar nga Eurobondi do të përdoret për mbështetje të përgjithshme buxhetore, e cila do të alokohet për shpenzime publike në sektorë kyçë, si: arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastruktura, si dhe në mbështetje të investimeve publike, të cilat synojmë t'i ruajmë mbi nivelin 5% të PBB-së. Një pjesë e Eurobondit do të mbetet në Thesar për nevojat e financimit për vitin 2022. Pas emetimit të këtij Eurobondi, niveli i borxhit në valutë pritet të shkojë rreth 50% kundrejt stokut total të borxhit.

Në terma afatmesëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë synon ta mbajë këtë tregues në nivelin 46-48 %. Kujtoj se aktualisht qëndrojmë nën kufirin 55%, të përcaktuar nga strategjia afatmesme e menaxhimit të borxhit publik, e cila është miratuar dhe është draftuar në bashkëpunim me FMN-në.

Siç është thënë më parë nga qeveria, politika fiskale ekspansioniste e Shqipërisë është projektuar si një përgjigje ambicioze për të zbutur ndikimin e goditjeve ekonomike dhe për të siguruar një rimëkëmbje të qëndrueshme. Duke parë drejt së ardhmes, prioriteti ynë mbetet të forcojmë stabilitetin makroekonomik të vendit, duke synuar një rënie graduale të borxhit publik. Borxhi i qeverisjes qendrore pritet që në fund të vitit 2021 të arrijë nivelin 80% të PBB-së, i ndikuar nga emetimi i Eurobondit dhe nga disbursimi i disa mbështetjeve buxhetore që janë në proces.

Sipas draftkuadrit makro të finalizuar këto ditë, niveli i borxhit do t'i rikthehet trajektore rënëse, duke nisur nga viti 2022 dhe duke arritur nivelin e rreth 74,9% të PBB-së në fund të vitit 2025. Këto parashikime janë në linjë edhe me të gjitha pritshmëritë e organizatave ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Basha nuk është.

Fjala për zotin Taulant Balla.

Fjala për zotin Erion Braçe.

**Erion Braçe** – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Në fakt, do të doja që kryetari i opozitës të ishte këtu, se, më thënë të drejtën, foli shumë dhe i meriton disa përgjigje.

Së pari dhe, mbi të gjitha, ky personalizim prej 3 orësh e 5 minutash këtu, që vret parlamentarizmin dhe zhbën rëndësinë e fjalës së çdo deputeti në këtë sallë, natyrisht që nuk i duhet kurrkujt, mbi të gjitha, nuk u duhet shqiptarëve; është i përsëritur dhe është bërë aq i padobishëm, sa nuk ka ku të shkojë më.

Së dyti, në përgjigje të asaj që tha zoti Basha, do të doja të thosha sa më poshtë vijon: e para dhe, mbi të gjitha, m'u bënë nja 30 vjet punë dhe jam krenar për çdo ditë të punës sime. Nuk i kam rënë kujt në qafë dhe, me thënë të drejtën, nuk i kam kurrkujt asnjë borxh. Do të vazhdoj të punoj, ashtu siç kam punuar.

Po, patjetër, kam qenë edhe zëvendëskryeministër; e kam bërë atë punë në shërbim të qytetarëve dhe në përmbushje të interesit publik qoftë me titull, qoftë edhe si dezurn, por me zor njeri në detyrë për të vrarë njerëz nuk më ka mbajtur; as nuk ka ndodhur dhe nuk ka për ndodhur kurrë të më përdorin për të vrarë njerëz në mes bulevardit, në mes të ditës për nevoja të familjes dhe të pushtetit. Duke thënë këtë, (për konsekuencë qëndrimesh, tha, zotëria pak më herët), nuk arrij ta kuptoj se çfarë do të thotë veting politik. Ka vetëm një veting: vetingu është penal për të gjithë, veçanërisht për ata që vrasin, një veting që e bën patjetër prokuroria, por jo për të larguar nga politika, por për të çuar në burg si shpajm për gjakun e atyre 4 njerëzve të pafajshëm të vrarë mu në mes të bulevardit. Ky është vetingu.

Më falni, për shprehjen, o zoti Basha, ke bythë për këtë veting? Për këtë ke, se boll dëgjuam sot 3 orë demagogji?

E treta, pa diskutim që unë di shumë, di aq shumë, sa zotit Basha nuk ia merr mendja fare.

Duke thënë këtë për shkak të detyrës, patjetër që di edhe për procesin e rindërtimit, për aq sa më ka takuar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që ka qenë një nga agjencitë kyçe të gjithë procesit të rindërtimit. Do t'ju jap disa shifra që, në dijeninë time, janë këto dhe janë të vërteta: 100 mijë metra katrorë sipërfaqe ndërtimore në arsim për 3,9 miliardë lekë me një kosto prej 326 eurosh për metër katror; 470 mijë metra katrorë sipërfaqe ndërtimore në pallate me 16,8 miliardë lekë dhe me një kosto prej 295 eurosh për metër katror. E dini pse? Sepse nga fillimi deri në fund Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka zbatuar vetëm një parim: çmimin më të lirë të të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në garë.

Tani të të bëj një pyetje, meqenëse je atje ku je, në Hamallaj sa është çmimi për metër katror i shtëpive dhe i vilave? Është ngjitur atje me rezidencën të re qeveritare të njërit këtu. E ka ai Zamiri edhe atë. Sa është metri katror? Po këtu, në Farkë, sa është metri katror i asaj rezidencës tjetër?

Të vijmë te një pikë tjetër, që kishte të bënte me ushqimet. “Ke ushqimet e njerëzve”, thotë zotëria. A ta pyes pak: e di sa është çmimi i vajit sot? Po çmimi i sheqerit, i miellit, i orizit apo i vezës e di zoti Basha sa është? 16 vjet në një lagje dhe nuk e pashë kurrë të bënte

ndonjëherë pazar. Kur nuk bën pazar, nga do ta dish? Kur merr njerëz për të të bërë pazarin, as e ndien çmimin dhe as e di se sa është çmimi; kurrë! Duke thënë këtë, edhe këtu, edhe në këtë pikë as ia ndjen fare për njerëzit e zakonshëm, fare! Ja, po jua them unë. Një njeri që nuk e di sesa i kushton ajo shporta e ushqimeve mujore, pra nuk ulet të bëjë llogari: “Ore, si e nxjerr muajin unë?!” as ka nga ta dijë dhe as ka nga t’i vijë ndjesia për ata të tjerët që nuk kanë para për të blerë ushqimet. Ka thjesht një interes: 150 milionë eurot, siç e tha, për Zamirin, për Gimët, për Fiqot, për Grigorin, për tjetrin e për tjetrin që janë në këtë treg, që kontrollojnë çmimet dhe, natyrisht, bëjnë pazar shpeshherë me politikën. Pra, po them që në një treg normal, në një treg që ka rregulla, në një treg ku funksionon konkurrenca dhe liria, patjetër që ulja e taksave ka edhe efekte, shkon edhe te qytetari, por në një treg ku çmimet i përcaktojnë këta, 150 milionë euro do të shkojnë drejtpërdrejt për këta, jo për popullin, as për qytetarët.

E fundit që kam përsëri me zotërinë në fjalë: kostoja e ushqimeve sot është shtrenjtuar, por ka një numër, për të cilin folëm edhe 2 javët e shkuara, pra 41,6 % e buxhetit të shqiptarëve shkon për ushqime dhe është më pak sesa 46,7% që ishte në vitin 2013, është më pak sesa 48% që ishte në vitin e krizës, në vitin 2010. Patjetër, more, mund t’ia bëni kështu gjithë ditën, po kur nuk keni matur kurrë, nuk keni çfarë u bëni këtyre numrave.

Patjetër që ky zotëria, edhe ju, ka problem me njerëzit që punojnë. Nuk e di se ku hyri puna e diellit, e cilësisë së tij, me fermerët e Lushnjës. Ka një rrezatim të veçantë, ka një rrezatim ndryshe që pjek edhe kungullin, madje edhe e djeg, pavarësisht bojës së flokëve, pavarësisht se sa herë e lyen flokun jo me brilantinë, por me bojë.

Për Eurobondin apo për borxhin kam dëgjuar shumë, e dëgjova edhe këtu pak më herët. Pa më të voglin diskutim që askush nuk do të jetë në borxh, askush nuk do të marrë borxh, askush nuk do të jetë i varur prej borxhit, por borxhi nuk është tabu. Të dëgjosh këtu ligjërime nga të djathtët që flasin për borxhin me terminologjinë e Enver Hoxhës, natyrisht që është për të ardhur keq. Por, mbi të gjitha, të mbetesh kaq mbrapa, në raport me evoluimin që ka trajtimi mbi borxhin, aq sa edhe Kina sot

është bërë tregtare e madhe politike borxhi, natyrisht që nuk shkon.

Pa diskutim unë u qëndroj të gjitha atyre që kam thënë (për konsekuencë politike, tha ai më parë) lidhur me borxhin në kohë të ndryshme dhe për nevojën për të. Një gjë është shumë e rëndësishme: kuptohet që e gjithë bota tani po e trajton borxhin si një instrument strategjik për të blerë të ardhmen, jo për të blerë pushtet. Është themelore kjo gjë për ta kuptuar, sepse vendosen prioritetet për ato borxhe që merren.

E kemi menaxhuar mirë borxhin?! Po, patjetër! Ka disa elemente shumë të rëndësishme, duke filluar nga afati i maturimit, që pothuajse është dyfishuar në harkun e 8 vjetëve, interesat që thuajse kanë rënë me 4-5 herë. Këto nuk janë shifra numerike që thjesht e vetëm i japin mundësi të mburret me borxhin. Nuk ka mburrje me borxhin, askush nuk do që të jetë në borxh, por janë mundësi që krijojnë një hapësirë fiskale. Patjetër, është përdorur borxhi, veçanërisht gjatë këtyre 2 vjetëve të fundit, i vlerësuar, i certifikuar edhe nga Fondi Monetar, edhe nga Banka Botërore, por ka pasur një qëllim: jetët e njerëzve dhe ekonominë e tyre, siç thuhet në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Tani ka ardhur momenti që të rikrijojmë hapësirën fiskale, të krijojmë një mundësi, me qëllim që të përballojmë çdolloj sfide që vjen. Kjo gjë vendoset këtu në parlament për të kontrolluar, për të dhënë llogari dhe për të qenë transparentë. Çdo qeveri vjen këtu për borxhin, duhet të vijë këtu për borxhin, duhet të japë llogari këtu për borxhin dhe, natyrisht, në fund fare të gjithë bashkë duhet të vendosin se çfarë ndodh me të. Po flasim për të ardhmen. Ne e kemi shtyrë me disa vjet nga mirëmenaxhimi i borxhit...

*(Bie gongu.)*

A mundem?

Nga mirëmenaxhimi në harkun e 4 vjetëve të fundit, veçanërisht, posaçërisht, por pa diskutim që kjo ka të bëjë dhe diskutohet me secilin këtu. Ka një rrezik që i vjen ekonomisë, që thuhet në mënyrën në të qartë të mundshme në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe në raportin e Bankës Botërore, çmimet projektohen si një risk, por kalimtar, në të gjithë botën për shkak të presioneve inflacioniste.

**Lindita Nikolla** – Zoti Braçe, përfundojeni, ju lutem!

**Erion Braçe** – Mbarova!

Rreziku më i madh është pandemia, thuhet aty. Tani si sot të harxhosh 3 orë e gjysmë për të bërë të bukurin këtu dhe për 2 muaj rresht ta bësh këtë punë këtu e të mos thuash një herë të vetme, të mos përsërisësh një herë të vetme një thirrje, si kryetar opozite, institucion kushtetues: vaksinohuni! Sepse, nëse nuk vaksinohemi në parametrat makroekonomikë që kemi, me një mundësi kufizimesh, po përsëri ky vend do të vuajë shumë, shumë më tepër sesa të tjerët. Ky është rreziku që çlirohet vetëm me vaksinim.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Gazment Bardhi.

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur bashkëqytetarë,

Sot do të lodheni duke dëgjuar nga qeveria për suksesin e madh të marrjes së një borxhi të ri. Do të lodheni duke dëgjuar se sa mirë jetoni për shkak të suksesit të jashtëzakonshëm ekonomik dhe se sa shumë ka punuar kjo qeveri për të na siguruar këtë borxh kaq të mirë!

Ka një fjalë që thotë: “Borxhi është varfëria më e keqe”. Ajo çfarë qeveria na propozon sot është marrja e 2 borxheve paralele: 700 milionë euro për qeverinë e korruptuar të Edi Ramës dhe 70 milionë euro të tjera për OSHEE-në e vjedhur të Ard Çelës. Këto 2 borxhe do t’u shtohen 3,3 miliardë eurove të tjera që Edi Rama i ka marrë borxh që kur erdhi në krye të qeverisë. Është Kryeministri që mban rekord për borxhin e marrë në 30 vjet. Mbi 4 miliardë euro nga rreth 10 miliardë, që është borxhi publik i krijuar në gati 30 vjet, janë marrë vetëm nga Edi Rama. Por rekordi më i zi i Edi Ramës nuk është te marrja e borxhit, por te mënyra sesi ky i ka shpenzuar paratë. A i ka çuar këto para për të hapur vende pune? E dimë të gjithë që përgjigjja është jo! Shqiptarët po ikin nga sytë këmbët si refugjatë, sepse këtu nuk ka punë. A i ka përdorur këto 3,3 miliardë euro të marra borxh, pa llogaritur borxhin e sotëm, për të ndërtuar një shtet në interes të qytetarëve, duke kursyer me tenderët, duke hequr dorë nga koncesionet abuzive, duke luftuar korrupsionin, duke nxitur garën në prokurimet publike, duke bërë procedurat më transparente dhe duke rritur llogaridhënien?! Të gjithë e dimë që jo! Nuk ka bërë asgjë nga këto që u interesojnë qytetarëve! Edi Rama ka vepruar me paratë e shqiptarëve fiks si një person që, sa

herë merr ndonjë kredi për të kryer punë të vogla në shtëpi, merr në telefon shokët e bën ftesën më qesharake në botë: “Sot kemi festë, do t’ju jap një darkë, se kam marrë kredi”. Kështu ka bërë edhe Edi Rama. Vetëm se ai nuk e ka me darkë harxhimin e lekëve të kredisë, por me tenderë, koncesione të paracaktuara për klientët, që na zhysin gjithnjë e më shumë në borxh, gjithnjë e më shumë në varfëri, pa ua kthyer mbrapsht investimin shqiptarëve.

Është qeveria që ka ndërtuar më pak rrugë, shkolla dhe spitale me më shumë lekë. Arsyeya është e thjeshtë: sepse vjedhin! Marrin borxh, siç po marrin sot, dhe këto para i ndajnë me një grusht njerëzish, me të cilët janë në biznes; ndajnë rryshfetin bashkë, pastrojnë paratë e korrupsionit bashkë.

Rasti më flagrant është ai i inceneratorëve. Foli sot gjatë edhe Kryeministri për to. Nga njëra anë qeveria thotë se s’ka para dhe i duhet të marrë borxh. Nga ana tjetër, paratë e borxhit shkojnë për të mbushur llogarinë në parajsë fiskale të impianteve të mbetjeve. Për 3 inceneratorët në Tiranë, në Fier dhe në Elbasan shqiptarët kanë paguar deri më sot rreth 80 milionë euro dhe deri në fund të kontratave korruptive duhet të paguajmë 400 milionë euro. Pra, e thënë më thjesht: Edi Rama u rrit borxhin e shqiptarëve për të paguar 2 njerëzit e dukshëm të inceneratorëve: Klodian Zoton dhe Mirel Mërtirin.

Cilët janë njerëzit e padukshëm pas inceneratorëve? Kemi paraqitur fakte për Edi Ramën, për Erion Veliajn, për Arben Ahmetajn. Sot do të prezantojmë disa fakte për Damian Gjijnurin, pak më vonë edhe për Belinda Ballukun. Të gjithë këta janë gati të hanë kokat e njëri-tjetrit për pushtet, por, kur vjen fjala për të paguar inceneratorët, lufta e klaneve harrohet. Me borxhin e marrë në emër të shqiptarëve paguhen qindarkë më qindarkë, dje me firmën e Damian Gjijnurit, sot me firmën e Belinda Balkukut dhe të Erion Veliajt miliona e miliona euro për kryeveprën e korrupsionit të kësaj qeverie: inceneratorët e Tiranës, Elbasanit dhe të Fierit.

Sot nuk do të flas për rolin e Arben Ahmetajt, sepse është fakt publik tashmë që, kur njerëzit e emëruar nga prej tij votonin për projektin e Klodian Zotos dhe Mirel Mërtirit në Tiranë, Arben Ahmetaj ishte me pushime me



përfituesin kryesor: Mirel Mërtirin. Kjo është dokumentar nga policia maqedonase gjatë aksidentit me makinë të dy miqve dhe ortakëve në biznes.

Por rol kyç në pasurimin e miqve të tij në skemën mafioze të inceneratorëve ka pasur edhe numri 2 i sotëm i Partisë Socialiste, Damian Gjikhuri. Ai ka rol kyç në skemën mafioze të inceneratorëve për të grabitur paratë e marra borxh në emër të shqiptarëve dhe për t'i çuar ato në parajsë fiskale. Ky nuk ka pasur fatin e keq të bëjë aksident me Mirel Mërtirin, si Arben Ahmetaj, por rezultoi se ka udhëtuar 15 herë me përfituesit kryesorë të inceneratorëve: Mirel Mërtirin dhe Klodian Zoton.

Këtu janë të gjitha datat, duke filluar nga data 20 nëntor 2013, asokohe ministër. Udhëtime të tre bashkë me avion, me makinë, me anije, me jaht, madje edhe me charter. Prej ditës së parë në pushtet kanë udhëtuar bashkë, kanë planifikuar bashkë dhe kanë miratuar që borxhin, e marrë në emër të shqiptarëve, të mos e çojnë për investime për shqiptarët, por ta çojnë tek inceneratorët, fillimisht në Elbasan me kontratën e vitit 2014. Dokumentet tregojnë se Damian Gjikhuri ka udhëtuar me Klodian Zoton dhe Mirel Mërtirin (këtu janë të dhënat nga sistemi TIMS) dy herë brenda një muaji gjatë javës, përpara miratimit të kontratës koncesionare në qeveri, ku përgjegjës direkt ishte Damian Gjikhuri si ministër i Ekonomisë dhe Energjisë.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Ja, se kam edhe dy pyetje. Ulu, të lutem!

E sigurt është se marr vesh më shumë sesa ti.

E njëjta skemë është përsëritur sa herë miratohej një kontratë koncesioni e inceneratorëve. Meqenëse erdhi tani zotëria, se kishte punë, këto udhëtimet me dy mafiozët e inceneratorëve, di gjë se për çfarë arsyeje i ke bërë? Sepse ke qenë ministër dhe ke firmosur për t'u dhënë miliona euro.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Ja, ja ku i ke. Teams-i këtu. Do t'i dorëzoj në fund të fjalës sime.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Do t'i dorëzoj në fund të fjalës sime.

Përpara se të thërras SPAK-un, zoti Gjikhuri, i zgjedhur nga Edi Rama si numri dy i Partisë Socialiste, po të bëj edhe nja dy pyetje të thjeshta. Sa herë ke bërë pushime në shtëpinë e

përfituesit të inceneratorëve, Mirel Mërtirin në Maltë, zoti Gjikhuri?

Për qytetarët që na ndjekin, Malta konsiderohet si parajsë fiskale për fshehjen pas kompanive guaskë të miliarda eurove që qarkullojnë. Nuk është çudi, të dashur qytetarë, e këtë e kam edhe paralajmërim, që edhe paratë që janë marrë borxh këta tetë vjet, e që u janë dhënë inceneratorëve përmes Mirel Mërtirit dhe Klodian Zotos, të kenë përfunduar në Maltë. Madje mund edhe të pyesja në mënyrë retorike, në mos ke ndonjë shtëpi në Maltë, të regjistruar në emër të ndokujt tjetër, apo ndonjë llogari të fshehtë bankare, të krijuar pas dhënies me koncesion edhe me ndihmën tënde, zëvendës i Edi Ramës në Partinë Socialiste.

Sot, në fakt, po ndalem këtu. Nuk po të pyes me detaje në lidhje me lejet minerare dhënë ortakut të inceneratorëve, lejet e HEC-ve e të energjisë, tenderët nga OSHEE-ja, sepse nuk më del koha me këto dhjetë minuta që kam sot.

Sot po mjaftohem duke të thënë se kjo është më e komplikuar se skema e blerjes së zgjedhjeve. Koka e Edi Ramës për vjedhjet e zgjedhjeve, nëse drejtësia bën detyrën e saj, nuk do të shohë tërmet, por cunam.

SPAK-u, që gjej rastin t'i bëj thirrje nga këtu, ka mundësinë e tij të artë që të hetojë këtë çështje, për të shkuar nga Damian Gjikhuri, Arben Ahmetaj e deri tek Edi Rama. Duhet vetëm pak vullnet, siç duhet vullnet për të hetuar edhe megakorrupsionin në operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike nën kryesimin e drejtuesit politik të Edi Ramës në qarkun e Durrësit, Ad Çela, për të cilin do të marr fjalën gjatë projektligjit tjetër.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Replikë, po. Fjala për zotin Gjikhuri.

**Damian Gjikhuri** – Në fakt, nuk është se doja ta merrja fjalën, por krejt rastësisht dëgjova emrin tim këtu.

Ju keni një problem, zotëri, sepse këtu pak më parë, ose para disa vitesh, kur unë isha ministër, keni bërë edhe një interpelancë për atë çështje. Madje, këtu ka qenë një zonjë, që u ngrit për këtë punë. Ju problemin e keni me kontratat e inceneratorëve dhe se si i kanë lëshuar ato, apo me personat në fjalë, përpara se të ishin inceneratorët? Se këtë s'po e kuptoj unë.

E dyta, në ato kontrata, ministria që unë kam drejtuar nuk ka asnjë rol, kështu që mos i ngatërrohi gjërat.

E treta, nuk mund të them se ato janë kontrata të gabuara, sepse nuk jam nga ata që thonë se meqenëse s'kam firmosur dhe nuk kam unë përgjegjësi, them se nuk është bërë mirë vendi.

Në lidhje me skemën ekonomike, për të cilën keni bërë kallëzim, çojeni deri në fund! Nuk kam asnjë problem me të. Ama të përmendësh këtu shpifje: jo Malta jo ajo, këto, nuk është diçka etike për ty njëherë, që mbahesh si jurist dhe sikur di. Kështu që, ti Gaz, kaq e ke. Ti edhe në jetë atë tip ke pasur. Maksimumi do të rrih te hija e tij, sa të qëndrojë edhe ai në krye, se të tjerët e kanë marrë në dorë këtë punë, e do të harrohesh edhe ti bashkë me ta. Kështu që, mos u mundo të ndërtosh karakterin tënd politik mbi shpifje, me ato grafika që nxjerr, se s'të bën asgjë. Ja ku po ta them publikisht: në qoftë se gjen se unë e kam vizituar më shumë se një herë Maltën, sepse vetëm një herë e kam vizituar, kur kam qenë ministër, po kjo është e vërtetë, por po gjete dy udhëtime të miat në Maltë, unë iki nga kjo sallë. Dil publikisht dhe thuaj! Po gjete më shumë se një udhëtim, sepse një herë kam qenë, kam qenë në tetor të vitit 2017 ose 2018, në mos gaboj, një udhëtim, por nëse gjen një udhëtim të dytë në Maltë, thuaje, se do të jesh ti ai që duhet të japësh dorëheqjen. Dil e thuaje këtu! Ose iki unë, ose ikën ti. Dil këtu, eja e thuaje këtu publikisht.

*(Ndërhyrje nga salla)*

**Lindita Nikolla** – S'ka replikë mbi replikë.

Fjala për zonjën Jorida Tabaku.

Për procedurë, urdhëro!

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, prisja të shpjegoje këto udhëtime me mafiozët e inceneratorëve...

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Me mafiozët e inceneratorëve...

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Prisja përgjigje për pyetjen nëse ke apo jo llogari të fshehtë në Maltë.

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Prisja të përgjigjeshe. Do të dal te procedura. Prisja të përgjigjeshe nëse ke apo jo shtëpi të fshehur në emrin e ndonjërit prej miqve të tu. I kanë marrë 400 milionë euro shqiptarëve

këta. Këta me të cilët udhëton ti me çarter, me jaht, me anije, me avion, me makinë. Këta.

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Këta. Po, po, këtu.

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Ta gjej unë: ja ku e ke këtu Teams-in.

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Teams-in, Teams-in këtu. Teams-in.

*(Deputeti Gjiknuri ndërhyrje nga salla)*

Shumë mirë që e njeh që në shkollë. Bën

mirë të mos flasësh shumë, se mund të të përdoren si të dhëna publike, kur të të thërrasin për të dhënë sqarime në lidhje me këtë çështje. Bën mirë të gjeshe edhe ndonjë avokat të mirë.

Faleminderit, zonja Kryetare!

**Lindita Nikolla** – Vetëm për procedurë nuk ishte fjala. Ju lutem, mos abuzoni me Rregulloren. Ju lutem!

Fjala për zonjën Jorida Tabaku.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Ia kam dhënë fjalën zonjës Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar qytetarë,

Unë besoj se seanca e sotme duhej të ishte një ndër seancat më të rëndësishme të parlamentit. Po diskutojmë për borxhin publik, po diskutojmë për detyrimin e shqiptarëve: sa ka qenë, sa është dhe sa do të bëhet? Por në fakt, këtu sharjet, retorika e ditës, propaganda, shpeshherë janë më të forta.

E kam dëgjuar ministren e Financave, e kemi diskutuar gjatë edhe në Komisionin e Ekonomisë, në lidhje me situatën e borxhit. Një gjë është e qartë, dhe shprehja standarde që ka shoqëruar këto dy muajt e fundit është: po marrim borxh, që të ulim borxhin. Është krenari e madhe që të marrim borxh. Në fakt, çdo fjalim fillon: "Dy sfida të mëdha ka pasur Shqipëria, pandemia dhe rindërtimi. Si i menaxhoi Edi Rama, nuk i menaxhon askush tjetër."

Domethënë, të dëgjosh çfarë flitet nga mëngjesi deri në darkë në komisionet parlamentare dhe këtu, në sallën e parlamentit, që injorojnë situatën ekonomike dhe flasin për një realitet totalisht tjetër, i cili nuk ekziston as në jetën e shqiptarëve, nuk ekziston as në llogaritë e shtetit, nuk ekziston në asnjë nga raportet ndërkombëtare që po dalin dhe po publikohen çdo ditë. Unë besoj se nuk ka mohues më të mëdhenj të realitetit se kjo qeveri që sot është këtu, dhe ajo që ka qenë për tetë vite me radhë.

Si është situata e shqiptarëve sot? Çfarë ka ndodhur në tetë vitet e fundit?

“Kemi dalë 5 herë ne tregun ndërkombëtar” - tha ministrja e Financave dhe Ekonomisë, “dhe kemi marrë borxh”.

Për çfarë është përdorur Eurobondi?

Në 2016-ën u morën 500 milionë euro borxh, për të larë një borxh 500 milionë euro të marrë dy vite më parë.

“Çfarë është bërë me borxhin?”, pyeti zoti Bardhi.

Qeveria ka dalë në treg përsëri, dy vite më pas, ka marrë 650 milionë euro të tjera borxh, me një nxitim të jashtëzakonshëm, përsëri për të paguar borxhin.

Është e vërtetë, jemi një forcë politike e djathtë, jemi një forcë politike që sigurisht nuk trembet nga investimet, nga infrastruktura, kur këto shkojnë atje ku duhet dhe investohen ashtu siç duhet, por jo të marrësh borxh, të shkatërrosh buxhetin e shtetit dhe të rritësh borxhin për çdo qytetar shqiptar me 1300 euro! 38% është rritur. Në 2013-n e gjetët me 2100 euro borxhin për frymë, ndërsa sot po shkon më shumë se 3400 euro borxh për frymë. Nuk besoj se ka pasur situatë më të vështirë ekonomike. Nuk besoj se ka pasur problematikë më të madhe me borxhin, sa ç’është viti aktual.

E kam thënë dhe e them: në qoftë se ne do të kemi projekte investimi për pandeminë, në qoftë se do të kemi projekte në infrastrukturë, për arsimin, që pothuajse është harruar nga kjo qeveri, ne mund ta shikojmë se si shkon Eurobondi dhe për çfarë shpenzohet. Por të marrim Eurobond për të mbuluar paga dhe pensione, për të paguar borxhin, pa pasur asnjë strategji, kur në të gjitha tregjet ndërkombëtare normat e interesit janë duke u rritur dhe kur buxheti i shtetit po paguan sot borxhet e OSHEE-së nga njëra anë, koston e korrupsionit të llogaritur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nga ana tjetër, unë besoj se është arrogancë, paaftësi dhe papërgjegjshmëri e jashtëzakonshme.

Si është përdorur borxhi?

Borxhi është përdorur për inceneratorët. Meqenëse zoti Damian Gjijknuri më përmendi, po kam bërë një interpelancë këtu në parlament me zotin Gjijknuri, në vitin 2017, në mos gaboj. Ka qenë një interpelancë ku asnjë nga qeveria nuk ktheu përgjigje për asgjë.

Kontrata korruptive, ku i gjithë shteti është ngritur në këmbë për t’i shërbyer një biznesi, për të mbrojtur një biznes, që sot po merr 400 milionë euro nga buxheti i shtetit. Kështu është përdorur borxhi.

“Borxhi është përdorur për kontratat dhe PPP-të,”- thotë FMN-ja.

Sot po arrijnë në mbi 50% të Produktit të Brendshëm Bruto koncesionet dhe PPP-të.

Këto janë shifrat e librave të qeverisë, këto janë shifrat që thotë edhe FMN-ja.

Të marrësh borxh dhe të mos i japësh asgjë ekonomisë, unë nuk arrij ta kuptoj e ta konceptoj. Ju morët 1 miliardë borxh gjatë pandemisë, por nuk u hodh në ekonomi. Po diskutojmë këto ditë edhe propozimin e Partisë Demokratike për uljen e TVSH-së për ushqimet dhe pijet joalkoolike.

Pak vite më parë e ulën TVSH-në për barnat, për ilaçet, dhe thanë, me një ligj, me një vendim qeverie: “TVSH-ja u ul dhe u ul çmimi i ilaçeve”. Ndërkohë, po të propozojmë të njëjtën gjë për ushqimet, kjo nuk ndodh. Sipas po të njëjtëve, që mbrojtën disa vite më parë uljen e TVSH-së në sistemin shëndetësor. Vijnë këtu dhe mbrojnë TVSH-në e jahteve, vijnë e mbrojnë edhe heqjen e rentës minerare, vijnë e mbrojnë çdo lloj ligji të mundshëm, por vetëm një ligj, me të cilin përfitojnë 95% e qytetarëve, nuk e mbrojnë dot.

Unë besoj se shifrat janë kokëforta, edhe shifrat e INSTAT-it. Nëse do të shikojmë se si janë familjet shqiptare sot, familjet shqiptare janë më të varfra. Një familje shqiptare, thotë INSTAT-i në vitin 2020, ka shpenzuar mesatarisht 13 % deri në 23% më shumë. Ka shpenzuar më shumë për ushqime, për arsim, si rezultat i rritjes së çmimeve. Kjo i ka varfëruar shqiptarët. Të ardhurat e disponueshme janë në rënie, janë në ulje, dhe sigurisht që ky varfërim do të reflektohet edhe në konsum. Përse mos ta ndihmojmë ekonominë, përse të mos e nxisim konsumin me politika të tilla, por të përpiqemi gjithmonë të mbrojmë e të mbulojmë më të fortin, jo më të dobëtin.

Përse ngrihet këtu një qeveri e tërë për të mbrojtur inceneratorët? Përse ngrihet këtu një qeveri e tërë për të mbrojtur kontrata koncesionare? Vetëm nëse janë të përfshirë vetë, mund ta kuptoj zellin, mund ta kuptoj mbrojtjen që u bëjnë.

Unë besoj se nuk ka skemë më korruptive, më kriminale, më mafioze se ajo e inceneratorëve. Ne e kemi çuar atë në SPAK, do t'i shkojmë deri në fund. Kemi kërkuar edhe ngritjen e një komisioni hetimor, se si ka mundësi që tre ministra, tre kryetarë bashkie, kanë mbështetur një kompani të krijuar nga zero, e cila ka marrë sot pjesën më të madhe të fondeve, siç thotë dhe raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit. 99.5% e të gjitha kontratave koncesionare gjatë vitit paguhen një më një, lek më lek. 54 milionë euro kanë marrë inceneratorët vetëm gjatë vitit të pandemisë, kur e gjithë bota ndaloi, vetëm inceneratorët vazhduan pagesat e tyre.

Këtë shqetësim kemi ne, që borxhi sot nuk po shkon në investime eficiente, borxhi sot nuk po shkon në ekonomi, borxhi sot, duke pasur parasysh edhe tendencën në tregjet ndërkombëtare për norma më të larta interesi, nuk po i shërben ekonomisë. Sot borxhi po merret për të mbuluar gropat e buxhetit, kontratat korruptive, dëmin ekonomik të shkaktuar.

Situatën që Shqipëria po kalon sot, që kaloi gjatë vitit të shkuar, sigurisht që nuk mund ta shohim të izoluar me tregjet ndërkombëtare. Për këtë situatë duhen marrë masa sot. Ekonomia ka nevojë për masa sot, përndryshe 100 mijë të tjerë do të dalin nga tregu i punës, ashtu siç dolën vitin e kaluar. Mbi 50 mijë biznese do të mbyllën, ashtu siç u mbyllën vitin e kaluar.

Duhet të marrim masa sot, e në qoftë se është e nevojshme, le të ulemi t'i shikojmë, t'i diskutojmë. Edhe propozimin tonë të TVSH-së, në qoftë se ka një bazë krahasimi, jemi të gatshëm ta bëjmë. Ta ofrojmë edhe atë ekspertizë, që ndoshta i mungon qeverisë.

U diskutua raporti i FMN-së. Sigurisht që raportet lexohen si kanë dëshirë. Disa të fryrë nga njëra anë, disa më të ulur nga ana tjetër. Raporti i FMN-së thotë: "Reduktoni të gjitha shpenzimet joprioritare. Miratoni vetëm ato shpenzime, të cilat janë të nevojshme për pandeminë."

Ndërkohë, edhe sot e kësaj dite, ndërkohë që jemi edhe në seancë, qeveria nuk e di akoma se sa do të shpenzojë për pandeminë. Mblidhet Komisioni i Ekonomisë një herë në dy javë, që miraton fonde shtesë për pandeminë. Është bërë buxheti i shtetit si fletore bakalli, që ndryshohet sa herë që kanë nevojë.

Në qoftë se është e nevojshme, i bëj thirrje edhe qeverisë, që të gjithë bashkë të dalim e të diskutojmë një buxhet për pandeminë, po ashtu edhe për rindërtimin, por problemi kryesor këtu nuk është as pandemia, as rindërtimi. Problemi kryesor këtu është korrupsioni.

Siç thoshte Kontrolli i Lartë i Shtetit në raportin e tij të fundit, pandemia dhe rindërtimi janë përdorur për arsye korruptive, tenderët janë bërë sekret, kur nuk duhej të ishin sekret, ndërkohë që nga ana tjetër, pjesa më e madhe e popullsisë shpenzon 41.7% të buxhetit të tyre për ushqime. Jemi në nivelin e mbijetesës. Ndërkohë që këtu diskutojmë shifra prej miliona e miliarda eurosh koncesione, një lek i vetëm nuk i shkon ekonomisë.

Ky është shqetësimi që ka Partia Demokratike. Këtë shqetësim do ta sjellim këtu, do të vazhdojmë ta diskutojmë në komisionet parlamentare. Punën tuaj nuk e bëjmë dot, është e vërtetë. Nuk e bëjmë dot punën tuaj, sepse juve ju mungon vullneti politik, po për t'i ngritur këto çështje për shqiptarët, nuk na ndalon askush.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Për replikë, zoti Gjijknuri.

**Damian Gjijknuri** – Në fakt, përgjithësisht, zgjedh të mos u përgjigjem shpifjeve, por qëllova këtu në sallë, e meqenëse shpifja përsëritet dhe shpeshherë njerëzit e përdorin si teknologji, që kush gënjen më shumë diçka do të mbetet, do t'i kthehem edhe një herë asaj që thatë vetë ju, zonjë, që bëtë atë interpelancën atëherë.

Në radhë të parë, në qoftë se i njihni politikat e këtij shteti, përcaktoni nëse problemin e keni me kontratën dhe modelin ekonomik të inceneratorëve, apo me persona? Një kjo.

E dyta: në qoftë se e keni me modelin ekonomik, thellohuni, shikoni përgjegjësitë, kush i ka bërë kontratat, si janë bërë kontratat dhe cili ka qenë autoriteti përgjegjës.

E treta: nuk mund të them se janë bërë gabim ato. Unë i mbroj, jo vetëm se kam solidaritet politik, por mbi të gjitha sepse e njoh shumë mirë aspektin pozitiv që kanë ato kontrata, përtej hamendjeve që mund të ngrihen apo shkeljeve që pretendohen. Ato çojnë në prokurori, nëse i keni! Por të dilet këtu nga ky tip karagozi politik, se kështu do ta quaj, me një skemë dhe ca fytyra aty, që i mendon çartera,

dhe kujton se ato kanë vlerë! Ti tashti të dalësh aty, nëse ke burrëri. Por ti nuk ke. Ty të dinë se kush je. Ku ke burrëri ti? Ti të dalësh e të thuash, siç thashë unë: në qoftë se gjen që Damian Gjikhuri ka qenë më shumë se një herë në Maltë, përveç vizitës zyrtare, të dalësh e ta thuash. Përndryshe, ose do të iki unë, ose do të ikësh ti.

E dyta, ato çartërat i shpik vetë, se unë s'kam udhëtuar ndonjëherë me çarter me asnjë nga ata persona. Ti shiko mirë se me kë ke udhëtuar. Kështu që, të lutem, se këto shpifje s'kanë asnjë vlerë. Po të doni, kthejuni interpelancës së zonjës, thellohuni më tepër në atë interpelancë, që keni bërë, dhe mos e nxirri në shitje foltoren tuaj, sepse kam frikë se e keni nxjerrë në shitje!

*(Ndërhyrje nga salla)*

Keni nxjerrë në shitje foltoren tuaj, jo atë foltoren tjetër. E keni nxjerrë në shitje për çdo lloj prurësi që ju jep pak lekë, dhe flisni këtu. Këtë di të bësh ti. Kështu që, nëse ke burrëri nga ana njerëzore, dil e thuaje këtu. Thuaj: "Po, jam i sigurt se ke qenë dy herë". Ai që ta ka thënë, kam frikë se ta ka thënë gabim.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Dil këtu publikisht. Në qoftë se gjen dy udhëtime në Maltë, do të iki unë.

**Lindita Nikolla** – Mbaroi fjala për ju!

*(Ndërhyrje nga salla)*

Për çfarë e keni, zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Për procedurë.

**Lindita Nikolla** – Po, urdhëroni, por, ju lutem, fokusohuni në procedurë! Përndryshe do t'jua ndërpres fjalën.

**Jorida Tabaku** – Patjetër!

Zonja Nikolla, faleminderit!

Zoti Gjikhuri, e kam lexuar të gjithë kontratën koncesionare të Tiranës, të Elbasanit e të Fierit. I kemi dorëzuar në prokurori. Sot, ndërkohë që flasim, janë në SPAK. I qëndroj çdo fjale që kam thënë katër vjet më parë. E gjithë qeveria u ngrit në këmbë: Kryeministri, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit, ministri i Mjedisit, ministri i Industrisë dhe Energjetikës, që ishit ju dhe bëtë interpelancën me mua, tre kryetarë bashkë: i Tiranës, i Fierit dhe i Elbasanit.

Ky është rrjeti i njerëzve që kanë lidhje me atë procedurë koncesionare: disa si autoritet kontraktues, disa si pjesë e sistemit të qeverisë për marrjen e vendimit. Por nuk më thotë dot

askush, që shtatëmbëdhjetë vendime qeverie brenda ditës, të marra për një kompani, për një kontratë koncesionare që lëvizi nëpër të gjitha ministritë, me mbi njëqind faqe, që dhanë mendim të gjitha ministritë, që u mor brenda ditës dhe doli në formën e vendimit të Këshillit të Ministrave në darkë, nuk është i përfshirë askush nga qeveria.

Sot të gjitha janë në prokurori: procedura, persona, ata që i kanë paguar lekët dhe ata që vazhdojnë t'i paguajnë lekët. U qëndrojmë të gjitha atyre që kemi thënë në 2017-ën.

Sot, unë e kuptoj që jeni i shqetësuar, sepse zoti Bardhi ka sjellë prova të tjera...

**Lindita Nikolla** – Kjo nuk është për procedurë, zonjë. Ndërpresim fjalën.

Urdhëroni, zoti Bardhi!

**Gazment Bardhi** – Faleminderit shumë, zonja Kryetare!

Të falënderoj, sepse sa herë që ju kërkojmë fjalën për procedurë, na e jepni, gjë për të cilën ju jam mirënjohës!

Të bëra një këshillë miqësore: mos harxho energji këtu! Ruaji energjitë për shpjegimet që do të duhet të japësh në SPAK, dhe jepu përgjigje atyre pyetjeve që unë të bëra. Përgjigje me pyetje e me sfida, se sa herë ke qenë ti në Maltë, ku ke qenë e sa ke qenë, këto shpjegoji kur të shkosh atje ku do të duhet të shkosh. Bëhu burrë, shko atje me një avokat të mirë dhe sqaroji!

**Lindita Nikolla** – Dakord!

**Gazment Bardhi** – Të lutem Kryetare, se do të dal te procedura.

Kjo është e para.

E dyta, meqë e ke marrë fjalën tri herë, akoma nuk kemi një përgjigje në lidhje me mafiozët e inceneratorëve, që u kanë përparë 400 milionë euro qytetarëve shqiptarë. Kanë marrë 80 milionë sot dhe s'kemi në punë inceneratorë. Digjen plehra në Durrës, në Fier, dhe në çdo qytet ka emergjencë mjedisore. A mund të na thuash: çfarë të lidh ty, zotëri, që në kohën kur këta marrin 400 milionë euro, ti i hipën avionit tri herë në muaj me të dy mafiozët, për pushime jashtë vendit?

**Lindita Nikolla** – Kjo nuk është procedurë. Do t'jua ndërpresim fjalën.

Fjala për zotin Dashamir Shehi!

*(Ndërhyrje nga salla)*

Kolegë deputetë, ju lutem, jo nga vendi!

**Dashamir Shehi** – E nderuara zonja kryetare!

Të nderuar kolegë!

*(Ndërhyrje nga salla)*

**Lindita Nikolla** – Kam dhënë fjalën ndërkohë.

**Dashamir Shehi** – Të them edhe unë nja dy fjalë për procedurë.

Zonja Kryetare, unë nuk pretendoj t'ju jap mend, por një këshillë të vogël, si të thuash. Besoj se kolegët këtu, fatmirësisht e paskan tepruar disa, por kemi gjithë mëngjesin këtu, që shohim se kryetari i opozitës dhe Kryeministri bëjnë replikë me njëri-tjetrin. Bëjnë shumë mirë, sepse kjo është jeta parlamentare, por kjo nuk mund të jetë pa fund. Se pastaj ky është dialog, nuk është më parlament. Unë mendoj se duhet vënë njëfarë kufiri për këtë punë. E kuptoj dëshirën që kanë për të folur, absolutisht, edhe unë jam pak llafazan, mirëpo kjo ka një kufi. Ne po e denatrizojmë parlamentin shqiptar.

Kështu që, e drejta dhe e mira është që atyre zotërinjve t'u jepet fjala, të kenë mundësi të flasin sa të duan, por jo pafundësisht.

E dyta, këta janë njerëz që kanë edhe hapësira të tjera. Kush e pengon Kryeministrin? Ai i ka të gjitha mediet atje, dhe mund të flasë nga mëngjesi deri në darkë. Ne një ditë në javë mblidhemi këtu. Na kanë votuar 140. Për çfarë? Për të dhënë ndonjë mendim, pra, se në qoftë se është vetëm për dy vetë kjo punë, hajde ta mbyllim dhe të ikim të gjithë, sepse nuk ka më vlerë, po them. Kjo do ta zhvlerësojë politikisht e moralisht këtë lloj salle, e cila nuk është e dy vetëve, as e tre vetëve, por e të gjithë shqiptarëve, ndaj kemi të gjithë të drejtë të flasin e të japim ide.

Të mos ofendohet askush nga kjo gjë, por unë besoj se përfaqësoj këtu një ide, që është nga të gjitha palët, sepse të gjithë e kuptojnë se kjo punë po teprohet. Javë për javë. Kaq për këtë.

Tashti le të flasim pak për këtë punën e borxhit.

E thashë edhe në komision, në Shkodër ka qenë një fjalë e vjetër, që pak a shumë thotë: “Lypa asht marre, por nuk të len pa gja.” Nuk e di kush ka këtu ndonjë damar që e lidh me Shkodrën, por kështu thonë.

Domethënë, një: lypja, të marrësh pare, është gjithnjë borxh. Dhe dy: është turp. Por prej hallit, merret. Ta fillojmë muhabetin siç duhet,

por e kujtoj edhe një herë: “Lypa asht marre, por nuk të len pa gja.”

Tashti, borxhi në kohët moderne, në financat moderne, sigurisht, po të ketë një sistem të mirë, interesa të ulëta, garanci për t'u kthyer, transparencë për atë që investohet, nuk është ndonjë gjë e keqe, sepse në fund të fundit çdo qeveri ka nevojë për para të lira në lidhje me këtë punë. Mirëpo kjo, minimalisht, kërkon një transparencë. Ta dimë, se ne po vazhdojmë të marrim e të marrim. Shërbimi i borxhit këtë vit, për shembull, është rreth 40 milionë. Në qoftë se ne do të vazhdojmë të marrim me këto ritme që kemi marrë këto katër-pesë vjetët e fundit, brenda pesë gjashtë-vjetëve do të ndodhë që shërbimi i borxhit të shkojë në tetëdhjetë milionë, nëntëdhjetë milionë. Domethënë do të bëhet një faktor negativ permanent në bilancin e Shqipërisë, në buxhetin e Shqipërisë, që do të vijmë ta miratojmë tani, pas dy javësh.

Kam dëgjuar shumë njerëz, që shohin ëndrra me sy hapur dhe që mendojnë se do të na e falin borxhin, sepse ia falën edhe Greqisë; ç'e gjeti Jugosllavinë? Pra, nga këto teoritë e kota, që i thonë kokëboshët e ekonomisë. Borxhi është borxh, more. Në qoftë se nuk shlyhet në një mënyrë, do të shlyhet në një mënyrë tjetër. Një vend që është borxhli, është peng për shumë gjëra. Në qoftë se nuk e shlyen ekonomisht, nga ana financiare, do ta shlyejë politikisht, do ta shlyejë duke dorëzuar disa nga sovranitetet e veta, do ta shlyejë në tavolinën e negociatave ndërkombëtare. Prandaj, borxhi duhet marrë me kujdes, duhet treguar sa është marrë.

Dëgjova këtu ca teori të tjera, herën tjetër, kur ishim në komision: që ata përpara nesh e merrnin borxhin me shumë interes, ndërsa ne e kemi përmirësuar, sepse e marrim me pak interes, a thua se po marrim pare me fajde këtu. Borxhi varet nga tregu ndërkombëtar: sa para të lira ka atje, sa janë çmimet në tregun ndërkombëtar. Në qoftë se në vitin 2009 është marrë me të vërtetë i shtrenjtë, 7,5, në 2009-ën ishte kriza financiare. Unë them: kush ka pasur guximin dhe ia ka dhënë Shqipërisë, kanë pasur njëfarë shprese, njëfarë besimi.

Ndërsa sot, që të jemi të sigurtë, për ata që s'e dinë, ka goxha parë në tregun ndërkombëtar. Kemi edhe një koperturë financiare nga Komuniteti European, që janë 15 miliardë për Ballkanin Perëndimor, të cilat u japin një garanci

investitorëve, por megjithatë kjo Shqipëria jonë e vogël dhe e dashur nuk ka qenë në gjendje të zbresë poshtë dy përqindjeve të interesit. Maqedonia, ata komshinj të tanë, i kanë marrë me 1,8, ndërsa ne i marrim me 3,5 e pastaj mburremi me këtë punë. Nuk është ndonjë zotësi kjo punë.

Megjithatë, nisur nga eksperiencia, unë them se edhe 3,5 nuk është ndonjë shifër e madhe, por duam të dimë se ku po shkojnë paratë e borxhit. Ku po shkojnë? Ku? E keni parë në ato ministritë e vjetra, kur varej një listë atje te xhami, në lidhje me shpenzimet që bëheshin? Tani marrim 500 milionë, marrim 700 milionë, por nuk ndjejmë detyrimin për të thënë se 50 milionë do të shkojnë për këtë punë, 37 milionë për këtë punë, 14 milionë janë për pandeminë. Pse s'e bëjmë këtë? Sepse ende nuk e kemi përcaktuar se si do t'i ndajmë, sipas interesave të këtij momenti.

Prandaj, do të thosha; borxh po, në princip s'jemi kundër, por borxh sa më të lirë, borxh i cili t'i mbajë ekuilibrat midis borxhit të brendshëm dhe borxhit të jashtëm, borxh i cili të mbajë ekuilibrat midis valutës dhe monedhës vendëse, borxh i cili është transparent dhe e dimë se ku shkon.

Ky është principi bazë, mbi të cilin mund të punojmë të gjithë. Pse them të gjithë, dhe jo vetëm një pjesë? Sepse kur të mbarojë mandatin kjo qeveri, mund ta mbajë edhe pas katër vjetëve, unë uroj shumë më përpara, por borxhin do t'ia lërë qeverisë tjetër që vjen, sepse borxhi është i shqiptarëve. Disave këtu mund t'u duket vetja sikur kanë dije të madhe, punë e madhe, marrim borxh, janë të zot etj. Ku jeni të zot ju? Në kurrizin tonë, në kurrizin e fëmijëve tanë?! Kujt po i marrim borxhe? Ne po u marrim borxhe kalamajve tanë, se ata do ta shlyejnë. Nuk u marrim borxh investitorëve, që janë atje jashtë.

Ky është principi që duhet të kemi parasysh, kur shkojmë të marrim borxh: që borxhin po ua marrim fëmijëve tanë, jo investitorëve, që janë në Amerikë apo ku di unë se ku janë, sepse për ata, punë e madhe, ata janë të mbuluar.

Kaq kisha për t'ju thënë. Nuk po merrem me makroekonominë e me shpjegime të tjera, sepse gjykoj se ajo që thashë në fillim ia vlejti më shumë sesa ky diskutimi i borxhit.

Kolegë, ju falënderoj! Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Përfitoj nga rasti t'ju uroj edhe ditëlindjen. Edhe 100, zoti Shehi!

*(Duartrokite në sallë)*

Fjala për zotin Agron Gjekmarkaj.

**Agron Gjekmarkaj** – Të nderuar deputetë,

Vetëm një ndihmë pata për të zgjidhur dilemën që me zu, nëse duhet të flas për punë ekonomie apo jo, meqë në profesion jam pedagog i letërsisë.

Më ndihmoi kujtimi i Kastriot Islamit, i cili pati thënë se nuk bëhet kurrë ministër financash, por u bë.

Por mbi të gjitha, Kryeministri i cili, piktor i mbaruar si ai, në ditët e tërmetit foli si inxhinier, aq sa zonja Bozo dukej si axhami para tij; si usta, aq sa usta Dinia desh la zanatin dhe desh hodhi plumbçen përtokë; si doktor në pandemi, aq sa doktoresha Çomo nuk guxoi të vinte në Kuvend; si dajrexhi, aq sa në Breg të Lumit hynë në krizë profesionale; si gogol që tremb gjithë Shqiptarët, sa asnjë aktor i mbetur kukudh pa teatër, s'e mund në rol.

Eurobondi, në fillim nga padija, m'u duk si seri e Xhejms Bondit, që u shfaq në një kinema të Tiranës, ku krejt yndyra e vendit, me kuç e me maç, mori pjesë e mbuluar, jo e veshur, me leket e huave marramendëse.

Thashë me vete: më mirë të darovis paqartësinë ekzistenciale, nëse është Ulsi Manja që i ngjet më shumë Edi Ramës, tashmë edhe ai me mjekër, apo Edi Rama Ulsiut në mendime, dhe të dy bashkë Alket Hysenit të ngratë, në pamje, në luk e në mendime.

U tundova të flas për ministren, që gjithnjë e më shumë i ngjan Majkell Xheksonit, dhe për rixha të Zotit nuk po e gjeja pse. Pse ngjan, do të pyesni ju. Për shumë kohë s'e kuptoja, po kur dëgjova nja dy fjalime, enigma u zgjidh vetë. Fjalimet e saj ishin këngë, këngë për liderin, këngë për progresraportin, këngë për rilindjen, këngë për integrimin, këngë kundër armiqve të tyre. Ngjakan, mejtova, se të dy qenkëshin këngëtarë të mëdhenj, ngjakan nga zëri dhe melodia.

Por e braktisa këtë ide dhe mendova të marr fjalën për procedurë, pas fjalimeve të Kryeministrit, me habi ta pyesja: me këto që thoni, ju jeni vërtet Kryeministri i këtij vendi apo mos bën gjoja, dhe ai i vërteti të përdor si sozi për t'u argëtuar?

E lashë nga droja se mos Kryetares së parlamentit, zonjës së dashur Linditë, i duket herezi e blasfemi dhe më ndëshkon, përpos shikimeve të vëngërta, edhe me nja dy javë dëbim si farisenjtë nga Tempulli. Nuk thotë kot fjala popullore: “Goja llap e shpina dap!” Por duke qenë se jemi të dy nga një zonë, nuk ia theva zemrën, ndërsa vetes i kurseva ndëshkimin.

Në Lezhë më thanë: “Fol or trim, pyete Kryeministrin, i cili nga kultura vjen e drejt asaj shkon, se me librin fle e mbi të zgjohet, që gjykimin e ka të epërm e të pagabueshëm, në kohën e duhur dhe të drejtë si profet: pse e la në vetmi poetin kombëtar Gjergj Fishta, sikur të ishte një poet veteran, një zborist a kapter i bashkisë së Lezhës, sikur të ishim pa qeveri e pa Kryeministër, që Zot mos e bëj llaf? Po të kishte qenë patronazhist, të madh do ta bënin peshqeshin, mendojnë ata. Himne e psalme me zë nimfe do t’u lexonte gjithë qeveria.

Por jo, partia më ka lënë detyrë të flas për Eurobondin, dhe nuk ia thyej zemrën asaj. Partia është mbi të gjitha, sidomos në këto kohe të zymta.

U rreka të di çfarë është Eurobondi?

Me durim si mësuesja zemërmadhe nxënësit përtac e trazovaç, zonja e dashur Tabaku ma shpjegoi se qenkësh borxh diku rreth 500 a 700 milionë euro. Atëherë u ftillova dhe vendosa të flas.

Ne fillim e mora me gëzim të madh. Sa shumë lekë, mendova, do të dalim në selamet. Sa gjëra mund të bëhen. Më erdhi ndërmend Torovica pa ujë të pijshëm, që prej dekadash lyp një ujësjellës, fusha e saj që ka nevojë për një hidrovor, që të thahet e të bëhet tepsi, dhe tepsitë ju i keni qejf, Shëngjini për pritë e gurta, që rëra të mos gërryhet nga erozioni, Rrila që kërkon një rrugë për të dalë në det, turistët me timon, se edhe timonin e keni qejf, një tjetër për Shëngjin në verë, që të mos bëhen 14 kilometra trafik për të zgjatur udhëtimi pa fund; Zadrime po, Kallmeti po një rrjet të ri elektrik, që mos të zhyten në errësirë pas çdo shiu; Ishull-Shëngjini një shkollë të re, se e vjetra po kalbet nga sëmundjet.

Ja, nga kjo foltore po i lutem përunjësisht zonjës Balluku dhe zotit Ahmetaj, që shquhet për zemërgjerësi, së bashku me zonjën Fridë, që mungon, me dorën përmbi zemër, që kur të vijë

babagjyshi me thesin e madh plot me parë, futeni dorën tuaj punëtore e të dhembshur, hidhni si sheqerin në dasmë, ca lekë mbi Mirditën, Lezhën e Kurbinin, sepse andej është krijuar përshtypja që Veriun nuk e konsideroni Shqipëri.

Po kaq besova se pedagogëve do t’u rritet paga sa atyre në Kosovë, policit që më ndaloi një ditë për dritat e fikura te stadiumi Dinamo, gjithashtu duhet t’i rritet diçka, sepse ishte me kredi, kishte një djalë katër vjeç dhe të shoqen pa punë.

Por ja, duke nxënë në punë ekonomie, mësova se borxhi publik qenkësh 80 % pa PPP, dhe se me to mbërrin 95%.

Por borxhi duket se po merret për të larë ca borxhe. E çfarë borxhi se. Gojë e liga, tonat, të opozitës, sepse ne jemi të ligjtë, thonë për atë të grabitjes së 25 Prillit, se ndokush mendon që qeveria merr borxh për të vjedhur vetë, siç është hapur nami, për vila, dyqane, ndonjë shtëpi lart e poshtë, ndonjë ofshore nëpër botë, se helbete lodhen, rroba, parfume, nusretlliqe, por jo, janë të besës! E kanë me besë a besë: hesap i qëruar, punë e mbaruar. Kudo nëpër Shqipëri çunat problematikë të Damianit presin ylyfenë.

Ja pra, si i ha qeveria paratë, se nuk po hyj në shifra, ngaqë nuk jam i shifrave, se si shifrat e copëtojnë Eurobondin dhe ia falin drejt, si i ha dreqi lekët që marrin poshtë e përpjetë, por leku i bardhë në ditë të zezë. Po kur bie në dorë të zezë, çfarë të mendojmë? Medet për njerëzit.

Në dorë të Ramës dhe të Ahmetajt, Eurobondi do të shkrihet si flok dëbore dhe nuk do t’i gjendet as varri. Shyqyr që do të kemi CD-në e këtij tubimi në këtë sallë, në të cilën binte, më përpara, se tani ka ikur, gëzimi prej Sokrati të vuajtur i zotit Taulant. Ndaj të rrojmë e ta kujtojmë, të rrojmë e ta shohim. I përjetshëm kujtimi! U prehtë në paqe! Në epitafin e tij, gdhendur me daltë nga Braçe, do të shkruhet: “E dha Europa, e hëngri gropa”.

Në fund, një fjalë për Krujën. Dy herë u helmua uji i qytetit: herën e parë nga sulltan Mehmeti, herën e dytë nga sulltan Salepi.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Petrit Vasili.

**Petrit Vasili** – E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,



Sigurisht, është mjerim i madh, që ditën kur miratohet një akt, përmes të cilit do të merren 700 milionë euro borxh, dëgjuam një Kryeministër, i cili këputi të gjitha broçkullat e dynjasë, por këtij momenti kaq të vështirë, kësaj ngarkese të re me borxh mbi shqiptarët, nuk i dha shpjegime. Kjo është një ditë e zezë për parlamentin shqiptar, por shumë herë më e zezë për qytetarët shqiptarë.

Ajo që doja t'ju kujtoja që në fillim të fjalës sime, është se kjo qeveri del për të katërtën herë me këtë procedurë, dhe që nga viti 2015 e deri më sot, në total ka marrë 2, 3 miliardë euro. Pra 2, 3 miliardë euro. Për të qenë të saktë e precizë, në vitin 2015 ka marrë 450 milionë euro, në vitin 2018 ka marrë 500 milionë euro, në vitin 2020 ka marrë 650 milionë euro, ndërsa tani, më 2021-shin, 700 milionë euro.

Ka qenë gjithmonë një ndër momentet më tragjike, por edhe me një element të lehtë komik, gëzimi i ardhjes në parlament, ngaqë po marrim sërish borxh. Pra, po e rëndojmë dhe po e dërrmojmë ekonominë e këtij vendi me borxhe pas borxhesh. Çdo shqiptar i thjeshtë dhe normal, thotë: ne po hyjmë në një borxh kaq të madh. Pra, janë 2, 3 miliardë euro. Ç' ndodhi me to? Çfarë prodhuan? Cilat qenë veprat e mëdha që u prodhuan, vepra infrastrukturore, shërbime të jashtëzakonshme ndaj qytetarëve, lehtësime apo përmirësime rrënjësore të shërbimit shëndetësor apo të arsimit të vendit gjithandej? Në të kundërt gjithçkaje, pra në të kundërt të gjithçkaje, të një borxhi kaq të rëndë, shikojmë të njëjtin mjerim dhe 2,3 miliardë eurot e marra borxh kanë bërë që jeta të jetë gjithmonë e më e vështirë, të mos përmirësohet gjëkund dhe shqiptarët të ikin pa u ndalur. Është fare e qartë që është një ekonomi, e cila jeton duke larë borxhin me borxh, me një qeverisje që vjen 10 herë në vit në parlament me akte normative dhe, çfarë thotë sot, nuk e bën nesër, çfarë ka planifikuar, nuk i pëlqen, se klienti i radhës thotë: nuk e dua këtë, dua këtë tjetër. Vijnë akte normative dhe ju i keni parë që aktet normative janë pa fund, pasi nuk ka planifikim, nuk ka objektiva afatgjatë që janë të rëndësishëm, janë principalë, të cilët nuk devijohen rrugës nga interesa gjithfarësh, por shkojnë përpara e krijojnë premisa të mëdha që rritja e produktivitetit në vend të jetë e dukshme, sinjifikative, të prodhojë mirëqenie dhe

zhvillim. Pra, në vend të rritjes së produktivitetit, të përdoret borxh për të larë borxhin. Kjo është krenaria më madhe e kësaj qeverie. Ndërkohë që në 5 praktika gjithsej qeveritë e mëparshme kanë marrë 300 milionë euro një herë në vitin 2010, në kushtet e një recesioni ekonomik të jashtëzakonshëm të Europës (këtë nuk besoj se e ka harruar njeri), kurse në vitet 2015 -2021 vetëm në 6 vjet, 4 procedura që bëjnë jo pak, por 2,3 miliardë euro. Ku është efienca e ekonomisë? Po risqet ndaj të cilave ekspozohemi?

Është fare e qartë dhe të gjithë e kuptojnë që i gjithë ky Eurobond është një risk, i cili bie i gjithi mbi interesin e madh publik. Nuk është një risk që e marrin përsipër investitorët, por bie mbi shqiptarët, pavarësisht se këta e konsiderojnë Eurobondin dhe gjithçka një thes që e kanë të tyrin, krahas xhepit, që e përdorin si të duan, sepse thonë vazhdimisht: "Jemi maxhorancë, marrim çfarë të duam". Po çfarë po marrin?! Borxhin që do t'ua lënë të tjerëve brez pas brezi. Kjo është maxhoranca që shpërdoron interesin publik dhe krijon gropa të tmerrshme, halle financiare pa zgjidhje për një kohë shumë të gjatë, që e mban me borxhe ekonominë e vendit vetëm e vetëm se do të bëjë shpërdorimin e radhës.

Këtu në sallë asnjë nga kolegët e mi, të majtë dhe të djathtë, nuk thotë dot se cilat janë gjërat thelbësore të mëdha që do të prodhojë e gjithë kjo marrje e madhe e borxheve, pra e parave; nuk thotë dot se çfarë ka prodhuar. Sot nuk dëgjuam në mënyrë të qartë: "Po i marrin këto 700 milionë, por do të kemi 1, 2, 3 objektiva që patjetër do t'i mbyllim, sepse prodhojnë këtë impakt kaq të madh ekonomik, rritin të ardhurat, rritin produktivitetin." Zero!

Dëgjuam që do të marrim 700 milionë euro borxh, një histori që e kemi dëgjuar edhe 3 herë të tjera në këtë sallë, pa iu tutur syri asnjërit. Sigurisht, mua më ka bërë shumë përshtypje mbështetja entuziaste dhe votimi i deputetëve të maxhorancës a thua se në këtë krah, maxhorancë apo opozitë, borxhlinjtë ndahen që borxhin e merr vetëm opozita dhe nuk e merr maxhoranca, është borxh që bie mbi të gjithë shqiptarët, pavarësisht për kë votojnë; varfërohen simetrikisht të gjithë njësoj, nuk privilegjohet asnjëri.

Sigurisht, kjo qeverisje ka një devizë të njohur tashmë që “pas meje qameti”, pra le të ndodhë qameti, nuk ka problem, pas meje; vendosim paratë në dispozicion, i shpërdorjmë, kalojmë nga borxhi në borxh, vetëm duartrokasim, se këtë e morëm me një përqindje më të vogël, këtë e morëm me një përqindje më të madhe. Por e gjithë ajo ngarkesë e tmerrshme borxhi ngelet në kurriz të njerëzve. Ka risqe të shtuara shumë të qarta, sepse dihet që, kur borxhi në valutë të huaj shkon afro 45%-50%, rreziqet janë të jashtëzakonshme, sepse kurset e këmbimit e bëjnë të ekspozueshme ndaj një rritjeje tjetër artificiale, pasi likuidohet në monedhë vendase. Kjo është një gjë fare e ditur, tronditet lehtë nga inflacioni, nga zhvlerësimi i lekut, fenomene dhe risqe plotësisht kërcënuese, të cilat e bëjnë gjithmonë edhe më kritike këtë situatë, e bëjnë më të parashikueshme, krijojnë një situatë tektonike që lëviz në mënyrë të vazhdueshme financat shqiptare dhe të gjithë këtë në emër të kujt?!

Do të dalë nga kjo sallë dhe do ta votojnë, sigurisht, këta pro e ne kundër, por ne kemi jo-avantazh. Ky që kemi është një avantazh shumë i hidhur, por është avantazh. Them sërish që është i hidhur, sepse ne nuk e votojmë, se kemi argumente të forta parimore, por çfarë do t’u thonë shqiptarëve? Se i morën? Si do të ekzaltohen këta nga vota e tyre? Kanë edhe një zakon të madh që duartrokasim se morën borxh dhe nuk u dhanë asgjë shqiptarëve. Nuk prodhuan asnjë vepër të madhe. Kemi dëgjuar vetëm që qajnë: “Ah, kur morëm këtë projektin! Ju i bëtë të gjitha kilometrat, por kishin ngelur ca për të rregulluar. Ato rregullimet na ngatërrojnë ne. Ju kishit bërë këtë, por nuk kishit bërë atë.”

Merr e prodho veprat e tua të mëdha! 2,3 miliardë euro borxh ke marrë. Jep llogari se çfarë janë 2,3 miliardë euro! Me 2,3 miliardë euro do të ishin bërë gjëra shumë të mëdha në Shqipëri. Çfarë janë bërë?! Janë kujdesur që të shkojnë në rregull paratë për koncesionet, të mos mungojë asnjë lek; janë kujdesur që, megjithëse marrin borxh, subvencion për të sëmurët me COVID të mos ketë. Janë afro 200 milionë që dalin nga xhepi i shqiptarëve, pavarësisht se votojnë e duartrokasim këta, sepse aq e kanë dhimbjen e popullit. Dhimbja e popullit fillon e mbaron tek interesi i tyre, por 200 milionë euro kanë dalë nga xhepi i shqiptarëve, këtë nuk e luan topi,

sepse afro 2 milionë shqiptarë janë infektuar nga COVID-i. Rimbursimet janë aq qesharake, sa zëre se nuk ekzistojnë më. I dinë të gjithë shqiptarët, kushdo që na dëgjon, sepse i kanë hequr në kurrizin e tyre. Cili ishte halli i madh i shqiptarëve që u zgjidh me të gjitha këto para të marra borxh? A numërojnë dot një hall të madh, pra që këta i dhanë një përgjigje përfundimtare? “Këtë vepër të madhe infrastrukturore e çuam deri në fund. Këto koncesione rrugësh i kemi dhënë, por e morëm një, e përfunduam, e çuam deri në fund.” Ne i pyesim: “Çfarë bëtë me koncesionet e rrugëve?”, ata thonë ju kishit lënë atje një këmbë ure pa bërë. Mirë që i morët, por mbaroni rrugët, se keni dhënë të gjitha këto para. “Kishte mbetur kanali kullues i një rruge atje në fshat pa mbaruar nga ju.” Kjo është logjika. Por me këtë lloj vulgariteti shumë të poshtër, i cili vetëm shkatërron financat e vendit, absolutisht nuk mund të shkohet përpara.

Natyrisht, ai që ka votat, mund ta shpërdorojë pushtetin, por ne jemi këtu që t’ua hapim gjithmonë e më shumë sytë shqiptarëve që të kuptojnë se çfarë do të thotë ta shpërdorosh pushtetin; ç’do të thotë ta kthesh atë në një instrument vetëm e vetëm pasurimi e rrëmbimi dhe t’u themi shqiptarëve që t’u mbetet në mendje se, përveç një borxhi që ka shkuar nga 6 miliardë euro në vitin 2013, në 10,2 miliardë euro në 6-mujorin e parë të vitit 2021, por në total janë marrë 2,3 miliardë euro borxh për asgjë ose për një gjë shumë të madhe: për të pasuruar klientët e qeverisë dhe për të majmur më së miri qeverinë, sigurisht, për të prodhuar vetëm varfëri pa ndalim.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr zonja Felaj.)*

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Vasili!

Fjalën e ka zonja Vokshi.

Të përgatiten zonja Aça dhe zoti Leskaj, para se të kalojmë në fjalën në emër të grupeve.

Faleminderit!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja drejtuese!

Para se të flas për projektligjin, dua të ngre edhe një herë një shqetësim, që e ngrita dje në Konferencën e Kryetarëve, në lidhje me një akt tjetër arrogancë të kësaj qeverie. Komisioni për Shëndetësinë me votat e të gjithë anëtarëve ka thirrur në një seancë dëgjimore dy ministret e

Arsimit dhe të Shëndetësisë në lidhje me masat e marra për përballimin e pandemisë në fillimin e vitit të ri shkollor dhe atij akademik. Në kushtet e rritjes së numrave të të prekurve nga COVID-19, ky shqetësim për ne bëhet edhe më i madh.

Ministria Kushi dje solli përgjigjen që refuzonte të paraqitej pranë komisionit parlamentar me arsyetimin se e ka informuar komisionin dhe nuk i përkasin asaj çështjet e shëndetësisë, pavarësisht se kanë të bëjnë me masat e marra në shkolla apo në universitete. E përsëris që është një përgjigje skandaloze, ndërkohë që ministria Manastirliu po dje pasdite ktheu përgjigje se nuk kishte kohë të vinte të premtën. Ndaj, dua t'u kërkoj edhe një herë Kryeministrit, Kryetares së Kuvendit që t'u tërheqin vëmendjen ministreve dhe t'i urdhërojnë të paraqiten pranë komisionit. Ne e morëm parasysh kërkesën e ministres Manastirliu dhe e riplanifikuam për të hënë në mëngjes dëgjuesën për masat e marra nëpër shkolla dhe universitete për përballimin e COVID-it. Jo pa qëllim Kushtetuta ka parashikuar kontrollin parlamentar si mjet për të kontrolluar ekzekutivin. Ndaj agjenda e komisioneve nuk përcaktohet nga ekzekutivi në asnjë rast, por përcaktohet nga deputetët e komisioneve.

Të nderuar qytetarë,

Sot kjo seancë do t'ju bëjë më të varfër; sot borxhi, që po merr Edi Rama për të larë një borxh tjetër, do ta përkeqësojë ekonominë e gjithsecilit prej jush. Kjo qeveri, për shkak të paaftësisë dhe korrupsionit, nuk i përdor këto para për të rritur mirëqenien tuaj, nuk i përdor për të rritur rrogat dhe pensionet, por për të paguar faturat e disa klientëve të saj, të cilët qëllojnë të jenë edhe ortakë në biznese të fshehura. Këto janë fatura të krijuara me borxhe të tjera, duke bërë që shqiptarët të jenë më të varfër dhe me një barrë të rëndë për t'u paguar në vitet që vijnë.

Fakti që sot ne po debatojmë për të rritur borxhin e Shqipërisë me 770 milionë euro, 700 milionë Eurobond dhe 70 milionë për korrupsionin në OSHEE, është një shenjë e dështimit flagrant të kësaj qeverie, një qeveri që nuk është në gjendje të paguajë faturat e saj, por duhej të ishte larguar prej kohësh.

Qytetarët nuk mund dhe nuk duhet ta mbajnë këtë peshë të rëndë të dështimit të Edi Ramës. Akti i sotëm është një tjetër plaçkitje për

shqiptarët, të cilët, nën drejtimin e Edi Ramës, renditen të fundit për nivelin e pagave dhe pensioneve, të fundit për cilësinë e shërbimit shëndetësor, të fundit për cilësinë e arsimit, të fundit për cilësinë e jetës. I vetmi vend, ku qeveria jonë renditet e para është niveli pandemik i korrupsionit.

Çfarë bëjnë me këto para? Ku shkon ky borxh i ri që marrin? Këta nuk bëjnë transparencë, sepse transparenca nxjerr zbuluar pagesat për punësimet elektorale, shërbimin që bëjnë ndaj koncesioneve të tyre korruptive dhe projekteve që u kushtojnë shqiptarëve miliona euro për 1 kilometër. Në emër të këtyre kontratave korruptive, që i paguajnë me borxhin që marrin në emër të shqiptarëve, prishin shtëpitë e shqiptarëve, shkatërrojnë djersën dhe mundin 30-vjeçar, i detyrojnë që të ikin nga sytë këmbët.

Edi Rama i trajton shqiptarët si armiq, kur ata i prishin planin për të vjedhur përmes projekteve pa transparencë. Këto ditë po shikojmë se si ai është vërsulur për të prishur banesat në zonën e 5 Majit në Tiranë, sepse i duhet që të lirojë tokë për ta dhënë me PPP-të në një zonë tjetër në Kombinat apo diku në Kinostudio. Ishte rrëqethëse dëshmia e sotme e një babai më 3 fëmijë, pa punë, tani edhe pa shtëpi; 35 vjet mund e djersë të ndershme janë rrënuar në vetëm 5 minuta.

Këto ditë, ndërsa merr borxh për të bërë 21 milionë euro 1 kilometër rrugë, një tjetër aferë e madhe korrupsioni po merr trajtë tek pjesa e papërfunduar e Unazës së Re. Këtë faturë Edi Rama kërkon ta paguajnë 700 familje me prishjen e banesave të tyre. Qindra qytetarë të njëjësive 9 dhe 11 në Tiranë janë në protestë prej më se 1 muaji kundër kësaj afere që shkatërrojnë jetën e tyre. Ata preken nga projekti i segmentit rrugor të unazës Sheshi Shqiponja- Bulevardi i Ri, pra një segment që do t'ju kushtojë taksapaguesve shqiptarë 62 milionë euro për vetëm 3 kilometra rrugë, thënë ndryshe 21 milionë euro për kilometër.

Si deputete përfaqësuese e njëjësive 9 dhe 11, kam marrë me qindra mesazhe nga qytetarë të ndryshëm, të cilët janë të shqetësuar, të stresuar dhe në ankth se munda, puna, djersa e një jete do t'u shkatërrohet e do të mbeten në mes të rrugës. Asnjë nga banorët që kam takuar dhe kam biseduar këto ditë, nuk është kundër zhvillimit, kundër projekteve me interes publik, por janë

kundër mënyrës së paligjshme, mungesës së plotë të transparencës dhe mënyrës së panjerëzishme të trajtimit.

Asnjë përfaqësues i ministrisë, i Autoritetit të Rugëve apo bashkisë nuk pranon të bisedojë me asnjë nga banorët, pavarësisht thirrjeve të përditshme të banorëve. Vetëm policë apo punonjës që shkojnë si banda, duke terrorizuar banorët në shtëpitë e tyre. Ajo që kërkojnë banorët është transparenca, por as nuk u thuhet, as nuk u jepet, as nuk u tregohet asgjë; heshtje totale. Mungesa totale e informimit pranohet edhe në shkresën zyrtare të ARRSH-së që unë kam sot këtu. Duke biseduar me banorë, evidentohet qartë diskriminimi edhe vetëm për arsye politike, korrupsioni me lejet e legalizimeve kundrejt pagesave nën dorë, krimi elektorale me dhënien e certifikatave të legalizimit gjatë fushatës elektorale.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Ministre, do të keni rastin dhe mund ta merrni fjalën. Mos flisni...

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, zonja Vokshi, vazhdoni fjalën

**Albana Vokshi** – Në një ndërtesë, gjysma është legalizuar, sepse është militant i PS-së, kurse gjysma tjetra është e palegalizuar, sepse mendohet se është anëtar i PD-së. Këto janë leje legalizimi elektorale, selektive, bazuar vetëm në bindjet apo përkatësitë politike apo për ata që kanë dhënë para, shuma marramendëse, nën dorë.

Dhjetëra familje janë përpjekur të komunikojnë më ndonjë institucion, me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të marrë dokumentet e shtëpisë apo informacion për to. E pamundur, askush nuk përgjigjet! Familjarët dyshojnë edhe për zhdukjen e dosjeve të shtëpive të tyre. Kërkoj informimin urgjent të tyre në lidhje me statusin e regjistrimit të pronës së tyre, sepse informimi është detyrim ligjor dhe kushtetues!

Le të marrim disa shembuj, meqenëse ministrja do shembuj. Në zonën e quajtur “Josif Pashko”, ku kalon projekti, familjet e Nikoll Kolndreut, Fran Kolndreut, Aurel Demkos, Mark Kolndreut, edhe pse i kanë paguar prej vitesh të gjitha faturat apo detyrimet, nuk i kanë marrë certifikatat e pronësisë. Gjithashtu, familja Marku, që i ka futur dokumentet e legalizimit që në nisje të procesit, nuk ia kanë marr ende, edhe

pse të gjithë rreth e rrotull i kanë marrë. Edhe familjet Seçi dhe Haxhisefa janë pa dokumente, edhe pse të gjithë fqinjët i kanë marrë ato.

Në zonën e sheshit “Shqiponja” Musa Ahmet Hyseni, edhe pse rreth e rrotull të gjithë janë me certifikata legalizimi, ai jo. Pse ka dy standarde? Projekti është miratuar para disa muajsh, thotë ARRSH-ja. Pse nuk janë pajisur banorët me dokumentet përkatëse të legalizimit.

Ka edhe një pretendim tjetër, dhe unë do të doja një përgjigje nga ju sot, zonja Ministre, banorët pretendojnë se projekti është devijuar. Siç e shikoni, ata pretendojnë se kjo është gjurma e vjetër dhe kjo me portokalli është gjurma e re. Pyetja që kam për ju, dhe dua që ta mbani shënim, sepse unë do ta vazhdoj deri në fund këtë çështje: cila është arsyeja? Nëse ka ndodhur devijimi, pse është devijuar? Banorët denoncojnë se devijimi i projektit është bërë për të ruajtur dhe për të futur brenda unazës sipërfaqe, për të cilat Edi Rama dhe Erion Veliaj kanë firmosur leje të tjera për kulla të pastrimit të parave. Kush qëndron pas këtyre lejeve? Cili është oligarku që arriti ta devijojë një gjurmë të tërë?

Sot, zonja Ministre, keni detyrë që t’ua shpjegoni banorëve të gjitha këto pyetje që ata kanë muaj që i bëjnë, por nuk marrin asnjë përgjigje.

Në datën 29 kam kërkuar informacion nga ministrja Balluku, nga Erion Veliaj në lidhje me këtë projekt. Përveç ARRSH-së, që e solli jashtë afateve, as ministrja e as kryetari i bashkisë nuk kanë respektuar detyrimet e tyre. Kjo është një tjetër shkelje kushtetuese.

Të dashur qytetarë,

Ky projekt shkatërron 654 ndërtesa dhe preken 700 familje. Ajo që unë kërkoj sot në emrin tuaj është që secila kategori, qofshin me certifikatë pronësie, me leje legalizimi, në proces legalizimi apo pa dokumente, të bëhet pjesë e skemës së shpronësimit, pa dallim e diskriminim.

Së dyti, vlera e shpërblimeve të jetë sipas çmimeve të tregut.

Së treti, pagesat t’u jepen përpara se shtëpitë e tyre të prishen, që të kenë mundësi për të siguruar strehim tjetër dhe, nëse ka pronarë të pakompensuar, të futen në fondin e shpronësimeve. Kaq ua keni borxh këtyre qytetarëve. Janë ata që po paguajnë me sakrificë për borxhet e korrupsionit të qeverisjes së Edi

Ramës, pra është koha t'ua ktheni borxhin e të mos i lini pa çati mbi kokë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Vokshi!

Fjalën e ka ministrja Balluku; 10 minuta në dispozicion.

Fjala jepet konform nenit 47, paragrafi 1/1, të Rregullores.

**Belinda Balluku** – Faleminderit, zonja Vokshi, që më dhatë mundësinë të flas. Kjo nuk është për përmendje emri. Ky është thjesht falënderim për mundësinë.

Para së gjithash, projekti ka qenë i bërë nga ju në vitin 2009 dhe ju nuk njiheni për projekte të mira. Të gjitha projektet që keni bërë, na është dashur t'i rishikojmë. Kështu që besoj se biem dakord me këtë fakt: pas 12 vjetësh, për shkak të urbanizmit të Tiranës, nuk mund të zbatojmë projektin që keni bërë ju, siç keni bërë edhe projektet e tjera në vitin 2009. Ka një projekt të rishikuar, i cili as nuk fut brenda toka dhe as nuk nxjerr jashtë toka, por mundohet të jetë sa më eficient, pra të kalojë në sipërfaqe, të cilat nuk kanë probleme gjeologjike, apo të ketë sa më pak vepra arti të cilat trisin koston.

Kur dilni këtu e flisni, realisht unë e kuptoj që ju bëni politikë, dhe bëni shumë mirë, dhe narrativën duhet ta keni për votuesit tuaj, por të thuash që janë 3 kilometra kur janë 7,7, sikur nuk shkon. Ju bëni si të doni, por janë 7,7 kilometra nga sheshi “Shqiponja” deri te Bërryli, ku do nisin lotet e reja.

E nderuar zonjë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...the një segment, tani ti do t'ireferohesh veprës, sepse iu referove 700 shtëpive që duhen shpronësuar. Pra, 700 shtëpitë nuk ekzistojnë, ekzistojnë 110 shtëpi të legalizuara, të cilat preken nga projekti dhe 540 shtëpi të palegalizuara që preken nga projekti. Projekti është 7,7 kilometra dhe nuk flitet me segmente, sepse më pas dilni bluf e filloni të justifikoheni.

Unë nuk e di ku janë këta banorët në protestë, sepse nuk i kam parë. Me banorët jam ulur vetë, nuk i keni informacionet e sakta, sepse keni vetëm familjen Ndreu dhe familjen Marku, nga çfarë dëgjova. Nuk besoj se janë vetëm ata që jetojnë në atë zonë. Pra, këto 110 dhe 540 familje kanë mbiemra të tjerë, të cilat janë njoftuar, i kanë takuar dhe nuk do të bëhet

shpronësimi siç thoni ju, sepse nuk bëhen gjërat siç mendoni ju dhe siç i keni bërë. Shpronësimi bëhet në bazë të ligjit. Ka një ligj në Republikën e Shqipërisë se si shpronësohet çdo pronar kur në situatë involvohet interesi publik.

Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë. Sot ne hapëm lotin e dytë dhe lotin e tretë. Sot për të shkuar nga Pallati me Shigjeta te Bërryli duhen ekzaktësisht 12 minuta. Me hapjen e kësaj rruge (mund të shkoni ta shikoni edhe ju), sot nuk do kalojnë më nga Rruga e Elbasanit dhe të qëndrojmë me orë në pritje, sepse çdo qytet i madh, çdo kryeqytet në të gjithë botën ka trafik. Ajo që duhet të bëjë çdo qeveri është t'i zgjidhë problemet me trafikun, me transportin dhe me infrastrukturën. Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë rrugë, ju pëlqen apo nuk ju pëlqen juve. Kur të vini ju, mos i ndërtoni, ashtu siç nuk i ndërtoat kur ishit. Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë sipas standardeve europiane. Do të shpronësojmë sipas ligjit në fuqi dhe jo siç doni ju.

Fatkeqësisht, duke qenë se edhe unë jam deputete dhe kam shpenzuar kohën në terren, nuk e di si ndodh ky fakt, sepse nuk di ta shpjegoj këtë punën e legalizimeve, sepse nuk jam marrë ndonjëherë, por, realisht, ata që kanë legalizime janë kryesisht votuesit tuaj. Në kohën e Shaban Memisë jeni kujdesur që t'i ndanit ashtu siç duhej dhe t'ia çonit PD-së. Kështu që, zakonisht, ne, kur shkojmë në terren, përballlemi e na thonë si ka mundësi që te ky oborr këtu ky i PD-së e ka marrë, unë që ju votoj ju gjithë jetën nuk e kam marrë! Kështu që të mos i futemi kësaj pune të politikës se kush i ka legalizimet dhe kush nuk i ka, pasi të gjithë trajtohen njësoj. Ata janë qytetarë të Republikës së Shqipërisë. Kush e ka shtëpinë e legalizuar, do të shpronësohet sipas ligjit. Ata që nuk i kanë të legalizuara, ndryshe nga ju, ne nuk do t'i lëmë në rrugë, por do të vazhdojmë të ndërtojmë rrugë. Kur të përfundojë e gjithë unaza e Tiranës, pra kur “Shqiponja” të bashkohet me segmentin që ne sot dorëzuar te Bërryli, atëherë e gjithën Tiranë do të përshkohet në 20 minua. Kjo është për t'u krenuar dhe jo për të dalë këtu e për të bërë abuzime me fjalë që nuk janë të vërteta, duke nisur nga protestat, që nuk i kemi parë se ku janë, te 700 familjet që paskan dashur të na kontaktojnë, por dy emra përmendët! Ndërkohë që unë kam takuar më shumë se 100 familje dhe dalkan punonjësit i takojnë! Patjetër që

punonjësit do të dalin. Kë prisni ju që të dalë t'i takojë? “Çoni atje disa punonjës.” Ne çojmë atje inxhinierët e ARRSH-së, të cilët shpjegojnë se ku është gjurma, ku do të kalojë dhe ku do të duhet të shpronësohen.

E nderuar zonjë, ne bëjmë punën, ashtu siç duhet ta bëjmë sipas ligjit, në rast se kjo nuk ju pëlqen, ky nuk është problem ynë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Balluku!

Zonja Vokshi, ju lutem, për çfarë e kërkonti fjalën?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për replikë?! Nuk ka replikë. Nuk tha asgjë që të përbënte fyerje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, ju e dini Rregulloren se çfarë thotë për replikën. Zonja Vokshi, jeni edhe kryetare komisioni dhe ju duhet ta përdorni Rregulloren edhe gjatë drejtimit të komisionit.

Fjalën e ka zonja Açka.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është thjesht çështje përmendjeje emri replika.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kolegë, ju të gjithë bashkë e dini shumë mirë se për çfarë jepet replika. Pse duhet të bëjmë sikur këtë nuk e dimë dhe të veprojmë në kurriz të Rregullores? Për cilën arsye? Nëse keni një përgjigje për këtë, dakord, ia jap fjalën zonjës Vokshi, por nuk është kështu.

Vazhdoni!

**Albana Vokshi** – Faleminderit, zonja drejtuese!

Të thoni që nuk shikoni qindra banorë që çdo ditë që protestojnë, është turp për një ministre. Kanë protestuar te sheshi “Shqiponja”, kanë protestuar vetëm para 3 ditësh para Kryeministrit dhe para Kuvendit. Është turp që një ministre të thotë që nuk shikon qindra banorë, të cilat duan të kontaktojnë me ju dhe nuk ju kontaktojnë dot.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Së dyti, të flisni ju për trafikun...

*(Diskutim pa mikrofon)*

Zonja Ministre, heshtni kur flas unë!

**Ermonela Felaj** – Zonja Vokshi, ju po flisni për replikën tuaj, mos u ktheni nga zonja ministre. Vijoni, sepse koha juaj po vazhdon.

Ju lutem, mos u ktheni andej!

Vazhdoni fjalën!

**Albana Vokshi** – Ju lutem, tërhiqini vëmendje zonjës ministre që të mos ndërhijë! Është e paedukatë që ndërhyni. Merreni fjalën dhe sqarohuni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kanë protestuar para Kryeministrit, kanë protestuar para Kuvendit. Është e turpshme që një ministre të thotë që nuk shikon një protestë një mujore me qindra banorë. Shkoni gjejini, sepse po protestojnë dhe sot do të protestojnë, edhe dje kanë protestuar.

Të flisni për trafikun në Tiranë, është akoma më turp, e keni bërë Tiranën ferr për banorët. Sapo më sollën edhe një listë të tërë me qindra banorë, ose gënjeni ju, ose gënjeni...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe ato familje janë. Ose gënjeni ju, ose gënjeni ARRSH-ja. ARRSH-ja thotë se nuk është ndryshuar gjurma, ju thoni se është ndryshuar. Kush gënjen, ju apo ARRSH-ja?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Së fundi, ne, si Parti Demokratike, jemi ndryshe. Ne kemi shpronësuar edhe pa certifikata legalizimi, sepse ne nuk i hedhim njerëzit në rrugë, ashtu siç i hidhni ju. Vetëm kujtoni pamjet e Bregut të Lumit, i keni nxjerrë me gaz, i keni qëlluar dhe i keni dhunuar. Ja kush është ndryshimi midis nesh dhe midis jush.

**Ermonela Felaj** – Fjalën e ka zonja Açka.

**Flutura Açka** – Të nderuar shqiptarë kudo që jeni,

Dua t'ju drejtohem juve, zonja Felaj, sigurisht, edhe zonjës Kryetare të Kuvendit, që asnjëherë nuk bëni vërejtje kur ndërpriten deputetët e opozitës kur flasin. Gjithmonë i ndërpresin këtu dhe asnjëherë nuk u bëni vërejtje çuditërisht, as Kryeministrit, ndërsa të tjerëve po, ua prisni edhe fjalën.

Dua ta nis fjalën time me një tërheqje vëmendjeje. Sigurisht, e kisha me zonjën Kryetare, por, meqenëse nuk është, ju lutem, përcilljani! Në lidhje me njoftimin për rendin e ditës në seancë plenare, sipas Rregullores së Kuvendit, në nenin 27/1 thuhet se deputetët e parlamentit duhet të njoftohen për rendin e ditës, të paktën një javë më parë. Në fakt, në të gjithë këtë legjislaturë, pra një muaj e pak ditë nga koha e nisjes së kësaj legjislature, kjo është zbatuar vetëm një herë, gjithmonë e kemi marrë dy ditë përpara, një ditë e gjysmë përpara, madje

në shkelje të ligjit. Ligji dhe rregullat këtu nuk janë barka shpëtimi për të shpëtuar nga shkelja e ligjit, kështu që sot duhet të kishim rendin e ditës të javës së ardhshme, në mënyrë që të vijmë të përgatitur, jo se nuk e dimë kalendarin, por duhet të respektojmë Rregulloren e Kuvendit, ku edhe ju jeni pjesë.

Ju do të thoni se mjaftojnë dy ditë parlamentare dhe, sigurisht, jeni të interesuar të krijoni përshtypjen se opozita është e hutuar dhe mbase t'u krijoni përshtypje shqiptarëve se punët këtu na shkojnë mbroth (shikojeni vetë parlamentin), ose t'i shërbeni alibisë që e keni shitur me kujdes në publik se ne me ju kemi bërë marrëveshje të fshehta dhe nuk duhet t'ju hapim punë me kërkesën tonë të llogarisë Nuk e di se si e keni hallin! Patjetër që në një nga këto gjëra e keni hallin.

Unë e kuptoj se ju ende nuk jeni çmësuar me dhomën bosh, se keni dy vjet dhe tani, ngaqë nuk është dhoma bosh, përpiqeni të mos përplaseni me ne dhe kanë filluar t'u merren mendtë, por opozita është realitet, është këtu, kështu që përpiquni ta përmbani këtë dëshirë që ju vjen në mendje.

Në fakt, u vu re edhe sot, është vënë re edhe ditë të tjera, se çfarë ndodh këtu: monologët e mërziqshëm të qeverisë, më pas të eksponentëve të qeverisë e të tjerë me radhë si kukulla kineze. Merreni gjithë kohën me opozitën, madje keni zënë merak të madh edhe me foltoren. Siç duket, Berishën e kanë makth të madh, dhe kjo është gjë shumë e mirë.

Problemi i shqiptarëve sot nuk është dhëmbi i prishur i opozitës, po të perifrazoj një batutë bajate të Kryeministrit tuaj, por sarkoma që ua keni vënë shqiptarë në kurriz, por këtë ju nuk e shikoni, sepse nuk keni nga t'i shikoni këto plagë. Ju merreni me buxhetin, e vishni bukur, u shisni shqiptarëve idetë tuaja, përpjekjet tuaja, kur, në fakt, problemet e shqiptarëve janë kaq elementare: punë, drita, ujë, rrugë, kanale, ndërtime, shkolla, koronë, kurse ju merreni me makrot dhe me gjëra me të cilat përpiqeni t'i bindni shqiptarët se do t'i dërgoni në Europë me këto forma.

Mjafton t'ju kujtoj ditën kur shpalosët programin tuaj politik. Këtu kanë ardhur me radhë ministrat tuaj, pas monologut të gjatë dhe të mërziqshëm të Kryeministrit, dhe kanë thënë brenda ditës tri herë të njëjtën gjë nga 10 minuta,

kur folën për programin e institucionit të tyre, kur u kthyen përgjigje pyetjeve që i kishin bërë vetë, ose ua kishin bërë të vetët dhe herën e tretë si diskutantë. Sipas linjës së racios, i bie që tri herë të thuhet gënjeshtër, e vërteta thuhet vetëm një herë. Ju përsërisni këtu po të njëjtat fjalë. Shikoni regjistrimet se si keni përsëritur për 10 minuta nga 3 herë, pra 60 minuta secili prej jush, të njëjtën gjë. Për këtë ju paguajnë shqiptarët? Për këtë i paguajnë taksat shqiptarët, që të përsërisni ju të njëjtat fjalë dhe të bëni sikur po punoni?!

Të them të drejtën, duke parë këtë parlament dhe duke parë çfarë po ndodh këtë muaj, kam edhe unë atë qasjen time për atë çfarë po ndodh. E di si më ngjan parlamenti shqiptar mua?! Një parlament totalisht astmatik, tamam si ai personazhi astmatik i Murtajës, i cili dilte në ballkon dhe pështynte macet. Në këtë rast macet i kanë për shpirtra njerëzorë, sepse për mua macja është një gjë shumë e shenjtë. I pështynte macet dhe, kur macet ikën, ashtu siç po bëjnë shqiptarët tanë me valixhet gati dhe ia mbathin, ky astmatiku i famshëm dilte përsëri te ballkoni ky, sepse e kishte bërë klishe, por çfarë të pështynte më? Hidhte copa letrash për t'i joshur macet për t'u kthyer, por macet nuk u kthyen më. Kështu që mblidheni mendjen sa jeni shpejt, pa na ikur të gjithë shqiptarët nga ku vend!

Ju e përsërisni shumë shpesh, tamam si dhëmbi juaj i prishur, "Ruga Kombit, Ruga e Kombit", unë po e kaloj dhe nuk po ndalem te Ruga e Kombit, sepse dua të them një gjë që ka lidhje me një shkollë, meqenëse u përdorën shkollat dhe Kryeministri kërkoi shembuj. Po, do t'i jap një shembull të rindërtimit në Tiranë që ka lidhje me shkollën "Hasan Vogli". Është një shkollë shumë e rëndësishme, në një zonë aty afër ku banoj unë. A e dini ju, a e di Kryeministri shqiptar që një natë të errët njerëz me matrapik kanë shkatërruar tarracën e shkollës, enkas që ajo të quhet e shkatërruar nga tërmeti? E dinë banorët. Shkoni pyesni banorët. T'i pyesë SPAK-u, nuk është detyra ime. Unë vetëm denoncoj me ato që më kanë thënë. Pse? Si shpjegohet që shkolla, që është ndërtuar 30 vjet pas godinës që është ngjitur me të, është dëmtuar dhe godina e banimit është ende në këmbë?

A e dini ju se projekti i famshëm i kësaj shkolle, që, për fat të keq, ministrja në komision

tha se nuk e kishte parë, ka dy krahë të zgjatur si krahë avioni që nuk hyjnë në punë fare? A vendosen në krahë avioni banka, nxënës, biblioteka, klasa? Shkoni shikoni se çfarë projekt i llahtaritur është! Nuk e di?!

Zoti Kryeministër ishte në *West Point* dhe pa se shkollat janë shkolla, nuk janë krah avionësh, meqenëse po flisni për shkollat ju. Të mos flas pastaj që shkollën e keni afruar një metër larg pallatit, duke shkatërruar jetën e shumë familjeve që jetojnë në atë ndërtesë. Ju solla vetëm një fakt, por ka fakte të tjera që do t'juja sjell herë tjetër.

Po kthehem te buxheti dhe te këto gjëra që po flasim sot. Sigurisht, besoj se te buxheti i vitit 2020 i keni nxjerrë edhe lekët e aventurës suaj kozmike të satelitëve. Pasi i mbaruat punët në tokë, ju mbeti të pushtoni qiejt. Kush?! Ju, që ngritët “institucionin e kanabizimit kombëtar” në vitin 2016?! Ju do të kontrolloni nga qielli?! Ju qofshi! Ju nuk e keni kuptuar fare hallin e Kryeministrit, sepse nuk e njihni aq mirë Kryeministrin, sepse nuk keni lexuar shkrimet e tij të para. Diku nga fillimi i viteve 90-të, atëherë kur ai ishte zog i lirë dhe nuk e kishte zënë sindroma e 20%-it dhe as sëmundja e koncesioneve, në një shkrim të tij te revista “Përpyekja” shkruan për veten, mes të tjerash, se ka një karakteristikë shumë të veçantë: ai ka një yll te vendi që nuk thuhet. Në fakt, shqiptarëve, dhe të gjithë kryeministrave të botës, u duhet një yll te vendi që thuhet. A e kuptoni ju?!

Kështu, pasi e kërkoi në tokë yllin dhe nuk e gjeti dot, kuturisi që ta kërkojë nëpër satelitë dhe, ngaqë ëndrrat i ka supersonike dhe i shkojnë deri në vitet 2025, 2029, 2033, është në kërkim të yjeve të tjera që t'i bëhen pesë për të qenë shef i madh në Europë, ëndërr për të cilën ka filluar të blejë shkesë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Açka!

Për korrektësi të asaj që ju ngritët si vërejtje ndaj Kryetares së Kuvendit për mosnjohimin e kalendarit dhe rendit të seancës së sotme plenare, në fakt, unë sapo komunikova me stafin e shërbimit të Kuvendit dhe konfirmova atë që ndodh prej shumë vjetësh në Kuvendin e Shqipërisë, dhe nuk ka pasur asnjë lloj problemi: Konferenca e Kryetarëve, jo kjo që u mbajt pardje, por e parafundit është mbajtur në datën

12 tetor dhe në atë Konferencë është miratuar kalendari i punimeve të Kuvendit dhe në kalendar përfshihet edhe rendi i ditës së bashku me ditën kur do të zhvillohen seancat plenare. Kjo u bëhet e njohur deputetëve në seancën më të parë plenare. Pra, është shpërndarë kalendari, sikundër publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit dhe më tej çdo komision miraton kalendarin e posaçëm në mbledhjen e tij të parë. Kështu që nuk besoj se ishte çështje ajo që ju ngritët.

Ju lutem, lexojeni edhe një herë nenin 27 dhe shikojini me kujdes të gjitha njoftimet që bëhen në Kuvendin e Shqipërisë!

Fjalën e ka zoti Leskaj.

Pastaj kalojmë në shprehjen në emër të grupeve.

**Bujar Leskaj** – Të dashur qytetarë shqiptarë,

Mendoj se nuk bëjmë gabim sikur në këtë seancë të flasim edhe për borxhin publik, të flasim edhe për Eurobondin. Ne kemi vende ku mund ta tregojmë erudicionin, *show-n* tonë si politikanë, por është për të ardhur keq që këto seanca, që duhet të jenë nga më të rëndësishmet për sa i përket borxhit publik, për sa i përket zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë sonë, të zhvillimit të vendit të qytetarëve shqiptarë, ne i shpërdorojmë, madje edhe qytetarëve u shkëputet vëmendja të kapin atë problemin kryesor. Megjithatë, kjo nuk është detyra ime.

Në krye të herës në fjalën time do të më lejoni të japë 2-3 shifra dhe të bëj ato interpretime që mendoj se janë të qarta si drita e diellit.

Në vitin 2005 stoku i borxhit publik në Shqipëri ishte 3 miliardë e 827 milionë euro. Në vitin 2013 stoku i borxhit publik ishte 6 miliardë e 320 milionë euro. Në shtator të vitit 2021 stoku i borxhit publik i deklaruar ishte 10 miliardë e 500 milionë euro. Duke shtuar këtu edhe detyrimet e fshehura që tashmë i pranojmë të gjithë në bisedat tona formale dhe joformale, detyrimet e papaguara, detyrimet gjyqësore apo PPP-të, sot borxhi publik i Shqipërisë është 12 miliardë euro e 500 milionë, ose i barabartë me të gjithë produktin e brendshëm bruto. Pra, në këta 8 vjet të qeverisjes “Rama”, që unë pëlqej ta quaj qeverisje e “sektit Rama”, borxhi shtesë në këta 8 vjet është 6 miliardë euro ose, thënë ndryshe, është dyfishi i borxhit që kjo qeveri gjeti në vitin 2013. Domethënë, ky borxh publik



i qeverisë “Rama”, që i faturohet gjithë Shqipërisë, ekonomisë sonë dhe shqiptarëve, është i barabartë me borxhin publik të qeverive shqiptare në 23 vjet, nga viti 1991 e deri më sot.

Të dashur qytetarë shqiptarë,

Në këta 8 vjet kjo “qeveri sekt” secilin prej jush, fëmijët tuaj, prindërit tuaj i ka ngarkuar me të paktën 2 200 euro shtesë, pra këto janë arritjet e qeverisë të “sektit Rama”.

Sot kjo qeveri na vjen ne me Eurobondin e pestë 700 milionë euro, duke u shtuar atyre 1,6 miliardë eurove borxh, që i ka marrë me eurobonde në tregjet e huaja. Me këtë Eurobondin e pestë borxhi i jashtëm me kushtet tregtare, i marrë nga instrumentet dhe nga ky sekt, do të shkojë në 2,3 miliardë euro. Në fakt, ky borxh nuk mund të mbulohet me fanfarat, me propagandën që “sekti Rama” po investon për të shpëlarë mendjen e shqiptarëve. Borxhi është borxh. Çfarëdo përkufizimi t’i vini ju, dhe mua më vjen mirë që disa deputetë e theksuan, borxhi është borxh, nuk është borxh vetëm për këtë qeveri, por është borxh edhe për qeverinë e nesërme, mbi të gjitha, nuk është borxh për pozitën apo opozitën, por është borxh për qytetarët shqiptarë.

Qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim se për çfarë konkretisht do t’i përdorë këto 700 milionë euro të Eurobondit të pestë, me përjashtim të ndonjë përcaktimi shumë të mjegullt që i do për mbështetjen e përgjithshme buxhetore. Kjo mbështetje mund të përkthehet edhe në fonde për të përballuar rritjet e premtuara të pagave, çka do ta shndërronte marrjen e Eurobondit në një fuçi të madhe risku për qëndrueshmërinë e financave publike. Në një interval kohor vetëm 16 muaj, qershor 2020-nëntor 2021, ne po marrim dy eurobonde me vlerë totale 1 miliardë e 350 milionë euro. Dy borxhe të tilla, kaq të afuara në kohë, nuk i ka marrë vende të ngjashme me ne, si Kosova, Mali i Zi apo Maqedonia e Veriut.

Komisioni European në progreraportin e vitit 2021 për Shqipërinë, cilëson se rreziqet fiskale vazhdojnë, ndërsa reformat në menaxhimin e investimeve publike kanë ngecur. Pikërisht këtu është defekti më i madh dhe pikërisht këtu është ajo plagë e madhe, që ju i keni shkaktuar dhe po i shkaktoni ekonomisë shqiptare.

Siç konstatonte edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar: “Investimet publike të financuara

me burime të brendshme dhe që nuk lidhen me tërmetin janë rritur me shpejtësi që nga viti 2020. Ndoshta qeveria do ta përdorë një pjesë të mirë të Eurobondit të pestë për të financuar marrëzinë e radhës së sektorit “Rama”, ndërtimin e segmentit rrugor Milot-Fier në autostradën adriatiko-joniane me vlerën 1 miliardë e 459 milionë euro, sepse kështu ia kërkojnë ata që e kanë kapur prej gryke.

Për 6-mujorin e parë të 2021-shit ne paguam nga paratë e taksapaguesve 6,5 miliardë lekë ose 53 milionë euro interesa për borxhin e jashtëm, me një rritje me 55% krahasuar me një vit më parë.

Në 5 vjetët e fundit vëmë re gjithashtu një shtim alarmant të stokut të borxhit të shtrenjtë, të siguruar jashtë vendit me terma tregtarë, kredi tregtare, për të financuar projektet mitomane të liderit global, në krahasim me kreditë e dhëna nga institucionet ndërkombëtare që na mbështesin. Këto kredi të buta sektit “Rama” nuk do as t’i shohë me sy, sepse nuk mund t’ua japë klientëve të vet oligarkë, ndërsa paratë e eurobondeve i përdor ku ia do qejfi dhe interesi malinj për vendin.

Ne duhet të mësojmë nga kriza greke e vitit 2010 dhe nga veprimet e kancelares në largim, zonjës Merkel. Unë po ju citoj diçka nga një biografi zyrtare e Merkelit, për qëndrimin që mbajti ndaj kërkesës së vazhdueshme dhe agresive të qeverive greke për eurobonde. “Merkeli u konfrontua me një kërkesë të njëjtë, eurobondet do të ndihmonin për të dalë nga balta. Një bond për të gjithë do t’ua bënte jetën gjermanëve më pak të shtrenjtë dhe grekëve pak më të durueshme”. Logjika e Merkelit ishte: “Kemi valutën të njëjtë, por jo politikën ekonomike. Eurobondet kanë kuptim nëse të gjitha qeveritë kujdesen që paratë e marra me çmim të njëjtë t’i përdorin me arsye dhe në mënyrë të kontrolluar”. Sipas mendimit tim, kancelarja Merkel këtu ka arritur pikët më të larta si politikane, e cila u përplas edhe me përfaqësuesit e Bankës Qendrore Europiane, të bankës së Gjermanisë dhe personaliteteve të vendeve të tjera të Europës dhe, mbi të gjitha, me politikanët grekë. Me sa duket, edhe ju jeni drejt kësaj rruge. Është për të ardhur keq që ju ende nuk i thërrisni ndërgjegjes dhe profesionalizmit.

Krahasuar me pesë vjet më parë borxhi i Shqipërisë me terma të butë është rritur me

vetëm 2%, ndërsa borxhi i jashtëm, i siguar me kushte të zakonshme tregtare, është rritur 27 herë më shumë ose 55%.

Eurobondi i ri përkeqëson pozicionin financiar të ekonomisë shqiptare, për shkak se nuk ka garanci, nuk ka ndershmëri dhe nuk ka profesionalizëm për mënyrën sesi do të përdoret.

Së pari, fakti që borxhi i ri merret në euro e rrit më tej rrezikun e mospagimit. Në rast krize financiare ka gjasa që leku të zhvlerësohet kundrejt euros, duke e bërë më të kushtueshme shlyerjen e borxhit.

Së dyti, qeveria nuk po e investon borxhin e marrë në aktivitete, që sjellin një kthim të shpejtë nga investimi, prej te cilave mund të shlyhet borxhi. Ky është borxh i siguar për mbështetjen e përgjithshme buxhetore. Shlyerja e tij pa dyshim do të financohet nga rritja e borxhit të ri, në një mjedis normash interesi, që mund të jetë dukshëm më pak i favorshëm se i sotmi.

Së treti, ritmi i rritjes së borxhit kombëtar të Shqipërisë është shqetësues, nga 67,3% e PBB-së në vitin 2019, në 77,6% të PBB-së në vitin 2020 dhe në 80% sot. Ky është i deklaruar, ndërsa realisht është mbi 100%

Së katërti, Shqipëria ka një bazë të ngushtë eksporti dhe diversifikim të kufizuar në produktet dhe shërbimet që eksporton, duke e bërë më sfidues shërbimin e vazhdueshëm të borxhit të jashtëm.

Së pesti, “Standard & Poors” vë në dukje rrezikun që mund të paraqesin detyrimet e kushtëzuara nga partneritetet publike-private mbi të ardhurat e qeverisë. Ato mund të shndërrohen nesër në mina me sahat.

Meqenëse kam edhe një minutë kohë, dua t’ju them që “Standard & Poors” dhe “Moody’s” e rendisin borxhin ekzistues të qeverisë shqiptare si shumë spekulativ, përkatësisht B+ dhe B1, duke e marrë si një paralajmërim serioz të tyrin. Për borxhin shumë spekulativ rreziku i mospagimit është thelbësor. Kohët e fundit “Standard & Poors” deklaroi: “Ne, gjithashtu, mund të ulim vlerësimet nëse stoku i borxhit të qeverisë shqiptare vazhdon të rritet”.

Jo më larg se dje drejtori ekzekutiv i një kompanie konsulence, këshilltarët financiarë të Euro-Phoenix, në një intervistë të dhënë dje për gazetën shqiptare “Albania Daily News”, theksonte se një eurobond tjetër prej 500 deri në 700 milionë euro do t’i shtojë shanset e

ardhshme për një ulje të vlerësimit të “Standard & Poors” dhe “Moody’s”. Kjo ulje, me kalimin e kohës, do të rriste kostot e borxhit për të gjithë stokun e borxhit jo vetëm për borxhin e marrë rishtazi.

Të dashur deputetë, ne të gjithë duhet t’i flasim ndërgjegjes, ndërgjegjes qytetare, ndërgjegjes profesionale, mbi atë politike dhe mbi interesat e ngushta të politikës së sotme.

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Leskaj!

Kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Gazment Bardhi** - Zonja nënkryetare, ne jemi duke shqyrtuar 3 projektligje shumë të rëndësishme në fushën financiare dhe shikoj një përgjegjshmëri totale të ministres së Financës, e cila nuk është në sallë. Prandaj, në emër të gjithë kolegëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, bazuar në nenin 47 të Rregullores, kërkojë që ministrja e Financave të vijë në seancë plenare. Nuk ka punë më të rëndësishme për ministren e Financave sesa të jetë prezente kur Kuvendi shqyrton tre projektligje nën fushën e saj të përgjegjësisë. Duhet të jetë prezente gjatë gjithë diskutimeve të deputetëve për tre projektligjet.

Prandaj, në bazë të nenit 47, pika 1, të Rregullores, kërkojmë që ju, në cilësinë e drejtueses së seancës, të kërkonit prezencën e ministres së Financave në seancë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj**- Faleminderit, zoti Bardhi!

Përpara se ju ta merrnit fjalët, unë kam komunikuar me ministren e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe zonja Ibrahimaj është duke u paraqitur.

Kalojmë në emër të grupeve. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Spaho. Të përgatitet zoti Xhafaj.

**Edmond Spaho** - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Përpara se të bëj diskutimin tim për buxhetin, dua të ndaj një mesazh nga përvoja personale dhe familjare në lidhje me COVID-19. Ne e kaluam të gjithë familjarisht jo me pasoja të rënda dhe mendoj se kjo është, në radhë të parë, falë vaksinimit. Prandaj dua të jap një mesazh

për të gjithë qytetarët shqiptarë: drejtojnë qendrave të vaksinimit. Përpara kemi një dimër të vështirë, pandemia, me sa duket, po rihapet në përmasat e dy vjetëve të fundit dhe, që ajo të përfundojë, e kemi vetëm në dorë dhe e kemi në dorë duke u vaksinuar. Nëse nuk do të vaksinohemi, të jeni të sigurt që do të humbim jetë njerëzish. Vdekshmëria po zbrit në moshë relativisht të reja, nën 50 vjeç, madje edhe më të rinj. Ne nuk jemi popull që nuk jemi mësuar me vaksinimin, ne kemi pasur vaksinim të detyrueshëm për një sërë sëmundjesh, si: difteria, tetanosi, hemofilusi, poliomyeliti, pneumokoku dhe në sajë të vaksinimit kemi shpëtuar nga këto sëmundje vdekjeprurëse. Kështu që thirrja ime është: besojini vaksinës, besojini shkencës dhe mos besoni ata që jetojnë në universin e konspiracionit dhe prapa çdo ferre shohin një armik të njerëzimit.

Faleminderit!

Në kushtet e ekonomive moderne borxhi merret dhe ka si qëllim që të mbështesë ekonominë. Praktikë e njohur në vendet me nivelin ekonomik dhe financiar të Shqipërisë është që të marrin rregullisht borxh, por që borxhi nuk duhet të kthehet në risk për ekonominë. Kundërshtimi që kemi në lidhje me Eurobondin ka të bëjë me faktin që gjendja ekonomike dhe financiare e vendit është e tillë, që riskohet rëndë nga marrja e borxhit shtesë. Ministrja e Financave thotë që nuk është e vërtetë dhe e paraqet gjendjen me ngjyra optimiste, por, atëherë, pse e kemi hequr rregullin fiskal, i cili është për të kontrolluar, kufizuar dhe miradinsitruar burimet financiare?! Ne e kemi pezulluar rregullin fiskal, sepse kemi pamundësi për të financuar ekonominë, na ka rënë kapaciteti fiskal, kemi nevojë të mbulojmë shpenzimet dhe, për rrjedhojë heqim këto pengesa, të cilat garantojnë stabilitetin makroekonomik dhe financiar. Nuk ka si të shpjegohet ndryshe.

Së dyti, faktet, vitet dhe përvoja e kësaj qeverie kanë treguar që ajo mbështetet vetëm në borxh dhe e ka instrumentin kryesor për të financuar ekonominë. Kjo për shkak të strukturës së deformuar të shpenzimeve që ne kryejmë.

E përmendi edhe zoti Leskaj, kjo është qeveria që ka marrë më shumë borxh se të gjitha qeveritë e të tjera bashkë, që nga qeveria e parë në sistemin demokratik dhe deri sot të gjitha

bashkë kanë marrë 5,9 miliardë euro borxh, ndërsa vetëm kjo qeveri ka marrë 6,3 miliardë euro borxh dhe do të marrë edhe 700 milionë të tjera. Të jeni të sigurt që prapë vitin tjetër do të ketë ndonjë projekt.

Siç e përmendën edhe kolegët e tjerë, ky është një rrezik afatgjatë, nuk është për sot. Shikimi i qeverisë është sot për sot dhe thotë: “Ta hedhim lumin, pastaj se çfarë ndodh mbrapa...”, por janë brezat ata që do ta paguajnë dhe do ta paguajnë me kosto të lartë.

Edhe sikur t’i kthehemi asaj që sot merret borxh në ekonomi, duhet parë efektiviteti, pse e përdor dhe pse e merr këtë borxh. Nga 700 milionë, 250 milionë do të jenë për të paguar borxhin e vjetër. Pra, merr borxh për të kthyer borxh, sepse llogaritë, kur janë marrë borxhet e përparme, nuk dalin sot në pazarin financiar. 450 milionë euro janë për shpenzime. Po për çfarë shpenzimesh?! Të ndërtohen rrugë, gjysma e të keqes, por është për të mbuluar shpenzimet e administratës, e cila është rritur me herë për efekte elektorale, apo për shpenzimet për PPP-të, ku 14 miliardë lekë në buxhetin e vitit 2022 janë vetëm pagesa për PPP-të, nga të cilat 3 miliardë janë për Rrugën e Arbrit, 2 miliardë për skanimin dhe pastaj vijnë me radhë të gjitha të tjerat, siç janë inceneratorët dhe PPP-të, që pretendohet se zgjidhin probleme të mëdha të qytetarëve, por që, në fakt, e kanë katandisur në skema korruptive për të financuar klientelën e partisë, shpenzimet për rrugë, që kanë 3-fshin, 4-fshin, nganjëherë 10-fshin e koston së ndërtimit të rrugëve të Bashkimit Europian në Shqipëri.

Projektet e Bashkimit Europian në Shqipëri janë me kosto me herë më të ulët sesa projektet e rrugëve tona. Ju mburreni se nga borxhi që keni marrë shpenzimet në lekë për rrugët, në krahasim me ne, janë më të larta. Sigurisht që do të jenë më të larta, sepse po ta bësh rrugën me 30 milionë euro 1 kilometër, sigurisht që do të kushtojë më shumë. Thatë se e keni hequr rrugën Milot-Fier. Jo, unë para dy ditësh pashë që procedurat për të dhënë koncesionin në një rrugë fushore 70% e mbaruar, me kosto gati 30 milionë euro kilometri, po ecnin. Unë nuk them që të mos bëhet rruga, sepse rruga duhet bërë, por jo me kosto të tilla shkatërruese, pasi nuk kemi ku t’i gjejmë paratë dhe, në të kundërt, do të shkojmë e marrim borxh, ashtu siç po bëjmë.

Duhet të kenë kujdes, sepse po na ikën struktura: raporti borxh i brendshëm me borxh i jashtëm, po shkon 60% borxhi i jashtëm dhe 40 % i brendshmi. Kjo do të ketë efekte në kursin e këmbimit dhe në inflacion. Dy muajt e fundit rritët importin e energjisë në euro, por a e keni parë sesi po ngjitet euro?! Pra, rritja e euros do të rrisë koston e borxhit, atë që po mburreni se e keni të ulët dhe e gjeni me interesa të ulëta. Një ekonomi si Shqipëria nuk mban dot goditje të tilla. Kriza energjetike do të na ekspozojë keq në planin financiar.

Pak ditë më parë Banka Botërore, në një material të saj për vendet e Ballkanit Perëndimor, i tërheq vëmendjen Shqipërisë që të ketë kujdes me borxhin, sepse do të ulen investimet. Pra, do të marrë shumë borxh, do të planifikojë shumë për të likuiduar, ka hyrë në një skemë, ku një pjesë e mirë e shpenzimeve nuk janë të karakterit prodhues dhe, për rrjedhojë, për t'i financuar ato do të ulë investimet. Ulja e investimeve do të rrisë rritjen ekonomike, do të përkeqësojë gjendjen e qytetarëve, si dhe do të rriten çmimet, ashtu siç po rriten.

Për ta mbyllur fjalën time, dua t'ju them se qeveria duhet të jetë jashtëzakonisht e kujdesshme në hapat dhe veprimet që bën, sepse këto veprime nuk janë vetëm për sot. Prandaj borxhi diskutohet në parlament, sepse ne kemi përgjegjësi për brezat e ardhshëm dhe parlamenti vendos rregulla fiskale për kufizimin e qeverive. Duke vepruar kështu, vepohet në mënyrën më të papërgjegjshme dhe jo në interes të qytetarëve.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj**- Faleminderit, zoti Spaho!

Faleminderit edhe për mesazhin në fillim të fjalës suaj lidhur me vaksinimin, sepse është një alert i rëndësishëm, pandemia vijon dhe ne duhet shpeshherë, jo vetëm kur problemi vjen te vetja dhe te familja, të kujtojmë që ky është një rrezik i vijuar për jetën dhe shëndetin.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Etjen Xhafaj.

**Etjen Xhafaj** - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Edhe unë dua t'i bashkohem thirrjes që bëri parafolësi, sepse besoj që për të gjitha familjet e

shqiptarëve që ne përfaqësojmë këtu, edhe ata që nuk kanë votuar, kjo është primarja.

Unë nuk dua të ndalem shumë te mesazhet konfliktuale, që u thanë shpesh këtu, duke e goditur borxhin si një instrument të financimit të qeverive, apo arsyen pse është marrë ky borxh, sepse ne të gjithë e dimë që në këtë sallë diskutohet edhe buxheti faktik, ku të gjitha shpenzimet e çdo qeverie shikohen sesi janë ekzekutuar dhe projektet sesi janë implementuar, por dua të flas vetëm për një fakt, që këtu u fol shumë për FMN-në, madje u fol edhe për parashikimet e vdekshmërisë që FMN-ja bën, kur, në fakt, FMN-ja është një institucion, i cili merret me rregullimin e sistemit financiar botëror dhe është një nga ata institucione që e ka vendosur këtë ciklik të financimit të borxhit publik.

Të gjithë e dimë, edhe çdo familje shqiptare e di që dikush që merr shpeshherë borxh në shuma të vogla dhe dikush që merr kredi për një investim janë tërësisht ë ndryshëm financiarisht. Kjo është diferenca më e madhe që ka ndodhur në vitin 2013. Prandaj, në atë periudhë, u arrit të merrej borxh vetëm një herë, madje u kërkua investim dhe u bënë edhe shkëmbime me institucione të pavarura financiare brenda Shqipërisë, siç është hotel "Dajti", për të financuar në mungesë të mundësive. Të gjithë ekonomistët dhe financierët në këtë sallë, por edhe jashtë saj e dinë që cikli i financimit të borxhit synon gjithmonë të shkojë drejt borxhit afatgjatë, drejt borxhit të financuar mes valutës së huaj dhe monedhës vendase, në mënyrë që të limitojë efektin ndaj inflacionit dhe të ndihmojë atë që është cikli normal i financimit. Të gjitha vendet e botës marrin borxh dhe një pjesë të tij e përdorin për të ripaguar borxhin. Prandaj, duhet të kujtojmë që borxhi më i madh që kemi është borxhi që kemi ndaj qytetarëve, të cilët na kanë votuar, është borxhi që u kemi për t'u thënë të vërtetën.

Të gjithë e dimë që në vitin 2014 ne hymë në një program me FMN-në, i cili, ndër të tjera, na ndihmoi të përgatisim një strategji afatgjatë për menaxhimin e borxhit dhe për uljen e borxhit, që u ndoq deri në vitin 2019. Në vitin 2019 të gjithë e dimë se çfarë ndodhi, pavarësisht se ne kemi qenë aty me qytetarët, kishte një nevojë shumë të madhe për t'iu përgjigjur

nevojave të tërmetit dhe pas saj edhe nevojave të ekonomisë si pasojë e pandemisë.

Unë jam shumë dakord që të përmendim vendet e tjera, të citojmë edhe alarmet që jepen, por hajdeni të citojmë disa shifra, që tani janë reale. Një koleg më parë citoi Komisionin European, por vetë Komisioni European ka vlerësuar që borxhi mesatar i eurozonës është 100,5% dhe në eurozonë janë edhe vende si Luksemburgu, të cilët e kanë borxhin 25%. Pra, të gjitha vendet kanë zgjedhur këtë rrugë për të financuar nevojat e imponuara në ekonomi nga pandemia dhe, sigurisht, në rastin e Shqipërisë, edhe nga tërmeti i 26 nëntorit. Prandaj, nuk mund të thoni: “Pse nuk kemi ndërtuar më shpejt dhe pse nuk përdorim më pak para”, sepse janë në paradoks me njëra-tjetrën.

FMN-ja, “Standard & Poors” dhe “Moody’s” kanë deklaruar besueshmërinë e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare dhe kjo nuk është mburrje, por fakt. Besueshmëria është rritur nga implementimi i reformave strukturore, nga rritja e investimeve të huaja të drejtpërdrejta dhe, sigurisht, nga avancimi në rrugën e integritit. Të tria këto janë objektiva afatgjatë, që ne duhet t’i kemi dhe, besoj se të gjithë bashkë i kemi.

Një gjë tjetër që thotë FMN-ja, që është baza e çdo doktrine që FMN-ja ka, është që stabiliteti makroekonomik është jashtëzakonisht i rëndësishëm, që përjashtimet fiskale në çdo paketë tatimore janë të dëmshme për ekonominë. Të gjitha propozimet, me të cilat ju vini, në fakt, përbëjnë përjashtime. Sikur t’i merrnim parasysh të huajt për këshillat që na japin vërtet dhe jo vetëm për ato që duam, ndoshta do të ishim të gjithë më mirë dhe do të kishim mundësinë që të diskutonim edhe në nivel teknik, por në kushtet kur ne krahasojmë borxhin e marrë në histori dhe borxhin e marrë në tetë vjetët e fundit, jemi jashtë çdo realiteti.

40% e të gjithë sasisë së parave të printuara në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ekonomisë më të madhe në botë, janë printuar në më pak se 15 muajt e fundit. E tillë është ekonomia, me kalimin e viteve fitojnë vlerë gjëra të tjera që nuk janë para dhe e tillë është edhe ciklura e financimit të borxhit, por situata e jashtëzakonshme para së cilës u gjenden të gjitha vendet e botës impononte mënyra zgjidhjesh, të cilat ishin vetëm 3.

Së pari, ishte rritja e taksave, e cila është zgjidhje afatshkurtër dhe imediate; së dyti, ishte rritja e interesave, pra e nivelit të inflacionit, çka do të kishte dëmtuar qytetarët dhe kursimet e tyre dhe, së treti, ishte rritja e borxhit. Nuk është sekret që të gjitha vendet në botë këtë rrugë kanë zgjedhur dhe nuk është aspak sekret që edhe objektivi afatgjatë i qeverisë suaj para 8 vjetësh ka qenë balancimi i këtij borxhi, sepse ka shkuar në atë trajektore, prandaj është e pamohueshme. Këto janë grafika, të cilat duken në kohë.

Dua t’ju jap disa shifra. Borxhi afatgjatë i Shqipërisë, aktualisht, që është një tjetër indikator besueshmërie, është 63,5%, në vitin 2013 ka qenë 45%; borxhi afatshkurtër është 17,5%, nga 30% që ka qenë. Interesat fikse vlejnjë për 55% të borxhit.

Për të sqaruar enigmën tjetër të madhe, pse merret borxhi në valutë të huaj, përtej nevojës dhe besueshmërisë për t’u financuar në tregje të huaja, kostoja apo interesi mesatar i borxhit në valutë të huaj të Shqipërisë, i marrë në tregje të huaja, është 3,5% i atij të marrë tregun e brendshëm është 4,07%. Kjo do të thotë se, përveç kostove dhe kursimit, që bëhet kur merret borxh në monedhë të huaj, kemi, gjithashtu, edhe një efekt tjetër, pasi efekti ynë është rritja e ekonominë, shpërndarja e mirëqenies për të gjithë qytetarët, pra rrjedhimisht të mos pengojmë duke marrë përsipër ato mjete, të cilat janë mjete që përdoren nga biznesi, që janë mjete që përdoren nga qytetarët dhe mjete, të cilat përdoren nga ekonomia vendase. Pra, të mos krijojmë atë që quhet *crowding out effect*, që ka ndodhur shpesh më parë, ku edhe vlera e interesave të kredive rritej për qytetarët, sepse të gjithë kredinë e merrte qeveria.

Unë besoj se ne sot kemi mundësi shumë të mirë që absolutisht duhet ta votojmë të gjithë këtë ligj. Besoj, gjithashtu, që ky diskutim, që ministrja e Financave e ka ofruar, duhet të bëhet jo vetëm në këtë sallë, por edhe në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, atje le të diskutojmë për cilësinë e borxhit dhe për të gjitha mundësitë që kemi. Nuk duhet të harrojmë në asnjë moment, kur paragjykojmë dhe në njërin krah themi: “Keni marr borxh pa fund dhe për çfarë e keni përdorur”, në të gjitha vitet, me përjashtim të vitit 2020, sasia e borxhit publik që është marrë çdo vit ka qenë më e ulët se investimet publike. Kjo do të thotë se ky nuk është një

borxh, i cili po përdoret në kushte krize, kur qeveria nuk ka më para në thesar dhe do të duhet të financojë rrogat apo pensionet, por është një borxh, i cili është marrë në mbështetje të rritjes ekonomike, e cila, në fund të ditës, është metrika dhe matësi më i mirë i performancës së çdo qeverie dhe të çdo kompanie.

Rritja ekonomike, në një periudhë me shok shumë të madh ekonomik, siç ishin dy vjetët e fundit, kur patëm një shok afër 10% të prodhimit të brendshëm bruto nga efekti i tërmetit, dhe, sigurisht, pandemia, ku të gjitha vendet janë ende duke u përpjekur ta llogarisin se sa efekt ka pasur, por rritja ekonomike është duke u kthyer, është certifikuar nga Banka Botërore, është certifikuar nga FMN-ja, që merret me këtë gjë. Sigurisht, për reagime në kohë krizash, në nevojë imediate jo vetëm qeveria e Shqipërisë, por çdo familje shqiptari shikon sesi do të ndihmojë të zgjidhë krizën, të zgjidhë nevojën dhe të zgjidhë atë që është më imediate. Përballimi i krizës, shëndeti i qytetarëve shqiptarë dhe kthimi i shtëpive i të gjithë atyre, të cilët humbën shtëpitë nga tërmeti kanë qenë prioritetet e qeverisë shqiptare, prandaj qeveria shqiptare në dy vjetët e fundit, 2020 dhe 2021, e ka rritur borxhin publik.

Ne duhet të shikojmë edhe strategjinë afatgjatë të menaxhimit të financave publike, që, duke filluar nga vitet e ardhshëm, ne do të kthehemi në trajektore rënës dhe, sa do të arrijmë ta përballojmë ne këtë, kjo nuk varet vetëm nga qeveria shqiptare, por nga fakti që do të jemi të gjithë këtu për ta gjykuar këtë edhe për 4 vjet të tjera, do të thotë që do të kemi mundësinë ta vazhdojmë këtë debat, por gjithmonë duke qenë të vërtetë ndaj asaj për të cilën na kanë besuar qytetarët shqiptarë, duke filluar nga ai që ka më pak mundësi dhe deri tek ai që ka më shumë mundësi, t'u shërbejmë duke mos bërë dallim mes tyre, por duke bërë më të mirën tonë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Këtu mbyllim pikën 4 të rendit të ditës së seancës së sotme plenare dhe kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës, te diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

(BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë së COVID-19”.

Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, ftoj kolegët që, nëse kanë pyetje për projektligjin t’ia drejtojnë ministrit propozues të projektligjit. A ka pyetje nga kolegët? Jo, nuk ka. Meqenëse nuk ka pyetje, po ia kaloj fjalën nismëtarit.

Fjala për ministren Balluku.

**Belinda Balluku**- E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it, për marrëveshjen e huas ndërmjet OSHEE-së dhe BERZH-it për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19”, është një nga projektligjet që e kemi diskutuar në Komisionin e Ligjeve, ku kemi hyrë në detaje më shumë se zakonisht, madje edhe në Komisionin e Ekonomisë, në Komisionin e Veprimtarive Prodhuuese dhe në Komisionin e Politikave të Jashtme ka pasur një qëndrim të ndryshëm nga grupet e opozitës, ku në disa komisione është votuar pro, në disa të tjerë është abstenuar dhe në disa është votuar kundër.

Megjithatë, e kemi diskutuar gjerë e gjatë dhe kemi kaluar edhe tej shpjegimeve që zakonisht jepen në raste të tilla, duke bërë transparencë si për deputetët, ashtu edhe për publikun. Kjo kredi ka nisur si punë nga OSHEE-ja, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe, pa dyshim, edhe nga Ministria e Financave, në muajin qershor, duke parë të gjithë impaktin financiar që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë dhe kompanitë e tij bija kanë pasur gjatë periudhës së pandemisë.

Më pas, sigurisht, duke pasur parasysh edhe ndërprerjen e investimeve që kemi bërë gjatë kohës së pandemisë, kemi qenë të detyruar të kërkojmë një mbështetje financiare përmes kësaj huaje, duke e kërkuar këtë hua në një nga institucionet financiare partnere, do t’i quaja, pasi BERZH-i është një nga institucionet që ka mbështetur në disa projekte të rëndësishme apo reforma të rëndësishme si Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë, ashtu edhe

qeverinë shqiptare, vendosëm t'i drejtoheshim kësaj banke për sa i përket huas.

Ashtu siç e përmenda më parë, unë nuk dua që në këto momente të futem dhe t'u jap detaje për sa u përket të gjitha operacioneve që do të mbulohen nga kjo hua, duke filluar nga nevoja që sot ndërmarrja e Operatorit të Shpërndarjes ka për të mbuluar të gjitha shpenzimet korrente, por, pa dyshim, edhe për të vazhduar me investimin shumë të rëndësishëm të nënstacionit të qendrës, por dua të kaloj vetëm disa pjesë teknike të rëndësishme. Ky projektligj parashikohet në ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it përmban tri nene, ku sipas nenit të parë termat dhe kushtet standarde të BERZH-it konsiderohen si pjesë përbërëse e marrëveshjes; neni dy përmban termat dhe detyrimet që rrjedhin nga garancia; neni tre përmban detaje mbi njoftimet dhe lëshimin e opinionit ligjor në përputhje me kushtet dhe termat standarde të BERZH-it.

Për të mos ju marrë kohë, dua të ndalem vetëm një moment tek termat e kredisë, që do të akordohen nga BERZH-i për OSHEE sh.a-në. Ato paraqiten si më poshtë: shumë e kredisë 70 milionë euro, komision administrimi 1% e shumës së huas, komision angazhimi 0,5% në vit e shumës së angazhuar dhe të papërdorur, afati i shlyerjes 5 vjet, periudhë e mos shlyerjes së principalit 1 vit, norma e interesit euribor 6 milionë plus 1%.

Unë ju ftoj ta votoni këtë projektligj, ashtu siç kemi bërë edhe gjatë seancave të komisioneve. Është një moment kritik për sektorin energjetik; është një moment kritik dhe një krizë globale, e cila, pavarësisht se ndonjëherë përfshihet në çështjet politike, nuk mund të përfshihet, pasi është një krizë e pamohueshme dhe parashikohet të zgjasë gjatë.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj-** Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e nismës!

Kalojmë te diskutantët. Sipas radhës së diskutimeve, më takon mua të flas. Kështu që, ju lutem, po e marr unë fjalën! Të përgatitet zoti Bardhi.

Marrëveshja për marrjen e një huaje prej 70 milionë eurosh nga BERZH-i nga ana e OSHEE-

së është një marrëveshje e rëndësishme, e cila nevojitet të marrë miratim nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, për faktin se kjo kredi i siguron likuiditet kompanisë më të rëndësishme elektro-energjietike shqiptare për blerjen e energjisë elektrike, e cila është një nevojë bazike e qytetarëve, e bizneseve, e institucioneve publike apo private. Pra, as më shumë e as më pak, ne flasim sot për një kredi të butë, me afat 5-vjeçar, e nevojshme, pa asnjë dyshim, po të kemi parasysh rrethanat e reja të krizës energjetike, sikundër flasim për një kredi, që kërkohet për arsye të njohura dhe të natyrës tërësisht objektive.

Pandemia e COVID-19 ka prekur shumëçka apo gjithçka dhe këtë mund ta pohojë secili nga ne në jetën personale, ku më shumë e prekur është e gjithë infrastruktura shtetërore dhe joshtetërore, e cila ka për detyrë kryesore pikërisht përmbushjen e nevojave bazike të qytetarëve dhe të këto nevoja, besojmë se biem dakord të gjithë, hyjnë furnizimi me energji elektrike dhe ai me ujë.

Në kushtet e karantinës dymujore dhe vijimit të mbylljes, si në të gjithë botën, konsumi i energjisë elektrike nuk ka rënë, por është rritur. Rezulton që konsumi i energjisë të jetë rritur me 7% vetëm nga konsumatorët familjarë dhe brenda rrjetit të konsumatorëve familjarë më shumë energji kanë shpenzuar kategoria e atyre që subvencionohen nga shteti për çmimin e energjisë elektrike. Ndërkohë jemi të qartë që çmimi për kilovat/orë ka qenë dhe vijon të mbetet i njëjtë. Nëse arkëtimet në vitin e fundit para pandemisë, pra në vitin 2019, shkonin në masën 97,5%, gjatë vitit 2020, koha kur është kontraktuar për marrjen e kësaj kredie, arkëtimet u ulën në masën 93%, duke konsideruar një humbje të konsiderueshme për Operatorin Shtetëror të Shpërndarjes së Energjisë dhe nuk janë pak, por janë plot 2,4 miliardë lekë, që janë humbur nga mungesa e arkëtimeve vetëm në vitin e fundit.

A është ky një moment alerti, si vetë pandemia?! Cila strukturë shtetërore, në cilin vend të botës u gjet e përgatitur për t'iu përgjigjur pandemisë në momentin e parë që ajo u shfaq?! Askush, në fakt, por kjo nuk mund të thuhet për reagimin, sepse ne reaguam me shpejtësi, duke evituar katastrofa të vërteta në humbjen e jetëve njerëzore. Ne nuk patëm asnjë

kolaps të llojit që të bllokonte çdo gjë dhe, pikërisht, nga reagimi i mirë, veprimi i shpejtë dhe afatgjatë ia kemi dalë të menaxhojmë.

Edhe momenti i kontraktimit të kësaj kredie duhet konsideruar si një moment i mirë, si një moment i duhur reagimi dhe si pjesë e së njëjtës logjikë të asaj përgjegjësie që shteti ka ndaj çdo konsumatori, i cili ka të drejtë të furnizohet rregullisht dhe pa ndërprerje me energji elektrike. Por debati midis jush dhe nesh nuk filloi këtu, ishte po ai debat i vjetër, që, në fakt, unë besoj se ju e keni humbur me kohë, i cili synon të mohojë çdo arritje dhe çdo ndryshim pozitiv, çdo gjë që qytetarët e prekin, e përfitojnë dhe e shohin në trajtën e një të mire publike që qeveria tanimë ua ka vënë në dispozicion. Sigurisht që e ka për detyrë t'ua japë këtë shërbim sot, i cili nuk mund të krahasohet me atë që jepej më parë, minimalisht që prej vitit 2014. Është një shërbim që për një pjesë të atyre që ne i konsiderojmë si kategori më të brishta jepet i subvencionuar, i tillë jepet shërbimi i furnizimit me energji elektrike për pensionistët, për të gjithë ata që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe për personat me aftësi ndryshe.

Ky shërbim jepet i garantuar, i garantuar për sa i përket pandryshueshmërisë së çmimit për të gjithë konsumatorët familjarë dhe për të gjitha bizneset e vogla, garantohet edhe furnizimi i pandërprerë përmes garancisë sovrane prej 200 milionë eurosh që qeveria ka vënë në dispozicion sipas planit më të fundit të shpallur për përbalimin e krizës së energjisë elektrike, një krizë globale, që tanimë dihet sesi kanë shkuar çmimet e energjisë dhe karburanteve.

Motivi i vjetër që na sillt si argument vijimisht nga opozita dhe që demok rrëzon reformën në sektorin elektro-energjistik, rrëzon çdo marrëveshje, çdo plan për energjinë, se janë arrestuar qytetarë për mospagim energjie elektrike, është një abuzim i madh me të vërtetën. “Askush nuk mund të futet në burg për mospagimin e detyrimeve civile”, këtë e thotë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ky nuk është një deklamim politik dhe aq më pak nuk është një deklamim i Partisë Socialiste apo imi personal. Abuzuesit e energjisë, vjedhësit, ata që bëjnë lidhje të paligjshme, ata që manipulojnë matës, vetëm ose në bashkëpunim me elektricistë, ata po, kanë hyrë dhe do të hyjnë në burg, sepse këtë ndëshkim e parashikon ligji.

Madje, rasti e sjell që vepra penale në fjalë është parashikuara në Kodin Penal pikërisht kur ishit ju në pushtet dhe shumë mirë që e bëtë, sepse kishte ardhur koha që vjedhjen e energjisë elektrike ta parashikonim si një krim të veçantë.

Sigurisht që mund të kenë ndodhur situata të ndryshme nga zbatuesit e ligjit në këtë pikë, nuk jemi ne, pasi këto janë çështje të përgjegjësisë së dikujt tjetër, si kanë ndodhur, por kurrsesi ky nuk mund të jetë një kut matës për një reformë të rëndësishme që duhet të ndërmerrej në sektorin elektroenergjistik, që ne e gjetëm në një gjendje skandaloz, pasi kishte një gropë prej 150 milionë eurosh përpara se të fillonim reformën në sektorin e energjisë elektrike, ku pagesat e energjisë elektrike nuk i mblidhte shteti, por qokaxhiu i pushtetit, i cili i merrte paratë edhe kesh, dorazi, duke injoruar çdo strukturë bankare.

Unë nuk po i hyj kësaj historie të ulët, që e ka emrin “CEZ”, e ka emrin “ARMO”, e ka emrin “qeverisja juaj”, po deshët, sepse nuk është as koha dhe as vendi për ta bërë këtë këtu, por e përmenda këtë gjë, sepse kujtesa vlen për të bërë diferencën mes asaj që ishte, që fatmirësisht nuk është më, dhe asaj që kemi sot. Për ta ilustruar këtë diferencë unë po lexoj vetëm disa të dhëna të investimeve nga viti 2014-2020 në disa qarqe të vendit. Në rajonin e Tiranës janë rikonstruktuar 8 nënstacione dhe 661 kilometra linja të tensionit të lartë, së bashku 1101 kabina; në rajonin e Elbasanit janë rikonstruktuar 2 nënstacione, 456 linja të tensionit të lartë dhe 64 kabina elektrike; në rajonin e Burrelit janë rikonstruktuar 2 nënstacione, 355 linja të tensionit të lartë dhe 73 kabina; në rajonin e Shkodrës janë rikonstruktuar 11 nënstacione, 394 kilometra linja të tensionit të lartë dhe 188 kabina; në rajonin e Kukësit janë rikonstruktuar 7 linja të tensionit të mesëm, 26 linja të tensionit të lartë dhe 47 kabina; në rajonin e Beratit janë rikonstruktuar 3 nënstacione, 997 linja të tensionit të lartë dhe 764 kabina. Kështu mund të vijoj me radhë për të gjitha rajonet, të Korçës, të Gjirokastrës, të Fierit dhe të Vlorës. Totali i investimit shkon në 29 803 449 lekë dhe përfituesit janë 1 300 000 banorë.

Me këto shifra dhe me këtë gjuhë flasim ne kur vjen fjala për sektorin elektro-energjistik.

Faleminderit!



(Drejtimin e seancës e merr zonja Lindita Nikolla.)

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bardhi.

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur bashkëqytetarë,

Besoj se e dëgjuat ministren, pohoi një gjë, në fakt, është e vërtetë, që është një moment kritik për sektorin energjetik. Po, zonja Ministre, patjetër është moment kritik, sepse OSHEE-në dhe fondet për OSHEE-në i keni kthyer si bankomat personal të qeverisë suaj.

Zonja Felaj tha këtu që nuk futet dikush në burg nëse nuk paguan një detyrim civil, është e vërtetë, por shqiptarët janë njohur me histori të dhimbshme kryefamiljarësh që jo vetëm janë futur në burg, por edhe kanë vlarë veten, për shkak të arrestimeve të paligjshme të kësaj qeverie, fiks, madje në ditët e para, kur rritët çmimin e energjisë elektrike.

Kjo është pika e dytë, edhe pse u tha e pesta, është projektligji i dytë që ne po diskutojmë sot dhe për fat të keq është i dyti projektligj që na vjen për të kërkuar borxh, prandaj edhe kjo është seanca e borxhit.

Tri pika ka rendi i ditës dhe për dy projektligje i kërkohet Kuvendit leje për të marrë borxh në këtë parajsën ekonomike që na ka siguruar qeverisja 8-vjeçare e Edi Ramës.

Besoj se shqiptarët nuk e kanë harruar që fiks në muajin kur do të duhej të paguanin faturë më të lartë të energjisë elektrike, për shkak të rritjes së çmimit nga qeveria e Edi Ramës, tenderi i parë, zonja Ministre, që bëri OSHEE-ja, ishte të rregullonte zyrat e reja të OSHEE-së, miliona euro të shpenzuara që A. Çela dhe stafi i tij të punonin në kushte më komode. Për këtë shqiptarët do të paguanin një çmim më të rritur energjie që zyrarët t'i kishin kolltukët e zyrave, televizorin dhe pajisjet e zyrave më komode se nuk mund të punonin dot në kushte jokomode.

Zonja Ministre, besoj e dini se nën drejtim e zotërisë që ka 8 vjet në OSHEE dhe që së fundi, për shkak të fryrjes së tepër të xhepave, e keni bërë edhe drejtues politik të qarkut Durrës, njeriut bankomat për Edi Ramën, shqiptarët janë vjedhur nga OSHEE-ja si në asnjë institucion tjetër. Ne sot marrim rreth 70 milionë euro borxh plus 200 milionë euro, që i përmendi si garanci

ministrja, që është ofruar nga buxheti i shtetit, fiks, sepse...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Të mbaroj unë dhe pastaj e merrni fjalën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mund të jetë edhe ashtu, por të mbaroj unë dhe...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Në rregull. U kënaqe? Mbarove?

Faleminderit!

...dhe 200 milionë të tjera garanci nga buxheti i shtetit (se këta na e shpallën planin për energji dhe emergjencën në energji si një arritje të madhe të qeverisë). Për sa kohë që je në këtë detyrë, zonja Ministre (e kuptoj që e keni problem atë që unë do të them), sepse, në fakt, përpara se të drejtoheshe për të kërkuar një borxh të ri për OSHEE-në do të duhej të kishe sjellë një informacion për Kuvendin e Shqipërisë se si i ka shpenzuar në këto 5 vjet paratë e shqiptarëve, pikërisht OSHEE-ja. Shqiptarët duhet ta dinë se në 5 vjet, me procedura prokurimi, OSHEE-ja ka shpenzuar plot 640 milionë euro, një shumë kolosale, e cila është dhënë pothuajse pa garë për kë ka dashur bankomati i Edi Ramës dhe vetë Edi Rama. Janë 640 milionë euro, gati sa borxhi tjetër që do të marrim me ligjin për Eurobondin, të cilat janë dhënë pa garë, me garë fiktive dhe sigurisht me vlerën më të lartë të mundshme. Kursimet nga procedurat e prokurimit të realizuara nga OSHEE-ja janë pothuajse të papërfillshme. Nuk ka vend për të kursyer, sepse duhet dorëzuar të paktën, këtë e di edhe ministrja, 30%-i të bankomati personal i Edi Ramës në OSHEE. Sa më e lartë të jetë vlera e tenderit aq më e lartë është përqindja e korrupsionit.

Po ju përmend vetëm pak të dhëna që tregojnë se sa thellë është zhytur në korrupsion OSHEE-ja, për të cilën sot shqiptarët po marrin edhe 70 milionë euro të tjera borxh. Për periudhën 2015-2021, janë zhvilluar gjithsej 1277 procedura prokurimi, vlera e kontratave të lidhura është 640 milionë euro, pra 97% e vlerës së fondit limit; 41 procedura prokurimi, konkretisht: 235 milionë euro, zonja Ministre, i keni prokuruar pa garë me vetëm 1 kompani pjesëmarrëse në tender, ndërkohë që 26% të procedurave, fiks aq sa kërkoni të merrni borxh sot, 70 milionë euro i keni bërë për procedura prokurimi luksi. Vetëm për automjete dhe

karburant keni shpenzuar plot 34 milionë euro, për rikonstruksion zyre dhe godine 8,4 milionë euro dhe për shërbim të ruajtjes fizike 23,5 milionë euro.

Të nderuar qytetarë,

Sot keni dëgjuar shumë shifra, sigurisht nga të dyja palët, dhe mund të jeni hutuar e të na shihni të gjithëve me mosbesim dhe për këtë mund të keni të drejtë, por mos harroni një gjë, ata që ju vjedhin janë sot këtu sipër, në qeveri. Ai që ju mban të varfër, që ju ka ngarkuar në 8 vjet me 4 miliardë euro borxh pa jua dhënë mbrapsht as për rroga më të larta, as për pensione më të larta, as për shërbime më të mira në shkolla apo spitale, ai që merr borxh për të vjedhur edhe të ardhmen e fëmijëve tuaj, duke ju vjedhur, sigurisht, edhe votën ditën e zgjedhjeve, e ka vendin këtu pas dhe quhet Edi Rama.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zonja Balluku.

**Belinda Balluku** – Zoti Bardhi, do ta nis nga ajo që duhet të kisha thënë në fjalën e parë, për të cilën ju ishit përgatitur dhe unë nuk e thashë. Faktikisht, janë 10 miliardë për këtë buxhet dhe 10 miliardë për vitin tjetër, për të qenë të saktë, se 200 milionë, ndoshta do të duhen edhe ato, por nuk janë aq, por nuk janë as për të mobiluar zyrat dhe as për të bërë ndërtesa. Edhe zëri që ju përmendët për zyrat dhe ndërtesat, a e dini çfarë janë? Janë qendrat ku presin abonentët, kur dikur një qendër ishte për 1600 abonentë, ndërsa sot një qendër është për 600...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Më bëtë vërejtje dhe më thatë që të mos ju ndërprisja dhe unë direkt u tërhoqa, duke ju lënë të flisni deri në fund, kështu që ma bëni edhe ju këtë nder.

Faleminderit!

E di që sot e kemi tepruar me shifrat, duke u folur qytetarëve me shumë numra, megjithatë unë dua t'ju them, e thashë edhe në komision, por do ta them edhe këtu, energjia është një produkt i prekshëm, nëse janë investuar para atë e dinë të gjithë qytetarët dhe abonentët, sepse e kanë mundësinë të krahasojnë, edhe ju, nuk ka rëndësi, sepse nuk ka përkatësi politike energjia. Energji përdorim edhe ne të majtët, edhe ju të djathtët, sepse të gjithë e mbajnë mend nëse kishin energji në vitet 2006, 2007 apo në 2011

dhe po të gjithë e kuptojnë sot, sepse kanë energji nëpër shtëpitë e tyre, pra nuk po diskutojmë cilësinë e shërbimit, kjo nuk diskutohet më.

Po i rikthehem faktit të ndërtesave apo të mobilimeve. Po, janë ato qendra ku shkojnë abonentët dhe drejtohen për çdo lloj problematike. Më parë ishte 1600 abonentë për qendër, ndërsa sot është 600 abonentë për qendër.

Sa i përket 10-miliardshit të akorduar nga qeveria shqiptare për vitin 2021, për të përballuar çmimet e rritura në bursën energjetike mbarëbotërore, të cilën nuk e kontrollojmë dot ne (me gjithë atributet që na jepni, pra që ne të arrijmë të kontrollojmë edhe çmimet e energjisë mbarëbotërore, nuk e kemi këtë t'ju them të derjtën), jemi të detyruar të blejmë me këto çmime sot në treg, siç ju e dini shumë mirë (sepse ju i dini të gjitha, pavarësisht se kur dilni këtu flisni sikur nuk i dini), kur çmimi i gazit është rritur, edhe çmimi i qymyrit, të cilin, madje duhet ta kishim hequr nga qarkullimi deri në vitin 2030, ka shkuar nga 34 euro/metër<sup>3</sup> në 60 euro. Ne nuk e kontrollojmë dot këtë, por jemi të detyruar t'u ofrojmë shërbim të pandërprerë qytetarëve shqiptarë.

Ndaj, duke pasur të gjitha problemet e sistemit elektro-energjetik për sa i përket prodhimit, që ka të bëjë me bazimin e prodhimit lokal vetëm në prodhimin hidrologjik, sot të gjithë jemi me sy nga qielli, por ka një lajm të mirë që ndoshta në datën 2 nëntor fillon shiu dhe presim 135 milimetra reshje, imagjinoni pra se si është i bazuar ky sistem. Neve do të na duhet...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Nuk është koha për batuta, sepse u dhëmb qytetarëve kjo, mund të duket shumë argëtuese...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Po, ka shumë mundësi që të duket ashtu, por ju e kishit mundësinë që të bënit ndonjë ndryshim në sistem dhe nuk e bëtë.

Ne i kemi nisur të gjitha proceset e devisifikimit, qofshin këto parqet voltaike, projekti i madh i Skavicës apo projektet e parqeve eolike, edhe këtë ju e dini. Unë nuk jam këtu për t'ju thënë gjëra që ju i dini, por jam për t'ju thënë qytetarëve se ato 10 miliardë të akorduara nga qeveria shqiptare për vitin 2021 dhe ato që do të akordohen në buxhetin e vitit 2022 janë për mburojën sociale, janë për të

mbrojtur të gjithë abonentët familjarë, si dhe abonentë që janë biznese të vogla, nga rritja e këtij çmimi, pra për të vazhduar dhe për t'u dhënë çmim të njëjtë me atë që kishin edhe para krizës globale.

Nuk po e zgjas më shumë, sepse e thatë drejtë që sot u thanë shumë shifra, por mendoj se u takon qytetarëve të gjykojnë se kush thotë të vërtetën dhe kush jo, por siç jua thashë energjia e ka matshmërinë me shërbimin dhe me cilësinë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Bardhi.

Ju lutem, jini korrekt, t'i qëndrojmë procedurës dhe jo komenteve!

**Gazment Bardhi** – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Ministre, në fakt, prita se mos më jepje informacionin që ju kërkova për verifikimin se si janë shpenzuar paratë e shqiptarëve nga OSHEE-ja. Do të ishte më e ndershme në raport me qytetarët dhe interesin publik të na informoje këtu, nëse i ke verifikuar ose jo ndonjëherë procedurat e OSHEE-së dhe të mos flisje për gjëra, të cilat as i përmenda dhe as nuk i kisha objekt të fjalës sime. Ajo që unë thashë është një dhe e vetme: në 5 vjet keni shpenzuar nga OSHEE-ja me tendera publike 640 milionë euro me vlerë kontrate 97% të vlerës së fondit limit.

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, ndërpriteni fjalën, sepse nuk është për procedurë!

**Gazment Bardhi** – Edhe një fjali...

**Lindita Nikolla** – Duke përdorur fjalën procedurë në ligjërimin tuaj nuk do të thotë që po flisni për procedurë.

Të lutem, sepse po abuzoni shumë sot!

**Gazment Bardhi** – Zonja Ministre, prita të na shpjegonit, këtu do të dal te procedura, zonja Kryetare, se si ka mundësi që 235 milionë euro janë dhënë në procedura pa garë, të paracaktuara nga bankomati i Edi Ramës. Prandaj, kërkesa ime për procedurë do të ishte që ne si Kuvend, zonja Kryetare, të ngrinim një komision të posaçëm për të hetuar pikërisht këtë kompani shtetërore se si i shpenzon paratë publike të qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Fatmir Mediu.

Të përgatitet zoti Helidon Bushati.

**Fatmir Mediu** – Të nderuar kolegë deputetë,

Po filloj të citoj nga relacioni: “Kjo kredi me BERZHI-n merret në kushtet e emergjencës energjetike dhe pamundësisë së përballimit të krizës nga OSHEE-ja për të blerë energjinë e nevojshme për shkak të çmimeve të larta në treg, si dhe të pamundësisë financiare të përballimit të këtyre çmimeve”.

Po vazhdoj me relacionin, ku thuhet: “Ky financim synon rritjen e performancës së OSHEE Grup dhe Republika e Shqipërisë do të jetë garanti për gjithë detyrimet që operatori i shpërndarjes do të marrë përsipër, sipas kësaj marrëveshjeje. Nëpërmjet këtij financimi OSHEE-ja jo vetëm siguron sa më sipër, por garanton që do të përballojë me sukses ripagimin e kësaj kredie me fondet e aktivitetit të saj”.

Pyetja që unë kam është: si do ta përballojë OSHEE-ja këtë kredi, këtë hua, në këtë situatë kur thuhet vetëm nga fondet e aktivitetit të saj?

Të paktën këto vitet e fundit OSHEE-ja ka dalë me humbje dhe askush nuk garanton që kjo krizë do të jetë afatshkurtër dhe për më tepër të garantojë që OSHEE-ja do t'i kapërcejë problemet e humbjeve të saj. A do të marrim vetëm borxh herë pas here për të shlyer borxhet apo duhet të shohim se cili është problemi real që ka të bëjë me menaxhimin e sistemit tonë energjetik?

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni t'ju theksoj se energjia nuk është thjesht dhe vetëm ekonomi, por është një sektor shumë i rëndësishëm i sigurisë sonë kombëtare. Energjia është përdorur dhe do të përdoret si armë gjeopolitike dhe ne jemi të papërfillshëm në këtë lojë, por ama kemi në dorë të menaxhojmë drejt apo të shtojmë burimet tona energjetike. Ne, në gjeopolitikën globale, jemi një pikë shumë irrelevante, por do të përfshihemi pa dyshim nga konsekuencat dhe efektet zinxhirë në ekonominë tonë kombëtare dhe jetën e qytetarëve shqiptarë, të cilat do të jenë të ndjeshme dhe të prekshme.

Për të qenë më konkret, po u referohem disa autoriteteve më me zë në këtë fushë. Në një konferencë në Arabinë Saudite, CEO i *Blackstone*, Stephen Schwarz, paralajmëroi të martën se çmimet e larta të energjisë ka të ngjarë të shkaktojnë trazira sociale në mbarë botën. Ai thotë: “Ne do të përfundojmë me një mungesë

reale të energjisë dhe kur ka mungesë energjie, ajo do të kushtojë më shumë, ndoshta do të kushtojë shumë më tepër nga sa pretendojmë ne dhe do të krijojë jo vetëm probleme ekonomike, por edhe sociale”.

Kjo çështje diskutohet sot shumë fort në të gjitha institucionet e rëndësishme si në Kongresin Amerikan, Parlamentin Europian dhe në institucionet ekzekutive, por besoj se ka ardhur koha që edhe ne ta shqyrtojmë me seriozitetin më të madh.

Pse po ndodh kjo krizë? Absolutisht, siç e thashë edhe në fillim, janë interesat gjeopolitike, rritja e kërkesës, lojërat që po bën Rusia për të garantuar interesat e veta strategjike për të imponuar furnizimin me gaz në Europë, duke e përdorur atë si armë politike. Kjo krizë është sot një shqetësim i madh botëror dhe ndoshta do të zërë edhe një vend kyç në diskutimet që do të bëhen në COP 26, në Skoci, për të marrë vendimet që duhen dhe për të gjetur balancën e duhur ndërmjet energjisë së rinovueshme dhe energjisë fosile.

Më lejoni t’ju bëj një parantezë, të nderuar kolegë deputetë. Do të doja të vlerësoja dhe të mbështesja të gjitha zhvillimet për investime në sektorin energjetik nga kompani në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shpresoj që të zhvillohen edhe në sektorë të tjerë. Në veçanti mbështes projektin e futjes nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të gazit të lëngshëm në Vlorë, duke besuar që ne mund të kthehemi edhe në një vend ku mund të depozitojmë gazin e lëngshëm në marrëdhënie me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për më tepër që kjo është një strategji e tyre jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për mbarë Europën. Kjo gjë duhet të na bashkojë, të jemi mbështetës dhe të bëjmë të mundur që plani të ecë sa më shpejt si një interes yni kombëtar, por edhe për faktin se kjo krizë globale mund të sjellë vonesa apo devijime të këtyre marrëdhënieve.

Po i kthehem çështjes që po diskutojmë sot. Ajo që është paradoksale është se ndihemi krenarë dhe lavdërohemi se marrim borxh pas borxhi, kredi pas kredie, pa pasur mundësi të gjenerojmë ekonominë dhe të ardhmen për qytetarët tanë. Duket sikur lehtësohemi dhe ndihemi mirë në mënyrë ironike, duke menduar se jemi të sigurt duke marrë borxh për të shlyer borxhet, por harrojmë se po shtojmë kostot për

shqiptarët për sot dhe për nesër dhe kjo është një lloj talljeje që ne i bëjmë vetes sonë, u bëjmë shqiptarëve, por edhe atyre që do të vijnë nesër.

Le të shohim disa nga ato që unë i konsideroj si pretendime për menaxhimin e sistemit tonë energjetik.

E para, OSHEE-ja, siç e thashë, vitet e fundit është me humbje, pra shpenzon më shumë nga çfarë arkëton dhe kjo krizë mund t’i thellojë akoma edhe më tej këto humbje.

E dyta dhe më e keqja është se borxhet më të mëdha të OSHEE-së janë nga entet publike të drejtuara dhe kontrolluara nga qeveria. Po ashtu, OSHEE-ja është tërësisht nën kontrollin politik dhe menaxhues të qeverisë dhe në shërbim të saj. Qeveria është borxhliu më i madh i OSHEE-së dhe vetë OSHEE-ja nuk ka asnjë autoritet për ta detyruar qeverinë, ashtu siç bën me qytetarët, që të paguajë detyrimet që i ka OSHEE-së, pra qeveria, që është garante, është edhe borxhliu më i madh.

17,3 miliardë lekë janë detyrim nga ujësjellës-kanalizimet, të cilat varen dhe kontrollohen nga qeveria, përdoren për interesa, për të punësuar dhe për të realizuar qëllime klienteliste, prandaj bëhen gjithnjë edhe më keq. Duket qartë se ka një paradoks në gjithë këtë marrëdhënie të qeverisë me OSHEE-në. 200 milionë dollarë është detyrimi që kanë institucionet, entet publike, institucionet shtetërore dhe disa ndërmarrje ndaj OSHEE-së.

Qeveria, siç u tha edhe nga disa kolegët të mi, së bashku me OSHEE-në detyruan me dhunë, arrestuan, burgosën, sekuestruan dhe ndërprejnë energjinë elektrike për familjet e varfra, duke i detyruar ata që të paguanin qindarkën e fundit apo të merrnin borxh për t’i kthyer detyrimet OSHEE-së, por duket qartë që nuk e kanë këtë forcë dhe autoritet ndaj vetes për ta kontrolluar atë.

Mjafton të lexojmë edhe raportet e KLSH-së ndër vite për të kuptuar që shumë gropa të zeza ka në menaxhim, të cilat vijnë nga interesat klienteliste. Pra, nuk kemi një problem të vetëm, pamundësinë për të blerë energjinë, por një zinxhir problemesh dhe detyrimesh, që nuk do të marrin fund me këtë kredi.

Të nderuar kolegë,

E ritheksoj që energjia, në gjykimin tim, është më shumë se ekonomi apo debat që duhet të na ndajë në mënyrë banale politikisht. E

rëndësishme është të mendojmë të gjithë me përgjegjësinë tonë si deputetë se si duhet ta menaxhojmë këtë mall publik dhe interes tonin kombëtar. Nuk po i ngre këto shqetësime thjesht se përfaqësoj opozitën këtu në parlament apo me pretendimin se di çdo gjë dhe çka them unë është e padiskutueshme, por mendoj se ka ardhur koha që ne si deputetë të hapim një debat real me veten tonë, për të vënë përballë përgjegjësisë qeverinë që të garantojë transparencë dhe menaxhim të drejtë të interesave tona kombëtare. Ne kemi detyrim kushtetues, e kam thënë edhe herë tjetër, të kontrollit dhe të bërjes së ligjeve dhe duhet të garantojmë që jemi në përputhje me strategjitë dhe politikat europiane.

Po u kthehem disa pyetjeve që bëra edhe në Komisionin e Ligjeve. Pyetja e parë është: kush e bën sot optimizimin e prodhimit dhe të shitjeve në KESH, privati apo KESH-i?

Nuk jam kundër iniciativave private, madje është e kundërta, por në çfarë interesi publik janë ato? Me çfarë interesi financiar dhe me çfarë procedure bëhen këto përzgjedhje?

Ky optimizim gjeneron të ardhura të konsiderueshme ose ka gjeneruar të paktën në favor të KESH-it, kurse sot janë në interes të privatit. Për të sqaruar më tej që optimizimi ekonomik i siguron KESH-it sigurimin e ardhurave shtesë, si rrjedhojë e diferencës ndërmjet çmimeve të shitjes dhe të blerjes së energjisë pa ndikuar në rezervën energjetike. Le ta shohim këtë problem, pse jemi në këtë situatë dhe në këtë marrëdhënie dhe sa ishte do të ishte vlera financiare që do të fitonte KESH-i, në qoftë se do ta bënte vetë në vend që ta marrë privati?

ERE, Enti Rregullator, ka vendosur në kontratën ndërmjet KESH-it dhe OSHEE-së një marrëdhënie të kuptimit të drejtë për sa u përket shitjeve dhe blerjeve apo depozitimit të energjisë, po ashtu ka hedhur poshtë dy herë dy vendime dhe marrëdhënie që kanë të pasur të bëjnë me privatin në depozitim dhe optimizim. Po pse nuk e blejmë ne energjinë në bursë, siç e blen Kosova dhe Maqedonia?

Thonë se nuk e blejmë dot ngaqë nuk jemi të regjistruar në bursë. Kush ju pengon? Pse Maqedonia dhe Kosova, që nuk janë të regjistruar, e blejnë në bursë me çmim më të ulët se ne? Si ka mundësi që OSHEE-ja ta shesë me 50-60 euro nga shkurti deri në qershor energjinë elektrike, ta blejë nga privatët tanë me 65, ndërsa

sot ta blejë me 330 në një kohë që në bursë është me 270?

Kam edhe pyetje të tjera, por nuk më lejon koha t'i bëj (nëse do të më lejoni edhe 30 sekonda). Ne duhet patjetër të shohim si parlamentarë këtu mënyrën e funksionimit që nga OSHEE-ja, KESH-i dhe ndërmarrjet e tjera jo vetëm si obligim apo debat me qeverinë për atë që do të na thotë, por si detyrim tonin për t'iu përgjigjur si deputetë qytetarëve, nevojave, emergjencave dhe interesave tona kombëtare.

Shpresoj që të paktën të hapim sytë ne si deputetë për të bërë që të hapë sytë edhe qeveria ashtu siç duhet, për të qenë transparente me shqiptarët, me paratë e shqiptarëve dhe me interesat tona kombëtare.

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Helidon Bushati.

Të përgatitet zoti Xhelal Mziu.

**Helidon Bushati** – Super e drejtë!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Siç u tha, sot do të kalojë një akt, i cili është një kredi për OSHEE-në, një kredi, të cilën qytetarët duhet ta dinë, sepse do të paguhet nga ata vetë, ashtu siç paguhet çdo kredi. Çdo ditë e më tepër po merren kredi, jo vetëm nga OSHEE-ja, por edhe nga qeveria shqiptare, dhe kjo kredi nuk do të ishte një barrë për qytetarët nëse do të menaxhohej siç duhej. Menaxhimi, një fjalë që u përsërit shpesh këtu dhe me të drejtë, i OSHEE-së ose, siç u shpreh një parafolës, kolegu im, bankomati i qeverisë, ndërsa unë do të thosha arka personale e bosëve të “rilindjes”, sepse bankomati ka disa limite, jep para për një limit të caktuar, ndërsa arka është arkë merret aq sa duhet, aq sa kanë nevojë bosët e “rilindjes”; ka qenë skandaloz.

Është folur shumë këto ditë sikur kriza është ndërkombëtare, pa dyshim që është ndërkombëtare. Ka të drejtë ministrja kur foli për çmimin e gazit apo të naftës, sepse janë produkte që blihen në bursë dhe importohen, ndërsa energjia prodhohet në Shqipëri.

Zonja Ministre, është keqmenaxhimi. Kriza energjetike botërore ka ardhur si rezultat i shumë faktorëve, ndërsa kriza energjetike në Shqipëri do të ishte shumë më pak e ndjeshme nëse do të menaxhohej si duhej. Ju e keni refren qeveritar që jeni më të mirët, keni bërë çdo gjë më tepër se çdo qeveri e mëparshme e të marra së bashku. Jo

më larg se sot Kryeministri tha: “Kam takuar më shumë njerëz se të gjithë kryeministrat së bashku në 30 vjet demokraci”. Jam i sigurt se ka takuar edhe më shumë se të gjithë liderët e Ballkanit, kjo është e padiskutueshme, “Skënderbeu” i tyre, “Odiseja”, i gjithëpushtetshmi. Çfarë po ndodh? Sot i gjithëpushtetshmi gjendet në krizë, detyron ministren t’i drejtohet qiellit që të vijë shiu, apo jo?! Kjo është e vërteta, sepse “Odiseja”, “Skënderbeu” i tyre ka dështuar.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

A e keni parë këto ditë megafonin e katastrofës të ketë bërë qoftë edhe një tryezë me ekspertë, ai që nxjerr në televizion çdo takim për çdo projekt tredimensional, që nuk realizohet asnjëherë në Shqipëri? A është bërë një tryezë me ekspertë për të gjendur rrugë për të lehtësuar dhimbjen? Sepse dhimbja është shumë e madhe.

Unë tani do t’ju tregoj disa nga arsyet, duke përdorur edhe shifra, ndoshta ministres nuk mund t’i pëlqejë kjo. Po e filloj me keqmenaxhimin e kaskadës Fierzë-Koman-Vau i Dejës. Zonja Ministre, përse? Më duhet t’ju them se zonja ministre në debatet që kemi pasur në komision, u qëndron dy koncepteve teknike: optimizimit dhe nivelit teknik. Pa dyshim ka të dhëna, sepse energjëtika dhe hidrocentralet nuk janë shpikur dhe ndërtuar sot dhe manuale.

Zonja Ministre, në qershor keni prodhuar, ndërkohë që çmimi në bursë ishte vetëm 75 euro, me 145% të kapacitetit, pra mbi nivelin teknik; në muajin korrik me 160% të kapacitetit, domethënë keni prodhuar më tepër sesa nivelin teknik dhe në muajin gusht me 125% të kapacitetit. Pse, zonja Ministre? Në atë periudhë çmimi në bursë ishte 75 euro, ndërsa sot është mbi 300 euro. A mund të ma shpjegoni?

Gjatë debateve në komision, zonja ministre, për të zhvlerësuar disa të dhëna që unë i dhashë, më tha: “Duhet t’i telefonosh rojës së hidrocentralit që të të japë të dhëna”. Unë i telefonova rojës së hidrocentralit dhe ai kishte të dhëna të sakta për të tria hidrocentralet, madje edhe të orës.

Data 28 tetor, ora 10:00, sot (shiheni, ju lutem, sepse do t’ia lë ministres). Çfarë thuhet? Kuota sot 267,56 metra, punohet me një agregat në Fierzë, me dy agregate në Koman dhe me asnjë agregat në Vaun e Dejës.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, zonja Ministre, të mos bëjmë kakofoni, të flas unë më pas ju e kështu me radhë, sepse koha kalon!

Janë nivelet e rezervës energjetike, siç e përmendi edhe zoti Mediu. Ligjërisht OST-ja e ka për detyrë të bëjë publikimin e këtyre vlerave që t’i tregojë popullit edhe sa rezervë energjetike kemi. Po jua them unë, kemi edhe për 1 muaj, në qoftë se do të punojë i gjithë sistemi energjetik. Kjo kuotë është vetëm 14 metra në Fierzë mbi nivelin zero, atij nivelin ku turbinat dalin mbi nivelin e ujit dhe nuk prodhojnë më. Sipas parametrave teknikë ato prodhojnë maksimalisht 280000 megavat/orë, plus 20 Vau i Dejës dhe Komani, por kjo ka pak rëndësi. Ky është keqmenaxhim, zonja Ministre.

Po kaloj te një element tjetër, pasi të gjithë e dimë që OSHEE-ja është fabrika e preferuar e punësimit e “rilindjes”. E promovuan drejtorin, duke e bërë komisar politik në një qark, pa dyshim që do ta bënin. A i mbani mend ata 2700 vetë të denoncuar nga opozita që kishin marrë rezidencë nëpër kontenierë? Çfarë ishin ata? Ishin punonjës të OSHEE-së nga e gjithë Shqipëria, që shkuan për të dhënë votën në vitin 2015 (i keni çuar me forcë atje). Në vitin 2017 fondi i pagave të OSHEE-së për 6200 punonjës ishte 29 milionë euro; në vitin 2018, brenda vitit shkoi 49 milionë euro, 20 milionë euro më tepër në vit, pra për 3 vjet është kredia që ne duhet të marrim sot; janë 60 milionë eurot që ne po kalojmë sot këtu vetëm nga fondi i pagave. Mos vallë janë superspecialistë? Aq specialistë janë sot, pa dyshim janë patronazhistë shumë të mirë, sa vetëm për një defekt teknik në Shkodër para 3 ditësh lanë pothuajse gjysmën e qytetit 6 orë pa drita derisa ka ardhur grupi i gatshëm nga Tirana. A më kuptoni se ku jemi?

U fol për investimet, 640 milionë euro investime. Në vitin 2013, OSHEE-ja ka pasur 4170 punonjës, ndërsa sot ka 6800 punonjës, 640 milionë euro në automatizime, në sisteme *smart* e të tjera. Kushdo e kupton që kur harxhon shumë në automatizim ul numrin e punonjësve, por jo, ne e kemi rritur dhe e kemi bërë 6800 për efekt elektoral. Për këto gjëra duhet të përgjigjet ministrja dhe komisari politik i Durrësit.

U përmend bursa. Ata që janë juristë dhe merren me të drejtën tregtare e kuptojnë dhe dalin e thonë për OSHEE Grup, por kushdo e di që ky grup nuk ekziston në legjislacionin

shqiptar, për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nuk ekziston termi “grup”. Pse e kanë bërë? Sepse e kërkonte Sekretariati i Energjisë, por duhej që edhe komisarit politik gjithmonë ta kishte çdo gjë në dorë. Këto tri kompani që duhej të funksiononin si kompani më vete funksionojnë me drejtimin strategjik të komisarit politik. Pse? Kjo lidhet edhe me bursën?

Furnizuesi i tregut të lirë (FTL) blen energji, por e blen nga ndërmjetësit, nuk e blen në bursë. Zoti Mediu, po jua them unë, 20 milionë euro është regjistrimi në bursë dhe duhej të ishte bërë që ne të mos kishim nevojë të blinim nga ndërmjetësit. Kjo është strategji, por nuk na intereson, sepse në bursë ne nuk dimë se me kë kemi të bëjmë dhe se kujt ia blejmë energjinë, ky është realiteti.

Këto janë vetëm disa nga shkaqet, ndërsa sa i takon diversifikimit të energjisë do të flas një herë tjetër, për disa nga abuzimet e sotme në sistemin energjetik. Përjasja që ka Kryeministri është përjasje individualiste dhe vetëm për interesat e veta. I gënjeu naftëtarët e Ballshit para fushatës për t'u marrë votën, ndërsa sot e kësaj dite ata janë në rrugë. Kjo është e turpshme. Bën investime në Krujë, ndërkohë që 130 veta helmohen. Kjo është përjasja e qeverisjes. Prandaj drejtësia duhet të funksionojë, jo se do të sjellë energjinë, por do të sjellë një rreze drite dhe shprese për të ardhmen.

Sa i përket dritës, kjo qeveri na premtoi “Prometun”, se do të sillte dritën mbi tokë, por solli gjeneratorët dhe errësirën.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Xhelal Mziu.

Të përgatitet zoti Fation Veizaj.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Më falni, zoti Mziu, fjalën e ka ministrja Balluku, sepse nuk e pashë!

**Belinda Balluku** – Kemi një problem permanent me shifrat e rojës dhe shifrat e mia. Nuk arrij ta kuptoj pse duhet të japësh shifra gabim, mundohem ta kuptoj, sepse u bënë disa ditë gjatë gjithë javës që merrem me këtë fakt, pse nuk jepni shifrat që janë, pasi nuk janë diçka për t'u fshehur, sepse ujin nuk e shtojmë dot as unë dhe as ti.

Kryeministri nuk i thotë ministres t'i mbajë sytë nga qielli për shiun, por i mbajmë të gjithë bashkë. A e dini pse? Sepse keni qenë 8 vjet në

qeveri dhe nuk keni bërë asgjë për të shtuar kapacitetet e prodhimit vendas, apo jo?

Pra, me gjithë këtë pathos, duke folur këtu se çfarë duhet të bëjmë, mund t'i kishit bërë, besoj se më kupton. Të gjitha projektet elektroenergjetike, siç e dini, janë kapital intensiv dhe kërkojnë kohë, kështu që detyrimisht ne do të na duhet kohë që të ndërtojmë edhe Skavicën, edhe portin e lundrueshëm të gazit të lëngshëm, edhe TEC-in e Vlorës, që u përmend nga parafolësi juaj. Është më se e vërtetë që janë investime gjeopolitike dhe jo vetëm elektroenergjetike, por mund t'i kishit bërë edhe ju, se më duket i keni pasur marrëdhëniet e mira. Edhe ne po punojmë me marrëdhëniet që kemi me ambasadorën, me ambasadën, edhe me aktorë në Uashington apo në Hjuston ku ndodhen të alokuara kompanitë që kanë vendosur të investojnë në Shqipëri. Këtë mund ta kishit bërë edhe ju para 8 vjetësh, por nuk e bëtë. Unë nuk e di se nga ju lind kjo e drejtë për të folur me pasion dhe pathos pse nuk prodhohet në Shqipëri! Nuk prodhohet, sepse këtë sistem prodhimi energjetik kemi trashëguar.

Sa i përket keqmenaxhimit, më duhet t'ju them një shifër, në mënyrë që të na kuptojnë njerëzit, sepse ju bëni një narrativë abuzive politike, është mirë ta bësh narrativën politike, por jo të abuzosh. Ti thua që ka keqmenaxhim të kaskadës, por unë do të jap vetëm dy shifra dhe njerëzit ta kuptojnë vetë nëse ka apo jo keqmenaxhim. Në një vit tregut shqiptar për t'u furnizuar me energji elektrike i duhet 4,7 teravat energji elektrike. Këtu flitet për çdolloj konsumi, qoftë ai familjar, qoftë për bizneset e vogla, tensioni i mesëm ose tensioni i lartë. Ne deri sot kemi prodhuar rreth 3,1 teravat, pra jemi në mungesë të 1,6 teravat/orëve. A ka mundësi të më thuash se ku është keqmenaxhimi këtu, sepse ti vazhdon të mos e shpjegosh, madje vazhdon të japësh shifra që nuk janë të vërteta, prandaj do të detyrohem t'i lexoj tani shifrat dhe të them sa është niveli i kaskadës në këto momente dhe sa pritët të jetë? Pra, kaskada në mëngjesin e datës 28 është 268,1 metër, prurjet janë 30 metra në sekondë. Kjo është kuota e Fierzës. Unë nuk e kuptoj pse vazhdon t'i heqësh nga një metër, sepse, në fakt, një metër në 80 kilometra katrorë është shifër e konsiderueshme. Tani është krizë energjetike në vend, sepse kemi thatësirë 3-

vjeçare dhe këtë nuk e fsheh askush, sepse nuk kemi interes ta fshehim, së pari.

Së dyti, është krizë energjetike në tregun global dhe këtë nuk e mohon dot ti sikur të dalësh e të flasësh tërë ditën, maksimumi njerëzit do të qeshin, sepse edhe ata që nuk kanë lidhje me fushën dëgjojnë lajmet nga bota, ku lajmi i parë është kriza energjetike.

Tani unë nuk do të merrem më me narrativën politike, por do të merrem me faktin që nuk mund të vazhdosh me historinë e keqmenaxhimit të kaskadës, sepse janë dy shifra që flasin. U mbyll muaji i 10-të, kemi edhe dy muaj deri në fund të vitit, ne kemi nevojë për 4,7 tera, na duhen edhe 1,6, por kjo varet nga shiu, që të mbushen hidrocentralet. Prodhimin lokal ne nuk e kemi të shpërndarë në muaj të barabartë. Ne nuk kemi fuqi prodhuese balancuese të hidrologjisë që kemi. Pra, për këto 3,1 mega shi nuk ka rënë në mënyrë të barabartë dhe ne nuk kemi prodhuar në mënyrë të barabartë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 e gjithë kërkesa për klientët fundorë, që ta kuptoni nëse e kemi menaxhuar ose jo kaskadën, pra deri në qershor nevoja për humbjet është siguruar nga tregu i brendshëm. Pra, prodhimi i energjisë nga HEC-et e vogla dhe KESH-i ka shkuar për të mbuluar totalisht nevojat e konsumatorit shqiptar, plus humbjet teknike të rrjetit. KESH-i ka furnizuar me 2,3 tera, kurse HEC-et e vogla kanë furnizuar me 1,5 tera, për të siguruar furnizimin edhe për periudhën shtator-tetor. Të them të drejtën ne nuk e kishim një njoftim, siç nuk e kishin edhe shtet e tjera, që do të rritej çmimi i gazit ose karbonit në pikën që do të vinte çmimi i OPEX-it mbi 250 euro, ndaj kemi bërë të gjitha aksionet dhe veprimet. Kështu, nga operacionet që u bënë në korrik vetëm për humbjet u importuan 58577 megavat. KESH-i furnizoi me 467 mijë 469 megavat, kurse në gusht KESH-i siguroi 323 mijë e 444 megavat dhe u importua teprica, pra ajo që kërkohej, 245 mijë e 448 megavat. Pra, në total deri sot kemi prodhuar 3,1 megavat.

Të duket keqmenaxhim ky? Në fakt, në vitin 2010, kur ju e keni pasur kaskadën në dorë, keni prodhuar 7,1 teravat dhe keni dalë në treg. Pavarësisht se thoni nuk keni qenë ju, por ka qenë CEZ-i, në fakt CEZ-i juaj ka qenë dhe ka blerë edhe 2,3 teravat të tjera. Pse? Sepse shirat

kanë rënë të gjitha në 6-mujorin e parë, duke përmbytur Shkodrën. Ne e kemi mirëmënaxhuar shiun që na ka rënë me pakicë. Ne nuk e kemi pasur këtë fat siç kishit ju në vitin 2010, që e linit tërë Shqipërinë pa drita, e fusnit nën ujë në përmbytje, ndërkohë blinit edhe energji, pavarësisht se prodhoni 7,1, sepse humbjet në rrjetet i kishit 45,3%. Ndërkohë sot, me pandeminë, me tërmetin dhe me të gjitha investimet që kemi stopuar, i kemi në humbjet 19,6, me provizionin për të përfunduar këtë vit. Kjo është diferenca ku shkon tani 7,1 –shi. Po si ka mundësi që tani me këtë 3,1-shin të na kërkohet edhe llogari?!

Tani sa u përket tryezave me ekspertë, të siguroj që mblidhemi çdo ditë me të gjithë ekspertët e kaskadës në tryezë, të ulur, duke bërë të gjitha ushtrimet për t'ia dalë dhe për të mos blerë sasinë që po blejmë sot.

Siç e thashë dhe në fillim, që t'u duk edhe për të qeshur, nga të gjitha ekspertizat, jo vetëm meteorologjike, por ekspertizat e inxhinierëve hidrologjikë të kaskadës, ne presim që nga data 2 nëntor për një javë t'i japim një frymëmarrje buxhetit duke mos blerë. Të shpresojmë që të gjitha provizionet të dalin të sakta.

Tani, nëse ti do që t'i nxjerrim ekspertët në televizor, unë do t'u bëj kërkesë këtyre të komunikimit që të t'i nxjerrin dhe të qetësohesh.

Ndërkohë, sa u përket naftëtarëve të Ballshit, ua keni ju atë borxh që sapo përmende. Naftëtarët e Ballshit i keni nxjerrë ju në rrugë dhe i latë të papunë ditën kur privatizuat, në mënyrën më korruptive të mundshme, rafinerinë e Ballshit.

Kjo qeveri po mban me paga si gjatë COVID-it, ashtu edhe gjatë këtij viti të gjithë naftëtarët, të 800 naftëtarë, dhe do të vazhdojë me këtë paketë sociale. Këto janë haraçet dhe kusuret që kjo qeveri paguan nga privatizimet tuaja, si për CEZ-in, ashtu edhe për rafinerinë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Zoti Mediu, keni fjalën për procedurë.

**Fatmir Mediu** – Unë i vlerësova të gjitha iniciativat që kanë të bëjnë me investimet në energji, sepse i shikoj shumë të rëndësishme, sidomos me partnerët strategjikë, siç janë SHBA-të, të cilat janë ende iniciativa, por të mohosh investime të qenësishme që janë bërë,



madje po i them me shifra, nëse ka 1300 megavat/orë që garantohej nga KESH-i...

**Lindita Nikolla** - Zoti Mediu nuk po flisni për procedurë. Ndërpriteni fjalën dhe vijojmë me diskutimet.

Fjala për zotin Xhelal Mziu.

*(Zoti Mediu ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Bushati keni fjalën për replikë.

**Helidon Bushati** – Zonja Kryetare, gënjeshtër gjithmonë kanë nevojë për replikë, është princip!

Atëherë, sa i përket diversifikimit, që është një ndër kushtet bazë për stabilitetin afatgjatë, siç e tha dhe zoti Mediu, të gjithë veprat e energjive të rinovueshme të viteve të fundit e kanë pasur origjinën, të paktën origjinën, gjatë 8-vjeçarit të qeverisjes së Partisë Demokratike: Ashta, Moglica, Banja, Moglica po hyn në funksion tani. Pra, janë të gjitha vepra të qeverisjes së Partisë Demokratike. Ju sfidoj: më thoni një vepër të energjive të rinovueshme të 3 vjetëve të fundit! Besoj se do ta merrni fjalën e do të më thoni një vepër të energjive të rinovueshme, jo si ai impianti fotovoltaiik i digës së Çyrsaçit, që, ndërkohë që banorët e Vaut të Dejës zhyten në errësirë, del drejtuesja politike e qarkut Shkodër dhe thotë se është një vepër madhore energjetike. A e kuptoni ku jemi? Ajo është për të ndriçuar godinën e hidrocentralit, sepse nuk kanë ku t'i çojnë lekët. KESH-i nuk ka ku t'i harxhojë lekët dhe tani vendos panele fotovoltaike.

Ndërkohë, zonja Ministre, keni bërë 3 ankande për fotovoltaiket: Nartën, që keni 1 vit e gjysmë që e keni pezulluar. Asnjëri nuk shpjegon pse është pezulluar kjo procedurë, që është 100 mega. Karavastaja ka 3 vjet që nuk ka përfunduar, është në fazat e para. Me Spitalën çfarë do të bëhet? Asnjë burim alternativ energjie. Nuk i dhatë përgjigje pyetjes: pse e keni mbishfrytëzuar në muajt qershor-korrik-gusht? Jepni shifra të kota, për t'u hedhur të qytetarëve hi syve. Ju lutem, shpjegoni pse e keni mbishfrytëzuar, sepse është një ndër vitet me më tepër reshje?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky vit është një ndër vitet me më tepër reshje. Shikoni nivelin e kaskadës, është mbi nivelet e viteve paraardhëse.

**Lindita Nikolla** – Po, zonja Balluku.

**Belinda Balluku** – Atëherë, pa përmendur emra, se zgjat shumë: jo me emra, jo pa emra, por e kam për të gjithë. A e dini çfarë investimi keni bërë? Keni bërë një investim në TEC-in e Vlorës, 120 milionë euro kredi.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

Unë nuk po flas për çfarë do të bëjmë ne, po flas për çfarë keni bërë ju.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Të lutem, të lutem, është shumë e rëndësishme, keni bërë një investim në TEC-in e Vlorës me kredi të Bankës Botërore...

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Janë marrë 120 milionë euro, të cilat paguhen sot nga KESH-i dhe nuk është ndezur asnjë ditë. Këto janë investimet që keni bërë ju zakonisht. Po si ka mundësi që të thuash se ka tre vjet është bërë Karavastaja? Është kollaj, futesh në Google dhe shikon kur është firmosur Karavastaja. Ajo ka 1 vit dhe e ka përfunduar të gjithë fazën e të gjitha lejeve, se merren leje këtu, nuk bëhen si dikur. Kështu që Karavastaja do të fillojë ndërtimin.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Helidon, ne flasim me vepra, por problemi është se ju thoni që bëtë këtë e bëtë atë, po nuk janë gjëkund, janë vetëm hidrocentralet e kohës së komunizmit që funksionojnë. Ashta, pa dyshim është pjesë e kaskadës, kurse Moglica dhe të tjerat nuk kanë nisur ende prodhimin, sepse ju i keni bërë vetëm letrat, se e gjithë pjesa tjetër, ndërtimi dhe gjithë suportit, është bërë gjatë 8-vjeçarit të fundit.

Dua t'ju njoftoj edhe një fakt: nuk ka angazhim të prodhimit të Moglicës për t'u lënë në Shqipëri, pra Devolli nuk e lë këtu, ikën, e shet jashtë, nuk e keni të angazhuar, siç mendoni. Pra, është një investim i huaj, para që janë futur në ekonominë shqiptare, por nuk ka rritur kapacitetet e prodhimit. Kapacitetet e prodhimit janë kapacitetet e kaskadës së Drinit plus hidrocentralet e vogla, të cilat përdoren për balancimin e humbjeve.

Ju kujtoj edhe një herë që ky sistem për sa kohë ka varësi vetëm nga prodhimi hidrologjik do të ketë gjithmonë këtë problematikë. Fatkeqësisht është viti i 3 me thatësi, sepse kanë rënë shumë shira në dy javë...

Helidon mos buzëqesh! Ne kemi qenë thjeshtë të aftë për të mos përmbetur pjesën

fushore të Shkodrës dhe ti duhet të jesh mirënjohës, se je edhe deputet i zonës.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Xhelal Mziu. Të përgatitet zoti Eduart Shalsi dhe më pas zoti Fation Veizaj.

**Xhelal Mziu** – Të nderuar bashkëqytetarë,  
Të nderuar kolegë,

Ratifikimi i marrëveshjes së garancisë ndërmjet Shqipërisë dhe BERZH-it për marrjen e huas prej 70 milionë eurosh për OSHEE-në për shpenzime operative dhe jo kapitale, në fakt, më stepi. Sapo erdhi në pushtet banda e “rilindjes” në qeveri përdori shtetin, policinë, prokurorinë dhe gjykatat për OSHEE-në, duke e fshehur sulmin e saj pas performancës së dobët, borxhit të lartë dhe punonjësve politikë.

Por çfarë ndodhi me OSHEE-në në këta 8 vjet, ku rilindja ka pasur çdo pushtet në dorë? Qeveria e ardhur në pushtet me premtime të mëdha, gjëja e parë që bëri ishte goditja e abonentëve familjarë, sidomos familjeve në nevojë; hoqi fashon mbrojtëse, duke e shoqëruar me rritje të çmimit të energjisë; ku iu ndërpre energjia me mijëra e mijëra familjeve; u burgosën me mijëra të tjerë, madje pati qytetarë të cilët provuan burgun për 35 mijë lekë të vjetër, ose u vetëvarën në qeli e banesa për shkak të pamundësive financiare.

Kur “rilindja” e nisi mandatin e tretë, të cilin e ka të vjedhur, borxhet e shtetit ndaj OSHEE-së ishin mbi dyfishin e vitit 2013 ose 100 milionë euro borxhe më shumë se në vitin 2013 dhe këto borxhe ishin vetëm nga entet shtetërore. Borxhet e shtetit ndaj OSHEE-së në vitin 2013 ishin gati 8,9 miliardë lekë, nga të cilat 3,9 miliardë lekë ishin borxhet e institucioneve buxhetore, dhe 5 miliardë ishin borxhet e institucioneve jobuxhetore, si ujësjellës e të tjerë. Llogaritë dhe krahasimet janë të thjeshta. Në 2014-ën qeveria ndërmoi një sërë hapash ligjorë, shtrëngues për mbledhjen e kësaj debie dhe patëm një ulje të borxhit, i cili shkon në vlerën 5 miliardë lekëve.

Çfarë ndodh sot, pas 8 vjetësh, në 2021 me këto borxhe? Sektori jpbuxhetor sot ka mbi 16 miliardë lekë borxhe, ndërsa sektori buxhetor sot ka 5 miliardë lekë të tjera borxh. Pra, një borxh shtetëror që është 4 herë më shumë se në 2015-ën dhe rreth 2,4 herë më shumë se në vitin 2013, e thënë ndryshe janë plot 21,5 miliardë lekë ose

180 milionë euro e barabartë me 1,2% të prodhimit të brendshëm bruto.

Ky borxh i fshehtë vjen për shkak të keqmenaxhimit politik dhe mbingarkimit me stafe politike të punonjësve të saj. Qeveria e rilindjes dy herë i ka futur duart në xhepat e taksapaguesve shqiptarë për të paguar borxhet dhe faturat e papaguara të ujësjellësve kundrejt OSHEE-së. Vetëm në shkurt të vitit 2015, OSHEE-ja, KESH-i dhe qeveria i falen borxhet njëra-tjetrës, borxhe të cilat shkonin në vlerën e 9 miliardë lekëve ose 80 milionë eurove. Një shifër kjo shumë më e madhe se kredia që merr sot OSHEE-ja nga BERZH-i. Vetëm për vitet 2018-2020 kemi 21 mijë 277 abonentë debitorë me 7,2 miliardë lekë detyrim dhe 2,9 miliardë lekë kamatë ose 10,1 miliardë lekë debi dhe miliona euro të tjera për shpërblime, gjyqe të humbura për largimet politike, apo për çështje të humbura në arbitrazhet ndërkombëtare të OSHEE-së, këtë e thotë KLSH-ja.

Edhe pse shteti u kthye në polic, prokuror dhe gjyqtar ndaj bizneseve dhe qytetarëve të thjeshtë, por jo konsumatorëve të mëdhenj; edhe pse u rrit çmimi i energjisë, duke shkuar deri në dyfishimin e saj për fasho të ndryshme të konsumatorëve, performanca e OSHEE-së është bërë keq e më keq. Pyetja që shtrohet është fare e thjeshtë: a kemi sot një OSHEE, tek e cila është investuar dhe trumbetuar në këta 8 vjet? Të dashur qytetarë, a e dini që humbjet teknike sot janë mbi 20%, edhe pse janë shpenzuar me miliona lekë për të ulur përqindjen e saj? A e dini që nuk blejmë energji në bursë, por me nënkontraktorë për arsye korruptive? A e dini që energjia u shit në verë me çmimi të ulët dhe sot blihet shumë më shtrenjtë? Kjo nuk ka kushtuar miliona euro vetëm për shkak të krizës globale, por këto miliona euro shpenzime kanë ardhur edhe për shkak të krizës qeveritare.

Kryeministri thirri tellallin e së keqes, se po vinte drejt Shqipërisë një krizë globale energjetike. Ai mashtroi, duke u përpjekur të fshehtë zullumin e korrupsionit në KESH dhe OSHEE. Po, po, mashtroi. Mashtroi, sepse të nesërmen e tellallit të së keqes, pikërisht më 4 tetor, nga ora 17:00 deri në orën 23:00 të mbrëmjes KESH-i i ka dhënë kompanisë “NOA”, 1807 megavat energji në periudhën e pikut, kur çmimi në bursën hungareze varionte nga 206-271 euro për megavat. Në atë ditë

“NOA” i ka kthyer KESH-it mbrapsht 817 megavat energji nga ora 01:00 deri në 06:00 të mëngjesit me çmim nga 50-150 euro për megavat. Nga data 1 deri më 13 tetor KESH-i i ka dhënë “NOA”-s, 10417 megavat energji me vlerë 2 milionë 620 mijë euro, dhe “NOA” i ka kthyer KESH mbrapsht, 12 200 megavat energji me vlerë 1 milion 557 mijë euro. Në 10 ditë kaskadës së Drinit dhe shqiptarëve u janë vjedhur plot 1 milion e 80 mijë euro. Kjo skemë korruptive është aplikuar nga qershori deri në tetor.

Kriza nuk po u vjen shqiptarëve nga tregu ndërkombëtar, por nga Edi Rama dhe vartësit e tij në KESH dhe OSHEE me skemat e tyre korruptive.

A e dinë shqiptarët që numri i punonjësve në OSHEE thajse është dyfishuar në këta 8 vjet me militantë e patronazhistë me rroga nga taksat e shqiptarëve në shërbim ndaj Partisë Socialiste? A e dinë shqiptarët që fondi i pagave në OSHEE është tre herë më i lartë se në vitin 2017 ose 4 herë më shumë se 8 vjet më parë? Po, 4 herë më shumë, sepse “rilindja” paguan me taksat e shqiptarëve militantët apo shantazhistë, siç u përmend edhe në raportin e Komisionit Europian si skandali i patronazhistëve, që përdorën të dhënat e shqiptarëve për t’u marrë votën me presione apo me para, apo falje faturash të energjisë e të ujit. Janë mbi 6 mijë e 800 punonjës të OSHEE-së, të përdorur si patronazhistë dhe pagatorë për dhënie parash në këmbim të votave.

Shqiptarët i kanë parë makinat luksoze të OSHEE-së në çdo rrugë, fshat, lagje, qytet, bashki, qark dhe gjithë Shqipërinë ditën dhe natën gjatë fushatës në vend që të ishin duke punuar për të rregulluar avaritë në sistemin e energjisë elektrike.

Shqiptarëve tashmë u është rikthyer zhurma e gjeneratorëve në qytete dhe qiriu e pisha në zonat rurale. Ju jeni dëshmitarë të ndërprerjes së energjisë edhe në komisionet parlamentare, por jo me orë si në qarkun e Dibrës, në Kamzë dhe në të gjithë Shqipërinë. Me mijëra familje janë pa energji elektrike për pamundësi financiare sot, pavarësisht se kanë fëmijë të vegjël ose të moshuar, por dhe të sëmurë në shtëpi.

Në të gjithë Shqipërinë investimet janë me pikatore, por në qarkun e Dibrës nuk është bërë asnjë investim kapital në këta 8 vjet. Kemi

kabina elektrike të rrënuara ose transformatorë të vendosur në tokë, shtylla me copa druri apo hekuri, tela me gjemba. Mjafton të shohësh pamjet që të kuptosh situatën e tyre.

*(Paraqet pamjet)*

Nuk ka elektrikist në asnjë zonë rurale të qarkut të Dibrës dhe banorët janë të detyruar të luajnë rolin e elektrikistit duke rrezikuar seriozisht jetën e tyre.

Kjo është situata me energjinë sot, kur ju doni të merrni borxh të ri që do t’i paguajnë shqiptarët, sepse ju doni të fshihni krizën e korrupsionit dhe jo krizën botërore.

Me siguri pas pak ditësh do të vini me një tjetër projekt për hua, këtë herë për të ngritur në hapësirë satelitët e Ramës, që fotografojnë nga lart korrupsionin dhe errësirën e kësaj qeverie.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Eduard Shalsi.

**Eduard Shalsi** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, fjalën time dua ta filloj me një falënderim për deputetët e opozitës në komisionin parlamentar, të cilët shtruan një sërë pyetjesh të arsyeshme, për disa prej të cilave edhe unë isha dakord, por edhe për debatin përgjithësisht racional që zhvilluan, ku besoj se të gjithë dolëm më të ndriçuar se ç’ishim më parë!

“Asit” do t’i thosha se është mirë të jesh i besuar për ne këtu dhe për ato që na dëgjojnë. Pra, duhet të thoshe që në vitin 2015 në Kamzë janë investuar 1,5 miliardë lekë dhe lajmi i mirë është që shumë shpejt atje do të fillojë ndërtimi i nënstacionit të ri. Gjithashtu, do të ishte mirë të thoshe që në vitin 2015 t’u zeruan borxhet dhe nuk mund të ankoheshe se ishte qeveria e Edi Ramës, sepse deri më 2013-ën kishe qeverinë tënde. T’u zeruan borxhet në vitin 2015 dhe në vitin 2019 Bashkia e Kamzës kishte 143 milionë lekë të rinj borxhe të gjeneruara, pa folur pastaj për borxhet e tjera. Gjithsesi, kjo është për t’i bërë me dije gjithsecilit që jemi të besueshëm kur pranojmë disa gjëra për veten tonë dhe pastaj të fillojmë dhe në sulme apo akuza nga ato që shpeshherë janë të tmerrshme. Unë e provova vetë, ju e dini 2 apo 3 javë përpara kryetari juaj më tha epitete të llahtarshme, por nuk ia mora seriozisht, ia kuptoj sikletin, ia kuptoj edhe hallin dhe nuk do të doja të përballësja me gjëra të tilla.

Unë besoj se pjesa më e madhe jona këtu nuk janë shumë të familjarizuar me shifrat kur flitet për sektorin e energjisë: x milionë, miliardë, janë çorientuese më shumë. Ka disa indikatorë kur ne gjykojmë mbi sistemin energjetik, në rastin konkret mbi një kompani që quhet "OSHEE". Në parantezë, këtu kam një nga raportet e Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, që ka qenë një nga partnerët tanë më serioz në komisionin parlamentar, i cili vijon të raportojë çdo vit për performancën e energjisë në Shqipëri, që, sigurisht, nuk niset nga aspektet politike partiake, por bën një pasqyrë reale të situatës energjetike. E keni raportin në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, atje janë raportet nga viti 2009 deri në vitin 2013, janë edhe paralajmërimet e tyre për çuarjen e sistemit drejt greminës.

Në vitin 2013, ta dini të gjithë, të nderuar deputetë, sistemi energjetik ka qenë në prag të kolapsit. Ç'mund të ndodhte me ekonominë pastaj?! Pra, situata erdhi duke u agravuar pikërisht për shkak të mosreagimeve adekuatë të politikës e për pasojë të titullarëve. Pra, morëm një sektor, që ishte në buzë të greminës. Për të gjithë ato që nuk janë të familjarizuar, janë disa indikatorë që demonstronjë nëse sistemi është i shëndetshëm apo jo: humbjet, arkëtimet, norma e arkëtimit, pagesat apo detyrimet karshi të tretëve, investimet e përgjithshme apo në një vend problematik, si Shqipëria, dhe ju i mbani mend mirë faturat aforfe që paguanin Shqiptarët. Pra, investimet në sistemin e matjes, detyrimet e prapambetura, shpenzimet operative, investimi në sistemin e shpërndarjes, sistemet e monitorimit edhe të kontrollit.

Sa i përket performancës, folët me të drejtë. Po, edhe gjatë mbledhjes së Komisionit të Ekonomisë u ndërpre energjia. Pati një ekzaltim nga deputetët e opozitës, ndërkohë që shumë shpejt u mësua që në një godinë private ngjitur ishte djegur një transformator, ishte bërë një masë dhe OSHEE-ja u detyrua të ndërpriste energjinë për të shmangur çdolloj rreziku.

Po për liberalizimin e tregut keni dëgjuar? Po për afatet për t'u lidhur në treg? Pra, për të gjithë ata që nuk janë ekspertë të fushës, këta janë indikatorët kryesorë që tregojnë ku jemi, nëse jemi më mirë apo jemi më keq, dhe për secilin nga këta indikatorë mund të japim të dhëna, lehtësisht të verifikueshme. Sot nuk jemi

në periudhën e viteve 2011-2012-2013, kur ne si deputetë hiqim picirin e zi për të marrë 2 apo 3 të dhëna, sepse sot i keni *online*. Shumë prej jush nuk kanë qenë në këtë sallë dhe nuk mund t'ju bëj fajtorë, të paktën ato që janë rishtarë këtu, por në vitet 2011-2012-2013, nuk po flas për titullarët arrogantë, që vinin dhe raportonin si gangsterë në komisionet parlamentare, nuk po flas edhe për gati zënkat fizike, që detyroheshim të bënim për shkak të mungesës së informacionit, Sot ndoshta jo 100% e informacionit mund të mos jetë *online*, por unë po ju them që sot ka shumë më tepër informacion *online* nga sa na lejohej të merrnim aso kohe ne si deputetë.

Folëm për humbjet në rrjet.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)*

E kundërta nuk ka mundësi të jetë e vërtetë, sepse po të them se sistemi energjetik ishte në prag të kolapsit. Niveli i humbjeve në rrjet arriti 45%.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Pra, niveli i humbjeve në rrjet arriti deri në 45% gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike, e pohoi dhe parafolësi. Po është 21,38%. A është më mirë apo është më keq, këtë gjykojeni vetë, ju që na dëgjoni, gjithashtu edhe qytetarët që na dëgjojnë. Pra, është përgjysmuar niveli i humbjeve në rrjet. Por çfarë do të thotë efekt, cilët janë efektet? Reduktimi nuk është qëllim në vetvete, reduktimi është një mundësi që të kursesh miliona euro, të cilat do t'i përdorësh pastaj për investime.

Po pagesat ndaj të tretëve si janë? E përmenda rastin e Kamzës, por ka shumë raste të tjera. Niveli i borxheve të OSHEE-së ndaj të tretëve ka rënë në mënyrë drastike. Keni gjurmë e korrespondenca midis titullarëve tuaj, që mund t'ju a vë lehtësisht në dispozicion, kur flitet për sasitë e borxhit, por, mbi të gjitha, për mënyrën të llahtarshme e komunikimit asokohe midis institucioneve, e cila nuk ngjante fare si një komunikim zyrtar por nuk po i vendos epitet.

Po investimet në sistemin e matjes? A i mbani mend faturat aforfe, apo jo? A e dini që në vitin 2013 nuk kishte dispeçeri. Sot nënstationet kanë një sistem, shumë interesant, për hir të së vërtetës, që monitoron *online* nënstationet e zonës së Tiranës, të Durrësit dhe po shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Dispeçeria ishte me telefon. A e imagjinoni se si mund të operonte kompania me një dispeçeri në telefon?

Po, edhe mua m'u vra veshi kur thatë që në 2015-ën kishte një numër punonjësish, pastaj ky numër ishte rritur dhe e kamufluat. Ndërkohë, përgjigja është shumë e saktë, ne e morëm përgjigjen dhe madje e verifikuam. A e dini se sa sportele ka pasur OSHEE-ja përpara 2015-ës dhe sa ka sot? A e dini që u shërbehej 1600 personave me një sportel, ndërkohë që numri është reduktuar ndjeshëm?

Dëgjova një deputet tjetër, që përmendi *smart metering* apo këto metodat, po flasim për një botë që po digjitalizohet dhe për sisteme që nuk të lejojnë të gabosh. Në vend të inkurajoni implementimin e këtyre sistemeve, akuzoni se pse po implementohen?

Sa i përket nivelit të arkëtimeve, është turp të thuhet, por a e mbani mend që në 1 milion e 200 mijë, në mos gaboj, njësi, individë dhe biznese, ishin rreth 700 mijë debitorë? Imagjinoni çfarë sistemi. Pa të drejtë theksuat që janë burgosur njerëz të varfër? Jo, jo, janë burgosur ato që vidhnin energjinë.

Mund të flisja akoma dhe më shumë, por janë disa tabela, të cilat jua vendosëm në dispozicion komisionit, jua vendosëm dhe tani. Ju përmenda 10 apo 12 indikatorët kryesorë, sfidoni indikatorët, por pa ulërima, pa të bërtitura dhe ja ku jemi. Këtu jemi, jemi deputetë. Ne kemi përgjegjësinë që të monitorojmë e të kontrollojmë operatorin dhe qeverinë gjatë veprimtarisë, por larg kësaj mënyre komunikimi dhe me këto akuza të tmerrshme.

Ju thashë, provova mbi vete disa epitete të llahtarshme përpara 2 javësh, uroj që asnjëri prej jush të mos i dëgjojë! Kini parasysh një shprehje anglisht: *the carma*, në fakt, por të paktën forconi argumentet dhe do të fuqizoni dhe gjuhën e moderuar.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Fatjon Veizaj.

Të përgatitet zoti Dashnor Sula.

**Xhelal Mziu** – Në fakt, parafolësi më përmendi si deputet i Kamzës, por unë nuk jam deputet i Kamzës, jam i Dibrës, megjithatë po ju tregoj se cila është gjendja e transformatorëve të energjisë elektrike edhe në Kamëz.

Së pari, për qarkun e Dibrës mund të themi që në 8 vjet nuk është bërë asnjë lloj investimi, vazhdojnë të jenë ato transformatorë, ato shtylla ose tela që kanë qenë para viteve '90. Mjafton

kjo foto për të ilustruar situatën në të cilën ndodhet sot qarku i Dibrës. Por nuk mjafton kjo, kam edhe një foto tjetër, që tregon se nuk është një kabinë elektrike, por një rrezik real për qytetarët e atyre zonave, të cilët rrezikojnë t'i zërë korrenti. Çudia është se te ky transformator, në fakt, hashashi ka zënë kabinën e energjisë elektrike. Besoj se kjo tregon edhe një herë bashkëpunimin e ngushtë që ka OSHEE-ja me kultivuesit e hashashit. Besoj se është e mjaftueshme si replikë për momentin.

**Lindita Nikolla** - Fjala për zotin Veizaj.

**Fatjon Veizaj** - Të nderuar kolegë,

Sigurimi i furnizimit me energji për qytetarët pa dyshim që është përparësi imediate, interesi i tyre është i pari. Unë mbështes pa mëdyshje në parim çdo përpjekje në këtë drejtim, por para se të marr një vendim konkret kam disa pyetje për të bërë.

Në fakt, isha përgatitur për të folur gjatë, por dua t'i referohem asaj që tha zoti Shalsi. Është e vërtetë që në komisionet parlamentare pati një debat konstruktiv, me pyetje nga deputetët e opozitës, të paktën në komisionin tonë parlamentar, por më informuan se e njëjta gjë ka ndodhur edhe në Komisionin e Ekonomisë në lidhje me këtë borxh që po merret. Në fakt, disa nga ato pyetje mbetën pa përgjigje. Kështu, së pari, ajo që nuk kam kuptuar unë, çfarë lidhje kishte pandemia me OSHEE-në, sepse nga të dhënat zyrtare ka pasur vetëm 3% diferencë në arkëtime dhe, në fakt, çmimi i energjisë është ulur për shkak të kërkesës së ulur për energji? Kështu, OSHEE-ja, duke qenë se është e detyruar të blejë për të mbuluar humbjet ose diferencën që nuk prodhohet nga vendi, i bie që ka pasur mundësi ta blejë me një çmim më të lirë në treg.

Gjithashtu, diçka tjetër që më shqetëson mua ka të bëjë me mënyrën e faturimit që u bëhen konsumatorëve shqiptarë. Si qytetar i këtij vendi pata një rast, nga i cili munda të shoh nëse ka mbifaturime ose jo. Në fakt, në përgjigjen që më dha drejtori i OSHEE-së doli se në të gjitha rastet e ankesave 96% e tyre janë zgjidhur. Mua, në fakt, më qëlloi të isha te 4%-shi i pazgjidhur, sepse në një shtëpi, që nuk banon kush, vinte një faturë prej rreth 400-500 lekësh të rinj, por një muaj më vjen 180 mijë lekë. Pas nja dy-tre muajsh shkova të ankohesha, por kuptova se ishte shumë e vështirë dhe e lodhshme dhe

mendova që më mirë po e paguaj, pasi nuk kisha ku të ankoheja. Nga ky rast kuptova se ky ishte fenomen. Qytetarëve shqiptarë u vijnë fatura me mbifaturime. Ata zvarriten në kalvarin e ankesave, nuk zgjidhin dot problemin e tyre dhe në fund detyrohen të paguajnë.

Për vitin 2019 janë raportuar 162 mijë ankesa të adresuara, kryesisht për ndryshim sahati dhe për mbifaturim. Këto ankesa zgjidhen nga operatori në masën 25-30%, duke zvarritur në kohë trajtimin e ankesës derisa leximi i sahatit të vejë në vlerën e faturuar. Kjo është një nga vjedhjet më të mëdha që u behët qytetarëve shqiptarë.

Problemi tjetër ka të bëjë me sistemin e pagesave. Kush paguan dritat në fund të muajit, në fakt, në përgjithësi pak e vënë re atë që kam kuptuar unë, sistemi tre ditët e fundit të muajit është i bllokuar, kështu nuk arrin të bësh pagesën dhe je i detyruar pastaj të paguash me kamatëvonesë. Ky është një problem, për të cilin bëra pyetje, por nuk mora përgjigje.

Ne jemi dakord që qytetarëve shqiptarë të mos u mungojë energjia. Ky ka qenë prioritet edhe i Partisë Demokratike. Normalisht mungesa e energjisë është një gjë që nuk ka vlerë, nuk ka çmim. Për këtë arsye, ne jemi dakord që të merret kjo kredi, me qëllim që qytetarëve të mos u mungojë energjia, por është e papranueshme mënyra se si abuzohet nga OSHEE-ja, sepse ne kemi investuar në *smart metering*, që sapo i përmendi parafolësi. Ky është maksimumi i evoluimit, kemi kaluar në epokë digjitale, është shtuar numri i punonjësve, por ende vazhdohet të bëhen mbifaturime, ende vazhdojnë faturat aforfe. Këtë gjë mund ta kuptoja para 10 vjetësh, pra faturimin aforfe, por sot nuk ka sens kjo gjë.

Ndaj, të nderuar kolegë, e kam shprehur edhe në komision, unë jam dakord që të merret kjo kredi, por pjesa e menaxhimit të OSHEE-së është një problem, për të cilin duhet të ngremë një komision hetimor, për të parë menaxhimin e OSHEE-së për mënyrën se si trajtohen faturimet e qytetarëve dhe furnizimi i tyre me energji.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Dashnor Sula.

Të përgatitet zoti Flamur Hoxha.

**Dashnor Sula** – Të nderuar kolegë, Sigurisht, sot është një ditë e lodhshme, sepse ora po shkon 17:00 dhe i ne kemi filluar

debatet dhe diskutimet këtu, në sallën e parlamentit shqiptar, që prej orës 10:00. Është për të ardhur keq, pasi kemi 7 gati orë që po dëgjojmë, dhe, sikurse e thotë edhe një fjalë e urtë popullore, kjo qeveri dhe maxhorancë s'ka nxjerrë asgjë në dritë.

Gjyshtet tona kur ishin në hall të madh përdornin një fjalë të urtë: “Bir Selmani i nënës, kë të qaj më parë!” Edhe kjo maxhorancë kështu ka përfunduar, kë të qajë më parë, Kryeministrin “sulltanin”, që iku, që la nam me mënyrën se si foli këtu sot, rrotullohej nga rrotullohej, vetëm “dëp, e dëp e dëp”, e s’po nxirrte asgjë në dritë; apo të qajë ministrin, e cila sa herë vjen këtu sorollatet e shtrëngohet ndër dhembë për të nxjerrë ndonjë gjë, por nuk nxjerr dot, sepse shifrat janë kokëforte.

Ne akuzohemi se nuk dimë ose jemi keq me shifrat. Jo, jo, shifrat janë aty, janë të hedhura në dokumente zyrtare.

Ndaj, të nderuar kolegë, mendoj se duhet të jemi më të arsyeshëm, në fund të fundit, të mos fyejmë inteligjencën tonë, por edhe të atyre qytetarëve shqiptarë, të cilët na dëgjojnë çdo ditë.

Çfarë mund t’u themi ne qytetarëve shqiptarë për abuzimin, për keqmenaxhimin dhe për vjedhjen? Sigurisht edhe në qeverisjen tonë, në periudhën 2005-2013, ka pasur abuzim, pa diskutim, keqmenaxhim, shpërdorim, madje edhe vjedhje, por e dini fort mirë që, qoftë KESH-i, qoftë OSHEE-ja apo disa ndërmarrje të tjera shtetërore janë parë si një lopë për t’u mjelë nga drejtuesit apo nga politika dhe për të përfituar mijëra apo miliona euro.

Mund t’ju sjell në vëmendje një rast, që ka ndodhur së fundi: besoj se të gjithë e dëgjuat *Pandora Papers*, nga ku doli emri i personit Vasil Kallupi, që për fat, unë e njoh, e kam komshi, i cili ka një kioskë 20 metër katrorë, bashkë me bashkëshorten dhe mbesën e tij. Nga kjo doli se ata kishin bërë gjithë ato transaksione për sa u përket investimeve, ku bëhej fjalë për shitës në KESH. Sigurisht, ato lekë, që ishin transferuar në parajsë fiskale, i përkisnin mbesës së gruas së tij. A e dini çfarë ishte mbesa e gruas së tij? Ishte shitëse aty në kioskë. Këtu jemi katandisur. Shikoni çfarë po ndodh!

Në Komisionin e Ligjeve kur u diskutua ky projektligj patëm prezent drejtorin e OSHEE-së, zotin Ardian Çela. Zoti Shalsi apo kushdo tjetër

u munduan ta justifikonin ndërprerjen e energjisë elektrike, kur ishte kulmi i diskutimit, madje doli menjëherë edhe ministrja. Me të vërtetë Zoti i dëgjon mirë gjërat atje lart! Pavarësisht abuzimit që bëni, në fund, duhet të besoni në Zot, gjithkush do të ndëshkohet një ditë. Zonja që po fliste në Komisionin e Ligjeve ishte përfaqësuese e maxhorancës dhe po tregonte superioritet, pikërisht në atë moment u fikën dritat. E dëgjoji fjalën Zoti!

Me të vërtetë “Sulltani” thotë: “Nuk më mundni dot, do të fitoj edhe 30 vjet të tjera”. Po, po, ai mund të fitojë, por ka një Zot lart dhe ju do t’ju mundë zullumi. Mos mendoni që do të rroni 500 vjet duke filluar që nga “Sulltani” deri tek i fundit!

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Zoti të fëlliq edhe një ditë para se të të marrë jetën”. Kështu do të përfundoni edhe ju. Nuk përfundojnë të gjithë, sepse, edhe kur ishim në maxhorancë gjatë periudhës 2005-2013, 20-30 vetë ishin personat që vidhnin, abuzonin dhe që u pasuruan. Edhe sot, më vjen keq për kolegët e mi socialistë, nuk janë të gjithë të korruptuar, por janë 10, 20 apo 30 vetë që qarkullojnë dhe përfitojnë të gjitha milionat e miliardat e eurove në buxhetin e shtetit.

Atë ditë në Komisionin e Ligjeve i bëra një pyetje të drejtpërdrejtë drejtorit të OSHEE-së: a e dini se në Shqipëri ka filluar në masë prodhimi i Bitcoin-it? Këtu ka inxhinierë elektronikë, elektrikë, specialistë të IT-së, të cilët e dinë fort mirë se 200 kompjuterë të vendosur në një “fermë” të Bitcoin-it shpenzojnë energji elektrike sa një qytet i tërë, jo Tirana, kuptohet, por Cërriku, Gramshi, Librazhdi apo Përrenjasi.

Drejtori i OSHEE-së, zoti Çela, e pranoi dhe tha se kemi kapur dy, një në Fushë-Krujë dhe një në Tiranë. Nga Kopluku deri në Konispol po lulëzojnë “fermat” e Bitcoin-it. Asnjë deputet i opozitës nuk ka absolutisht këllqe të bëjë një gjë të tillë apo t’i mbrojë, asnjë drejtor i vogël i OSHEE-së, i KESH-it apo kushdo qoftë, apo një politikan i vogël atje në zonën ku është nuk mund ta bëjë këtë. Jo, vëllezër. Kjo do të thotë atë që s’po e them fjalën, duhet të kesh vërtet këllqe ta bësh një gjë të tillë, dhe këtë e ka vetëm një person, “Sulltani” juaj bashkë me çirakët e tjerë, me drejtorin e OSHEE-së apo kushdo qoftë.

Këtu është energjia që vidhet, madje vidhet shumë. Sigurisht, ju mirë bëtë kur erdhët në pushtet në vitin 2013, sepse ne ishim tolerantë me qytetarët dhe vërtet mbyllnim një sy për ata që vidhnin energji elektrike, por, në fund të fundit, të vjedhësh për të mbajtur një dritë ndezur apo për një furnelë për t’u ngrohur, nuk mund të krahasohet me vjedhjen e mafiozitetit për të bërë “ferma” Bitcoin-ash e gjëra të tjera.

Ndaj, vëllezër, duhet të jeni me këmbë në tokë. Ju ka ngelur ora: “Opozita, opozita”. Ne e morëm ndëshkimin për shkak të korrupsionit në vitin 2013 dhe shumë mirë na e bënë qytetarët shqiptarë!

“Kali i betejës” së Edi Ramës ishte: do të luftonin korrupsionin, por ndërkohë e dhjetëfishoi, e njëzetëfishoi atë. Klientët e Partisë Demokratike të Sali Berishës i përqafojnë, puthet përditë me ta, rrinë pranë oxhakut e çfarë nuk bën, vëllezër.

Sigurisht, borxhet e ujësjellës-kanalizimeve apo të ndërmarrjeve të tjera shtetërore ishin vërtet të mëdha. Po sa ishin ato borxhe? 90 milionë euro lamë në vitin 2019. Sa është sot? Është 165 milionë euro deri në gusht. Qeveria i dha sërish një kredi OSHEE-së prej 40 milionë eurosh, që gjithsej shkon 200 milionë euro. Këto janë shifrat. Le të dalë t’i kundërshtojë ministrja!

Të jeni të jeni të sigurt që ky keqmenaxhim është jashtëzakonisht i madh.

Mos harroni, të nderuar kolegë, që ndërmarrjet elektrike si OSHEE-ja dhe KESH-i janë kthyer si ndërmarrjet më të mëdha të punësimit të militantëve socialistë, të patronazhistëve. Sigurisht, edhe para vitit 2013 kishte militantë të Partisë Demokratike, nuk duhet mohuar, por shikoni sa ka shkuar ky numër tani, është pesëfishuar. A e dini sa është numri i administratës në bashki, minibashki, ujësjellës dhe elektrik në qytetet: Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh, Përrenjas, Librazhd dhe Elbasan? Jashtëzakonisht i madh. Në Peqin administrata e bashkisë ka pasur 105 punonjës bashkë me ujësjellësin. A e dini sa ka sot? Sot ka 350 punonjës. Të dalë një këtu e të më kundërshtojë!

A e dini që në Bashkinë e Peqinit punonjësit kanë 4 muaj pa marrë pagat!

Administrata e bashkisë bashkë me komunat në Belsh ka pasur 130 punonjës deri në

vitin 2015. Sot ka 450 punonjës. Këto janë shifrat.

Në Bashkinë e Elbasanit është tmerr. Janë me mijëra e mijëra punonjës që nuk shkojnë në punë dhe janë të gjithë militantë dhe patronazhistë. Ju lumtë! Sigurisht që do t'i fitoni zgjedhjet ju. Policinë e keni në anën tuaj, ushtrinë po, bashkinë po, pra të gjitha gjërat i keni vetë, madje edhe Kryeministri do të rrijë në pushtet derisa t'i teket, por, po ju them sërish: ka një Zot lart, që do t'i vijë hakut "Sulltanit" tuaj!

Në fund do ta përmbledh vetëm me një fjalë të famshme të Krishtit: "Zot, fali, se nuk dinë çfarë bëjnë!".

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Flamur Hoxha.

Të përgatitet zonja Dhurata Tyli.

**Flamur Hoxha** – Të nderuar qytetarë, Kolegë deputetë,

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për huanë prej 70 milionë euro mes OSHEE-së dhe BERZH-it" synon të mbështesë kompaninë në sigurimin e stabilitetit ekonomiko-financiar, nga ku pritët rritja e performancës së OSHEE-së për t'i siguruar likuiditet shoqërisë.

Gjithashtu, në vlerësim të përmirësimit të sektorit, kjo hua argumentohet me situatën e thatësirës së madhe, me situatën COVID-19. Në përfundim, ky financim në rast të pamundësisë për t'u shlyer nga OSHEE-ja paguhet nga buxheti i shtetit, buxheti i parave të shqiptarëve.

Në rastin konkret mendoj se vështirësitë e krijuara duheshin vlerësuar dhe dakordësuar më parë mes nesh, por në çdo komision që u diskutua nuk u dha transparencë dhe argumentim. Ne mbetëm të paqartë dhe morëm pjesë në një shfaqje pa drita, në errësirë të plotë. Nuk arritëm të qartësoheshim se si është administruar OSHEE-ja, sa është portofoli total i borxhit, rezultatet financiare e fitimet ndër vitet e fundit, pritshmëritë për vitet në vazhdim, ndikimi i kredisë për uljen e humbjeve dhe sigurinë e rrjetit, investime të anuluar dhe parashikimet për investime në vitet e ardhshme.

Jam i bindur se çdo kompani e di mirë se si skanohet nga banka për të marrë një kredi sado e vogël qoftë, analizohen bilancet e tyre të shumë

viteve, vlerësohet rentabiliteti, performanca, plani i investimeve, detyrimet, likuiditeti e të tjera vlerësime dhe arsye për të cilat çdo kompani shqiptare, në vështirësitë e krijuara prej pandemisë COVID-19, nuk arriti të përfitojnë kredi nga bankat me kolateral garancinë sovranë nga qeveria jonë.

Fatkeqësisht, kam bindjen e plotë se kjo kompani vuan keqmenaxhimin, që ka sjellë uljen e performancës, thellimin e borxhit të akumuluar nga shteti; vuan nga shpërdorimet me tenderë me çmime marramendëse; vuan rritjen e shpenzimeve të fondit të pagave me punësime shtesë për qëllime elektorale, duke vijuar të shpërdorojë paratë e shqiptarëve në kushtet që çdo ditë vuajnë rritjen e çmimeve dhe mospërballimin e kostos së jetesës.

Kjo politikë e zhvatjes dhe e keqmenaxhimit me dashje nisi menjëherë pas vitit 2013 nga grupimi i KESH-it, OSHEE-së dhe OST-së, me pseudoreforma për përmirësim e investime të mëdha dhe në emër të kësaj reforme paguajnë bizneset dhe familjet shqiptare.

Në emër këtyre reformave e gjithë sipërmarrja prodhuese dhe bizneset në tërësi menjëherë patën një rritje drastike të çmimit të energjisë elektrike deri në 54%, por në realitet sot nuk ka asnjë përmirësim në cilësinë e furnizimit me energji elektrike, kemi mungesa dhe ndërprerje të saj në të gjithë Shqipërinë, sot që flasim ata presin të paqartë rritjen e radhës së çmimit të energjisë.

Duke qenë se mua më pëlqen të bazohemi në fakte, kam sjellë këtu fatura të një sipërmarrjeje prodhuese në fillim të viteve 2014-2015 e në vijim, ku çmimi nga 9,1 lekë është bërë 14 lekë për kilovat/orë. Llogaritë behën thjeshtë, ka një rritje me mbi 54%, çmimi është pa TVSH, që më pas duhet të rimburohet në pritje.

Një tjetër shembull i standardit dhe i kujdesit të furnizimit me energji elektrike ndaj sipërmarrjeve prodhuese, që mundohen të investojnë e ndërtojnë objekte prodhimi, janë kostot e larta me dhjetëra mijëra euro për ndërtimin e kabinave elektrike, kabllove elektrike me qindra metra për lidhjen në rrjet e më pas ju duhet edhe një mik "nën dorë" që të japë dakordësinë, të bëjë lidhjen, të vendosë pajisjen matëse, pastaj sipërmarrësi të paguajë menjëherë në fillim të muajit, sepse më vonë



fillon kamata shtesë dhe nëse vonohesh pak në pagesë, të vijnë e të ndërpresin energjinë.

Kjo është qeverisja e përkujdesjes për bizneset, që rriti me mbi 50% jo vetëm energjinë elektrike, por edhe taksat, tatimet, tarifat e shërbimit, të cilat u rritën vit pas viti, rënduan kostot prodhuese dhe sollën vështirësi në kufirin e mbijetesës apo falimentimin e tyre.

Gjithashtu, e paguan edhe konsumatori familjar, që në pamundësi financiare u burgos e u gjobit rëndë, e do të vijojë të paguajë për dhjetëra vite me radhë këto gjoba me kamatë.

Qarku i Kukësit që prej gjysmë shekulli furnizon me energji elektrike të gjithë vendin dhe rajonin dhe i jep arkës së shtetit shqiptar qindra miliona euro në vit, por atje situata vijon e përkeqësuar dhe është ende me rrjetin e furnizimit të energjisë së viteve '70. Në zona e fshatra të ndryshme në çdo kohë, kryesisht në dimër, dritat fiken me orë e ditë të tëra. Banorët kujdesen për rrjetin e furnizimit të amortizuar totalisht, duke u bërë vetë elektricistë dhe duke vënë në rrezik jetën e tyre.

Para se ta mbyll diskutimin, duke qenë se e shoh shpesh nivelin e Fierzës, pasi jam deputet i asaj zone, do të doja një përgjigje nga ministria: a është shitur në muajt korrik-gusht-shtator energji elektrike, duke e eksportuar atë?

Ky është realiteti, pas dy mandateve të qeverisjes suaj, që po e zhyt Shqipërinë në borxhe me qindra miliona euro, të cilat do të paguhen një ditë nga të gjithë ne ndër vite e breza.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Dhurata Tyli. Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

**Dhurata Tyli** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar qytetarë,

Shumë prej nesh këtu në sallë e dimë se në vitet “90 shoqëria ndahej në një grupim optimist, që besonin se Shqipëria pas 5 vjetësh do të ishte e krahasueshme me vende e Europës, dhe në një grupim tjetër, që ishin pesimistë, të cilët thoshin se kjo mund do të ndodhte maksimumi pas 10 apo 12 vjetësh. Ndërkohë, sot jemi 31 vite më pas dhe gjendja është shumë herë më keq se në vitet “90 për sa i përket perceptimit. Ne jo vetëm që nuk jemi bërë pjesë e BE-së, por nuk ka më grupim shoqëror optimist. Asnjë nuk beson më

se ne do të bëhemi si Europa, andaj edhe zgjidhja që kanë gjetur të rinjtë në këta 8 vjet ka qenë të largohen vetë drejt vendeve të BE-së.

Shqiptarët patën një shpresë se mund të normalizohet situata dhe ajo ishte 25 prilli. Por, Edi Rama e vrau edhe këtë shpresë, duke përdorur qindra miliona euro për të zhbërë të vetmen armë të qytetarëve të thjeshtë: votën. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it evidentoi fenomenin më të frikshëm të demokracisë: shkrirjen e partisë me shtetin. Rrjedhimisht, një parti, që nuk është zgjedhur nga vullneti i lirë i votuesve, nuk mund të jetë kursesi e përgjegjshme. Kjo papërgjegjshmëri vërtetohet edhe në atë që na kërkohet sot.

OSHEE-ja, një kompani shtetërore me vetëfinancim, na kërkon neve, deputetëve, që të japim dakordësinë që shteti të jetë garant në marrjen e një borxhi prej 70 milionë eurosh në formë kredie nga BERZH-i.

Me justifikimin e krizave kjo qeveri ka vjedhur shumë para. Një prej rasteve është kjo marrëveshje prej 70 milionë eurosh që na kërkohet të miratojmë. Arsyetimi që japin është qesharak: “Të përballojmë krizën.” Ndërkohë që ky vit është nga më të suksesshmit për sa i përket prodhimit të energjisë elektrike nga kaskada e Drinit.

Sigurisht, kur do të vjedhësh edhe kur shet, duke e shitur më lirë se bursa dhe të vjedhësh edhe kur blen, duke e blerë më shtrenjtë, nuk do të të mjaftojnë paratë që mblihen nga faturat e konsumatorëve familjarë dhe bizneset e vogla e apo të mëdha.

Thonë që ka krizë energjetike. Ju bëj thirrje që t'i pyesin pak operatorët privat se sa vit fitimprurës ka qenë ky. Pse privatët nuk i shkarkuan kaskadat, kur energjia shitej shumë lirë?

Ky korrupsion po u shkakton shqiptarëve kriza të njëpasnjëshme dhe varfëri të thellë e më të thellë. Shqiptarëve do t'u duhet të paguajnë një kredi ekstra për oborrtarët e qeverisë, ndërsa në shtëpitë dhe oborret e tyre po përballen me ndërprerjen e energjisë, ndërsa ata, që nuk e paguajnë dot, përfundojnë në burg, e, për fat të keq, kemi pasur edhe vetëvrasje.

Me një arrogancë të paparë zëvendësministri i Energjetikës në Komisionin e Ligjeve përçmoi një person të ndjerë. Besoj e mbani mend ngjarjen e rëndë në Lushnjë, ku një

person i dha fund jetës së tij në burg për një faturë vetëm 35 mijë lekë të vjetër ndaj shtetit, pasi e kishte të pamundur ta paguante energjinë.

Është tronditëse, por dhe më tronditës është fakti se si e trajtojnë zyrtarët e këtij vendi këtë ngjarje, duke e lidhur me gjendjen emocionale të të ndjerit dhe jo me faktin se sa të papërballueshme e kanë jetën shqiptarët, të cilët përfundojnë në burg për shkak të pamundësisë.

U them kësaj qeverie dhe institucioneve përgjegjëse, po kryetarët e bashkive, drejtorët e ujësjellësve, drejtorët e tatimeve përse nuk futen në burg, sepse kanë krijuar borxhe ekstremisht të mëdha në OSHEE dhe nuk paguajnë faturat?

Nuk mjaftojnë borxhet që i keni ngarkuar kësaj shoqërie me koncesionet korruptive, por doni t'ua shtoni borxhin që të shkojë deri te nipërit e tyre, duke u mbivendosur 70 milionë euro dhe një rritje çmimi të energjisë që përflitet se do të ndodhë në vitin e ardhshëm.

Mund të dalë Kryeministri e të thotë se nuk do të ketë rritje për familjarët. Po mirë, po nëse e rrit çmimin e energjisë për prodhuesit, kostoja e tyre a do të faturohet te produktet që ata do të nxjerrin në treg? A nuk është kjo një tullë tjetër betoni mbi shpinën e qytetarëve të ndershëm!? Por, sigurisht, ju nuk i njihni këto shqetësime sepse jeni në botën e luksit. I zhysni në të tjera borxhe. Janë plot 70 milionë euro që duhet të paguajmë të gjithë vetëm për 3-4 oborrta, para të cilat mund të përdorëshin për t'i nxjerrë shqiptarët nga skema e varfërisë.

Imagjinoni sa është trashur zullumi i kësaj qeverie! Nuk fshihet dot, pavarësisht milionave që shpenzohen për propagandë. Ditën që drejtori i OSHEE-së në sallat e Kuvendit, teksa kërkonte garanci për eurot dhe ofronte garanci për dritat, në sallë ikën energjia elektrike.

Kur kjo ndodh mes kryeqytetit, ç'mund të ndodhë në lagjet e largëta e të varfra të Dibrës?

Qytetarëve të Dibrës u thonin se do të rimbursoni rritjen e çmimit deri në një farë mase dhe të mos harxhojnë më shumë se kaq. Por me çfarë do të ngrohen ata në këta muaj të acartë që i presin, me batutat e dala boje nga Kryeministëri? Karburanti është rritur, lënda drusore po ashtu, energjia elektrike, po e po. Imagjinoni se çfarë qeverie sociale jeni!

Jemi të fundit për sa i takon ekonomisë, sepse kemi mbi kokë një pushtet familjarësh, klientësh e shërbëtorësh të "njëshit".

Jemi të fundit për institucione të pavarura në shërbim të të gjithëve, sepse shteti është bërë vegël e pushtetit dhe pavarësia e institucioneve pengohet nga pushteti i bërë njësh me shtetin.

Jemi të fundit për liri të konkurrencës dhe vlerësim sipas meritës, sepse tregu është vënë nën kontrollin e pushtetit të "njëshit".

Kjo është përgjigjja e këtij pushteti për çdo shqiptar që pyet veten si ka mundësi që mbetëm të fundit në Europë, edhe 30 vjet pas shembjes së diktaturës.

Ju mundoheni të fshihni realitetin, por qytetarët nuk i kapërdijnë më gënjeshtat.

Varfëruat një Shqipëri të tërë, vetëm që të mos kenë mundësi të reagojnë kundër vjedhjeve tuaja. Sot hallet kanë hyrë në shtëpitë e shqiptarëve dhe dëshpërimi i tyre është ulëritës.

Një shoqëri e varfër nuk është në gjendje t'i kundërvihet një tiranie, ndaj edhe detyrohen të ikin në një vend të huaj.

Rama na fton për satelitë sot, ndërsa unë e ftoj për vizitë në dyqanet ku hyjnë njerëzit e zakonshëm të këtij vendi që t'i lexojmë së bashku listat e borxheve për bukë, oriz, makarona, sheqer, vaj, ilaçe apo të shikojë edhe llogaritë e atyre bizneseve të vogla që oligarku i madh, Edi Rama, i ka futur në rrathët e ferrit, në emër të informalitetit.

Unë jam në këtë Kuvend me votat e qarkut të Dibrës, dhe tanimë dihet nga të gjithë se cili ishte vullneti i shumicës së dibraneve: vullneti për ndryshim në Dibër dhe në të gjithë Shqipërinë. Uroj të vijë sa ma shpejt kjo ditë për të gjithë vendin!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Tritan Shehu. Të përgatitet zonja Erisa Xhixho.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjala për ju, zoti Shehu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Marrëveshja OSHEE-BERZH në pamje, po të shikohet formalisht, duket si një marrëveshje e rëndësishme që duhet votuar pozitivisht. Megjithatë, unë që në fillim të fjalës sime dua të deklaroj para jush dhe opinionit publik votën time kundër. E kam deklaruar votën time kundër në komision, e deklaroj edhe këtu. Vota ime është kundër, sepse është një votë proteste edhe për katandisjen e këtij sistemi; është një votë

proteste për keqpërdorimin e sistemit energjetik; është një votë proteste për mosshërbimin siç duhet qytetarëve, duke përfshirë edhe ata të qarkut të Gjirokastrës.

Nuk kam asnjë besim se investime të tilla të mëdha e të rëndësishme në këtë sektor jetik për ekonominë, qytetarët dhe për zhvillimin në tërësi do të arrijnë të japin efekte pozitive, do të kenë rentabilitet prodhues dhe shërbimin e duhur ndaj qytetarëve, që do ta kishin, në qoftë se do të përdoshin drejt këto fonde, me korrektësi për ato qëllime që, teorikisht, janë në shërbim të qytetarëve. E them këtë, sepse, së pari, në këtë sektor janë bërë shume investime, janë përdorur burime të mëdha financiare; çmimi i energjisë është rritur ndjeshëm; u hoqën politikat mbrojtëse për qytetarët dhe shtresat në nevojë, duke i detyruar qytetarët të paguajnë një për një në mizërinë e tyre, ose të mbeten pa energji, madje, akoma më keq, shumë nga ata u futën në qelitë e burgjeve, edhe më keq akoma në mënyrë kriminale u çuan deri në vetëvrasje.

Rezultati: gjendja e rrjetit të furnizimit të qytetarëve me energji është shumë e rëndë, primitive, qoftë edhe për nevojat e tyre më të thjeshta. Për këtë mjafton të shkoni të shikoni qarkun e Gjirokastrës, nga Çarshova në Krahës, nga Pogoni në Buz, nga Dropulli në Lopëz, nga Cepo në Këlcyrë. Shikoni çfarë ndodh! Errësirë, sterrë. Mjaftojnë një erë e lehtë dhe dy pika shi që qytetarët të rrinë në terrin e errësirës dhe në të ftohtë. Pse?! Sepse rrejtja është ndërtaur që në vitet '70 dhe nuk mund t'i përballojë as ndryshimet më të lehta klimatike apo ngarkesën më minimale që mund të krijohet nga nevojat më zhvillim të qytetarëve.

Ju e dini që qytetarët e paguajnë një për një çmimin në qarkun e Gjirokastrës, edhe pse nuk kanë drita, megjithëse sistemi elektrik i dëmton pajisjet e tyre, megjithëse duhet të dëmshpërblehen për shërbimin jonormal që u ofrohet, duke e paguar atë. Në qoftë se nuk paguajnë, u prihen dritat, dhe kjo është më e mira, ndryshe përfundojnë në burg.

Pra, vota ime kundër është edhe protestë ndaj çfarë po ndodh me energjinë, me diskriminimin që po u bëhet qytetarëve të qarkut të Gjirokastrës vlerash dhe kulture, por të zhytur tashmë në terr dhe në varfëri.

Kjo gjendje nuk është vetëm në Gjirokastrë, për në të gjithë Shqipërinë. Shqipëria është në

këtë situatë mesjetare në shumicën dërrmuese të saj si pasojë e keqpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit të resurseve dhe keqpërdorimit të rezervave.

Vota ime është kundër edhe për faktin e keqpërdorimit politik që po i bëhet këtij shërbimi jetik për qytetarë nga vetë Kryeministri. Ju e dëgjuat Kryeministrin një të diel të qetë pasdite, kur doli në televizion papritur dhe, si Kasandra, parashikoi e ndolli më të keqen e mundshme, foli me fjalët më të errëta duke ngjallur frikë, panik, duke dashur në këtë mënyrë të krijojë te qytetarët shqiptarë ndjenjën e terrorit, ndjenjën e pushtetit të tij dhe që vetëm Zotin mbi tokë mund t'i shpëtonte shqiptarët në këtë batërdi të madhe që i priste për shkak të krizës së madhe energjetike.

Me këtë donte të fshihte krizën e regjimit të tij, keqpërdorimin e thellë politik të energjisë elektrike, për t'u hequr vëmendjen dhe për t'i hutuar qytetarët, për t'i trembur ata e për t'i larguar nga rruga e protestës, e domosdoshme kjo për çdo qytetar, kur përballet me një regjim të tillë.

Ai tentoi në këtë mënyrë të godasë shpirtin opozitar, të çorientojë opozitën duke tentuar të na fusë në spirale surreale që mendja e tij i nxori atë ditë. Ai në këtë mënyrë donte të hiqte vëmendjen nga problemet e mëdha dhe të justifikonte dështimet e mëdha të krijuara pikërisht nga keqmenaxhimi, keqqeverisja e qeverisjes së tij, kur thelbi i problemit është keqqeverisja, mosrespektimi i qytetarëve edhe në elementin më të thjeshtë, siç është furnizimi me energji elektrike.

Jam i bindur që, edhe nëse merret kjo kredi, nuk është se do të bëhet më tepër, por do të tentohet të transformohet sërish në element politik dhe në rentabilitet shumë të ulët të vlerës së saj ndaj energjisë.

Në këtë marrëveshje shkruhet se do të përdoret edhe për frenimin e pasojave të COVID-it. Kjo më kujton çfarë tha Kryeministri në fillimin e pandemisë te ne, kur ai për muaj të tërë nuk e pranoi ekzistencën e saj, foli për mijëra arkivole, për kodra me varre, nxori tanket në rrugë për të luftuar një virus, ashtu siç bëri edhe para pak javësh për energjinë. Doli si Kasandra atë ditë, doli si Kasandra edhe sot. Pra, ai u përpoq në të dyja rastet për të terrorizuar popullsinë, pa marrë masat e nevojshme dhe të

veçanta për të përballuar epideminë, ashtu si tani, pa marrë asnjë masë realisht për atë që ai e quan “krizë”. Çfarë solli atëherë?! 16 mijë të vdekur; 150 milionë euro të humbura direkt nga xhepi i qytetarëve; financa të shkatërruara dhe një vend në kolaps. Ai mbolli dhe programoi vetëm terror, por asgjë reale nga ato që duhet të bëjmë. E njëjta skemë u përdor edhe pak ditë më parë, edhe tani, pikërisht për energjinë, ndaj unë nuk i besoj Kryeministrit të kësaj qeverie dhe nuk mund të votoj për t’i dhënë një fond të ri që jam i bindur se do ta keqpërdorë. Ndaj, do të votoj kundër.

Në marrëveshje flitet për pasojat e COVID-it mbi sistemin. Unë do ta pyes: për çfarë pasojash bëhet fjalë? Çfarë bëri ky sistem për të lehtësuar jetën dhe vuajtjet e qytetarëve gjatë epidemisë? A u bë ajo që u bë në vende të ndryshme, që shpeshherë nuk u paguan shpenzimet e energjisë? A u bënë politikat sociale dhe ndërgjegjësuese për qytetarët? Nuk u bë asgjë e tillë.

Nuk u paraqit as edhe një projekt në funksion të qytetarëve nga sistemi energjetik për ta lehtësuar barrën e tyre, përkundrazi, u paguan të gjitha, ashtu sikurse nuk u bë asnjë rimbursim edhe në sektorin shëndetësor. Cilido qytetar i sëmurë në Shqipëri ka paguar mesatarisht 1 mijë euro nga xhepi për t’u shëruar dhe është rimbursuar vetëm me 40 euro.

150 milionë euro janë pak për të gjithë ata. Kjo llogaritje nuk është imja, por është e institucioneve ndërkombëtare.

Çfarë bënë për t’u shërbyer qytetarëve të sëmurë?! Ju e dini, unë, gjithashtu, kam parë në zonat e largëta të Picarit njerëz që mjekoheshin në shtëpitë e tyre me perfuzione venoze dhe me antibiotikë të blerë nga vetë ata, që ishin në errësirë, sepse kishin energji elektrike, sepse edhe spitali i Gjirokastrës ishte mbyllur, edhe sistemi shëndetësor nuk funksiononte, ashtu si nuk funksiononte sistemi shëndetësor, edhe sistemi energjetik i linte në errësirë të thellë.

Pra, si duhet vepruar dhe duhet reaguar në këtë rast?! Kur ky sistem reagoi në ato momente kaq të vështira për qytetarët, duke u prerë energjinë elektrike edhe të sëmurëve që kanë harxhuar edhe kacidhen e fundit për t’u mjekuar dhe nuk kishin mundësi të paguanin asnjë qindarkë për energjinë, si duhet reaguar?! Duhet reaguar duke protestuar për ta rrëzuar këtë regjim

dhe jo duke mbështetur absolutisht instrumente, të cilat keqpërdoren nga ky regjim për arsye politike dhe jo për rentabilitetin e këtij sistemi kaq të rëndësishëm.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Erisa Xhixho. Të përgatitet deputeti Belind Këlliçi.

**Erisa Xhixho** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është i papritur, në fakt, në kontekstin e krizës energjetike, të paralajmëruar gati një muaj më parë nga Kryeministri Rama, diskutimi për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për marrëveshjen e huas ndërmjet OSHEE-së dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim me vlerën e përgjithshme deri në 70 milionë euro. Kjo të krijon pa dyshim një ide për një varkë shpëtimi në këto momente. Për Kuvendin, dhe më shumë për qytetarët, kjo marrëveshje duhej të vinte pas një analize të detajuar, transparente të performancës së OSHEE-së, ku presim të përballemi me një krizë të rëndë energjetike.

Kredia që sot po diskutojmë për ta miratuar, me qëllim për të mbështetur kompaninë për sigurimin e stabilitetit ekonomik-financiar, vjen, pasi ky sektor ka kaluar, sikurse është thënë, nëpër disa reforma shumë të thella, nga të cilat mbi 30 mijë qytetarë janë proceduar penalisht.

Ndërkohë sot, po në emër të shqiptarëve, po kërkohet të merret një kredi prej 70 milionë eurosh, e cila do të shlyhet po nga shqiptarët, pa u shpjeguar asgjë, pa asnjë analizë, pa asnjë vlerësim dhe pa më të voglën përgjegjësi të sektorit ndaj abonentëve të vet. Sot, kur shqiptarët përballen me rritjen e çmimeve të produkteve të shportës me 20 deri 30 lekë më shtrenjtë, këtu nuk bëri përjashtim as buka që për qeveritarët mund të mos thotë asgjë, por për familjet shqiptare është kryesoja e çdo vakti jetik, pa të cilën nuk mund të bëjnë dot.

Qeveria nuk e pa të udhës të merrte asnjë masë për t’i mbrojtur qytetarët, as kur u cenua buka e gojës, edhe pse ata përditë dëshpërimisht shprehën se e kanë të pamundur ta përballojnë rritjen e çmimeve.

Asnjë masë, edhe pse jemi vendi me pagat më të ulta në rajon dhe me qindra familje u takojnë shtresave të varfër; asnjë mbështetje financiare; me mijëra pensionistët janë pa përkrahje dhe studentët në pamundësi të mëdha ekonomike. Të gjithë mbetën përsëri vetëm, me një skenar të njohur tashmë, njësoj siç ndodhi me tërmetin apo pandeminë që po i vuajnë edhe sot e gjithë ditën.

Si të mos mjaftonte e gjithë kjo, një ditë të diel, Kryeministri njoftoi një tjetër të zezë që na pret, krizën e madhe energjetike që do të përfshijë edhe vendin tonë të rrënuar ekonomikisht, edhe pa krizën që po troket. Për këtë situatë, i pari i qeverisë, por pa dyshim, jo i qytetarëve, pasi këta janë lënë në harresë, shprehu mbështetjen, por për OSHEE-në, me garanci sovraane 200 milionë euro. Ndërkohë, nuk jep llogari se, përse ne, vendi që presim që të na godasë kriza, shesim energji elektrike më lirë dhe e blejmë më shtrenjtë. Përse ndodh kjo, kur jemi vendi më i pasur me burime ujore? Në 8 vjet qeverisje, ende vendi ynë është i varur nga shiu apo nga risku i ndryshimit të çmimit, pasi ne e blejmë jashtë të gjithë nevojën për konsum.

Një vend si ky yni, i bekuar nga kaq burime ujore, e importon të gjithë energjinë nga jashtë vetëm si pasojë e keqmenaxhimit të ndërmarrjeve publike, e sistemit energjetik, e thellimit të borxhit, pra një krizë e prodhuar nga keqqeverisja.

Pasi i la për ditë të tëra në heshtje, Kryeministri na trumbetoi një nder shumë të madh që po u bënte qytetarëve duke deklaruar se nuk do të ketë rritje çmimi për konsumatorin familjar dhe për biznesin e vogël. Thënë më qartë, nuk do të ketë rritje për konsumatorin e lidhur me tensionin e ulët, ndërkohë energjia që konsumohet, ndërkohë që biznesi i madh do të përballet me rritjen e çmimit. Kjo do të thotë se pritet që çmimi i energjisë të rritet për më shumë se gjysmën e furnizimit që bën OSHEE-ja.

Po çfarë pasojë sjell te qytetarët kjo rritje e çmimit të energjisë për biznesin e madh? Sigurisht, rritje të çmimit për ta. Nuk ka njeri të mos e kuptojë se rritja e çmimit të energjisë do të përkthehet në rritje të kostos së prodhimit apo të shërbimit që u ofrohet qytetarëve, pra më shumë para nga xhepi i qytetarëve.

Jo vetëm kaq. Historia e ka treguar tashmë dhe qytetarët e kanë provuar në kurriz se rritja e

çmimit të energjisë nuk ka prapaktehu. Nëse çmimi do të rritet si pasojë e krizës, kalimi i saj, pavarësisht sa zgjat, nuk do të sjellë uljen e çmimit të energjisë. Vjet, edhe pse OSSHE-ja e ka blerë me çmim të lirë energjinë, kjo nuk u reflektua kurrë në uljen e çmimit për abonentët. Ata që e pësojnë janë prapë qytetarët; ata që sot ankohen për çmimin e bukës, të vajit dhe orizit, sepse kjo qeveri nuk e trajton konsumatorin denjësisht, në respekt të të drejtave të tij, këtë konsumator, që, duke i treguar ligjin, nuk ia ka kursyer burgun, edhe pse në pamundësi financiare për të paguar energjinë. Ky nuk është konstatim, por vlerësim i Bankës Botërore, që na klasifikon si vendi me numrin më të lartë të të varfërve në rajon.

Një qeveri e majtë duhet të ketë prioritet mbështetjen e shtresave në nevojë, të atyre që sot përballen me mbijetesën nga kapërcimi i çmimeve të produkteve të shportës, bukës, gazit dhe karburantit.

Ndaj sot prioritet kombëtar është mbrojtja sociale e shtresave në nevojë, për t'u siguruar kushtet minimale të jetesës dinjitoze, që u takon me ligj në një shtet demokratik që mbron dhe advokon të drejtat e njeriut.

Në fakt, sot prisja një plan masash për këtë shtresë dhe jo një projektbuxhet që shton PPP-të apo rritjen e borxhit publik, kur FMN-ja e thotë qartë që në kohë krizash duhet të merrni masa për mbrojtjen e shtresave në nevojë.

Sot duhet të jemi solidarë; sot qytetarët presin garancinë se nuk do të jenë vetëm përballë krizës ekonomike që po kalon vendi, por kjo qeveri, që ka dëshmuar dhe mbështetur aleancën e saj të vetme me oligarkët dhe krimin e organizuar, për të blerë varfërinë e qytetarëve dhe për të sunduar këtë vend, e ka të pamundur ta japë këtë mesazh.

Kjo krizë do të prodhojë dhe do të thellojë akoma më shumë shpopullimin në vend, zhgënjimin për të ardhmen në këtë vend dhe kjo do të mbahet mend shumë gjatë si arritja më e madhe e kësaj qeverie.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Belind Këlliçi. Të përgatitet zoti Lefter Gështenja.

**Belind Këlliçi** – Të nderuar qytetarë,

Në fakt, kemi që prej orës 10:00 që dëgjojmë këtu lloj-lloj termash të mrekullueshëm, por për të gjithë qytetarët që na

ndjekin nga ekrani dhe nuk e kuptojnë fort mirë gjuhën juridike, duhet t'i qartësojmë, duke u thënë shkurtimisht se sot jemi mbledhur në këtë sallë që qeveria të marrë borxh. Shifra e këtij borxhi që po merret sot është 770 milionë euro, nga të cilat 70 milionë euro do të merren për llogari të OSHEE-së, që, sipas projektaktit, u dëmtua financiarisht nga pandemia Covid-19 dhe nga thatësira e jashtëzakonshme.

Gjithashtu, shkruhet se kjo hua do të jetë një zgjidhje momentale; ashtu urojmë të gjithë! Amen!

Por borxhliut i duhet dikush që t'i dalë garant, sepse fjala e dhënë nuk mjafton. Ky garant, të dashur qytetarë, jeni ju. Thënë popullorçe, në rast se OSHEE-ja nuk e lan dot këtë borxh me paratë e saj, do ta lani ju. Ju jeni Republika e Shqipërisë, ju jeni taksapaguesit e saj, ju jeni buxheti i shtetit.

Na thuhet se OSHEE-ja është dëmtuar nga pandemia dhe kurimi i këtij dëmtimi na kushton 70 milionë euro! Jo më larg se në prillin e këtij viti, në muajin e zgjedhjeve, administratën e OSHEE-së e kemi parë të shëndetshme në të gjitha rrugët e Tiranës, kur bënëin fushatë elektorale pallat më pallat e shtëpi më shtëpi. Punonjësit e OSHEE-së dukeshin mjaftueshëm të kalitur dhe të motivuar për të bërë nga dy punë. Ky ekspozim i tepruar derë më derë, në fakt, mund të ketë sjellë probleme serioze në shëndetin e punonjësve. Prandaj, nëna parti duhet të jetë më e kujdesur me shëndetin e patronazhistëve të saj; kjo si fillim.

Së dyti, nga seanca në seancë dëgjojmë nga qeveria deklarata që kundërshtojnë njëra-tjetrën, për shembull, Edi Rama, Kryeministri, një herë thotë se Shqipëria është një superfuqi energjetike në rajon dhe pa u mbyllur 2-3 ditë thotë se Shqipëria është në krizë. Tani, cilës Shqipërie i referohet, asaj në krizë apo asaj që është një superfuqi energjetike?

Thoni se jemi përpara një krize energjike botërore, mirëpo askund jashtë Shqipërisë nuk dëgjohej të flitet për këtë krizë me një shqetësim të jashtëzakonshëm si në Shqipëri.

A mos ndoshta lideri i proletarietit, Kryeministri i kësaj superfuqie energjetike, po paralajmëron botën për krizën që po i afrohet?!

Të gjithë qytetarët, në fakt, me të drejtë, pyesin: "A do të ketë ndonjëherë me këtë

qeverisje në krye kufij mashtrimi, propagandash, fasadash dhe karagozllëku?"

Jam i bindur se, në fakt, deputetët socialistë, më mirë se cilido tjetër në këtë sallë, e njohin mirë të parin e tyre, i cili i ka lëshuar satelitët me kohë; po edhe këtu do të futemi. Kjo është një krizë e shkaktuar nga ai dhe nga korrupsioni i tij, dhe këtë nuk ka qytetar shqiptar që nuk e di.

Shqipëria, me Kryeministër Edi Ramën, i ngjan një pacienteje me sëmundje terminale, që mbahet në jetë me oksigjen. Ju, në fakt, po e shpini vendin drejt një falimenti total dhe e vetmja zgjidhje është të merrni borxhe për të larë borxhet.

Me borxhe në grykë dhe bishtin përpjetë, Kryeministri një herë thotë: "Do të ndërtoj 3 porte", pastaj i prishet mendja e thotë: "Jo, do të ndërtoj 4", i fut edhe nja 3 aeroporte e më pas thotë se do ta ulë borxhin publik me masën 20%, ndërkohë që sot, në këtë sallë, po merren borxh 770 milionë euro.

Ju jeni ata që thoni në studio televizive: "Nuk ka gjë në dorë shteti; s'kemi çfarë të bëjmë, këto çmime ka e gjithë bota". Për cilën botë e keni fjalën? Shihni vetëm qeverinë franceze, po ju marr një shembull, e cila ka thënë se do të ndihmojë me 100 euro për person të gjitha familjet që kanë të ardhura më pak se 2000 euro në muaj. Qeveritë, në fakt, europiane dhe perëndimore, siç ne kemi aspiratën, kanë mekanizma për të ndihmuar qytetarët, por, sigurisht, qëllimi juaj është të vidhni sa më shumë. Kur flitet për çmime, ju e krahasoni Shqipërinë me botën, por kur vjen puna te kompensimet thoni: "Ne nuk jemi si bota, jemi një vend në zhvillim, një vend i botës së tretë; nuk kemi mundësi". Patjetër që mundeni, por ju nuk doni. Ju keni vullnet politik vetëm për të vjedhur buxhetin e shtetit, vetëm për të vjedhur xhepat e shqiptarëve.

Çfarë ju pengon të bëni ndryshime në ligjin për reduktimin e taksimit për karburantet, që edhe ne të jemi në të një nivel me vendet e rajonit? Ju pengon korrupsioni dhe ortakëria me oligarkët.

Vitin që vjen keni parashikuar të jepni me koncesion rrugën "Milot-Fier", mbikëqyrjen e kolaudimit të makinave, sigurinë rrugore dhe lulishtet e Elbasanit, koncesione këto që do të

shkojnë në vlerën 1,8 miliardë euro, thënë ndryshe, 2 miliardë dollarë.

Tani, për të gjithë qytetarët, që këtu kanë dëgjuar shifra me miliona, miliarda e të tjera, duhet t'i sqarojmë këto. Në terma, po të marrim kartëmonedhat 1-dollarëshe, t'i vëmë sipër njëra-tjetrës, në lartësi, kjo distancë do të shkojë në 109,5 kilometra për 1 miliard dollarë. Është ekzaktesisht nga sipërfaqja e Tokës deri në troposferë, që është sipërfaqja e jashtme e atmosferës. 2 miliardë, që do të marrë qeveria vitin tjetër, pra Edi Rama, do të thotë se do të dalë përtej atmosferës. Nëse e doni me gjatësi, 1 miliard dollarë janë 156 mijë kilometra në gjatësi; 2 miliardë janë 312 mijë kilometra, mjaftueshëm për t'i rënë tokës pothuajse rreth e përqark 8 herë. Mbase kjo është arsyeja pse Kryeministri ka një pasion të ri tani: satelitët; mbase ky është dhe pasioni i tij i fundit, në fakt, i cili do ta rrëzojë shumë shpejt nga karrigia që ka uzurpuar në masakrën e 25 prillit.

Ndërkohë që ju dëgjoni shifra, që kalojnë dollarët në stratosferë, në Shqipëri 45% e buxhetit të familjeve shkon për ushqime, dhe një të riu, një familjeje me rroga normale, me të ardhura normale, i duhen mesatarisht plot 60 vjet për të blerë një shtëpi.

Po kalojmë nga borxhi në borxh. Në fakt, në Shqipëri borxh kanë edhe ata që janë ende të palindur. Çdo fëmijë në barkun e nënës sot, që ende nuk e ka parë dritën e diellit, është një borxhli i së nesërme.

Nëse në këtë Kuvend ka një ndarje në korridore ndërmjet të majtëve dhe të djathtëve, në popull duhet të ketë një bashkim për interesin e përbashkët.

Për qeverinë, 70 milionë euro janë një e rënë e lapsit, për Edi Ramën janë një firmë në letër, ndërsa për shqiptarët kjo është luftë për mbijetesë.

Prandaj unë bëj thirrje sërish nga kjo foltore, për të disatën herë, për protesta, protesta dhe vetëm protesta.

Çdo kryefamiljar të ri shqiptar nga Veriu në Jug, që sot paguan më shumë për energjinë dhe ushqimin, çdo familjar që paguan dyfishin për karburant dhe ata që zhyten në borxhe për të mbijetuar i ftoj t'i bashkohen sheshit të protestës.

U bëj thirrje të gjithë qytetarëve, të majtë, të djathtë dhe pa bindje politike, se ka ardhur

momenti t'i lemë mënjanë njëherë e mirë mllfet politike dhe të bashkohemi si shqiptarë për të ndaluar falimentin e vendit dhe për ta rrëzuar një orë e më parë këtë qeveri!

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Lefter Gështenja.

Të përgatitet në emër të grupit zonja Sorina Koti.

**Lefter Gështenja** – Të nderuar qytetarë,

Kjo sallë është bërë shumë shpesh simbol i betejave të ashpra politike, përfshirë edhe atë të ditës së sotme, dhe shumë pak herë simbol i zgjidhjeve për mirëqenien e qytetarëve që përfaqësojmë.

Sot kërkohet miratimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19". Në fakt, e diskutuam dhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, ku sipas relacionit të paraqitur thuhej që projektligji i mundëson Republikës së Shqipërisë marrjen e një huaje me kushte të favorshme nga BERZH-i, për të mbështetur kompaninë OSHEE Grup, në vlerën 70 milionë euro. Në fakt, kushtet dhe interesat janë favorizuese, për të thënë të vërtetën, sepse duhet thënë që e bardha është e bardhë dhe e zeza është e zezë.

Thuhet se shoqëria OSHEE gjatë vitit 2020 është përballur jo vetëm me situatën e thatësirës së jashtëzakonshme, por kësaj situatë iu shtua dhe situata e COVID-19, e cila pati efekte shtesë negative në financat e kompanisë, që, në fakt, sipas mendimit tim, të cilin e citova edhe në komision, nuk është aspak e vërtetë.

Qeveritarë të nderuar duhet të jeni të sinqertë dhe transparentë me ne, por edhe me shqiptarët. Nuk është kjo e vërteta për të cilën ju kërkoni këtë kredi. Pse? Sepse vetë treguesit financiarë të kompanisë nuk e thonë një gjë të tillë. Sipas informacionit zyrtar të OSHEE-së niveli i arkëtimeve për vitin 2020 ka qenë rreth 64,7 miliardë lekë. Arsyet përse kompania është në këtë situatë janë: keqmenaxhimi në procedurat e prokurimit publik; rritja e numrit të

të punësuarve në kompani, krahas rritjes së numrit të punësimeve elektorale, si dhe investimet në shpenzime luksi.

Pyetja që kisha për Kryeministrin, i cili, në fakt, nuk është prezent, ishte: përse kjo kompani, pra OSHEE-ja, është i vetmi institucion në Shqipëri, e vetmja kompani që prej 8 vjetësh vazhdon të procedojë me prokurim publik, me variantin me çelësa në dorë, njësoj si të jemi në kohë emergjente, me një procedurë që lë hapësira për abuzim me fondet publike? Përse nuk aplikohen procedurat me çmime njësi, ashtu si në çdo institucion tjetër, pra me projekte të preventiva të sakta? A nuk ju mjaftuan 8 vjet për të hartuar projekte e preventiva? Për çfarë arsyeje e ndoqët kjo lloj procedure? Kush mund të ma thotë? Ju mungon stafi? Mungojnë kompanitë projektuese për të hartuar projekte të sakta? Unë them që jo.

Në fakt, OSHEE-ja është kompania kampione e patronazhistëve në Shqipëri, pasi në këtë ekip gjejmë të gjithë lojtarët e mundshëm patronazhistë, nga portieri deri tek trajneri. OSHEE-ja është një institucion për të cilin komisioni hetimor i 25 prillit do të na zbulojë xhevahire.

Ne fakt, misioni dhe prioriteti i kësaj kompanie duhet të ishte përmbushja e kërkesave të konsumatorëve me furnizim të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë elektrike; forcimi i marrëdhënieve me konsumatorët dhe me partnerët publikë e privatë; arritja e një performance të mirë financiare; konsolidimi i besueshmërisë së kompanisë në tregun vendas dhe atë të huaj; integriteti; përkushtimi dhe përgjegjshmëria. Këto duhet të ishin shtyllat kryesore për këtë kompani.

Në fakt, shqetësimi im është se si do të përdoren këto fonde, si do të menaxhohen nga OSHEE-ja, kush do ta shlyejë këtë kredi, pasi treguesit financiarë ndër vite në këtë kompani janë negativë, mjafton të shohësh raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku vetëm në vitin 2020 stoku i papaguar ndaj OSHEE-së është vlerësuar në vlerën 3,8 milionë lekë. Ndërkohë, 13,2 milionë lekë është dëmi ekonomik i shkaktuar në këtë kompani nga shpërblimet e padrejta, penalitetet dhe pagesat gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna; 863 milionë lekë të rinj për shpërblime në natyrë të punonjësve

dhe pjesa tjetër për zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

Nuk është kryer ankandi për gjendjen e pjesëve materiale që ka kjo kompani, në vlerën 108 milionë lekë të rinj. OSHEE-ja, që nuk thuhet në asnjë vend, ka krijuar detyrime të reja ndaj KESH-it për periudhën 2019, në vlerën e plotë 9 milionë dollarë, ndërkohë që në relacionin e paraqitur në komision, OSHEE-ja jo vetëm na siguronte, por edhe na garantonte se do të përballonte me sukses ripagimin e kësaj kredie me fondet e aktivitetit të saj. Gjithkush nga ne është i bindur se kjo është e pamundur, thjesht duke kuptuar performancën që ka kompania në 5 vjetët e fundit. Gjithsesi, si gjithmonë, qeveria nuk harron, ku shton edhe një nen: “Ky financim përbën detyrim të drejtpërdrejtë për OSHEE-në kundrejt BERZH-it dhe, në rast të pamundësisë për të shlyer detyrimin nga OSHEE-ja, detyrimet e kredisë paguhen nga buxheti i shtetit, mbështetur në marrëveshjen e garancisë”, pra detyrimet do t’i paguajnë shqiptarët.

Dëgjova këtu, në sallë, se qeveria do të marrë nga 500-700 milionë euro të tjera, përveç 70-milionëshit për të cilin po diskutojmë.

A mund të më thonë ku po e çojmë këtë vend?!

Personalisht, nuk e kam luksin të humbas mes batutash politike, pasi zonat që përfaqësoj, Librazhdi dhe Përrenjasi, janë ndër zonat më të varfra të vendit dhe kurrsesi nuk mund t’ia lejoj vetes të dal mbi nevojën e madhe që kanë banorët për mundësi dhe mirëqenie. Edhe pse qarku i Elbasanit është një ndër qarqet më të varfra, në veçanti Librazhdi dhe Përrenjasi, qytetarët e këtij qarku janë paguesit më të rregullt të energjisë elektrike.

Më besoni, miqtë e mi, pensionistët apo përfituesit e ndihmës ekonomike janë të parët që paguajnë energjinë elektrike, para se të shkojnë në market për të blerë ushqime apo në farmaci për të marrë ilaçe. Mund të duket ironike, por banorët më të varfër janë paguesit me të rregullt të energjisë elektrike, edhe pse rrjeti që furnizon me energji elektrike banorët e Librazhdit dhe të Përrenjasit është i amortizuar, me investime minimale dhe u përket viteve ’80. Sot që ne diskutojmë, atje ka shtylla druri të kohës së merhumit dhe shpesh banorët lihen në errësirë nga avaritë e shumta që ndodhin çdo ditë, edhe në kohë me diell.



Në fakt, është e vështirë t'ia nisësh nga problemet, sepse vetëm në Librazhd mund të përballesh me shumë probleme. Fakti më i rëndë është se qeveria është dorëzuar para të gjitha problemeve. Mungesa e punësimit është thelbi i kërkesave të këtyre banorëve. Ata duan punë, por qeveria nuk ka asnjë vend pune për të ofruar. Kjo vërtetohet lehtësisht në agjencitë zyrtare, në agjencitë e punësimit të qarkut të Elbasanit, në çdo agjenci, në zyra lokale, ku nuk ka të publikuar asnjë vend pune, as në administratën shtetërore, as në institucionet private. Kjo është ironi therëse në një krahinë, e cila ka mbi gjysmën e popullsisë në varfëri. Janë plot 8600 persona që marrin ndihmë ekonomike. Ndaj këtë çështje nuk duhet ta lëmë pas dore. Premtimet e qeverisë janë kthyer në mesele ndërmjet banorëve, të cilën tallen pafundësisht me qeverinë e tyre.

Gjithashtu, duhet të investohet në mënyrë urgjente për rrugë, ujësjellës dhe energji. Shumë prej investimeve të realizuara deri tani janë minimale.

Personalisht, para pak ditësh u angazhova në ndihmë të banorëve të lagjes "Gropa" në Skroskë, të cilët ishin të izoluar prej vitesh për 1 kilometër rrugë, thjesht çakullim. Rruga u shtrua dhe shpresoj t'u vijë në ndihmë këtyre banorëve.

E përmenda këtë shembull për të treguar se, kur ka dëshirë, punët dhe detyrimet e qeverisë apo të pushtetit vendor mund të kryhen fare lehtësisht, sepse i kanë të gjitha mundësitë dhe levat financiare.

Por nga t'ia nisim? Ky është shqetësimi im. Ku do të shkojnë dhe kur do të shlyhen këto kredi? Apo do të prisni kur pensionistët të marrin pensionin për t'i shlyer këto kredi?

Kështu nuk vazhdohet, duhet një plan për nxjerrjen e banorëve të Librazhdit dhe Përrenjasit nga varfëria. Qendrat shëndetësore në shumicën e rasteve janë kasolle. Për shkolla e mësues nuk bëhet fjalë! Kjo është një gangrenë më vete.

Sot në Librazhd lulëzojnë vetëm disa biznese të lidhura ngushtë me qeveritarët, të cilët po e vjedhin këtë krahinë, po shfrytëzojnë burimet dhe asetet natyrore. Mjafton të përmend dy kompani, që shfrytëzojnë lëndën drusore, njëra në Stravaj dhe tjetra në Gramsh, të licencuara nga kjo qeveri dhe të lidhura me

njerëz eksponentë të Partisë Socialiste. (*Biegongu.*)

Zona ka traditë të saj blegtorinë, ka mundësi fantastike për zhvillimin e turizmit malor dhe atë të natyrës. Banorët e asaj zone nuk mund të mbijetojnë gjatë në treg, nëse nuk ndihmohen nga qeveria me subvencione apo investime për të ulur kostot e tyre.

**Lindita Nikolla** – Zoti Gështenja, mbaroi koha.

**Lefter Gështenja** – E mbylla, zonja Kryetare.

Të nderuar deputetë,

Në mbyllje të kësaj fjale, do të kërkoja mbështetjen tuaj, pasi shumë prej jush përfaqësoni zona të varfra, ashtu si dhe unë, që të diskutojmë për politika reale zhvillimi. Nëse ne bashkë, në këtë sallë, do të vijojmë me beteja të kota politike, të jeni të bindur se herën tjetër qytetarët do të na ndëshkojnë të gjithëve bashkë me votë.

Ju faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Sorina Koti, në emër të grupit.

**Sorina Koti** - Të nderuar qytetarë,

Borxhet për këtë qeveri nuk kanë të sosur.

OSHEE-ja do të marrë një kredi prej 70 milionë eurosh, me garanci sovranë qeverinë shqiptare. Kjo qeveri, që po e rrit borxhin nga muaji në muaj, del garant për të paguar këstet e një kredie, e cila dihet se si do të përfundojë: qytetarët shqiptarë do të paguajnë papërgjegjshmërinë e kësaj qeverie, të OSHEE-së, për keqmenaxhimin e burimeve natyrore dhe fondeve publike.

Marrëveshjes së huas i mungon detajimi me zërat dhe objektivin për përdorimin e fondeve, i mungon transparenca dhe argumentimi për çdo investim.

Arsyeja pse po merret borxh është kriza nga Covid-19, por a nuk është kjo kompani në krizë prej kohësh? A nuk është kjo kompani jo rentabël prej vitesh?

E pra, abuzimi me këtë pasuri natyrore po na shkakton borxh pas borxhi, pa e ditur sa është masa e kredive të financuara nga bankat, që operojnë brenda territorit të Shqipërisë apo me financime nga institucione jashtë saj, të mbuluara ose jo me garanci sovranë nga qeveria shqiptare.

Cili është fitimi vjetor neto i OSHEE Group për 3 vitet e fundit, si dhe cilat janë parashikimet

për 5 vitet e ardhshme, meqenëse kredia do të jetë për 5 vjet, kur kësaj qeverie t'i ketë mbaruar mandati?

Sa garanci gjykohet të ketë, që pagesat për kredinë e marrë të mbulohen vetëm nga të ardhurat e gjeneruara nga OSHEE Group, pa penalizuar fonde publike nga qeveria shqiptare?

Asnjë plan nga OSHEE Group për të rritur eficiencën e kompanive të grupit dhe ngushtimin e diferencës së çmimit të lartë të blerjes me çmimin e shitjes brenda territorit të Shqipërisë!

Këto shifra, në mënyrë thelbësore, rrezikojnë rezultatit financiar të kompanisë publike, pavarësinë e saj financiare dhe aftësinë paguese të OSHEE Group karshi BERZH-it dhe mosangazhimit të fondeve publike nga qeveria shqiptare. Madje, kompanitë e OSHEE Group nuk përdorin kontratat detyruese afatgjata të importimit të energjisë elektrike me shitës rajonalë, duke iu shmangur në kohë çmimeve të pikut dhe duke siguruar në këtë mënyrë energji të garantuar për nevojat e vendit me çmime më të ulëta, për të ndihmuar kështu konsumatorin shqiptar.

Por sa dhe si do të ndikojnë investimet dhe përmirësimet teknologjike nëpërmjet kredisë 70 milionë euro në uljen e humbjeve në rrjet apo në përmirësimin e sigurisë së rrjetit?

Cilësia e performancës së OSHEE Group ka qenë gjithmonë e dyshuar, kjo jo vetëm si një ndërmarrje publike që qarkullon vlera të mëdha monetare nëpërmjet tenderëve të përfolur me diferenca të larta të çmimeve në blerje dhe çmimit të ulët të energjisë në shitje, por shumë më tepër kanë marrë vëmendje politikak e menaxhimit të kompanisë dhe ndikimi i tyre në sigurinë kombëtare, në zhvillimin e ekonomisë dhe nevojat e konsumatorit familjar.

Por ja si vidhen shqiptarët: çmimi i shitjes së energjisë nga KESH-i tek OSHEE-ja për konsumatorin është 12 euro për megavatorë, ndërsa çmimi i importit të energjisë është 260 euro për megavatorë. Nëse konsumatori do të furnizohej nga KESH-i për muajt shtator-dhjetor, me çmimin 12 euro për kilovatorë, do të kushtonte 8 milionë euro, ndërsa me çmimin e importit do të kushtojë 150 milionë euro. OSHEE-ja do të vazhdojë të vjedhë paratë e shqiptarëve, plot 142 milionë euro për 4 muajt në vazhdim. Nëse do të menaxhoheshin prodhimi

dhe nevoja e tregut të brendshëm, këto para do të kurseheshin.

Gjithashtu, kërkesa e lartë për import energjie, po shkakton ditët e fundit dhe një zhvlerësim të lekut kundrejt euros, i cili do të sjellë një shtrenjtim jo vetëm të borxheve të marra, por edhe të çmimeve të produkteve që shqiptarët konsumojnë përditë. Gjithçka në kurriz të shqiptarëve!

Shteti ka marrë dhe një kredi prej 200 milionë eurosh, për të mbuluar krizën e OSHEE-së që nga vitet 2018-2021. Ky fond u përdor për rritje pagash dhe jo për investime në këtë infrastrukturë. Fondi i pagave u rrit nga 29 milionë dollarë për 6400 punonjës në vitin 2017, në 49 milionë dollarë, gati një rritje 70% të pagave.

Në projektbuxhetin që qeveria solli në Kuvend pardje, parashikohet që ky sektor do të dalë me një humbje prej 73 milionë lekësh. Kjo do të thotë që kjo qeveri legjitimon vjedhjet dhe humbjet e kësaj kompanie vit pas viti.

OSHEE-ja do të vazhdojë të manipulojë dhe të keqmenaxhojë fondet e buxhetit të shtetit, si dhe të abuzojë me kredinë shtesë që do të marrë nga BERZH-i. Qeveria do të vazhdojë të bëjë një sy qorr dhe një vesh shurdh.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Këtu mbyllet diskutimi në parim edhe për këtë projektligj.

Para se të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, ju lutem, dy minuta kohë për të bërë shpërndarjen e fletëve të votimit nga shërbimi i seancës!

*(Pas pushimit.)*

Vijojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Ju lutem, votoni një nga një, jo në grup!

Projektligji “Për miratimin e buxhetit faktit të vitit 2020”.

Para se të fillojmë me shqyrtimin në parim, sjell në vëmendjen tuaj se, referuar ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit miratohet nga Kuvendi brenda muajit tetor të çdo viti buxhetor. Kështu që ne sot përmbushim detyrimin ligjor për sa i përket afatit. Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, a ka pyetje për projektligjin? Nuk ka.

Fillojmë diskutimin në parim, me paraqitjen e projektligjit nga nismëtari.

Zonja Ibrahimaj, keni fjalën.

**Delina Ibrahimaj** - Të nderuar deputetë,  
Politika fiskale ekspansioniste e Shqipërisë, e ndjekur gjatë dy viteve të fundit, është projektuar si një përgjigje ambicioze, për të zbutur ndikimin e goditjeve ekonomike dhe për të siguruar një rimëkëmbje të qëndrueshme.

Frytet e politikës së ndjekur gjatë vitit 2020 po materializohen këtë vit në rritje dyshifrore ekonomike, në rritje të punësimit dhe të tregtisë, në rritje të konsumit dhe të investimeve private.

Ekonomia shqiptare gjatë vitit të kaluar tregoi shenja qëndrueshmërie dhe këtë vit ecuria e aktivitetit ekonomik tregon optimizëm dhe besim të shtuar. Këto janë rezultatet e një pune intensive të kryer nga qeveria gjatë vitit 2020.

Më lejoni që, në funksion të prezantimit të buxhetit faktik të vitit 2020, të paraqes një përmbledhje të shkurtër të parametrevë të përgjithshëm të ekonomisë, të masave të ndërmarrura nga qeveria për bizneset dhe qytetarët, si dhe një panoramë të buxhetit faktik të vitit 2020.

**Lindita Nikolla** – Të nderuar, kolegë, me qetësi, ju lutem!

**Delina Ibrahimaj** - Situata ekonomike e vitit 2020.

Për më shumë se dy dekada, Shqipëria nuk ka hasur ndonjë situatë recensionale të ngjashme me atë të vitit 2020 dhe as fatkeqësi natyrore, si tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia e vitit 2020.

Prej vitit 2013, ekonomia kishte një rritje me 1-2%, ndërkohë që qeveria shqiptare arriti të rikthente norma të larta, duke arritur në mbi 4%.

Si rrjedhojë e dy fatkeqësive natyrore, prodhimi i brendshëm bruto nominal u kontraktua me 4% në vitin 2020, rënie më e përmbajtur se parashikimi fillestar, i cili luhatej nga 6% deri në 8%.

Pavarësisht kësaj ecurie, parametrat e tjerë të rëndësishëm të ekonomisë kanë rezultuar të qëndrueshëm, duke vlerësuar masat kufizuese të ndërmarrura nga autoritetet publike.

Tkurrja e eksporteve u kompensua nga pesha e lartë strukturore e importeve, gjithashtu, në rënie. Ndërkohë, gjatë vitit inflacioni mesatar rezultoi 1,6% dhe inflacioni në fund të vitit rezultoi 1,1%.

Tregu i punës pësoi luhate të vazhdueshme në vitin 2020, me një rikuperim të mirë në gjysmën e dytë të vitit, si pasojë e rihapjes së

ekonomisë dhe masave për mbështetjen financiare për sipërmarrjet dhe individët.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha sa më sipër, kanë qenë rrjedhojë e një sërë masash konkrete të ndërmarrura nga qeveria dhe të ecurisë pozitive ndër vite të ekonomisë, si pasojë e reformave, duke përmbajtur efektet në punësim, ekonomi dhe varfëri.

Tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19 ndikuan në ecurinë ekonomike të vendit dhe rritën ekspozimin ndaj vendeve fqinje dhe rreziqeve fiskale.

Në kuadër të pandemisë u ndërmorën një sërë masash për të mbështetur ekonominë gjatë krizës, të cilat synuan rritjen ekonomike.

Së pari, u rritën transfertat sociale për familjet e varfra dhe të papunët, duke dyfishuar ndihmën ekonomike për familjet përfituese për një periudhë tremujore gjatë karantinës. Po ashtu, familjet që kishin aplikuar, por nuk ishin kualifikuar për programin e ndihmës ekonomike, përfituan secila një pagesë prej 16 mijë lekësh.

Si rezultat, shpenzimet për ndihmën ekonomike u rritën me 24%, ku përfituan 66 mijë e 650 familje dhe individë në nevojë...

**Lindita Nikolla** – Kolegë, ju lutem, qetësi!

**Delina Ibrahimaj** - ...7850 familje të tjera përfituese për herë të parë dhe 168 mijë e 243 persona me aftësi të kufizuar apo kujdestarë përfitues.

Së dyti, një sërë masash u ndërmorën në mbështetje të punësimit dhe të rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik, përfshirë mbështetjen për biznesin e vogël, të mesëm dhe të madh.

Fondet për masat në ndihmë të punësimit u rritën me rreth 12,7 miliardë lekë dhe shkuan për 243 mijë e 500 biznese dhe individë të prekur nga pandemia nëpërmjet pagave të luftës. Ndërkohë, 23 mijë e 320 përfitues përfituan mbështetje financiare për zbatimin e masave dhe protokolleve anti-Covid, me një kosto prej 118 milionë lekësh.

Gjithashtu, u aktivizuan dy garanci sovraane për mbështetjen e biznesit, nga të cilat u disbursuan 14,3 miliardë lekë për një shumë të madhe ndërmarrjesh.

Një shumë e madhe parash shkoi dhe për mbështetjen e sektorit të shëndetësisë. Rreth 2,5 miliardë lekë u akorduan për mbështetjen e këtij

sektori, përveç parave që u akorduan për blerjen e vaksinave.

Të gjitha këto masa kushtuan 43 miliardë lekë ose 2,8% të PBB-së për vitin 2020.

Gjithashtu, një sërë masash u ndërmorën në kuadër të lehtësimit fiskal dhe u miratuan gjatë vitit 2020, si: përjashtimi nga detyrimi për këstet e parapagimit të tatimit apo përjashtimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Njësitë e qeverisjes vendore, gjithashtu, bënë përjashtimet e tyre, sipas rastit.

Të nderuar qytetarë,

Ishin këto masa, që zbutën ndikimin e pandemisë, lejuan një zbatim të ndryshimeve të buxhetit, në përputhje me nevojat që u shtuan, për t'i hapur rrugën një rikuperimi më të shpejtë të ekonomisë në vitin 2021.

Buxheti i vitit 2020 rezultoi me të ardhura në nivelin e 425,9 miliardë lekë dhe shpenzime në nivelin 536,2 miliardë lekë.

Të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar ishin rreth 33,4 miliardë lekë ose 7,5% më pak se një vit më parë. Edhe ky kontraktim i të ardhurave, erdhi si pasojë e kontraktimit më të fortë në dekada dhe sërish rezultoi se ishte më i ndjeshëm, më i zbutur se parashikimet fillestare. Si peshë ndaj ekonomisë, të ardhurat e përgjithshme publike arritën në 26,5% të PBB-së, nga 27,4% në vitin 2019.

Në terma nominalë, shpenzimet e përgjithshme publike gjatë vitit 2020 ishin 536,5 miliardë lekë, 44,3 miliardë lekë ose 9% më shumë, dhe faktor në zëra të rëndësishëm për qytetarët ishin shpenzimet kapitale për procesin e rindërtimit, si dhe shpenzimet për ndihmën sociale dhe financiare në mbështetjen ndaj efekteve të pandemisë.

Shpenzimet e përgjithshme publike u realizuan në masën 97,7% të planit vjetor të buxhetit fillestar dhe 92,6% të planit vjetor të buxhetit ndryshuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 ato ishin 9,1% më të larta ose rreth 44,6 miliardë lekë më shumë.

Në përmbyllje, deficitin fiskal në vitin 2020 arriti në 6,8% të GDP-së, nga një mesatare prej 2% në 3 vitet e mëparshme, por megjithatë rezultoi më i ulët se kufiri prej 8,4% i PBB-së.

Borxhi publik, i shumë përmendur në media dhe këtu sot, arriti në nivelin 77,84 % të PBB-së, më i ulët se pritshmëria fillestare prej 80%.

Duhet të theksojmë për qytetarët se borxhi publik u rrit për herë të parë pas katër vjetësh, për shkak të situatës së pandemisë dhe në linjë me konferencën e donatorëve për tërmetin e nëntorit 2019.

Të nderuar qytetarë,

Viti i kaluar na përballi me recesionin më të egër që kemi hasur që prej vitit 1997 dhe sot ekonomia shqiptare rritet me 18 %. Rritja është qartazi materializim i politikave ekonomike, sociale e fiskale të ndërmarra nga qeveria.

Buxheti i vitit 2022, i cili është depozituar në parlament, është një pasqyrë e politikave që do të ndërmerren dhe prioritetëve të qeverisë, me qëllim vijimin e reformave strukturore; rritjen e produktivitetit, mbrojtjen e shtresave në nevojë dhe, mbi të gjitha, rritjen e eficiencës në të gjithë sektorët nëpërmjet digjitalizimit. Të gjitha këto do të ndërmerren në optikën e rritjes së eficiencës së mbledhjes së të ardhurave, duke mundësuar rikthimin e parametrave fiskalë të qëndrueshëm, duke e sjellë borxhin publik në një trajektore rënëse dhe, gjithashtu, duke sjellë balancën primare pozitive në vitin 2024, sipas rregullit fiskal të parashikuar në ligj.

Ju ftoj të gjithëve të votoni buxhetin faktik për vitin 2020.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Referuar nenit 74, pika 2, të Rregullores, fillojmë debatin për projektligjin.

Fjala për deputetin Taulant Balla.

Fjala për zotin Arben Ahmetaj.

Fjala për zotin Arbi Agalliu.

**Arbi Agalliu** – Përsëritje!

Zonja Kryetare, do t'ju sugjeroja që herë tjetër, për një diskutim kaq të rëndësishëm, edhe për respekt të ministres që foli, të marrim kohën e nevojshme për të votuar, pasi salla po kthehet në arenë sporti.

Pandemia dhe tërmeti janë termat që përdoren si mburojë për çdo mosarritje apo abuzim, quajini si të doni.

Unë do të përmend disa shifra të Ministrisë së Financave, të INSTAT-it dhe të FMN-së, të cilat tregojnë se ka mosrealizim të buxhetit të planifikuar, me atë faktik.

Rritja ekonomike pësoi 3,3% rënie krahasuar me vitin 2019; TVSH-ja pati 21,2 miliardë lekë diferencë; 9,6 tatim-fitimi; akciza minus 6; TAP-i minus 13,8 dhe fondet speciale

minus 6,3%. Totali i të ardhurave: minus 84 miliardë lekë.

Tatimi dhe doganat mblodhën 16,1 miliardë lekë më pak se në vitin 2019; rimbursimi i TVSH-së rezultoi me një ulje prej 7 miliardë lekësh krahasuar me vitin 2019; deficiti shkoi në masën 110 miliardë lekë, afërsisht 7% e GDP-së; borxhi publik është rreth 80% dhe, sipas FMN-së, parashikohet të rritet në vitin 2021.

Gjithashtu, sipas të dhënave, për paketën mbështetëse anticovid rezulton se jemi vendi me paketën ndihmëse më të ulët në rajon. Paratë, të cilat mund të ishin përdorur për t'u ardhur në ndihmë familjeve dhe bizneseve, kanë shkuar për pagesa të PPP-ve.

E pyeta ministren në komisionin përkatës se përse nuk u shtynë pagesat, për të cilat, sipas Eurostat-it, Shqipëria është e para dhe Italia është e fundit, dhe më tha se për këtë ka pasur një kontratë. Patjetër që do të kishte kontratë, por sikurse parashikohet në ligj, ashtu duhet të jetë edhe në kontratë, që në raste të jashtëzakonshme merr prioritet situata, të cilën vetë Kryeministri, me të madhe, e përmend si fatkeqësi natyrore. Por, edhe pse ka pasur një kontratë, ju nuk pyesni për kontrata, sepse aq sa shpenzuar për ndihmë në kohën e pandemisë, do t'i paguani Becchettit pikërisht për prishjen e kontratës.

Kishte rreth 2 mijë e 327 rishikime apo rialokime, parashikueshmëri e dobët kjo për sa i përket buxhetit, në masën 50,7 miliardë lekë.

Copëzimi dhe çelja e shumë projekteve krijoi presion në rritje gjithmonë e më shumë për financime të ndryshme apo për rritjen e borxhit.

Janë lidhur mbi 500 kontrata investimesh me vlerë 23 miliardë lekë pas datës 15 tetor, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin organik të buxhetit të shtetit.

Kemi 7 raste prokurimesh me fond limit 4,3 miliardë të marra angazhim pa fonde disponibël për këto projekte, duke shkelur atë që njihet si procesi ligjor i PBA-së.

Janë paguar rreth 203 milionë lekë nga fondet e detikuara për Covid 19 për gjëra, të cilat nuk kanë lidhje me Covid-in, sikurse janë: dietat, interneti, ruajtje objektsh, mirëmbajtje të ndryshme, pagesa energjie elektrike e të tjera. Në këtë kontekst, institucionet publike kanë 790 miliardë lekë borxh ndaj ISSH-së.

Këto janë të dhëna që, nëse do të shtojmë edhe detyrimet e prapambetura, rreth 77 miliardë

lekë ose 630 milionë euro, 14,6 miliardë lekë nga institucionet qendrore dhe vendore, 11,8 miliardë lekë TVSH dhe 50,5 miliardë lekë detyrime nga vendimet e paekzekutuara të gjykatave, borxhi tatimor do të vlerësohet rreth 5,4 miliardë lekë, më i lartë se në vitin 2019, dhe borxhi doganor 3 miliardë lekë më i lartë se në vitin 2019.

Nga të gjitha këto kuptohet edhe një herë se ku ka dështuar kjo qeveri, duke mos realizuar me korrektësi buxhetin e planifikuar. E vetmja korrektësi që ka realizuar është vjedhja dhe abuzimi në kurriz të shqiptarëve.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Saimir Korreshi.

**Saimir Korreshi** – Përsëritje, të gjithëve!

Në kuadër të borxheve, duke qenë se qeveria është shumë e hapur ndaj tyre, i ka qejf, lan borxhet me borxhe, kam një shqetësim për mbylljen e disa institucioneve, për zvogëlimin apo për centralizim midis tyre.

Duke qenë se kemi marrë lekë, mirë është të lëshojmë ndonjë grusht dhe të bëhemi zemërgjerë. Po flas për hartën gjyqësore. Kjo ka shumë lidhje me drejtësinë dhe reformat që ne i kemi pompuar si të forta.

Së fundi, duke qenë se kjo hartë gjyqësore i takon qeverisë, Këshilli i Ministrave është duke diskutuar të shkurtohet Gjykata e Lushnjës, dhe mua më vjen keq për këtë.

Qyteti i Lushnjës ka 200 mijë banorë. Gjykatat shqyrtojnë një numër të jashtëzakonshëm dosjesh, mbi 20 procese në ditë, me një eficiencë maksimale. Për shembull, në gjykatat e tjera të rretheve, për të dalë data për zgjidhjen e martesës duhen 9 apo 10 muaj, si rasti i Kavajës apo i Durrësit, kurse në Lushnjë gjykohen brenda 45 ditëve apo 2 muajve.

Argumentet janë: procesi i vetingut, heqja e gjyqtarëve e të tjera, por këto nuk mund të jenë argumente.

Argumentet janë dhënë teknikisht në ligjin nr. 98/2006 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i cili ka përcaktuar disa objektiva për kompetencat tokësore për organizimin e pushtetit gjyqësor si garantimin e aksesit në drejtësi, çka lidhet me afërsinë e individit me gjykatën, uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshëmri të

burimeve publike, rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Bazuar në objektivat e mësipërme, ligji ka përcaktuar edhe një grup kriteresh detyruese në ndërtimin e këtij sistemi, si: ndarjen administrative territoriale të vendit, zhvillimin demografik, numrin e banorëve në raport me numrin e gjykatave, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën rrugore dhe kushtet e transportit për në gjykatë midis dy gjykatave, karakteristikat gjeografike, ngarkesën e gjykatave për çështjet e ardhura, të përfunduara dhe në shqyrtim, eficiencën e gjykatave dhe gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë, burimet njerëzore në dispozicion, vendndodhjen dhe përmasat e institucioneve të ekzekutimeve të vendimeve penale.

Krahas kësaj gjykatë, prokuroria largohet nga Lushnja drejt Fierit.

A e dini ju që sot në Fier ka vetëm 4 salla gjyqësore? A e dini ju se gjyqtarët, me njëri-tjetrin, qëndrojnë në radhë për të bërë gjyqe? A e dini ju që ka një marrëveshje me OSBE-në, që të gjitha proceset duhet të jenë të regjistruara audio dhe video, për të shmangur të gjitha ato që ne kemi kërkuar ndër vite?

Realisht, sot gjyqet bëhen në zyrat e gjyqtarëve, çka është e papranueshme për çfarë ne kërkojmë. Pra, një hartë gjyqësore, e cila sot do të sillte dobishmëri për të gjithë Shqipërinë fillon të cungohet, të centralizohet, për të pasur nën kontroll.

Nga gjykata e Lushnjës për në gjykatën Fierit ka një largësi 30 kilometër.

Së pari, njerëzit duhet të përpiqen të gjejnë gjykatën, të ikin 2 muaj më parë, të humbin kohë dhe lekë, sepse dihet që proceset gjyqësore jo domosdoshmërisht zgjidhen po atë ditë, sepse duhen dëshmitarë, njohje, ka shkuar njoftimi apo jo, krijohet kaos dhe moseficiencë në dhënien e vendimeve. Pra, drejtësia e vonuar, është drejtësi e munguar.

Më pas thoni se ka një projekt, ku 6 Apelet e Republikës së Shqipërisë, do t'i sillni në një të vetme.

Kemi rastin konkret të Gjykatës së Apelit Administrativ, ku duhen 4 vjet për të dalë çështja, nëse do të kesh fat. Për fatin, e dini ju se çfarë del pastaj. Krahas kësaj, ikën prokuroria, pra për të dhënë një deklaram, për t'u thirrur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, duhet të bësh sërish 30 kilometra.

Për t'i thënë ministres së Financave të kursejë lekë, burgu i Kosovës është 13 kilometër nga Lushnja dhe 45 kilometër nga Elbasani. Burgu i Rrogzhinës do të jetë më gjatë me Durrësin sesa me Lushnjën. Prandaj, ju bëj thirrje ta rigjykoni dhe ta rishikoni.

Krahas këtyre, do të ikë Shërbimi i Provës. Pra, të gjithë njerëzit e dënuar me dënime alternative, duhet të lënë ditën e punës që të shkojnë në Fier për të bërë shërbim prove, sepse shërbimi atje është 8:00-16:00. Pra, duhet të lënë ditën e punës për të shkuar në shërbimin e provës. Në këtë mënyrë ju nuk po u jepni mundësi, por po i dënoni sërish, sepse ata dalin pikërisht për atë punësim.

Tjetra, do të ikë edhe Shërbimi Përmbarrimor, sepse dihet që është krahas gjykatave. Për të shkuar te Shërbimi Përmbarrimor, që familja të marrë kontributin për fëmijët, duhet të ikë në Fier. Për të bërë një takim me fëmijën, nëse nuk realizohet, duhet të shkojë në Fier. Kjo është e papranueshme për një rreth gjyqësor siç është Lushnja me Divjakën, me 200 mijë banorë.

U bëj thirrje të gjithë deputetëve dhe Partisë Socialiste, e di që e kanë në vëmendje, por duhet të dëgjojnë më tepër se çfarë mendimi kanë qytetarët e Lushnjës për këtë rast. Do të jetë e papranueshme nëse Këshilli i Ministrave e kalon Hartën Gjyqësore pa gjykatën e Lushnjës.

Tjetra, kam një shqetësim për bujqësinë.

Fermerët kanë ngritur disa probleme.

Në fakt, kishin bërë dhuratë një palë çizme për ministren e Bujqësisë, por Garda nuk më lejoi t'i fusja, dhe unë u kërkoj ndjesë që nuk munda t'i sillja.

Fermerët sot kanë dy probleme emergjente, jo vetëm në Lushnje, por në të gjitha zonat e Myzeqesë, Urës Vajgurore në Berat, për vlerësimin e situatës për domaten oskan F1.

Ju keni ngritur një grup pune për problemin e moslidhjes së frutave për një bimë të rritur mirë, por me shumë pak fruta.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, ka defekte në teknologji, mbidozë hormoni; ka pasoja negative të klimës, temperaturë të lartë e të tjera. Ky konkluzion nuk qëndron, sepse në të njëjtën serrë janë mbjellë dy hibride, oskan F1 dhe një tjetër çfarëdo, por oskan F1 nuk ka prodhim. Hormoni teorikisht deformon frutin, jo se nuk jep prodhim apo nuk lidh kokërr.

Keni bërë një verifikim për 4 milionë e 200 mijë fara, 300 mijë prej të cilave kanë dalë të papërdorshme, dhe keni llogaritur që me ato mbuloheshin vetëm 100 hektarë serrë, ndërkohë që rezultati ka dalë se janë afro 200 hektarë. Mos vallë këto fara, që ankohen këta fermerë, kanë ardhur nga ana juaj, kontrabandë? E mira është të verifikohet fara dhe të thirret përfaqësuesi i kompanisë turke “Yüksel”. Ata realisht e kanë shumë problem këtë rast.

Gjithashtu, kemi një skemë piramid të një sipërmarrësi, i cili ka gënjyer të gjithë fermerët e Imshtës. Ka marrë një fond nga Ministria e Bujqësisë për të bërë një magazinë për mbjelljen ose grumbullimin e fruta-perimeve. Në dijeni, më sa më thanë fermerët, nuk është realizuar, por lekët janë “rruajtur”, si gjithmonë.

E para, zotëria ua serviri farën, ua mori lekët, lidhi kontrata pa noter, që shalqinj të do t’ua merrte me 13 lekë për kilogram. Çfarë ndodhi? Bëri reklamë dhe panair shalqinjsh në Lushnje, tha se do të konkurronte Greqinë dhe Maqedoninë, dhe në fund: “opingat” themi ne, sepse shalqinj të ngelën në arë.

Unë e di se ministria ka shumë punë, por e mira është të vijë. Vërtet është rritur nafta, por ndoshta ka ngelur ndonjë tollon nga ata që do të rimburosonit ju, që i ndatë për zgjedhje. Gërmo në ndonjë sirtar, se ndoshta gjen.

Kam edhe diçka për OSHEE-në.

Sa pikë e bukur është kjo, sepse ju po merrni shumë lekë.

*(Bie gongu në sallë)*

Mendoj se një pjesë të këtij borxhi duhet ta përdorni për të blerë batanije. Po, të ndërroni objektin e OSHEE-së dhe të shpërndani batanije, që qytetarët të ngrohen në dimër. Me çmimin e energjisë, 90% të familjeve shqiptare nuk kanë mundësi të ngrohen dhe batanijet që kanë pasur, u janë grisur këto 8 vjet të qeverisjes suaj.

Sa për asin, se do të merrni borxh për t’u ngrohur, nuk ta lejon tensioni i dobët i investimeve tuaja marsiane...

*(Bie gongu në sallë)*

... sepse nuk mund të ndezim njëkohësisht lavariçen dhe dushin, jo më të ngrohemi.

**Lindita Nikolla** – Zoti Korreshi, mbaroi koha juaj, ju lutem!

Fjala për zotin Bledjon Nallbati.

**Bledjon Nallbati** – Përshëndetje, të gjithëve!

Të nderuar bashkëqytetarë,  
Kolegë,

Sot kemi miratimin e buxhetit faktik të vitit 2020.

Si një dokument që nuk ka pasoja pasardhëse, pasi ka kaluar, por bëhet thjesht certifikimi, pashë vetëm disa elemente, sepse, siç thotë populli: gjuha shkon ku dhemb dhemb.

Këtu kam një tabelë të shpenzimeve faktike të vitit 2020 në rang qarku.

Qarku i Korçës, Bashkia e Devollit: zero. Zero më tej, zero më tej.

Në vitin 2020 Bashkia e Devollit, për këtë qeveri, paska qenë me pushime. Pashë vetëm dytri elemente, sepse nuk kisha çfarë të shikoja. Për shembull, pashë arsimin, që është problematik.

Sipas dokumentit të qeverisë, në infrastrukturën arsimore janë investuar 2.67 miliardë lekë të rinj. Nga këto në Devoll, zero, zero, zero. A thua se atje nuk ka fëmijë, si në të gjithë Shqipërinë, që meritojnë të shkollohen në kushte më të mira, ku në shumicën e shkollave të fshatrave situata është katastrofë.

Pashë bujqësinë dhe investimet në bujqësi në fushën e ujitjes, kullimit apo të sistemimit të rrugëve të arrave, që është një problem shumë i madh, dhe sipas dokumentit të qeverisë janë 4.2 miliardë lekë të rinj. Nga këto, në Devoll, zero. Ndërkohë, të gjithë e dinë, edhe këta mbrapa, apo jo, Niko, se Devolli është një nga zonat më punëtore dhe ka investuar më shumë se kushdo tjetër në bujqësi, kryesisht në pemëtarë.

E dini si është situata sot atje? Është kështu: *(Tregon një fotografi)*.

Këto janë mollë. Bëra gabim që nuk i bëra me ngjyra, që t’i shikonit më mirë.

Apo jo, Niko?

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ke qenë ministër i Bujqësisë.

Unë kam ditur të lexoj, por ti nuk ke lexuar.

Para disa kohësh, zotëria ishte ministër i Bujqësisë dhe drejtues i listës së qarkut të Korçës. Korçarët dhe devollinjët fërkuar duart dhe menduan se më në fund u erdhi shansi të kenë investime në bujqësi. Këtij nuk i doli koha. U ngatërrua me disa muhabete, për disa silikone, një muhabet lëmsh, që nuk u mor vesh, dhe më pas iku tek tanket dhe topat, e harroi bujqësinë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Hajde, të mirëpres!

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Të mirëpres!  
Mos më ndërprit!  
Më pas, dil, sepse të mirëpres!  
Kjo është gjendja.  
Nuk kam as Kryeministrin, as ministrin e Bujqësisë.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Që kur ka ardhur Nikoja në Korçë, e ka ndritur.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Shiko zonën që ke dhe mos ndërhy tek unë!  
Unë e di më mirë se ti Korçën dhe Devollin.

Shko të qash hallet e tyre, mos më ndërprit!

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, mos ndërhy!

**Bledjon Nallbati** – Mos më ndërprit!

Kjo është situata e produkteve sot.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Urdhëro?

E di që ka mbaruar.

Kjo është situata e infrastrukturës.

Tjetra, që të mos zgjatem, jo më larg se një javë më parë nga kjo foltore i kërkova Kryeministrin të impenjohej për një marrëveshje me vendet e Lindjes së Mesme, kryesisht me Egjiptin, që kanë shumë interes për produktet tona.

Si për ironi të fatit, pas një jave shkoi në Egjipt, dhe në vend të bënte një marrëveshje për këtë, me interes të madh ekonomik për mijëra e mijëra familje të qarkut të Korçës, të Devollit, por edhe të gjithë Shqipërisë, nënshkroi tre memorandume. Për çfarë ishin? Për mumie.

Unë nuk jam aspak kundër marrëveshjeve në fushën e kulturës, aq më tepër me Egjiptin, sepse e dimë të gjithë që kemi një lidhje të veçantë me Egjiptin, por, nëse do të kishim mundësi ta pyesnim mbretin Farruk se cilat marrëveshje ishin më të rëndësishme në këto momente, sigurisht që do të thoshte për bujqësinë, se Farruku dhe mumiet e Egjiptit kanë pritur me mijëra vjet dhe mund të prisnin edhe pak, nuk ishte qamet i madh, kurse fermerët e Korçës, të Devollit e të gjithë Shqipërisë nuk presin dot.

Thirrini mendjes, ulni kokën, impenjohuni dhe angazhohuni për problematikat e fermerëve, për qytetarët që na kanë sjellë këtu, sepse falë tyre jemi këtu, e jo falë mumieve dhe asgjëje tjetër.

Niko, faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Frida Krifca.

**Frida Krifca** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar fermerë,

E dëgjova me vëmendje seancën e ditës së hënë, ku konstatova me kënaqësi se pothuajse të gjithë deputetët që referuan, kishin bujqësinë në përmbajtje të fjalimeve.

Nga ana tjetër, nuk m'u dukën fare të përshtatshme për këtë sallë fjalët denigruese, me të cilat u vesh profesioni i fermerit i portretizuar në këtë foltore si në harresë, si skillever, në mëshirë të fatit e pa shpresë.

Dua t'ju kujtoj se ushqimi në tavolinën tonë vjen pikërisht nga fermerët tanë, prodhues me dinjitet nga Kutallia, Zharrëza, Lapardhaja, Maqellara, Kozmaçi apo Devolli.

Këta fermerë nuk njohën kurrë pushim, as në pandemi, kur të gjithë ishin brenda në shtëpi. Fermerët tanë ishin në fushë, duke prodhuar për ne dhe për tavolinat e Europës. Ata na ushqejnë fëmijët, kujdesen për tokën, bimët dhe burimet tona natyrore. Ata punojnë, sepse toka u jep mirëqenie.

Patjetër që kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe financim, prandaj punohet çdo ditë. Në buxhetin e vitit 2022 kemi vënë fondin më të madh në dispozicion për mbështetje të drejtpërdrejtë, për investime në asete fizike. Kemi mundësuar akses në fonde europiane që më parë flinin në letra; kemi mundësuar pothuajse dyfishimin e fondit të vënë në dispozicion për financim të fermerëve, pasi i treguam Europës që investimet në bujqësi në vendin tonë janë të duhurat, shtojnë vlerë, rrisin standardin për konsumatorin dhe e afrojnë fermerin shqiptar me atë europian. Kjo nuk bëhet me baltosje, nuk bëhet me pallavra, por me punë dhe përpjekje të mëdha të përditshme nga fermerët, por edhe nga administrata.

Mbi të gjitha, fermerët kanë nevojë për respekt, i cili tregohet edhe nëpërmjet fjalës së përdorur në këtë foltore. Ata kanë nevojë për dije, që të mbështeten në politika të qarta e të duhura; kanë nevojë për formalizim, për eliminim barrierash, për forcim institucionesh, për akses në tregje dhe në financime. Ata kanë nevojë të jenë pjesë e një zinxhiri, që e rrit vlerën e produktit të tyre; kanë nevojë për infrastrukturë, për ujë, ku kemi bërë përmirësime



të ndjeshme dhe investime që orientojnë të mira më të mëdha e mirëqenie në hapësirën rurale.

Të nderuar,

Po përiqem t'ju them se narrativa për bujqësi mbijetese duhet të eliminohet nga fjalori juaj, pasi është deprimuese, është demotivuese për sektorin dhe për ata që aspirojnë të investojnë në bujqësi. Nuk u jep shpresë të rinjve si Bleisi, që ka studiuar në Spanjë për ekonomi bujqësore dhe mbrojtje bimësh; që ka investuar në teknologji të reja inovative dhe furnizon me fidanë nga Maminasi rreth 3 mijë fermerë. Narrativa e padenjë deprimuese nuk i jep dinjitet Mikelit në Suk të Roskovecit, i cili prodhon sot edhe falë mbështetjes 9 mijë fidanë. Nuk motivon djalin e Dashurisë në Dibër, që punon me pasion në punishten e jufkave dhe në fermë, ku shërben në bujtinë për vizitorët.

Bujqësia përtej shifrave të vetëpunësimit, informalitetit, nevojës për më shumë subvencionim, është bujqësia shqiptare e zhvillimit dhe e rritjes së produktivitetit. Toka jonë bëhet prodhuese me punën e fermerit, por edhe me dinjitet, me fjalët e këtij parlamenti për vetë bujqit, por edhe për fëmijët e tyre, që ju shohin e dëgjojnë nga televizioni. Le t'i japim respektin e duhur profesionit të tyre.

*(Diskutime nga salla pa mikrofon)*

Patjetër që ka probleme, për të cilat po punojmë shumë fort për t'i zgjidhur.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Prit, sepse duhet të më japësh çizmet!

Strukturat janë në terren.

Dua t'ju bëj thirrje se, kur vjen puna te bujqësia, të mundohemi ta njohim më shumë realitetin, të njohim politikën e përbashkët europiane drejt të cilës jemi të drejtuar, të njohim efektet klimatike, sepse agjenda *green deal* afekton edhe Shqipërinë, dhe të jemi proaktivë për sjelljen e problemeve në këtë hapësirë apo në Ministrinë e Bujqësisë.

U tha se ministrja nuk e njeh terrenin, por, së pari, mua më bëri ministre pikërisht terreni, si pika ime më e fortë, e një Shqipërie të prekur cep me cep e fshat më fshat.

Ju ftoj këtu të shikoni medien time sociale! Mos harroni të bëni *like* dhe *follow* dhe do të njihni Shqipërinë rurale nëpërmjet syve të mi.

I ndjek çdo ditë shqetësimet e sektorit.

Jam e qartë për dualitetin e bujqësisë shqiptare, e cila me zhvillimin e sektorit e bën

më të qartë ndarjen mes fermës produktive, që orientohet drejt eksportit dhe fermës që prodhon për vetëkonsum, e cila përmban efektin social në këtë sektor.

E kam ndjekur, patjetër, edhe shqetësimin e çmimeve në bujqësi, që ka ndikim në rritjen e kostove të prodhimit. Ndodhemi në një krizë të re të energjisë, e cila ka efekt në çdo sektor ekonomik ndërkombëtarisht. Ne i kemi analizuar faktorët që ndikojnë në vendin tonë, si: ndërprerja e zinxhirit të transportit ndërkombëtar si pasojë e papunësisë nga Covid19; pamundësia e ofertës për të përmbushur rritjen e jashtëzakonshme të kërkesës së menjëhershme; rritja e madhe e çmimit të energjisë dhe gazit; ndryshimet klimatike dhe ndotja atmosferike, e cila vazhdon të rrisë temperaturat dhe të prishë ciklet e prodhimit tradicional.

Me eksperiencën e tri vjetëve të fundit, ku tërmetin dhe pandeminë i përballuam dhe i shfrytëzuam në shërbim të zhvillimit, jemi gati ta kthejmë edhe këtë sfidë në pikë force në këtë moment.

Stabiliteti financiar i fermerëve tanë do të ruhet duke injektuar politika incentive në programin zhvillues të bujqësisë, si pjesë e buxhetit të vitit 2022. Konkretisht, do të mbështesim rritjen e prodhimit dhe sipërfaqes së punuar; do të mbështesim shtimin e sipërfaqes së serrave me standarde; do të mbështesim rritjen e certifikimit; do të mbështesim peshkatarët dhe akuakulturën, blektorët, fuqizimin e agropërpunimit, marketimin e prodhimeve bujqësore shqiptare; do të mbështesim me naftën pa akcizë mekanizimin dhe teknologjinë në bujqësi si dhe turizmin rural, si një katalizator dhe treg i zgjeruar për prodhimet e fshatit.

Do të vijojmë të investojmë në mbrojtje dhe në uji. Që uji të shkojë në parcelë, kushton shtrenjtë në të gjithë botë, jo vetëm këtu. Po mendojmë edhe mënyra alternative dhe inteligjente për ta kryer këtë së bashku me partnerët tanë, me Bankën Botërore, për më shumë infrastrukturë, kanale ujitëse dhe kulluese, për rritjen e sipërfaqes së të mbjellave dhe për përmirësimin e cilësisë së tyre.

Bujqësia sot zë vendin e tretë në totalin e eksporteve të vendit.

Meqenëse nuk preferohen krahasimet me 2013-ën, po bëjmë krahasime me 2017-ën. Totali i eksporteve bujqësore në vlerë, nga viti 2017 në

vitin 2020, është rritur me 30%. Perimet shqiptare të eksportuara, sipas Global G.A.P, janë rritur me 19% për 9-mujorin e fundit. Është rritur me 16,4% totali i eksporteve për 9-mujorin e fundit krahasuar me 1 viti më parë, dhe që deri në fund të vitit parashikojmë të arrijmë në 450 dollarë eksporte bujqësore. Kjo rritje ka ardhur nga puna e palodhur e fermerëve, por edhe për shkak të rritjes së konsiderueshme të investimeve në infrastrukturë, në energji, në kanale ujitëse, në rritje kapacitetesh përpunuese nëpërmjet shtimit të 250 pikave të grumbullimit në të gjithë Shqipërinë me standarde të BE-së dhe me mbi 700 njësi përpunimi.

Po orientojmë investimet në bujqësi, në përputhje me nevojat për më shumë investime në energji të rinovueshme, në menaxhim fermash të integruara, më shumë teknologji dhe inovacion në bujqësi.

Po ndërtojmë zyrën e eksporteve brenda institucionit të ministrisë, që do të ketë në fokus aksesin në tregjet e reja të produkteve shqiptare, forcimin e markës, si dhe thithjen e investitorëve të huaj, të cilët do të sjellin teknologji dhe dije në përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale në vend. Po marrim modelet e më të mirëve dhe do t'i adoptojmë.

Një komponent tjetër thelbësor i punës që po kryejmë është siguria ushqimore, e lidhur ngushtë me rritjen e standardeve të prodhimit konform rregullave të BE-së dhe praktikave më të mira në përdorimin e pesticideve, në funksion të shëndetit publik dhe të hapjes së tregjeve të reja.

Në këtë mandat siguria ushqimore do të marrë një dimension edhe më të rëndësishëm. Për këtë qëllim po punohet për vendosjen e detyrueshme të librit të fermerit, duke i dhënë mbrojtje nga abuzuesit, për ngritjen e urdhrin të agronomit, mekanizmave institucionale dhe ligjore për mbikëqyrjen dhe asistimin e fermerit në të gjitha fazat e prodhimit. Po vijon puna për akreditim të thelluar dhe forcimin e rrjetit të gjerë të laboratorëve.

Për të arritur këto objektiva, ne kemi nisur një proces reformimi tërësor me strukturat e Ministrisë së Bujqësisë, për të pasur një qasje të përditësuar, të formalizuar për gjurmueshmërinë dhe transparencën e origjinës së ushqimeve.

Sfida e vërtetë është që rigjenerimi i sistemit tonë prodhues bujqësor të përkthehet në

rritje produktiviteti për fermerët, që ata të gjenerojnë më shumë të ardhura, si dhe konsumatori shqiptar të ketë më shumë produkte të përpunuara në Shqipëri, me cilësi të lartë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Ina Zhupa.

**Bledjon Nallbati** – Zonja Kryetare, kërkoj fjalën.

**Lindita Nikolla** – Po, urdhëroni!

**Bledjon Nallbati** – Faleminderit!

Zonja Ministre, ju dëgjova me kujdes.

Së pari, kur fola për shifrat e investimeve, ju referova buxhetit faktit të vitit 2020, dhe për këtë ju tregova dokumentet e buxhetit që na keni sjellë ju, nuk nxora të dhënat e mia.

Nëse keni planifikuar të bëni investime në këtë buxhet, do t'i mirëpres dhe do t'ju falënderoj.

Unë jam nga ata që kam falënderuar kur janë bërë gjëra të mira. Ka këtu njerëz që e dinë, edhe deputetë, edhe përfaqësues të mazhorancës, dhe do të falënderoj sërish. Dakord?

Ju thatë se janë rritur eksportet. Kam vetëm një pyetje.

**Lindita Nikolla** – Nuk është për procedurë, ju lutem!

*(Zoti Nallbati flet pa mikrofon.)*

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Zhupa.

**Ina Zhupa** – Seanca e sotme nisi duke dëgjuar mashtime të mëdha nga numri dy i babëzisë, i cili foli për rindërtimin.

Më lejoni t'ju them disa të vërteta të mëdha për zonën e Kombinatit në Tiranë.

Nga pallatet e boshatisura, janë shembur 50%, ndërsa pallatet e tjerë janë bosh, si zona luftime. Ndërkohë, për pallatet e shembura është bërë vetëm një pastrim pjesor gjatë fushatës dhe janë ende gërmadha.

Shumë pallateve u janë dërguar letrat 2 vjet pas tërmetit, ndërkohë që kanë banuar në shtëpitë e tyre, duke u thënë se pallatet duhet të shemben, sepse përbëjnë rrezik. Si mund të përbëjnë rrezik 2 vjet më pas dhe nuk përbënin rrezik gjatë këtyre 2 vjetëve? Është shumë e thjeshtë. Kombinatin duan ta kthejnë në një zonë me sheshe të lira, për të ndërtuar oligarkët, të cilëve u është premtuar në zonën e Kombinatit.

Një pjesë e mirë e banorëve prej 4 muajsh nuk po marrin bonusin e qirasë me pretendimin se po kryhen verifikime. Mund të na thoni se

çfarë verifikimesh po kryeni, ndërkohë që u keni shembur pallatin, sepse ua keni dhënë më parë bonusin? Duhet të bënit verifikimet e duhura në kohë ose nuk duhet t'ua jepnit bonusin më parë.

Ndërkohë, keni bërë një marifet të ri. Ndryshuat administratorin e njësisë administrative nr. 6 në Kombinat, sepse administratori i parë bëri shumë premtime dhe mashtrime gjatë fushatës, dhe sapo dilte në rrugë, i thoshin: mbajti fjalët që premtove në fushatë! Ndërkohë, ato ishin vetëm mashtrimet e radhës. Tani keni vendosur si administratore një vajzë të re, e cila u thotë: “Unë dua kohën time për të parë dokumentet”, dhe banorët nuk po marrin bonus.

Në katet e para të pallateve të shembura ka pasur biznese të ligjshme, që paguanin taksa dhe tatime në Bashkinë e Tiranës; u vinte AKU-ja, paguanin sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, pra ishin të formalizuara. Në një moment ju harruat që i trajtonit si biznese, dhe i konsideruat si shtëpi. Kur erdhi momenti t'ua jepnit bonusin si shtëpi, nuk e morën, sepse kishin shtëpi tjetër, por ata kishin biznes. Ndërkohë, i latë pa punë dhe nuk u dhatë bonus, sepse kishin shtëpi dhe u ishin prishur vetëm bizneset.

Zëvendëskryeministri na shpjegoi 10 minuta se si do të bëhej bingoja e ndarjes së kateve të pallateve. Nuk kam asnjë dyshim që është ekspert i bingos, por nuk kemi arritur ende të kemi sheshet e ndërtimit të pallateve, jo më pallatet, që të ndahen katet e tyre.

Konkretisht, në Kombinat është caktuar një zonë, e cila njihet si ish-Kombinati Tekstil. Aktualisht, atje jetojnë banorë, që duan të shpronësohen. Nuk ka nisur ende shembja e godinave të vjetra, që të kthehen në një shes ndërtimi, e jo më të fillojë ndërtimi, të ndahen katet dhe banorët të kenë fatin të shkojnë në shtëpitë e tyre të reja.

Këto gjëra duhet t'i dijë shumë mirë edhe zonja Balluku, e cila përfaqëson zonën e Kombinatit, dhe jo të vijë këtu për të thënë se në Tiranë, nga rruga e pallatit me shigjeta deri te Bërryli, ka një distancë prej 12 minutash.

Zonja Balluku ndoshta ecën me eskortë, i hapin rrugën dhe mund ta bëjë edhe më shpejtë, por, kush jeton në Tiranë, e di shumë mirë se çfarë tmerri është trafiku i Tiranës, çfarë tmerri heqin çdo ditë qytetarët e Tiranës për të bërë

segmente edhe më të shkurtra, jo më nga pallati me shigjeta deri te Bërryli.

Për t'ua kthyer te buxheti, që në fakt është edhe çështja e ditës, por nuk mund të rrija pa folur për rindërtimin, sepse ishte pjesë e seancës, Shqipëria sot shpenzon më pak se çdo vend tjetër në Ballkanin Perëndimor për sa i përket arsimit. Të gjitha vendet shpenzojnë, së paku, 4% të GDP-së për arsimin, ndërsa ne shpenzojmë 2 herë më pak.

Kosova i ka bërë tarifata falas për të gjithë studentët, ndërsa ne paguajmë tarifa të plota edhe kur nuk bëhet mësim.

*(Bie gongu në sallë)*

Zonja Kryetare, e shkurtuat shumë kohën, megjithatë, unë po e tregoj edhe të fundit.

**Lindita Nikolla** – Ishte propozim i kryetarit të grupit.

**Ina Zhupa** – Ia kam thënë tri herë ministres së Arsimit, ia kam thënë në komision, ia kam thënë edhe nga Saranda se kampusi i ndërtuar me paratë e taksapaguesve në Sarandë, zonja Ministre, është bosh, sepse nuk u keni çuar banka dhe mjete arsimore. Ju lutem, çojuni fëmijëve të Sarandës! Por, nëse nuk e bëni për këta fëmijë, bëjeni, sepse Edi Rama ka vënë emrin e vet atje, “Edi” në krye të godinës, pra të paktën bëjeni për respekt të udhëheqësit tuaj, se ndoshta ka dëshirë ta shikojë emrin e tij nga satelitët.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Antoneta Dhima.

**Antoneta Dhima** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Të dashur qytetarë,

Viti 2020 ishte me shumë sfida sa i takon implementimit të buxhetit, pasi u desh të përballemi dhe të menaxhojmë dy ngjarje shumë të rëndësishme, atë të tërmetit të 26 nëntorit 2019, si dhe situatën e pandemisë COVID-19.

Shqipëria është një vend i vogël dhe nuk mund t'i përballojë katastrofat natyrore pa mbështetjen e miqve dhe të partnerëve tanë. Ishte Konferenca e Donatorëve për Shqipërinë, e cila u organizua në një kohë të shkurtër, që dha mbështetjen maksimale për procesin e rindërtimit të banesave, shkollave, kopshteve, si dhe institucioneve shëndetësore të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.

Të jeni të sigurt se asnjë tjetër, që prej vitesh pret për të ardhur në pushtet, nuk mund t'i përballonte me sukses këto goditje, që erdhën njëra pas tjetrës. Ka qenë dhe është vullneti i kësaj maxhorance dhe i Kryeministrit Rama që me përgjegjshmërinë dhe detyrimin për kujdesin ndaj njerëzve hap çdo ditë dyert për strehimin e tyre, hap dyert e shkollave dhe kopshteve për ofrimin e mësimdhënies me standarde, si dhe hap dyert për objektet shëndetësore për ofrimin e një shërbimi me standarde cilësore për qytetarët në zonat e dëmtuara.

Ishte domosdoshmëri që gjatë vitit 2020 të bëheshin disa akte normative, të cilat në të gjitha rastet u bënë për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve, bizneseve dhe zhvillimit të ekonomisë.

Buxheti faktik i vitit 2020 ka financuar 129 programe buxhetore dhe ka realizuar 604 produkte për 11 ministri të linjës. Në përgjithësi nga ministritë është evidentuar një performancë relativisht e mirë e realizimit të produkteve buxhetore, duke pasur parasysh vështirësitë e krijuara nga pandemia COVID-19, pasi ajo pati një efekt mbizotërues në ekonominë shqiptare dhe atë globale, si dhe efektet e tërmetit të nëntorit 2019.

Gjithashtu, edhe tregu i punës u ndikua ndjeshëm nga pandemia, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit 2020, por në gjysmën e dytë të vitit, si pasojë e rihapjes graduale të ekonomisë dhe masave të marra nga qeveria për subvencionimin e pagave dhe implikimet strukturore afatgjata për tregun e punës, një pjesë e punësimit u rikuperua.

Të ardhurat e përgjithshme publike arritën në 26,5% të prodhimit të brendshëm bruto, nga 27,4% që ishin në vitin 2019.

Shpenzimet e përgjithshme publike në terma nominalë gjatë vitit 2020 ishin 536,2 miliardë lekë, ose 44,3 miliardë lekë më shumë se në vitin 2019.

Deficiti fiskal në vitin 2020 arriti në 6,9% të prodhimit të brendshëm bruto, nga një mesatare prej afro 2% në tre vjetët e mëparshëm, megjithatë rezultoi më i ulët se kufiri ligjor prej 8,4% të prodhimit të brendshëm bruto.

Vlen të theksojmë faktin se borxhi publik gjatë vitit 2020 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjikë afatmesëm

për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Ndryshimet e domosdoshme ligjore të bëra gjatë vitit 2020 për taksat vendore synuan mbështetjen e subjekteve të prekura nga pandemia COVID-19, si dhe rehabilitimin e komuniteteve të prekura si pasojë e fatkeqësisë natyrore.

Nëse do t'u referohemi treguesve të vitit 2020, realizimi i investimeve në total ka qenë në nivele të larta, veçanërisht për financime të brendshme. Me buxhetin e vitit 2020 janë financuar dhe mbyllur rreth 369 kontrata investimesh me financim të brendshëm.

Qeveria shqiptare gjatë vitit 2020 ka bërë të mundur dhe ka siguruar mbështetje për shëndetësinë, mbështetje sociale për familjet në nevojë, mbështetje për punësimin dhe bizneset, ka marrë masat për nxitjen e punësimit, si dhe ka stimuluar ekonominë nëpërmjet fondit të garancisë sovraane.

Në zbatim të rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar për mbajtjen nën monitorim të PPP-ve dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vijuar monitorimi i performancës së kontratave koncesionare dhe PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar ecurinë e pagesave faktike buxhetore, si dhe treguesit e performancës së planifikuar dhe të realizuar për secilën kontratë koncesionare dhe PPP.

Në vijimësi, me anë të institucioneve përgjegjëse, duhet të përpiqemi të përmirësojmë të ardhurat tatimore nëpërmjet ngritjes së një sistemi më të drejtë, më të thjeshtë, më efikas dhe më transparent, i cili të nxitë rritjen ekonomike.

Për të gjithë ne e rëndësishme është se qeveria me buxhetin e vitit 2020 ka mbështetur me financime dy nga prioritetet kryesore, siç është rimëkëmbja e ekonomisë nga tërmeti dhe pandemia COVID-19.

Prandaj, të nderuar kolegë dhe kolege, ju ftoj ta miratojmë buxhetin faktik të vitit 2020.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Kreshnik Çollaku.

**Kreshnik Çollaku** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, e di që koha shtrëngon pak, por do të përpiqem shumë shkurt të them dy gjëra, pa hyrë në detaje.

Unë jam deputet i qarkut të Dibrës dhe përgjithësisht kam bërë fushatë në zonën e Matit. Ishte hera e parë që bëja fushatë për veten, edhe pse kam 30 vjet që bëj fushata për të tjerët dhe patjetër e dija çfarë kërkonin njerëzit në fushata. Ata kërkojnë punë, kredi, një bursë studimi, një mik këtu apo një mik atje. Mua gjatë gjithë fushatës sime ata qytetarë të Matit, që më votuan, në asnjë rast nuk më shprehën nga këto kërkesa, por në çdo vend ku shkoja më kërkonin dy gjëra: rrugë dhe uji.

Ajo është një ndër zonat më të pasura të këtij vendi dhe ata njerëz ecin mbi flori, mbi krom, mbi pasuri, nga të cilët pasurohen dhe shtojnë miliardat njerëz të tjerë në këtë vend, duke mbushur edhe buxhetin e këtij shteti.

Nuk e di nëse jeni futur në ato fshatra, besoj se kolegët socialistë të atij qarku e kanë bërë, pra ministrat apo drejtuesit i kanë shkelur dhe i kanë parë këto fshatra. Miqtë e mi, është turp t'ju them se ata njerëz jetojnë në kushtet e mesjetës, atje nuk ka rrugë për të ecur makinat, nuk ka rrugë për të çuar të sëmurët në spital. Ajo është një ndër zonat me cilësinë e tokës mbase më pjellore të republikës, por gjatë verës dhe në kohë të mbjellash atyre u thahen dhe u kalben të mbjellat. Nuk kanë ujë as për të pirë në shtëpitë e tyre e jo më të vadisin tokat, edhe pse është një zonë ku uji derdhet kot. Është një fshat që quhet Gurrë, që do të thotë burim uji. Ky fshat ka aq shumë ujë sa derdhet në lum dhe rrugëve, ndërsa ata ende vadisin me mjete dhe mënyra primitive të stërgjyshërve, sepse shteti mungon dhe nuk ka bërë investime për rrugë dhe për ujë.

Edhe kësaj radhe në këtë buxhet faktik që keni sjellë pashë që kishte zero lëvizje dhe zero investime për ta ndërruar atë gjendje katastrofike, ku ata banorë jetojnë pa rrugë dhe pa ujë.

Gjatë fushatës sime, e kam thënë këtu dhe çdo banori të Matit që kam takuar, këtë e di edhe njeriu që unë mendoj se duhet të ishte Kryeministri i këtij vendi, kryetari i partisë sime, zoti Lulzim Basha, për këtë janë dëshmitarë ata dhe zoti Basha. Unë besova se më 25 prill zoti Basha do të ishte Kryeministër i këtij vendi. E kam thënë hapur dhe po jua them edhe juve këtu, votën time nuk do ta kishte as qeveria e tij nëse

nuk do të fillonte investimin për të shëruar njëherë e mirë gjendjen e rrugëve dhe situatën e ujit në Mat.

Një studim i Bankës Botërore tregon se i gjithë rrethi i Matit, me të dyja bashkitë, të Burrelit dhe Klosit, pra çdo fshat për t'u lidhur me rrugë asfalti me akset nacionale koston maksimale nuk e ka më shumë se 40 milionë euro. Në Tiranë 40 milionë euro janë harxhuar vetëm për 2 kilometra rrugë. Çfarë i kushtonte kësaj qeverie për 8 vjet, që të gjitha menjëherë ose të ndara në kohë, ta realizonte këtë investim dhe ata njerëz në vitin 2021 të mos jetonin në kushtet e mesjetës.

Unë e di që është e vështirë, por sot dua t'u them në mënyrë shumë të sinqertë dhe pa dashur t'i vë në pozitë kolegëve të mi të maxhorancës së qarkut të Dibrës: bëjeni edhe ju një sforcim, ushtroni presion, nuk po them të votoni kundër, sepse e di që nuk do ta bëni, siç unë ia kam thënë Lulzim Bashës, mbase një ditë koha do ta tregojë dhe ju do ta shikoni këtë gjë: pa shëruar situatën e rrugëve dhe të ujit në Mat votën time nuk do ta ketë. Këtë ia ka thënë në Mat, por ua kam thënë edhe atyre njerëzve. Kështu erdhën gjërat. 25 prillin e sajuat siç dini, por gjejeni edhe ju forcën, ushtroni presion te këta njerëz që qeverisin, që t'i kthejnë sytë për të investuar në ato zona.

Në këtë sallë ne mund të flasim për gjeopolitikën dhe për satelitët, por më besoni, pas 4 vjetësh, nëse ne nuk ua kemi bërë pak më të mirë jetën atyre njerëzve që na kanë sjellë këtu, ne nuk kemi bërë asgjë dhe nuk i meritojmë këto mandate.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për Emilia Koliqi  
**Emilja Koliqi** – Të nderuar qytetarë,

Buxheti i vitit 2020 nuk ishte garantues i rritjes së qëndrueshme ekonomike, i punësimit, i përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesit të integritimit në Bashkimin Europian. Në fakt, kjo nuk është një surprizë për qytetarët shqiptarë, të cilët vazhdojnë t'i vuajnë pasojat e reformave të pamenduara mirë.

Instrumenti kryesor për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe reduktimin e varfërisë është rritja ekonomike. Ndërkohë që reklamoni stabilitetin makroekonomik dhe sukseset imagjinare, gjendja social-ekonomike në vend është në një pikë kritike. Rezultatet e

deritanishme të reformave ekonomike tregojnë tkurrjen e disa sektorëve të ekonomisë, zgjerimin e deficitit tregtar, rritjen e borxhit publik, rritjen e çmimeve etj.

Viti 2020 ishte një vit i vështirë për vendin tonë në tërësi, por veçanërisht ishte i vështirë për pushtetin vendor. Të ardhurat nga pushteti vendor u realizuan në masën 22 miliardë lekë, 82% ose 5 miliardë lekë me pak se plani fillestar i vitit 2020. Rënia e të ardhurave të pushtetit vendor ka ndodhur për shkak të një sërë faktorëve, si: përkeqësimi i gjendjes financiare të biznesëve dhe familjeve për shkak të pandemisë, por edhe të tërmetit të vitit 2019 në disa bashki të mëdha; lehtësimi i detyrimeve vendore në periudhën e fatkeqësisë natyrore për familje, për biznese dhe për kategoritë në nevojë, si dhe nga zhvendosja në kohë e pagesave të këtyre detyrimeve. Megjithatë, rënia relative e të ardhurave nga pushteti vendor ishte më e ulët se të ardhurat e tjera të buxhetit të shtetit. Ndërkohë, qeverisja qendrore nuk ka zbatuar dispozitat ligjore dhe nuk i ka kompensuar bashkitë për humbjet në buxhet për të gjitha ndryshimet në taksën e biznesit të vogël, si taksë lokale që nga viti 2016, dhe kjo u kushton bashkive 1/5-ën e të ardhurave të tyre të munguara për çdo vit.

Gjatë viteve 2018-2019 nuk u respektua ligji i financave vendore, duke mos u akorduar për 2 vjet rresht njësi vendore taksën e ndarë, 2% e tatimit mbi të ardhurat personale.

Paketa anti-COVID, e miratuar nga qeveria, kishte një vlerë prej 16,5 miliardë lekësh, por pushteti vendor nuk përfitoi asnjë lek, me gjithë performancën e mirë në drejtim të realizimit të të ardhurave për vitin 2020.

Po kush ishte afër qytetarëve? Bashkitë u përballën me një fluks të madh kërkesash nga familje dhe individë, të cilët kërkonin pako ushqimore, medikamente, pako dezinfektuese. Në kushte izolimi kishte familje dhe individë pa ndihmë, kishte grupe të marginalizuara me vështirësi të rënda ekonomike-sociale, kishte pensionistë, të cilët familjarët i kanë në emigracion ose jetonin vetëm, kishte persona me aftësi të kufizuar, të cilët nuk i kanë familjarët në moshë aktive pune, kishte familje dhe individë, që janë përfitues të ndihmës ekonomike dhe të asistencës, kishte familje me shumë anëtarë, që kryefamiljarët kanë punuar në të zezë dhe nuk

kishin asnjë të ardhur tjetër për të përballuar jetesën për shkak të izolimit. Ishin bashkitë ato që përballuan dhe i lehtësuan pasojat e kësaj fatkeqësie, si: dezinfektimin e të gjitha ambienteve administrative, të depove të ujit të pijshëm, të rrugëve kryesore, kanalizimeve, hapësirave publike, tregjeve dhe të gjitha institucioneve arsimore publike, përfshirë shkollat, kopshtet dhe çerdhet, si dhe pajisjen e tyre me mjete dezinfektuese.

Shërbimet që u prekën më shumë nga pandemia dhe rregullat mbrojtëse ishin: gjendja civile, marrëdhëniet me publikun, tarifrat dhe taksat vendore, aktivitetet kulturore e sportive dhe transporti publik.

Në mbështetje të ligjit për mbrojtjen civile, buxheti i shtetit, Ministria e Mbrojtjes, kishte për detyrë të akordonte 4% të totalit të buxhetit vjetor të bashkive për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësisë dhe mbrojtjen civile, por as ky fond nuk iu dha bashkive.

Meqenëse qeveria nuk u akordoi asnjë lek, në kushtet e mungesës së burimeve financiare, bashkitë vazhduan punën duke përdorur fondet e tyre modeste, të planifikuara për mbrojtjen civile dhe duke rishpërndarë fondet e tyre. Por rishpërndarja ishte në kurriz të investimeve, në kurriz të rritjes së standardit të shërbimeve publike.

Për vitin 2020 ka një realizim prej 89,7 % të shpenzimeve të pushtetit vendor në krahasim me planin fillestar.

Në raport me një vit më parë shpenzimet për investime patën një rënie me rreth 5 miliardë lekë ose rreth 28% më pak krahasuar me vitin 2019.

Mungesa e investimeve është një nga shkaqet kryesore për papunësinë, emigracionin e të rinjve, stanjacionin ekonomik dhe pasigurinë.

Me buxhetin e akorduar nga qeveria, që është vetëm 1% e prodhimit të brendshëm bruto, 61 bashkitë nuk mund të përmbushin një gamë kaq të madhe përgjegjësish, funksionesh dhe llojshmëri shërbimesh administrative dhe publike.

Si në të gjitha bashkitë e vendeve të rajonit dhe të Europës, pritej që bashkitë tona të kërkonin mbështetjen që u takonte për mjete financiare nga qeveria. Kjo nuk ndodhi për shkak të përkatësisë së njëjtë politike, gjë të cilën qeveria e shfrytëzoi shumë mirë, duke e

përqendruar të gjithë pushtetin ekonomik e politik në duart e saj në përballimin e pandemisë me tenderë sekretë, korruptivë, që asnjëherë nuk u bënë transparentë për publikun...

**Lindita Nikolla** – Të lutem, ju mbaroi koha!

Faleminderit!

Kalojmë në fjalën në emër të grupeve politike.

Fjala për Jorida Tabakun.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar qytetarë,

Unë besoj se nuk ka shqiptar që të mos e ketë kuptuar se çfarë ka ndodhur në sallën e parlamentit. Besoj se nuk ka shqiptar që të mos e ketë kuptuar se çfarë do të bëhet me 770 milionë euro, që janë marrë borxh dhe se çfarë do të ndodhë me fermerin, me mësuesin, me familjet shqiptare dhe me çmimin e energjisë elektrike.

Po marrim 770 milionë euro borxh, por a do të jemi më mirë apo më keq nesër? Nuk besoj se dikush nga qeveria arriti të japë një përgjigje për këtë, por besoj se është e qartë nëse lexojmë dhe shikojmë se çfarë ka ndodhur në vitin 2020. Për ta bërë këtë më lejoni të them tri shifra.

Në 8 vjet dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit të shtetit nga qeveria “Rama” është 7,2 miliardë euro. Çdo vit 500 milionë euro është kostoja e korrupsionit. Disa organizata ndërkombëtare thonë se është arritur në kapje të shtetit. E dini çfarë është kapje e shtetit? Kapje e shtetit është vendimi për TVSH-në. E ulën nivelin e TVSH-së, pasi bizneset e vogla falimentuan, por ishte një periudhë kohore, ku të gjitha bizneset e vogla u përfshinë në skemën e TVSH-së. Ajo ishte kapje e shtetit. I detyruan të dalin nga tregu, me qëllim që të gjithë konsumatorët të shkonin në qendrat e mëdha tregtare. Pra, jo propozimi i Partisë Demokratike për TVSH-në. Kapje e shtetit është vendimi që u mor për lojërat e fatit; kapje e shtetit është vendimi që ka marrë kjo qeveri për “Teatrin-Fusha”; kapje e shtetit janë pothuajse 9 ligjet e marra peng nga kjo qeveri, e thënë nga Kontrolli i Lartë të Shtetit dhe nga shumë raporte të tjera ndërkombëtare.

Çfarë shikojmë në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për buxhetin faktik? 4 fusha kryesore:

Së pari, buxheti i shtetit thuhet nga Kontrolli i Lartë të Shtetit, është kthyer në një fletore bakalli. Buxhetit të shtetit i janë bërë

2327 rishikime dhe rialokime me 50 miliardë lekë nga fillimi deri në fund të vitit.

Nuk ka asnjë pasqyrë të plotë se sa janë borxhet, cilat janë angazhimet, çfarë ndodh me kontratat koncesionare në fillim dhe në fund të vitit?

Ka shumë projekte që hapen dhe mbyllen në mes të vitit me pak fonde, duke krijuar presion edhe mbi investime të tjera të ardhshme.

Janë lidhur 500 kontrata pas 15 tetorit, në shkelje të ligjit. Buxheti i shtetit nuk duhet të zbatohet në 2 muajt e fundit të vitit.

Thuhet se janë bërë 7 raste prokurimi, kur për projektet nuk kishte fonde disponibël. Pastaj, vazhdojmë me perlat e tjera, si: fondet e dedikuara për përballimin e COVID-it janë përdorur për pagesat e internetit, për energjinë, për dieta, për ruajtje objektesh, këtë ka bërë qeveria. Prandaj, kur them që borxhi i marrë për pandeminë dhe për tërmetin do të ketë po këtë fat që kishte borxhi i marrë vitin e kaluar, nuk abuzoj fare, vetëm u referohem materialeve që vetë qeveria ka vendosur në faqen e saj të internetit.

Cilat janë katër fushat që tregojnë dështimin? PPP-të. Kontrata e koncesioneve ka arritur në 50% të produktit të brendshëm bruto vitin e kaluar.

Është bërë një analizë shumë e detajuar, të cilën ministrja e Shëndetësisë, që nuk është këtu, duhej ta lexonte, për të 4 kontratat koncesionare në sistemin shëndetësor, ku gjenden shkelje shumë të rënda.

Është dhënë pagesa për 2137 kontrolle *check up*-i, por nuk janë kryer.

Koncesioni i laboratorëve nga fillimi deri në fund është një procedurë me shkelje, është korruptive, i cili vazhdon të paguhet edhe sot. Laboratorët duhet të ishin ngritur, por nuk janë ngritur.

E njëjta gjë është edhe për setet e sterilizimit, ku janë paguar fondet, por shërbimi nuk kryhet.

E njëjta gjë është edhe me kontratat koncesionare në Elbasan, ku punohet me 20% të kapacitetit, por paguhet 99% të fondeve.

Në Fier nuk është hapur dhe nuk ka filluar operimi, ndërkohë janë paguar 99% të fondeve.

Kjo është situata që tregon raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e buxhetit, katastrofë. Në fakt, nuk prisja asgjë

tjetër, por më vjen keq për ata shqiptarë që kishin ende shpresë.

Për sa i përket energjisë, sektori i energjisë sot është në kolaps. Borxhet e këtij sektori po i paguan Ministria e Financave, e cila ka dalë garant. Që në vitin 2017 sektori energjetik ka paaftësi paguese. Kjo nuk lidhet as me rritjen e çmimeve jashtë dhe as me tregun ndërkombëtar, por me paaftësinë dhe korrupsionin që ka kapur të tre operatorët në sistemin energjetik.

Çfarë thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit për arbitrazhin, ku Shqipëria ka humbur 5 gjyqe me vlerë 388 milionë euro. “Agjencia Europiane ka njoftuar Republikën e Shqipërisë se ka filluar, - thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, bllokimin e aseteve të Shqipërisë”. Për këtë arsye ishte e nevojshme ngitja e komisionit hetimor për Beketin, që ju e ndaluar, por sigurisht që Gjykata Kushtetuese do të marrë një vendim për të.

Shifrat janë një kampanë alarmi; janë një kampanë alarmi për këta që firmosin, që për një pjesë të madhe përdoren si mburojë; janë një kampanë alarmi për shqiptarët; janë një kampanë alarmi për buxhetin e vitit aktual, por edhe për atë të ardhshëm dhe nuk njohin asnjë limitin, as pandeminë, as vdekjen, as sëmundjen, por e përdorin çdo gjë vetëm për korrupsion; janë një kampanë alarmi edhe për financat publike. Sot financat publike janë të rrezikuara e kërcënohen nga kontratat koncesionare dhe nga borxhi publik. Ne duhet të marrim masa sa nuk është vonë, që, në fakt, duhet të ishin marrë vite më parë. Por, me këtë dokument të prodhuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, besoj se, edhe ata kolegë socialistë që kanë një minimum arsye, që kuptojnë dhe marrin vesh nga shifrat nuk duhet ta miratojnë buxhetin faktik.

Buxheti i vitit të ardhshëm duhet të na shërbejë të gjithëve për ta ndryshuar. Ne mund ta vendosim të gjithë eksperiencën dhe ekspertizën tonë në dispozicion, sepse do të jetë një vit i vështirë, sepse familjet shqiptare do të vazhdojnë të varfërohen akoma më shumë, gjasat janë edhe më shumë se gjatë pandemisë. Jam e sigurt që nuk ka mbetur asnjë pikë vullneti politik për të marrë vendime për qytetarët dhe do të vazhdojë i njëjti diskutim nga të gjithë kolegët socialistë, por këtu bëhet fjalë për të ardhmen e të gjithë shqiptarëve. Këtu nuk është puna për 10 koncesione që mbron apo 10 kontrata që jepni dhe për ministrat që janë këtu.

Në fakt, isha shumë e çuditur, por edhe shumë kolegë socialistë për faktin që në zyrën e Kryeministrit po krijohen agjenci të reja, si: agjencia e medias, agjencia për fondet, agjencia e duam Shqipërinë. Pra, brenda Kryeministrisë po ngrihet një strukturë e tërë, që zëvendëson punën e të gjitha ministrive paralele dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave vijnë dhe thonë: “Do të përdorim fondin rezervë”. Pa filluar viti do të përdoret fondi rezervë për të paguar pagat.

Këtu e 8 vjet më parë është zhvilluar një diskutimi i jashtëzakonshëm përdorimin e fondit rezervë për përmblytjet, ndërkohë që sot, me një lehtësi të jashtëzakonshme, e përdorin gjatë vitit fondin rezervë sa herë të duan, ndryshojnë buxhetin, Kushtetutën dhe ligjet, sepse në fund të ditës për çfarë janë bërë, për t’u shkelur.

Unë i bëj thirrje të gjithë kolegëve këtu në parlament: thirrini arsyet, mos e miratoni, sepse po i hapni rrugë një kolapsi të financave publike, mungesës së transparencës, po i hapni rrugë shkeljes së buxhetit; po i hapni rrugë prishjes së të gjithë standardeve të transparencës që kanë ngritur financat publike, po i hyni një trajektoreje shumë të rrezikshme, që do të jetë me pasojë shumë të pakthyeshme për ekonominë shqiptare.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Të nderuar deputetë, ju lutem, procesi i votimit po përfundon, prandaj kush nuk ka votuar, të votojë tani.

Fjalën e ka zonja Anila Denaj në emër të Grupit të Partisë Socialiste.

**Anila Denaj** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një ditë e lodhshme, me shumë shifra, debate dhe diskutime, por, në fakt, e kemi obligim për qytetarët që t’ua përmbledhim shumë shkurt se çfarë ishte viti 2020. Në fakt, ata e dinë më mirë se ne sa i vështirë ishte ky vit për ta, për familjet, për bizneset, pra sa e vështirë është të përballosh, në disa zona, dy goditje: tërmetin dhe pandeminë për të gjithë Shqipërinë. Kjo situatë nuk është më pak e lehtë për buxhetin e shtetit, i cili, mund ta them me bindje, i tejkaloi edhe pritshmërinë që kishte në fillim të vitit për menaxhimin e situatës.

Dua të theksoj se janë vetëm 4 akte normative. U përmendën shumë shifra këtu, por, në fakt, shifrat për të gjitha kontratat tregojnë se sa shumë është punuar. Ne nuk kemi fjetur, por kemi punuar, kemi bërë kontrata dhe akte



normative edhe në orën 00:00 të natës, edhe në orën 02:00 të mëngjesit, sepse e kërkonte nevoja, emergjenca dhe domosdoshmëria për t'u ardhur në ndihmë të gjithë banorëve, të cilët jo vetëm të prekur nga tërmeti, por edhe nga situata e pandemisë kishin nevojë për ndihmë të menjëhershme. Prandaj nga këto 4 akte normative, 2 të parat janë totalisht të dedikuara për emergjencën.

Në Komisionin e Ekonomisë ne kemi diskutuar edhe për kontratat koncesionare, prandaj më vjen shumë keq që kolegët deputetë përmendin faktin që nuk u prekën, që nuk u negociuan dhe nuk u shtynë. Po, kontratat koncesionare janë shtyrë. Janë 4,5 miliardë lekë, të cilat janë negociuar në një kohë rekord brenda një periudhe gati 1- mujore dhe janë kursyer para nga buxheti i shtetit, 4,5 miliardë lekë, por janë kontratat, të cilat duhet të zbatohen sipas ligjit.

Sot flasim për kontrata koncesionare që në vitin buxhetor 2020 arritën një tavan, i cili shkoi deri në gjysmën e lejimit të tavanit sipas ligjit. Pra po flasim për 2,6%, kur tavanin i lejuar është 5% dhe po flasim për menaxhim efektiv.

Nuk dua të lë pa përmendur se në pjesë e parë të vitit ne dhamë ndihmën për 300 mijë individë, për 86 mijë biznese dhe mbështetjen indirekte që u është dhënë edhe shumë bizneseve të tjera nëpërmjet faljes së kamatëvonesave.

Pandemia nuk kufizoi vetëm lëvizjen e njerëzve, jetën tonë të përditshme, por edhe ekonominë, e cila brenda vitit 2020 e mori veten. Po flasim për një situatë të shtatorit, ku tregu i punës u kthye në të njëjtët tregues që ishte përpara krizës, pra u kthye në treguesit e shkurtit.

Po flasim për 2 akte normative, që pasuan pas dy akteve të para normative, ku rimëkëmbja e ekonomisë ishte fakt. Ky parlament ka miratuar akte dhe ligje shumë të rëndësishme, të cilat ndihmuan jo vetëm tregun e punës me tre paketa me ndihmë dhe subvencione të drejtpërdrejta, por nuk duhet të harrojmë edhe ndihmën në lehtësirat fiskale për 89 mijë biznese me zero tatime, për 8 vjet për tatimfitimin dhe rritjen e pragut të TVSH-së.

Të flasësh sot dhe të akuzosh që nuk është bërë asgjë, më vjen keq, por është turp! Është bërë shumë punë dhe shifrat flasin vetë, sepse janë kokëforte.

Ne mund të flasim për raporte internacionale, për KLSH-në, por të flasim edhe për raporte, të cilat sot në buxhetin faktik janë të lexueshme nga të gjithë ata që kanë pak, siç e thatë edhe ju zonja Tabaku, edukatë në financa.

Ne po flasim për një turrje të ekonomisë, e cila në mesataren e rajonit ishte me 3,6% dhe Shqipëria performoi shumë afër asaj mesatareje dhe ishte shumë larg, në kuptimin e mirë të fjalës, atij parashikimi që edhe institucionet ndërkombëtare kishin bërë. Besoj se e kujtoni në fillim të vitit që ishin minus 9%, minus 7,5% dhe vetë Ministria e Financave minus 6,1% dhe përfunduan një vit të vështirë, falë asaj pune dhe gjithë atyre akteve që ju përmendët, me një turrje me minus 4%.

Flasim për tregun e punës që, siç e thashë, sot është totalisht i rimëkëmbur.

Flasim për borxhin, i cili është në performacë shumë më mirë se parashikimi. Ne vitin e kaluar e parashikuam 80% borxhin publik, por sigurisht që e realizuam atë edhe më ulët se parashikimi ynë.

Ekonomia shqiptare sot është drejt rimëkëmbjes falë atyre investimeve në 2 akte normative, të cilat rritën investimet në shëndetësi, për t'i ardhur në ndihmë sektorit, investimet në infrastrukturë, të cilat nuk u ndërprejnë asnjëherë dhe kanë qenë një motor energjie për të rimëkëmbur ekonominë, por, mbi të gjitha, ndihmën ekonomike, ndihmën sociale, e cila u dyfishua për të gjitha shtresat në nevojë.

Nuk dua të lë pa përmendur sektorin bankar dhe financiar, sepse është shumë e rëndësishme të flasim edhe për këtë element.

Dua të falënderoj bashkëpunimin me Bankën e Shqipërisë, e cila, përtej faktit në funksionin e saj dhe me gjithë vëmendjen e saj, edhe në koordinimin me stimujt fiskal, arriti të vë në jetë një politikë me një sërë masash monetare dhe siguroi një stabilitet të tregut!

Nuk dua të lë pa përmendur mbështetjen e qeverisë me dy garanci sovraane, të cilat në shumën totale prej 260 milionë dollarësh ndihmuan biznesin, por edhe vetë sistemin bankar që të ketë një qasje proaktive ndaj bizneseve.

Stoku total i kredive pati një rritje në vitin 2020, një vit krize, e megjithatë kishte një rritje me 6,6% krahasuar me vitin 2019, ku, sigurisht, kredia në lekë pati rritjen kryesore me 7,3%.

Nuk mjafton me kaq, për ata që kanë kulturën minimale në financa, siç e tha zonja Tabaku, kemi edhe një përmirësim të dukshëm të treguesve të performacës së cilësisë së tregut financiar me ulje të raportit të kredive me probleme në 8,2%. Nëse i referohemi këtij viti kemi rekordin më të mirë vitet e fundit.

Në lidhje me politikën fiskale, ne mund të flasim pafund, por është shumë vonë për të folur për politikë fiskale. Sigurisht, nuk dua të flasim vetëm për zerimin e tatimit për bizneset e vogla, por ndërkohë ne vazhduam të stimulojmë sektorë të veçantë të ekonomisë.

Viti 2020 ishte viti me tatimitimin 5% për të gjithë sektorin e automotivëve, me nga 15 %, pra flasim edhe për stimuj edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë. Është shumë e lehtë të flasësh dhe të krijosh vetëm në kontekstin negativ, por është nevojshme që gjërat t'i them siç janë për të gjitha bizneset dhe individët.

Shtyrja e pagesave të detyrimeve tatimore ka qenë një stimul tjetër, i cili vërtet i krijoi buxhetit të shtetit një vështirësi, sepse mungoi një shumë e konsiderueshme në buxhet, gati 2 miliardë lekë, por, nga ana tjetër, krijuam lehtësi likuiditeti për të gjitha bizneset në një vit të vështirë. Arritëm në të ardhura buxhetore, që në vitin 2020 ishin 425,9 miliardë lekë, të cilat, në krahasim me një vit më parë, u reduktuan me vetëm 5 pikë përqindje. Shpenzimet e përgjithshme arritën në nivelin 636,5 miliardë lekë ose 9,1 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë.

Në lidhje me fondin e rindërtimit, ai është një fond, i cili erdhi nëpërmjet ndihmës së një programi të suksesshëm rindërtimi, i cili jo vetëm krijoi mundësinë e alokimit të fondeve buxhetore të menjëhershme, me një shumë prej 31 miliardë lekë të buxhetuara në fillim të vitit, por njëkohësisht edhe me një program buxhetor afatmesëm me 65 miliardë lekë, të cilat sot e në vijim do t'i shikojmë në vepra konkrete, me apartamente konkrete. Gjatë gjithë kësaj kohe nuk u la mënjanë asnjë individ, pasi çdo bonus qiraje është paguar dhe nëse ka çështje, të cilat krijojnë problematika për qytetarët, atëherë këto trajtohen në mënyrë individuale dhe jo në parlamentin e Shqipërisë.

Po, përmendët KLSH-në, përmendët një raport shumë të madh të KLSH-së, por nuk vlerësuat aspak vlerësimet që ishin raportin e

KLSH-së, ku kishte përmirësim të dukshëm të elementeve dhe treguesve të uljes së gjetjeve, të përmirësimit dhe të ndjekjes së rekomandimeve. Dua të përmend vetëm 3 elemente të rëndësishme që kanë vendosur KLSH-ja si rekomandime:

Së pari, ndjekjen e vazhdueshme të elementeve që evidentohen nga institucionet, si në pushtetin qendror, ashtu edhe vendor.

Së dyti, bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Kuvendin.

Së treti, zbatimin korrekt të të gjitha dispozitave.

Sigurisht, ky bashkëpunim nuk ka munguar, ka qenë dhe do të jetë në vijim.

Besoj se buxheti faktik i vitit 2020 është një buxhet për t'u miratuar, pasi shifrat janë të gjitha të konsoliduar edhe nga KLSH-ja dhe kjo nuk u tha këtu, si dhe është një buxhet i daljes nga një situatë e vështirë, e pazakontë, por që sukcesi është i padiskutueshëm dhe shifrat janë kokëforte dhe nuk e mohojnë atë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Këtu mbyllet diskutimi në parim edhe për këtë projektligj.

Më lejoni t'ju bëj me dije çështjen tjetër, për të cilën sot vetëm do të votonim, projektvendimin “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe procedurës së ndjekur nga organet ekzekutive në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane në Tiranë, Elbasan dhe Fier”. Për këtë projektvendim ju njoftoj se është arritur dakordësia mes dy krahëve politikë për sa vijon: titulli i projektvendimit ndryshon si më poshtë: “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”. Pikat 1, 2 dhe 4 ndryshojnë si vijon:

1. “Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”. Ky hetim do të synojë nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, garantimin e transparencës,

mbrojtjen e konkurrencës dhe të tregut të lirë, si dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për një mjedis të pastër.

2. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ana e organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane.

2. Verifikimi i pasojave ekonomike në buxhetin e shtetit shqiptar si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të organeve publike.

3. Verifikimi i efekteve mjedisore dhe pasojave mbi konkurrencën dhe tregun e lirë.

4. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave ligjore për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe parimit të mosdiskriminimit.

5. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave të përshtatshme ligjore për mbrojtjen e mjedisit.

6. Rekomandimi për marrjen e masave të përshtatshme, duke ndërgjegjësuar hallkat e administratës shtetërore për aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e mjedisit.

7. Vlerësimi i nevojës për përafrimin e legjislacionit për koncesionet dhe mjedisin me direktivat dhe praktikat më të mira të BE-së.

4. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar, i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, miratime, ndryshime apo korrigjime të kuadrit ligjor dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për fillimin e çështjes penale”.

Përbërja është:

Jorida Tabaku, kryetare

Ermonela Felaj, zëvendëskryetare

Arben Pëllumbi, anëtar

Eduard Shalsi, anëtar

Etjen Xhafaj, anëtar

Anila Denaj, anëtar

Fadil Nasufi, anëtar

Antoneta Dhima, anëtare

Besion Ajazi, anëtar

Edmond Spaho, anëtar

Helidon Bushati, anëtar

Dhurata Çupi, anëtare

Belind Këlliçi, anëtar

Luçiano Boçi, anëtar

Lefter Gështenja, anëtar

Anëtarë zëvendësues janë:

Jurgis Çyrbja

Denis Deliu

Luan Baçi

Ina Zhupa

Përpara se të kalojmë në shpalljen e rezultateve të votimit, kam edhe një njoftim për të bërë. Ju njoftoj se në Kuvend është depozituar akti normativ nr. 31, datë 27.10.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar”.

Në mbështetje të nenit 61, pika 2, të Rregullores, ju komunikoj rezultatet e votimit:

Për projektligjin “Për eurobondin, që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë”, rezultati i votimit është: 78 vota pro, 4 vota kundër, 33 vota abstenim.

Miratohet.

Për hyrjen menjëherë në fuqi të ligjit kanë votuar pro 78 deputetë, kundër 4 deputetë, abstenim 33 deputetë.

Miratohet hyrja menjëherë në fuqi e ligjit.

Rezultati i votimit në tërësi është: 78 vota pro, 4 vota kundër, 33 vota abstenim.

Miratohet.

Për projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2020”, rezultati i votimit në parim është: 76 vota pro, 41 vota kundër, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Rezultati i votimit në tërësi është: 76 vota pro, 41 vota kundër, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas, ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19”, rezultati i votimit në parim është: 78 vota pro, 3 vota kundër, 36 vota abstenim.

Miratohet.

Rezultati i votimit në tërësi është: 78 vota pro, 3 vota kundër, 36 vota abstenim.

Miratohet.

Për projektvendimin “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane”, rezultati i votimit është: 117 vota pro, asnjë votë kundër, 1 votë abstenim.

Miratohet ngritja e komisionit.

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, diskutime jashtë rendit të ditës. Për këtë pikë janë regjistruar deputetët...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, tërhiqen.

Atëherë, seanca mbyllet. Seanca e ardhshme do të njoftohet.

Faleminderit!

*(Seanca u mbyll në orën 19:30)*

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtori i Shërbimit të Redaktorëve  
Krenar Hajdëri**